




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2019



**XXIII  
INCOSAI**

---

Tiranë 2020

Adresa:  
**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë

Tel: ++355 (04) 251267

Fax: ++355 (04) 232491

E-mail: [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)

[WWW.klsh.org.al](http://WWW.klsh.org.al)



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORTI VJETOR I  
PERFORMANCES PËR VITIN  
2019**

**MARS 2020**

## Përmbajtja

<b>I. KLSH: Misioni, Vizioni dhe Objektivat.....</b>	<b>4</b>
<b>II. KLSH dhe aktiviteti i saj auditues për vitin 2019.....</b>	<b>7</b>
II.1 Fakte dhe statistika kryesore të veprimtarisë audituese.....	7
II.2 KLSH dhe Menaxhimi i Financave Publike.....	13
II.3 Auditimet financiare dhe të rregullshmërisë financiare.....	21
II.4 Auditimet e përputhshmërisë dhe të rregullshmërisë së aktivitetit.....	25
II.4.1 Auditimet e përputhshmërisë në Institucionet Qendrore.....	26
II.4.2 Auditimet e përputhshmërisë në njësitë e vetëqeverisjes vendore.....	32
II.4.3 Auditimet e përputhshmërisë në shoqëritë publike dhe projektet me financime të huaja.....	36
II.4.4 Auditimet e përputhshmërisë në fushën e menaxhimit të pronave.....	44
II.5 Auditimet e performancës.....	55
II.6 Auditimet e sistemeve të informacionit.....	74
II.7 Kallëzimet penale dhe proceset gjyqësore.....	84
<b>III. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit .....</b>	<b>86</b>
III.1 Komunikimi dhe Transparenca.....	86
III.1.1 Aktiviteti i KLSH në media.....	86
III.1.2 Prezenca e audituesve në median e shkruar.....	87
III.1.3 Trajtimi i letrave të qytetarëve dhe kërkesave për informim.....	88
III.1.4 Muaji i hapur.....	88
III.1.5 Konferenca YOUNG ALSAI dhe Revista Shkencore “Auditimi Publik”....	90
III.1.6 Botimet në KLSH gjatë vitit 2019.....	93
III.1.7 Faqja zyrtare e KLSH dhe gazeta online “Auditi për qytetarin”.....	96
III.1.8 Buletini statistikor.....	97
III.2 Bashkëpunimi i KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë.....	97
III.2.1 Monitorimi i Plan-veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit për vitin 2017.....	102
III.3 Marrëdhëniet e KLSH me OJF, Organizatat e profesionistëve të fushës, institucionet homologe dhe organizata ndërkombëtare.....	107
III.3.1 Bashkëpunimi me SAI-et partnere dhe institucionet ndërkombëtare ..	107
III.3.1.1 Pjesëmarrja e KLSH në Task-Forcat e INTOSAI-t.....	111
III.3.1.1.1 Takimi i V-të të Grupit të Punës së EUROSAT-t për “Auditimin e fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat” në Tiranë.....	112
III.3.1.1.2 Projekti me USAID-“Transparenca në sistemin shëndetësor”.....	113
III.3.1.1.3 Projekti “Forcimi i kapaciteteve në auditimin e prokurimeve publike, koncesioneve dhe PPP-ve”.....	114
III.3.1.1.4 Bashkëpunimi KLSH-SIGMA për vitin 2019.....	115
III.3.1.1.5 Vetëvlerësimi i integritetit- IntoSAINT”.....	115
III.3.1.1.6 Kongresi i XXIII-të i INTOSAI-t dhe aktivitete të tjera.....	117
III.3.1.1.7 Internshipi i ECA-s dhe Fellowship i GAO-s.....	120
III.3.2. Marrëdhëniet e KLSH-së me OJF-të, Organizatat profesionale të fushës, institucionet akademike etj.....	121
<b>IV. Menaxhimi institucional dhe zhvillimi strategjik .....</b>	<b>122</b>
IV.1 Performanca bazuar në kornizën e Indikatorëve të Matjes së Performancës.....	122

IV.1.1	Analiza e Performancës sipas Treguesve .....	122
IV.1.2	Përmbledhje e Treguesve të Performancës për vitin 2019.....	124
IV.2	Implementimi i Strategjive .....	130
IV.2.1	Monitorimi i Strategjisë së Zhvillimit 2018-2022 .....	130
IV.2.2	Monitorimi Strategjisë së Komunikimit 2017-2019 .....	135
IV.2.3	Monitorimi Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të KLSH-së .....	140
IV.3	Progresi i menaxhimit institucional .....	142
IV.3.1	Analiza SWOT e KLSH-së.....	142
IV.3.2	Zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve njerzore .....	149
IV.3.3	Trajnimet profesionale .....	157
IV.3.4	Teknologjia e informacionit në shërbim të KLSH dhe auditimet IT .....	162
IV.3.5	Sigurimi i cilësisë në procesin auditues .....	164
IV.4	Zbatimi i rekomandimeve të adresuara në Raport Progresin e KE-së publikuar në Prill 2019 .....	172
IV.5	Financat e KLSH dhe auditimi i tyre .....	179
IV.5.1	Treguesit buxhetor dhe Financiar të vitit 2019 .....	179
IV.5.2	Konkluzion i auditit të brendshëm mbi Pasqyrat Financiare 2019 .....	182
<b>V.</b>	<b>KLSH në shifra dhe grafikë: 10 vite (2002-2011) kundrejt 8 vite (2012-2019)</b>	
<b>VI.</b>	<b>ANEKSE .....</b>	<b>213</b>
A.1	Për zbatimin e rekomandimeve të adresuara në auditimet e mëparshme ...	213
A.3	Evidenca e dëmit ekonomik dhe fondeve pa efektivitetit sipas subjekteve ..	223
A.4	Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave drejtuar KLSH-së .....	228
A.5	Institucionet e audituara nga KLSH gjatë vitit 2019 .....	228
A.6	Pasqyrat financiare 2019 .....	232
A.7	Korrespondenca KLSH - Institucione kushtetuese mbi përzgjedhjen e Kryetarit të ri të KLSH.....	246

## I. KLSH: Misioni, Vizioni dhe Objektivat

Misioni kërkon që KLSH të jetë lider dhe të udhëheq nëpërmjet shembullit në sektorin publik, duke qenë një institucion i besueshëm, i pavarur e kompetent.

Gjatë viteve të fundit (2012-2019), KLSH ka ndërmarrë reforma që mbështesin përmirësimin dhe zhvillimin, për të zbatuar qasje të reja e dobiprurëse të auditimit, duke synuar modernizimin e institucionit e për të sjellë veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me standardet ISSAI dhe qëllimet strategjike të INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, si dhe për të kontribuar për një qeverisje të mirë, nëpërmjet luftës pa kompromis të rasteve sistematike të korrupsionit dhe parandalimit të tij.

Adresimi i rasteve të mashtrimit e keqpërdorimi të fondeve dhe pasurisë publike nga zyrtarët e çdo niveli të qeverisjes në organet ligjzbatuese kanë forcuar profilin e KLSH-së ndaj Parlamentit dhe ka krijuar besim tek qytetari shqiptar, si një hallkë aktive në zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit.

KLSH është përkushtuar që të ruajë dhe promovojë vlerat e shoqërisë së hapur dhe të menduarit kritik, vetë-reflektues. Ai synon përsosmërinë në zotërimin e njohurive dhe aftësive audituese, kulturën për të ndjekur zhvillimin profesional dhe krijimin e dijeve të reja si dhe angazhimin në promovimin e aplikimit të tyre në praktikën audituese, veçanërisht nëpërmjet implikimeve të tyre në rastet e korrupsionit dhe keqpërdorimit të fondeve publike. KLSH në përmbushje të misionit të tij ka zhvilluar dhe do të zhvillojë instrumenta dinamike drejt përsosjes së funksionimit, nëpërmjet vlerësimit objektiv të aktiviteteve, arritjeve dhe mangësive të tij.

KLSH synon të jetë një model i ri për auditimin publik rajonal, një qendër për studimin e sfidave bashkëkohore të auditimit në fushat ekonomike, sociale dhe politike dhe bazuar në analizën e “rrënjës” së faktorëve shkak-pasojë dhe një institucion, që udhëheq nëpërmjet shembullit për të sjellë vlerë dhe krijuar impakt pozitiv në jetën dhe dinjitetin e qytetarëve.

Misioni përbën boshtin i cili përcakton identitetin institucional që Kontrolli i Lartë i Shtetit ka krijuar përgjatë rrugëtimit të tij dhe që do të sigurojë qëndrueshmërinë në të ardhmen.

***Misioni: KLSH është institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që ti shërbejë qytetarit shqiptar, të jetë “agjent” i Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.***

Në përmbushje të misionit të tij dhe në zbatim të Ligjit nr.154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartët të Shtetit”, KLSH kryen auditime financiare, të përputhshmërisë, të rregullshmërisë, të performancës, të teknologjisë së informacionit, si edhe ndërmerr vlerësime të sistemit të menaxhimit financiar e kontrollit dhe njësisive të auditimit të brendshëm të strukturave qeveritare dhe enteve të tjera publike.

Vizioni ynë shkon përtej qasjes tradicionale të fokusuar në vlerësime dhe konstatime. Audituesit e jashtëm publikë e realizojnë aktivitetin e tyre jo vetëm duke vepruar por duke bashkëvepruar nëpërmjet rekomandimeve dhe këshillimeve të subjekteve publike të audituara për të maksimizuar vlerën e parasë publike. KLSH do të vazhdojë të veprojë si një agjent ndryshimi, në shërbim të qytetarit dhe të qeverisjes së mirë, duke reflektuar vlerat dhe parimet e një SAI modern, anëtar i komunitetit të INTOSAI-t i udhëhequr nga motoja “Të gjithë të bashkuar në ambicie dhe vendosmëri”.

Vizioni: **KLSH është një institucion model që udhëheq nëpërmjet shembullit, që nxit rritjen e përgjegjshmërisë, transparencës, dhe përdorimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të pasurisë publike, duke forcuar integritetin dhe besimin e publikut tek institucioni, për të qenë vlerë e shtuar për shoqërinë dhe të sjellë ndryshim në jetën e qytetarëve.**

Ndërsa, “**KLSH shërbestar i qytetarit**” është motoja e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2018-2022. Për vitin e kaluar 2019, në të cilin janë përcaktuar tre qëllime strategjike, është bërë zberthimi i tyre në objektivat përkatës.

Kështu, për qëllimin e parë strategjik “Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6E-të” janë përcaktuar si objektiva:

- Forcimi i pavarësisë dhe mandatit të KLSH;
- Auditimi mbi bazë risku – qasje efektive e auditimit;
- Kryerja e auditimit financiar në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit;
- Fokusi në rritje drejt auditimit të performancës;
- Thellimi në auditimin e Teknologjisë së Informacionit;
- Konsolidimi i auditimit të përputhshmërisë vlerësuar sipas kërkesat e ISSAI-ve
- Cilësia si prioritet i KLSH - përmirësimi i cilësisë dhe përfitimi nga auditimet e KLSH;
- Forcimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, rritja e nivelit të rekomandimeve të pranuar dhe të zbatuara;
- Rritja e impaktit të raportimeve nëpërmjet rritjes së përdoruesve të produkteve të KLSH-së; dhe
- Roli i KLSH-së në luftën kundër korrupsionit.

Qëllimi i dytë strategjik “Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese; procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse” ka si objektiva:

- Korniza e Matjes së Performancës - si mjet vlerësimi dhe faktor zhvillimi të veprimtarisë së KLSH-së;

- Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit të metodologjive dhe standardeve të aplikueshme në përputhje me praktikat më të mira të profesionit;
- Nxitja dhe promovimi i vlerave të larta profesionale të audituesve nëpërmjet kultivimit të kulturës të të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- Forcimi i sistemit të strukturuar të edukimit profesional nëpërmjet certifikimit të audituesve publikë dhe zhvillimit të vazhdueshëm;
- Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i dokumentit të politikave të burimeve njerëzore të KLSH-së.
- Integriteti si vlerë themelore
- Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për qëllimin e tretë strategjik “Përmirësimi i kanaleve të komunikimit dhe bashkëpunimit” është përcaktuar realizimi i objektivave;

- Konsolidimi i marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin;
- Roli i KLSH në axhendën e vitit 2030 për zhvillim të qëndrueshëm
- Implementimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i Strategjisë për komunikim të KLSH-së;
- Thellimi dhe shtrirja e bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Niveli i përmbushjes së objektivave, për vitin 2019, në funksion të përmbushjes së qëllimeve strategjike, është në përmbajtje të këtij Raporti Performance, dhe në mënyrë më të sintetizuar e gjeni në kapitullin e katërt, pjesa e dytë të Raportit.

## II. KLSH dhe aktiviteti i saj auditues për vitin 2019

### II.1 Fakte dhe statistika kryesore të veprimtarisë audituese

#### Treguesit kryesorë të aktivitetit auditues

Për periudhën janar – dhjetor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit nga 151 auditime të planifikuara ka kryer 160 të tillë, nga të cilët ka përfunduar dhe evaduar 140 auditime dhe 20 auditime në proces.

---

	<b>Auditime me opinion</b>
	- 42 auditime përputhshmërie
	- 23 auditime financiare
<b>Auditime sipas llojit</b>	<b>Auditime rregullshmërie</b>
	- 41 auditime financiare dhe ligjshmërie
	<b>Auditime performance</b>
	- 16 auditime performance
	<b>Auditime të sistemeve të informacionit</b>
	- 7 auditime IT
	<b>Auditime tematike</b>
	- 11 auditime tematike

---

Rezultatet e punës audituese të vitit 2019, janë raportuar në bazë të klasifikimit si dëm ekonomik<sup>1</sup> dhe si parregullsi/paligjshmëri me efekte negative në performancën e subjekteve nën auditim<sup>2</sup>.

---

<b>Shkeljet me dëm ekonomik</b>	<b>Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 27,304,777 mijë lekë ose 223.8 milionë euro.</b>
---------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

---

<sup>1</sup> Dëmi ekonomik në aktivitetin auditues i referohet, detyrimit të shpërblimit monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet autoritetit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në cenim të disiplinës financiare dhe kuadrit rregullator përkatës.

<sup>2</sup> Efekti negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike

---

**Indikatori i dobisë    Indikatori i dobisë së auditimit është 72.4**

(Indikatori është llogaritur si raport i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim nga KLSH në vlerën 27,304,777 mijë lekë me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 377,008 mijë lekë).

Në total janë konstatuar shkelje në shumën 157,816,371 mijë lekë ose afërsisht 1,293.6 milion Euro.

**Parregullsitë dhe paligjshmëritë me efekte negative në performancë**

Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën **130,511,594 mijë lekë**, afërsisht **1,069 milionë euro** nga e cila: **46,632,192 mijë lekë** në fushën e të ardhurave, afërsisht **382 milionë euro dhe 83,879,401 mijë lekë** afërsisht **687.5 milionë euro**, në fushën e shpenzimeve.

Parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara, i referohen përdorimit të fondeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet në fushën e prokurimit publik shoqëruar me mungesë kontrolli në realizimin e procedurave të prokurimit, të cilat në shumë raste rezultojnë të realizuara jo në përputhje me kuadrin ligjor. Një zë i rëndësishëm janë edhe shkeljet e disiplinës buxhetore në likuidimin e faturave për shpenzime/investime, keqmenaxhimin e fondeve të programuara i cili në çdo rast është shoqëruar me krijimin e detyrimeve të prapambetura.

---

Puna audituese është përqendruar kryesisht në fushat për të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka vlerësuar një nivel të lartë risku. Edhe këtë vit, shkeljet më të mëdha me efekte të konsiderueshme në buxhetin e shtetit lidhen me administrimin e të ardhurave; menaxhimin jo të kujdesshëm në procesin e përdorimit të fondeve publike; keqadministrimin e pronës shtetërore ndjekur nga paligjshmëritë procedurale dhe ineficencat në realizimin e procedurave të prokurimit publik.

Duhet theksuar se me impakt janë edhe shkeljet e lidhura me shkeljet në programimin, implementimin dhe zbatimin e kuadrit fiskal. Këto shkelje financiare përgjithësisht i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2016-2018 përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

Parregullsitë dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik prej 27,304,777 mijë lekë, dhe parregullsitë dhe paligjshmëritë me efekte negative në performancën e subjekteve të audituara, në shumën 130,511,594 mijë lekë, janë analizuar sipas fushave në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.1 Analiza e dëmit ekonomik/efekteve negative sipas fushave

Mijë lekë


Në fushën e të ardhurave	Dëm ekonomik	Parregullsi/paligjs hmëri
<b>Në fushën e zbatimit të Legjislacionit Tatimor</b>	113,650	42,105,458
<b>Në fushën e zbatimit të Kodit Doganor</b>	959,514	3,329,415
<b>Në keqadministrimin e pronës shtetërore të dhënë me qira, marrëveshjet hidrokarbure dhe kontratat koncesionare</b>	20,640,915	256,914
<b>Në administrimin urban</b>		244,557
<b>Të tjera</b>	3,397,540	695,848
<b>Totali</b>	<b>25,111,620</b>	<b>46,632,192</b>
<b>Në fushën e shpenzimeve</b>		
<b>Në fushën e pagave, sigurime dhe shpërblime</b>	8,028	348,911
<b>Në fushën e shpenzimeve operative</b>	416,013	24,334,774
<b>Në fushën e shpenzimeve për Investime</b>	1,678,989	50,487,166
<b>Të tjera</b>	90,127	8,708,550
<b>Totali</b>	<b>2,193,158</b>	<b>83,879,401</b>

Burimi: KLSH

#### Treguesi i dobishmërisë/Indikatori i dobisë së auditimit është 72.4

Indikatori i dobisë së auditimit, i cili përbën një element thelbësor të Kuadrit të matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, për periudhën Janar – Dhjetor 2019 rezulton 72.4, çka do të thotë se për çdo 1 (një) lekë të shpenzuar për KLSH-në nga buxheti i shtetit për periudhën Janar – Dhjetor 2019, janë zbuluar nga auditimet e kryera 72.4 lekë dëme për të cilat është kërkuar dhe arkëtimi i shumës. Treguesi i dobisë së auditimit është llogaritur si raporti i dëmeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdëmtim në vlerën 27,304,777 mijë lekë me shpenzimet buxhetore faktike të KLSH-së në vlerën 377,008 mijë lekë. Trendi i këtij indikator është paraqitur në grafikun nr.1.


Grafik nr.1. Indikator i dobisë së auditimit ndër vite



Burimi: KLSH

Duke lexuar dinamikën në 8 vitet 2012-2019, rezulton se mesatarisht për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së është kërkuar për t'u zhdëmtuar 82.2 lekë. Treguesi është 4 herë më i lartë po ta krahasojmë me periudhën 10 vjeçare 2002-2011 (mesatarisht 21.1 lekë).

Grafik nr.2 Krahasimi i indikatorit të dobisë 10 vjet (2002-2011) kundrejt 8 vjet (2012-2019)



Burimi: KLSH

### Institucionet ku janë ushtruar misionet e auditimit

Gjatë vitit 2019, auditimet janë shtrirë në 192 subjekte. Ato kanë përfshirë, institucione qendrore, ministri dhe agjenci (përfshirë drejtori qendrore dhe rajonale në varësi të tyre), njësi të vetëqeverisjes vendore (qarqe, bashki, komuna), drejtori të përgjithshme të administrimit fiskal, fonde speciale si dhe shoqëri aksionere me kapital shtetëror, në të cilën shteti ka mbi 50% të aksioneve, apo projekte me financim të huaj. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur shpërndarje e auditimeve sipas institucioneve.

Tabela nr.2 Shtrirja e auditimit sipas institucioneve

Lloji i institucioneve	Numri	Si % ndaj totalit	Fondet në mbulim auditimi
<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Institucione të qeverisjes qendrore, fondet speciale (ISSH dhe FSDKSH) dhe njësi varësie</b>	40	21%	Niveli i fondeve të mbuluara me auditim për këto dy lloje institucionesh është përkatësisht 100 % dhe 58 %.
<b>Institucionet e vetëqeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor</b>	31	16%	
<b>Shoqëritë publike dhe projektet me financim të huaj</b>	23	12%	
<b>Institucionet e administrimit të aseteve dhe mbrojtjes së mjedisit</b>	23	12%	
<b>Institucionet në të cilat janë kryer auditimet IT</b>	17	9%	
<b>Institucionet në të cilat janë kryer auditimet e performancës</b>	58	30%	
	192		

Burimi: KLSH

Në bazë të detyrimeve të ndërsjella kushtetuese midis dy institucioneve, KLSH për


vitin 2019, i ka përcjellë Kryetarit të Kuvendit dhe Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Raportet dhe Vendimet e Kryetarit të KLSH-së për 135 auditime të realizuara gjatë kësaj periudhe. Marrëdhënia dhe raporti institucional i KLSH-së me Kuvendin, në shërbim të interesit publik, ndërlihet ngushtësisht dhe kryesisht me Komisionin për Ekonominë dhe Financat, por edhe me Komisione të tjera, në funksion të tematikës që trajtojnë auditimet tona. Për këtë arsye, Vendimet/Raportet e auditimit i janë përcjellë kryesisht Komisionit për Ekonominë dhe Financat, por edhe Komisioneve të tjera të Kuvendit, referuar fushës që mbulojnë.

### Mbi rekomandimet e dhëna sipas natyrës


KLSH, gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, ka adresuar rekomandime për institucionet publike të audituara. Rekomandime për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, masa administrative dhe disiplinore gjithsej janë 3 441, nga të cilat: 100 janë përmirësime ligjore, 713 masa rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 2 628 rekomandime organizative.

Grafik nr.3 Masat e rekomanduara nga KLSH sipas llojit Janar- Dhjetor 2019


Përmirësime ligjore Rekomanduar/Pranuar




Masa organizative Rekomanduar/Pranuar



Masa disiplinore Rekomanduar/Pranuar




Masa administrative Rekomanduar/Pranuar



Burimi: KLSH

KLSH në 8 vitet e fundit, 2012-2019, ka rekomanduar gjithsej 30 964 masa për ndryshime apo përmirësime ligjore, organizative, masa administrative dhe disiplinore nga të cilat; 637 përmirësime ligjore, 10 594 masa rekomandime disiplinore dhe administrative dhe 19 733 rekomandime organizative.

Grafik nr.4 Masat e rekomanduara nga KLSH gjithsej Janar- Dhjetor 2019



Burimi: KLSH


### Kallëzimet Penale

KLSH nga auditimet e realizuara në vitin 2019 ka përcjellë 28 kallëzime dhe indicie penale, nga të cilat 25 prej tyre kanë përfunduar dhe i janë dërguar prokurorisë si kallëzime dhe indicie, 3 janë dërguar për vlerësim në Prokurori dhe 2 janë në proces shqyrtimi dhe vlerësimi nga Departamenti Juridik në KLSH.

KLSH në 8 vitet e fundit, 2012-2019, ka përcjellë 337 Kallëzime Penale për 999 persona. Numri i kallëzimeve penale në 8 vitet e fundit 2012-2019 (337) është 2 herë me shumë krahasuar me periudhën 10 vjeçare 2002 – 2011 (168) në grafikun nr.4.


Nga të dhënat e grafikut nr.4 dhe nr.5 del qartë se numri i kallëzimeve penale në 8 vitet e fundit 2012-2019 (337) është 2 herë me shumë krahasuar me periudhën 10 vjeçare 2002 – 2011 (168), ndërsa numri i personave të kallëzuar penalisht është 2 herë më i lartë .

Grafiku nr.5: Numri kallëzimeve penale 2002-2011 (10 vjet) kundrejt 2012 – 2019 (8 vjet)



Burimi: KLSH

Grafiku nr.6: Persona të kallëzuar penalisht për vitet 2002-2011 kundrejt 2012 – 2019



Burimi: KLSH

## II.2 KLSH dhe Menaxhimi i Financave Publike

Objektivi kryesor i veprimtarisë është përmbushja e misionit të KLSH-së, si një institucion i pavarur kushtetues, i ndërtuar që ti shërbejë qytetarit shqiptar, Kuvendit dhe palëve të interesit duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, përgjegjshmërinë qeverisëse si dhe tregojnë efektivitetin e përdorimit të parave të taksapaguesve shqiptarë, objektiv që është realizuar pavarësisht vështirësive që shoqëruan aktivitetin auditues në këtë vit sfidues.

Gjatë vitit 2019, KLSH, ka përmbushur me sukses misionin e tij të përgatitjes së “Raportit të Zbatimit të Buxhetit për vitin 2018”, raport i cili është dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë në tetor 2019, duke sjellë një material profesional, me një analizë të thelluar të risqeve të financave publike dhe adresime të kujdesshme për ndërhyrje në drejtim të mirëmenaxhimit fiskal. Ky opinion është rezultat i auditimeve të realizuara në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, Drejtorinë e Koncesioneve, Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorinë e Kontraktiveve dhe Financimeve të fondeve të BE, BB dhe donatorëve të tjerë, të gjitha njësi në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Institucione të tjera qendrore, njësi të vetëqeverisjes vendore si dhe shoqëri publike dhe projekte me financim të huaj.

Opinionin e auditimit është i bazuar në një mbulim të kujdesshëm për të qënë sa më afër plotësisht të standardeve të auditimit në formulimin e opinionit të auditimit në zbatim të buxhetit në referencë të ISSAI. Në paraqitjen e mëposhtme, jepet niveli i mbulimit dhe niveli i devijimeve mbi të cilët është bazuar opinionin e KLSH, lidhur me zbatimin e buxhetit.

*Niveli i mbulimit dhe niveli i devijimeve mbi të cilët është bazuar opinionin e KLSH*

	<b>Niveli i mbulimit</b> <i>(mijë lekë)</i>	<b>Niveli i devijimeve</b> <i>(mijë lekë)</i>
<b>Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit</b>	<b>194,959</b>	<b>17,670</b>
Fondi rezervë dhe kontigjenca	1,500	
Fondi I të përndjekurve	1,000	
Shpenzimet për interesa	36,513	
Huamarrje e brendshme	19,591	
Huamarrje e jashtme	83,761	
Ripagesat e borxhit të jashtëm	51,678	
Mbështetje Buxhetore	916	
<b>Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit</b>	<b>71,552</b>	<b>53,430</b>
Investimet kapitale me financim të brendshëm	51,552	
Detyrimet e prapambetura	20,000	
<b>Drejtoria e Kontraktiveve dhe Financimeve CFCU</b>	<b>26,210</b>	<b>121</b>

Investimet e huaja	26,210	
<b>Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor</b>	<b>40,154</b>	<b>1,891</b>
Shpenzime sociale për sigurime shëndetësore	40,154	
<b>Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve</b>	<b>24,395</b>	<b>41,706</b>
Rimbursim TVSH përfshirë Det. Prap	24,395	
<b>Drejtoria e Koncesioneve</b>	<b>161,448</b>	<b>1,389</b>

*Burimi: KLSH*

Përgjatë punës audituese, në funksion të misionit kryesor KLSH ka adresuar risqet potenciale dhe reale në menaxhimin e financave publike, shoqëruar me rekomandime të cilat në gjykimin tonë kërkojnë një lexim të kujdesshëm jo vetëm nga ekzekutivi, por edhe nga Kuvendi.

**1. KLSH, vijon të theksojë nevojën për një proces buxhetimi kredibël, se buxhetimi optimist i të ardhurave sjell programim jo real të shpenzimeve që shoqërohet më pas me shkurtime buxhetore dhe krijim detyrimesh të palikujduara.**

Kredibiliteti nuk gjykohet si një mjet për tu përqasur në buxhete statikë, por si një proces ku ndërhyrjet të jenë jo vetëm të nevojshme dhe si rrjedhojë e variablave të qartë të ndryshimit por ajo që është më e rëndësishmja të realizohen në kohë për të qenë në kuptimin e plotë dhe të gjerë të fjalës programim. Në këtë kontekst është kërkuar që procesi buxhetor si nivel afatmesëm dhe ai vjetor të mos shihen si procese formale, në respektim të afateve kohore dhe kornizës ligjore por të shikohet si një proces kompleks dhe i thelluar për një programim sa më realist të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore në plotësim të objektivave strategjik qeverisës, për menaxhim të kujdesshëm të financave publike, ruajtjes së treguesve fiskale dhe njëkohësisht në rritjen e investimeve dhe nxitjen ekonomike. KLSH, gjatë auditimeve të 2019 ka konstatuar se në vitin 2018, PBA 2018-2020 as nuk është hartuar dhe as nuk është paraqitur për miratim në Këshillin e Ministrave.

**2. KLSH, kërkon vëmendje maksimale për një menaxhim të kujdesshëm të fondeve që programohen për investime publike, pasi ky proces shoqërohet me anomali materiale dhe të përhapura me efekte si në cilësinë e investimeve të përfituara edhe në krijimin e detyrimeve të prapambetura.**

Kemi konstatuar se vijon e njëjta praktikë buxhetore, ku realizimi i investimeve bëhet në tremujorin e fundit duke arritur pikun në muajin dhjetor shoqëruar me deviacione nga kuadri rregullator në fuqi. Nga auditimet e vitit 2019, janë konstatuar se në 2018, shpenzime për investime publike të kryera në kushtet e paligjshmërisë procedurale kështu: 2,238 milion lekë si rrjedhojë e problematikave të përgatitjes së projektit “Përmirësimi i Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, 850 milion lekë projekte investimi pa përshkrim projekti në kundërshtim me ligjin; 428 milion lekë projekte të reja të cilat nuk kanë kaluar në procedurat e miratimit të investimeve publike, 122 milion lekë vlerë totale e kontratave të lidhur pas datës 15.10.2018 në kundërshtim me dispozitat ligjore. Gjithashtu, për shkak të hapjes së projekteve të reja pa mbyllur ato të vjetrat dhe

me rialokime të fondeve në destinacione të ndryshme nga ato të programuara në fillim, KLSH, ka kërkuar të mos ketë investime të reja pa përmbyllur investimet që janë në proces, si dhe e rëndësishme është zbatimi i radhës së pagesave për këto lloj detyrimesh. Kemi konstatuar se janë transferuar fondet nga njëri projekt investimi në tjetrin brenda të njëjtit program buxhetor në vlerën për 275 milion lekë. Nga auditimi me zgjedhje të kampionit, u konstatua se, me miratimin e Nëpunësit të Parë Autorizues, janë bërë sistemime/saktësime/ndryshime emërtimi të projekteve të investimit në vlerën 545 milion lekë, kompetencë që në bazë të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, i takon Ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

### **3. KLSH, thekson se risku që i vjen financave publike dhe qëndrueshmërisë fiskale të vendit, nga kontratat koncesionare/PPP është i lartë.**

Nga auditimet përgjatë vitit 2019, ka rezultuar se pagesat faktike për koncesionet/PPP për vitin 2018 janë në shumën 8,761 milion lekë (pa përfshirë detyrimet e prapambetura të konstatuara në kontratat koncesionare/PPP në sektorin e shëndetësisë të krijuara në FSDKSH), ndërkohë që vetëm për 9-mujorin e vitit 2019 pagesat e kryera janë 10,222 milion lekë. Kemi theksuar nevojën që projeksionet për të ardhurat tatimore të jenë konservatore për sa kohë në vlerësimin e respektimit të kufirit prej 5%, impakton edhe niveli i rritjes së të ardhurave tatimore, si emërues i këtij treguesi. KLSH ka konstatuar se për vitin 2018 është respektuar kufiri i pagesave për koncesionet/PPP në raport me të ardhurat tatimore. Nga ana e jonë, vlerësohet e domosdoshme respektimi i këtij kufiri për të gjithë kohëzgjatjen e kontratave koncesionare/PPP për vitet në vazhdim, sipas flukseve të projektuara saktë me qëllim vlerësimin e drejtë të respektimit të kufirit ligjor përpara miratimit të kontratave të reja koncesionare/PPP. Gjithashtu, KLSH sugjeron për vëmendje maksimale mbi normën e rritjes së të ardhurave për efekt të respektimit të kufirit të 5% përgjatë periudhave koncesionare të kontraktuara.

Kemi konstatuar se, koncesionet/PPP nuk janë të integruara në procesin e menaxhimit të investimeve publike ndërkohë që konstatohet mungesa e një strategjie të qartë të përdorimit të tyre (si instrument) për financimin e nevojave për të mira dhe shërbime publike. Në 3 nga 6 projektet e audituara konstatohet se kostot që rrjedhin nga projektet koncesionare/PPP nuk janë të planifikuara në projekt-buxhetin përkatës të miratuar nga Parlamenti, duke angazhuar fonde për vitet e ardhshme buxhetore pa marrë autorizimin përkatës. Nga ana tjetër, në asnjë nga projektet e audituara nuk justifikohet argumentimi i përdorimit të koncesionimit/PPP përkundrejt prokurimit sipas kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi për këto financime, duke mos garantuar vlerën më të mirë për para për sektorin publik. Monitorimi i kontratave koncesionare, deri tani ka rezultuar jashtë kontrollit shtetëror dhe me problematika të shumta, duke përfshirë në mënyrë të konsiderueshme materializimin e risqeve të marra përsipër që në studimet e fizibilitetit pa i kuantifikuar në terma monetare. KLSH ka kërkuar ndërhyrje të menjëhershme për rishikimin e ligjit për koncesionet, duke synuar një përafrim të plotë me kuadrin rregullator evropian sidomos në ato aspekte ku devijimet janë më të mëdha dhe hapësirat lejojnë pranimin e propozimeve të pa kërkuara në masë të gjerë dhe për sektorë të rëndësishëm si ai i porteve, aeroporteve, energjisë elektrike

dhe asaj të rinovueshme. Gjithashtu, referuar fakteve dhe ngjarjeve të deklaruara mbi këto kontrata, si dhe faktit që mundësia e kontroleve shtetërore është e limituar, është kërkuar të sanksionohet në ligj që në kontrata të tilla të rëndësishme të mos marrin pjesë kompani që operojnë në sisteme off-shore apo që nuk kanë historik të mjaftueshëm të aktivitetit dhe eksperiencës në fushat ku konkurojnë për të fituar të drejtën e koncesionarit, kjo për të garantuar performancë sa më të lartë në ofrimin e shërbimeve të kërkuara prej tyre, situatë për të cilën Autoritetet Kontraktore mbajnë përgjegjësinë më të madhe. Në përfundim për dy nga kontratat PPP, në fushën e infrastrukturës rrugore nga KLSH është kërkuar anulimit i këtyre kontratave.

Me qëllim transparencën e informacionit financiar të publikuar nga sektori publik, KLSH, ka rekomanduar aplikimin e standarteve ndërkombëtare për klasifikimin dhe raportimin e kontratave koncesionare/PPP, duke qenë se pesha e tyre si përqindje ndaj PBB është rritur ndjeshëm. Në gjykimin tonë, trajtimi i kontratave koncesionare/PPP, si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, do të rrisë transparencën në lidhje me treguesit makroekonomikë kryesorë duke përfshirë edhe stokun e borxhit publik ndaj prodhimit të brendshëm bruto. Në të kundërt, referuar kushteve aktuale të raportimit financiar në sektorin publik në Shqipëri, cilësia e informacionit financiar do të denatyrohet duke shfaqur anomali në kohën e raportimit të krijimit të asetit (duke e lidhur atë me periudhën e pagesave buxhetore) dhe njëkohësisht mbi nivelin e detyrimeve të shtetit (duke nënvlerësuar apo mos raportuar detyrimet që rrjedhin nga këto kontrata).

Nga auditimet e ushtruara (gjatë vitit 2019 dhe më parë) lidhur me zbatimin e kontratave koncesionare/PPP që janë në fuqi, kemi arritur në përfundimin se monitorimi i kontratave koncesionare, deri tani ka rezultuar jashtë kontrollit shtetëror dhe me problematika të shumta fakt që ngre problemin e cilësisë së përgatitjes së kontratës dhe indikatorëve të matshëm mbi monitorimin e shërbimeve për të cilat janë lidhur këto kontrata. Përmendim kontratat e shërbimeve shëndetësore, inceneratori, apo HEC.

#### **4. KLSH, ka tërhequr vëmendjen për nivelin e rritur të detyrimeve të prapambetura të cilat kanë ndikim në ngadalësimin e rritjes ekonomike dhe rritjen e papunësisë, për sa kohë bizneset e varura nga kontratat qeveritare pushojnë ose shtyjnë aktivitetin e tyre si rezultat i vonesave në pagesa.**

Më vlerësimin e KLSH, detyrimet e prapambetura janë të paktën 20 miliardë lekë në fund të vitit 2018 (pa përfshirë rimbursimin e TVSH dhe detyrimet e prapambetura të FSDKSH). Vlera e detyrimit për TVSH të rimbursueshme rezulton të jetë në shumën 20.7 miliard lekë në fund të vitit 2018 dhe ajo në FSDKSH rezulton të jetë në shumën 1.2 miliard lekë. Në krahasim me një vit më parë konstatohet një rritje me 12 miliard lekë nga 30 miliard të vlerësuar nga KLSH në fund të vitit 2017.

Nga ana tjetër, KLSH ka konstatuar se vendimet gjyqësore të formës së prerë nuk kontabilizohen si detyrime dhe nuk pasyroheshin si shpenzime. Në shumë institucione nuk ekziston databaza e vendimeve gjyqësore në mënyrë që nga ana e KLSH të raportohet efekti i detyrimeve si pasojë e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë. Efekti i pagesave të kryera nga Buxheti i Shtetit për vitin 2018 për largim të padrejtë të punonjësve nga puna nëpërmjet llogarive të

shpenzimeve operative vlerësohet në rreth 1.6 miliard lekë dhe për vendime të tjera gjyqësore në rreth 0.8 miliardë lekë. Nga ana tjetër, sipas raportimit nga MFE të gjendjes së detyrimeve të prapambetura konstatohet se këto pagesa të kryera gjatë vitit nuk pasqyrojnë gjendjen reale të këtyre anomalive të identifikuara, pasi stoku i detyrimeve të prapambetura deri në 31.12.2018 llogaritet në rreth 3 miliard lekë. Duke ju referuar institucioneve më problematike buxhetore të cilat kanë ekzekutuar pagesa për punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna të konstatuara me vendim gjyqësor konstatohet se 10 institucione përbëjnë edhe rreth 50% të pagesave, kryesuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë etj.

KLSH, parashton rëndësinë e zbatimit të menjëhershëm të vendimeve gjyqësore dhe futjen e tyre në procesin e ekzekutimit buxhetor, duke marrë parasysh efektin e mundshëm në vitet e ardhshme në formën e detyrimeve të prapambetura nga njëra anë dhe trajtimin e plotë të përgjegjësisë në lidhje me vendimmarrjen me kosto financiare të nëpunësve publike, në të njëjtën linjë me kërkesën e vazhdueshme për hartimin dhe miratimin e ligjit “Për përgjegjësinë materiale”. Nga ana tjetër, mos zbatimi i vendimeve gjyqësore për rikthim në punë sjell si pasojë akumulimin e detyrimeve, pasi është konstatuar se ekzistojnë vende vakante dhe në të njëjtën kohë nuk rikthehen në punë ish-punonjësit e larguar padrejtësisht. Nga auditimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, mbi pagesat e bëra, për shlyerjen e detyrimeve ndaj ish punonjësve të larguar nga puna është konstatuar mos respektim i radhës së pagesave sipas parimit “First In First Out” (FIFO). Komisioni i Posaçëm “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil” nuk ka vepruar dhe nuk ka ushtruar kompetencat në përputhje me dispozitat dhe afatet ligjore, duke lënë të patrajtuara për vite, 126 praktika gjyqësive, ndërkohë që gjatë vitit 2018 numri i vendeve vakante në administratën tatimore qendrore ka variuar nga 179 vende vakante në janar 2018 dhe 173 vende në dhjetor 2018. E njëjta situatë është konstatuar edhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Pavarësisht kostos financiare, këto shmangie nga kuadri rregullator në fuqi konstatohet se krijojnë kushtet për një performancë më të dobët të institucioneve publike, krijuar nga një paligjshmëri e akumuluar ndër vite.

#### **5. KLSH ka kërkuar një kuptim të drejtë dhe zbatimin e kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin nga institucionet publike, kjo duke synuar ngritjen e sistemeve efektive të kontrolleve të brendshme me ndikim në performancës e administratës publike.**

KLSH ka konstatuar se në praktikë ka një lexim të ndryshëm nga entet publike, të fushës së zbatimit të këtij ligji, ndërkohë që strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë janë të ngarkuar me çdo detyrë tjetër përveç atyre që kërkon ligji për monitorimin dhe raportimin e drejtë të situatës. Nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2018, lidhur me ecurinë e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit duke reflektuar një kuadër jo të plotë rregullativ të miratuar pas ndryshimeve strukturore të ndodhura, mungesa

të strategjisë për menaxhimin e riskut, nuk dokumentojnë mbledhjet e GMS, nuk hartojnë gjurmët e auditimit dhe nuk ka stafe të trajnuar mjaftueshëm për zbatimin e MFK. Konstatohet se ka përpjekje për plotësim formal të kërkesave ligjore lidhur me dokumentacionin, por që praktikisht janë larg proceseve që garantojnë implementimin e sistemeve efektive të kontrollit. Kur flitet për strukturat e AB, nevojat për pavarësinë e këtyre strukturave është imediate shoqëruar me ngritje të kapaciteteve njerëzore.

## **6. Raportimi financiar në sektorin publik, vijon të jetë jashtë vëmendjes së duhur të strukturave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, pavarësisht se nevoja për një informacion të drejtë dhe të plotë financiar lidhet me cilësinë e vendim-marrjes qeverisëse.**

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të shtetit, edhe për këtë vit, nuk janë pjesë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit. Mungesa e pasqyrave të konsoliduara të shtetit, sic kemi vite që e cilësojmë, ndikon jo vetëm në nivelin e transparencës, por është e lidhur ngushtë me analizën e treguesve makroekonomik. Konstatohet se me ndryshimet e fundit të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, nuk ka bazë ligjore mbi të cilën realizohet Raportimi Financiar, fakt që krijon jo vetëm mangësi në mbajtjen e kontabilitetit nga njësitë që duhet të raportojnë mbi bazë të standardeve të kontabilitetit publik, por krijon edhe pamundësi për KLSH që të dali me një opinion financiar për pasqyrat e qeverisë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, vijon të mos ketë një listë të plotë të gjithë institucioneve buxhetore dhe jo buxhetore, bilanci i të cilave është pjesë e Pasqyrave të Konsoliduara të Shtetit.

## **7. Problematikat më të mprehta të evidentuara nga auditimet deri në Dhjetor të vitit 2019 në fushën e prokurimeve publike në entet shtetërore publike, të cilat kërkojnë ndërhyrje dhe përmirësime të ligjit aktual për prokurimet publike.**

Për këtë mendojmë që drejtimet kryesore më të rëndësishme në të cilat mund të fokusohen përmirësimet ligjore në fushën e prokurimeve publike duhet të jenë:

a) Nisur nga numri i lartë i procedurave të prokurimit me një pjesëmarrës dhe fitues njëkohësisht, kërkohet domosdoshmërisht ndryshimi i ligjit në vlefshmërinë e procedurave të prokurimit në jo më pak se dy operatorë ekonomik pjesëmarrës që plotësojnë kriteret e kualifikimit.

Nga analiza e të dhënave për vitin 2018 rezulton se nga 8400 procedura (me vlerë mbi 800,000 lekë) të shpallura nga sistemi elektronik i prokurimit, 2353 procedura janë anuluar dhe 6047 kanë vazhduar, ndërkohë që 5116 prej tyre ose 61% kanë përfunduar me fitues.

Numri i procedurave të prokurimit publik të përfunduara me një operator dhe finalizuar me lidhje kontrate janë 1686 ose 33 % e numrit tyre, me vlerë 35,214,459,376 lekë ose 27 % e vlerës gjithsej të fondeve të prokurimit.

Autoritetet kontraktore: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) SHA, Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH SHA); Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit; ALBCONTROL SHA (ish ANTA) dhe Agjencia e Blerjeve

të Përqendruara kanë prokuruar 75% të fondeve të prokurimeve me një pjesëmarrës në garë dhe fitues njëkohësisht, të cilat përbëjnë 19% të numrit total të procedurave të prokurimit.

Përfundimi i procedurave të prokurimit me një pjesëmarrës jo vetëm ka ulur ndjeshëm konkurrencën e pjesëmarrësve dhe për pasojë efektivitetin në përdorimin e fondeve publike, por çon gradualisht në krijimin e monopoleve në tregun e prokurime publike për sektorë të ndryshëm, por kryesisht në sektorët e ndjeshëm të shërbimit për qytetarin..

Vendosja e kushtit ligjor për numrin minimal të dy operatorëve ekonomik pjesëmarrës të kualifikuar për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, do të ngushtojë hapësirat e autoriteteve kontraktore në përcaktimin e kriterëve të veçanta për subjekte të veçanta të përzgjedhura, me qëllim përfitimet e paligjshme dhe korruptive.

b) *Vendosja e garancisë së ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, do të rrisë transparencën, seriozitetin e prokurimit dhe konkurrencën e pjesëmarrësve dhe për pasojë do të rrisë efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.*

Në bazë të auditimeve të realizuara nga KLSH, në autoritete të ndryshme kontraktore si dhe në referim të sistemit të prokurimit elektronik të app.gov.al, kanë rezultuar raste kur operatorë ekonomikë ofertojnë me dokumente të rregullta ligjore, financiare, teknike dhe më pas tërhiqen në mënyrë të njëanshme pas hapjes dhe leximit të ofertave, duke bërë që këta operatorë, automatikisht s'kualifikohen nga procedura e prokurimit pa paguar asnjë penaltet për kostot e dështimit të proceseve të prokurimit dhe me hije dyshime të lëna pas

Krahas tyre, janë evidentuar operatorë ekonomik të shpallur fitues, të cilët tërhiqen përpara afatit të përcaktuar për nënshkrimin e kontratës, duke sjellë në disa raste dështimin e procesit të realizimit të procedurës të prokurimit ose shpalljen e operatorit ekonomik të radhës fitues me vlerë më të lartë se operatori ekonomik i vetë-tërhequr nga procedura. Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, këto raste hedhin dyshime për marrëveshje të fshehta në paraqitjen e ofertave, për të cilat duhet të ketë rezultate për hetime të mëtejshme.

c) *Përcaktimi i qartë ligjor, transparent dhe ezaurues i alternativave për përlogaritjen e fondit limit sipas llojit të kontratës për shërbime, furnizime dhe punime civile, me qëllim shmangien e subjektivizmit dhe veprimtarisë evazive të autoriteteve kontraktore dhe rritjen e kontributit të enteve shtetërore për një konkurrencë reale në këtë fazë të rëndësishme të procesit të prokurimit.*

Gjatë auditimeve të kryer nga KLSH ka rezultuar se, po thuajse në të gjitha institucionet qendrore dhe vendore, entet e tjera shtetërore dhe shoqëritë publike ka një fryrje të fondit limit nga ana e autoriteteve kontraktore për shkak të mungesës së qartësisë në legjislacion të metodologjisë së përlogaritjes së fondit limit në një procedurë prokurimi, duke vendosur për secilën alternativë shprehjen “dhe/ose”, në mungesë të një radhe dhe përcaktimeve se si duhet kryer secila alternativë në përlogaritjen e fondit limit. Pas këtij veprimi evaziv, autoritetet kontraktore me vendosjen e ekzagjeruar të kriterëve të veçanta të kualifikimit,

procedura e prokurimit çohet drejt pjesëmarrjes të vetëm një konkurrenti, pra në përcaktimin e fituesit që në shpalljen e tenderit.

Në rastin e studimit të tregut, autoritetet kontraktore do të duhet të komunikojnë ngushtësisht dhe brenda një kornize ligjore me organet tatimore, pasi operatorët ekonomikë që janë objekt studimi, të dhënat e veprimtarisë tyre tek organet tatimore i raportojnë. Veç këtyre, e njëjta gjë duhet bërë dhe me organet doganore, kryesisht në kontratat e furnizimeve.

d) Hartimin e një kuadri rregullator të veçantë për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare të klasifikuar “sekret”, duke u bazuar në Direktivën përkatëse të BE-së, me qëllim nxitjen e konkurrencës së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, përfshirë të drejtën e ankimimit, duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve të konsiderueshme publike të këtij sektori.

Gjatë auditimeve në Ministrinë e Mbrojtjes në periudhën 2015-2017 ka rezultuar se në procedurat që i janë nënshtruar ligjit nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, efekti i konkurrencës së pjesëmarrësve është dukshëm pozitiv, pasi çmimi i kontratave të realizuara është nga 19 % deri në 40% më i ulët se fondi limit i llogaritur. Ndërsa për procedurat e prokurimit për qëllime ushtarake që janë zhvilluar me procedurë me negociim të drejtpërdrejte apo të kufizuar në zbatim të VKM nr. 521 datë 08.08.2007 “Për procedurat e blerjes nga Ministria e Mbrojtjes të disa mallrave të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit Publik”, i ndryshuar dhe procedurat e prokurimit “sekret shtetëror” për mallra shërbime dhe pune janë zhvilluar me negociim të drejtpërdrejte apo të kufizuar në zbatim të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror” dhe VKM nr. 701, datë 22.10.2014 “Për miratimin e rregullave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar në fushën industriale” fituesit e kontratave janë me çmim pothuajse të barabartë me fondin limit, pasi zbritja e vlerës është nga 0.2% deri në 0.7%.

Pa neglizhuar dhe mangësitë në përlllogaritjen e fondit limit, nga analiza krahasuese e disa zërave të veçantë në kontratat e mallrave, shërbimeve dhe punimeve të këtij sektori të prokuruar sipas procedurës së ligjit të prokurimit publik dhe sipas procedurave ushtarake dhe sekrete, ka rezultuar se në këto të fundit çmimet e tyre janë 10-20 % më të larta, diferencë e cila për periudhën 2015-2017 arrin në vlerën rreth 1 miliard lekë.

Ne mendojmë se drejtimet e mësipërme duhet të jenë shtyllat kryesore të diskutimit të ndryshimeve ligjore që pritet të bëhen në ligjin për prokurimin publik, të cilat u janë bërë të ditura Kryetarit të Kuvendit, Zëvendës Kryetarëve të Kuvendit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Komisionit për Çështje Ligjore dhe Agjencisë së Prokurimit Publik me shkresat përkatëse nr.94, 94/1, 94/2, 94/3 dhe 94/4 prot., datë 17 dhe 22.01.2020.

## II.3 Auditimet financiare dhe tërregullshmërisë financiare

### Mbi auditimet financiare (me opinion)

Numri i auditimeve financiare të realizuara nga KLSH, në përmbushje jo vetëm të misionit të saj, por edhe të obligimeve të cilësuar në progres raportet e BE, është rritur nga viti në vit. Duhet të theksojmë faktin se për shkak të mungesës së një kuadri të plotë të raportimit financiar në sektorin publik, si dhe të mungesës së pasqyrave financiare të konsoliduara të shtetit, KLSH është në pamundësi të plotë të ofrimit të një opinionit të auditimit financiar mbi pasqyrat financiare të shtetit. Pavarësisht këtij kufizimi, bazuar në planin vjetor të auditimeve, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2019, KLSH ka kryer 23 auditime financiare kryesisht në njësi të vetëqeverisjes vendore dhe entitete të tjera publike. Në tabelën nr. 4 janë paraqitur llojet e opinionëve të lëshuara nga audituesi publik, duke kërkuar të jetë në përputhje me kërkesat e ISSAI dhe Manualit të Auditimit Financiar

Tabela nr. 4 Opinioni për auditimet financiare

Opinionit i Auditimit	Subjektet	Nr
<b>Opinione të pakualifikuara<sup>3</sup></b>	Bashkia Librazhd, Bashkia Libohovë	<b>2</b>
<b>Opinione të pakualifikuara (me theksim të çështjes)</b>	Bashkia Dropull, Bashkia Klos, Bashkia Librazhd–auditim tematik	<b>3</b>
<b>Opinione të kualifikuara<sup>4</sup></b>	Univeriteti “Ismail Qemali” Vlorë, Drejtoria e Konvikteve të shkollave të mesme (Bashkia Tiranë, Bashkia Mat (auditim tematik), Bashkia Pukë (Auditim Tematik), Bashkia Fushë Arrëz, Bashkia Sarandë, Bashkia Patos, Bashkia Bulqizë, Bashkia Shkodër, Bashkia Tiranë, Tirana Parking (Bashkia Tiranë), Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit (Bashkia Tiranë), Bashkia Delvinë, Bashkia Krujë, Bashkia Kurbin	<b>17</b>
<b>Opinione të Kundërt<sup>5</sup></b>	Bashkia Gramsh	<b>1</b>
<b>Refuzim për Opinion</b>		<b>0</b>

Burimi: KLSH

Tabela tregon qartë se në 5 subjekte është dhënë opinion i pakualifikuara (me apo pa rezervë), konkretisht Bashkia Librazhd, Dropull, Libohovë, Klos etj. Opinioni i kualifikuara është dhënë në 17 subjekte, ndërsa për Bashkinë Gramsh, grupi i auditimit ka arritur në një opinion të kundërt. Duke qenë se grupi më i madh i auditimeve financiare janë bërë në subjekte të njëjësive të vetëqeverisjes vendore,

<sup>3</sup> Opinioni i pakualifikuara – Audituesi duhet të shpreh një opinion të pakualifikuara mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare kur ai/ajo konkludon se transaksionet financiare përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

<sup>4</sup> Opinioni i kualifikuara. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuara: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

<sup>5</sup> Opinioni i kundërt – Audituesi jep një opinion të kundërt në rastet kur konstatohen devijime materiale dhe të përhapura në prezantimin e rezultateve të aktivitetit dhe/ose pasqyrave financiare

problematikat e evidentuara janë të lidhura me këto subjekte. Nga auditimet janë konstatuar problematika lidhur me:

1. Mos evidentim dhe mungesë dokumentacioni lidhur me Aktivët Afatgjatë Materiale. Mungon pothuajse në të gjitha subjektet regjistri i përditësuar i aktiveve, megjithëse jemi pas një reforme të gjerë me lëvizje të qenësishme të aktiveve materiale dhe jo vetëm.
  2. Në të gjitha subjektet e audituara, nga njësitë e qeverisjes vendore, nuk janë kryer inventarizimet periodike mbi gjendjen fizike të Aktiveve (Të qëndrueshme) Afat Gjatë Materiale (si toka, troje, terrene, pyje, plantacione, ndërtesa e konstruksione...), pavarësisht nga burimi i financimit (të ardhurat e veta ose nga kalimet në pronësi të tyre me VKM).
  3. Konstatohen gabime materiale në regjistrimin dhe pozicionimin e saktë të aktiveve sipas klasifikimit të drejtë sidomos po ti referohemi aktiveve afatgjatë jomateriale, duke sjellë në shumë raste denatyrime të këtyre llogarive. Regjistrime të gabuara ka edhe lidhur me njohjen e aktiveve të dhuruara apo përfituara nga grante.
  4. Nuk ka pasqyrim të drejtë të detyrimeve debitore dhe kreditore duke dhënë një pasqyrë jo të saktë të situatës financiare të këtyre subjekteve të cilat në shumë raste na rezultojnë në kushtet e paaftësive financiare për ekzistencën e tyre. Mos njohja e të ardhurave dhe mos rakordimi i të ardhurave të evidentuara nga sektori i mbledhjes është një problem i madh në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.
  5. Mos pasqyrim i drejtë dhe mos ndjekje e kujdesshme e detyrimeve të prapambetura të cilat vijojnë të krijohen në këto subjekte për shkak të keqmenaxhimit buxhetor, hapjes së projekteve të reja në kohën kur nuk janë mbyllur projektet në proces. Mos evidentim i vendimeve gjyqësore për largimet nga puna dhe jo vetëm, vlera të cilat janë të konsiderueshme.
  6. Angazhimet disa vjeçare nuk janë pjesë e informacionit të pasqyrave financiare, nuk reflektohen saktë detyrimet e angazhimit sipas vlerës së kontratave të lidhur me sipërmarrësit pas procedurave të prokurimit.
- Duhet të theksojmë se gjatë vitit 2019, përveç auditimeve financiare me opinion të dhënë duke zbatuar kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar dhe standardet ndërkombëtare të auditimit, KLSH ka realizuar edhe auditime të rregullshmërisë financiare kryesisht në institucione qendrore, në të cilat janë konstatuar problematika të lidhura me rregullshmërinë financiare dhe zbatimin e disiplinës financiare. Në vijim po ndalojmë në problematikat kryesore sipas subjekteve ku janë shtrirë këto lloj auditimesh.

**Ministrisë së** *Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

**Shëndetësi së dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)** *Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të AQT. Kështu, Procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer thuhet formalisht për atë kohë sa ai nuk mund të krahasohet me inventarin kontabël, rrjedhojë e mungesës së unifikimit të të dhënave midis ish ministrive.*

*Gabime në klasifikim dhe regjistrim kontabël.* Kemi konstatuar denatyrin të situatës financiare për shkak të pasqyrimeve jo të sakta të transaksioneve ekonomike

**Ministria  
për  
Evropën  
dhe Punët  
e Jashtme**

*Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit jo eficiente dhe jo të pavarura.

*Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të aktiveve.* Konstatuam se nuk është bërë reflektim i plotë i aktivitetit të ish Ministrisë së Integritimit Evropian, në mënyrë që pas bashkimit/konsolidimit këto pasqyra të mbulojnë të gjithë aspektet e funksionimit të të dy ministrive. *Raportimi financiar i përfaqësive diplomatike nuk është i plotë,* pasi përfaqësitë diplomatike nuk hartojnë pasqyra financiare të veçanta. Në strukturat e tyre nuk parashikohen domosdoshmërisht punonjës me profil financë-kontabilitet. Përdorimi dhe raportimi i fondeve të transferuara ndaj përfaqësive për realizimin e aktivitetit operativ dhe investues të tyre, nuk shoqërohet me evidenca mbështetëse. Nga auditimi rezultoi se, për vitin 2018, përdorimi dhe raportimi i fondeve të transferuara ndaj përfaqësive prej 1,635 milion lekë, për realizimin e aktivitetit operativ dhe investues të tyre, nuk shoqërohet me evidenca mbështetëse. Ndërtimi i pasqyrave financiare kërkon verifikimin dhe mbështetjen në evidenca mbështetëse për të ruajtur dhe pasqyruar vërtetësinë dhe besueshmërinë e tyre.

**Ministrinë  
e Arsimit,  
Rinise dhe  
Sportit**

*Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit jo eficiente dhe jo të pavarura

*Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të aktiveve.* Procesi i inventarizimit të aktiveve është kryer thujse formalisht për aq kohë sa ai nuk mund të krahasohet me inventarin kontabël, rrjedhojë e mungesës së unifikimit të të dhënave midis ish ministrive. Treguesit e pasqyrave financiare nuk japin një pamje të drejtë dhe të plotë të situatës financiare vjetore të institucionit.

Pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2018, nuk kanë të përfshirë treguesit financiarë të ish-MMSR, si pasojë kemi mospasqyrin të saktë të zërave, dhe denatyrin të situatës financiare të institucionit në fund të periudhës kontabël.

**Universiteti  
i Vlorës**

*Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

*Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të aktiveve.* Procesi jo i saktë dokumentar lidhur me inventarizimet, pasi nga evidencat e marra rezultuan thyerje të kontrolleve përgjatë këtij

procesi. Pasaktësi në evidencat e zërave të aktiveve. Edhe administrimi i aktiveve qarkulluese (veçanërisht pjesa e infrastrukturës mësimore) ka rezultuar me probleme.

**Universiteti e Shkodrës** *Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara plotësisht si dhe mungojnë trajnimet në këtë fushë.

*Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të aktiveve.* Janë konstatuar parregullsi dhe vonesa të pa justifikuara në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimeve fizike të aktiveve; mos dokumentim i sipërfaqeve dhe vlerave të tokës truall, nuk është aplikuar amortizimi i AAJM. Investimet e reja janë realizuar në kushtet e mosefektivitetit. Mos dokumentim i sipërfaqeve, tokë truall me vlerë 149,169 mijë lekë; probleme në llogaritjen e amortizimit AAJM për periudhën 2015-2018, etj.

*Nuk janë aplikuar në mënyrë të drejtë rregullat kontabël, në bazë të parimit të angazhimeve dhe detyrimeve të konstatuara.*

*Parregullsi në pagesat e bordit të administrimit dhe anëtarët e senatit*

**Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës (DARD)** *Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

*Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të AQT.* Kështu, janë përfshirë në pasqyrat financiare vlera e objekteve ndërtimore që janë në administrim të pushtetit vendor. U konstatuan mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimit fizik të aktiveve, parregullsi në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve; nuk është miratuar lista e pronave shtetërore dhe nuk janë kryer procedurat e regjistrimit të pasurisë në ZVRPP; për objektet ndërtimore mungojnë dokumentacionet respektive justifikuese si genplane, planimetri dhe plan-vendosje dhe aktet e vlerësimit, etj.

**Drejtoria Arsimore Rajonale Fier (DARF)** *Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

*Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të AQT.* Kështu, janë përfshirë në pasqyrat financiare vlera e objekteve ndërtimore që janë në administrim të pushtetit vendor. U konstatuan mangësi dhe parregullsi në kryerjen e të gjithë fazave të inventarizimit fizik të aktiveve, parregullsi në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve; nuk është miratuar lista e pronave shtetërore dhe nuk janë kryer procedurat e regjistrimit të pasurisë në ZVRPP; për objektet ndërtimore mungojnë dokumentacionet respektive justifikuese si genplane, planimetri dhe plan-vendosje dhe aktet e vlerësimit, etj. Janë konstatuar shpenzime në kushtet e mungesës së efektivitetit në vlerën 25 milion lekë.

**Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU)** *Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

*Problematika lidhur me njohjen dhe evidentimin e saktë të AQT.* Godinat e ndërtuara nga Komisioni Evropian në kuadër të zbatimit të Instrumentit të para zgjerimit (IPA2011), me vlerë 4.5 milionë Euro nuk janë të evidentuara si aset dhe nuk janë të regjistruara në kontabilitet. Në kontabilitet nuk është e evidentuar e gjithë vlera e investimit të projektit IPA 2009, investim i Delegacionit Evropian, komponent i të cilit ka qenë zhvillimi i pjesës së Teknologjisë dhe Informacionit me vlerë totale 875 mijë Euro. Sektori i Buxhetit dhe Financës nuk disponon dokumentacion pasi është mbyllur projekti për zhvillimin e sistemit AKU-net për programe softwar në vlerën 475 mijë Euro vlerë si dhe nuk e ka regjistruar këtë grant në kontabilitet

**Garda e Republikës** *Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

*Problematika lidhur me përdorimin pa kriter të qartë të letër kredive në bazë për sigurimin e pajisjeve të furnizuara nga kontraktorë të huaj.* Parapagimi i investimeve përmes këtyre instrumenteve sjell edhe njohje jo të drejtë të investimeve megjithëse ato nuk janë realizuar akoma. Rregullimi edhe kontabël i këtij instrumenti është i rëndësishëm.

## II.4 Auditimet e përputhshmërisë dhe të Rregullshmërisë së aktivitetit

### Mbi auditimet e përputhshmërisë (me opinion)

Gjatë viti 2019, KLSH ka kryer 42 auditime përputhshmërie nga të cilat, vetëm për 6 subjekte është dhënë opinion i pakualifikuar (me apo pa rezervë). Në auditimet e tjera opinionin ka qënë i kualifikuar, për shkak se konstatimet dhe devijimet nga kuadri rregullator sipas gjykimit të audituesve kanë qenë materiale por jo të përhapura (22 subjekte të audituara). Ndërsa në auditimin e 14 subjekteve konstatimet dhe devijimet nga kuadri rregullator nën të cilin zhvillohet aktiviteti i tyre kanë rezultuar jo vetëm materiale, por dhe të përhapura duke justifikuar opinionin e kundërt të përputhshmërisë.

Tabela nr. 5 Opinioni për auditimet e përputhshmërisë

Opinionin e Auditimit	Subjektet	Nr
Opinione të pakualifikuar <sup>(6)</sup>	Agjencia e Prokurimit Publik, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, ISSH	5

<sup>6</sup>.Opinionin e pakualifikuar – Audituesi duhet të shpreh një opinion të pakualifikuar mbi rregullshmërinë e pasqyrave financiare kur ai/ajo konkludon se transaksionet financiare përputhen në të gjitha aspektet materiale me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

<b>Opinione të pakualifikuar (me theksim çështje)</b>	Komisioni i Prokurimit Publik	<b>1</b>
<b>Opinione të kualifikuar <sup>(7)</sup></b>	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Bashkia Kurbin, ZVRPP Bulqizë, ZVRPP Tropojë, ZVRPP Gramsh, ZVRPP Lushnje, ZVRPP Gjirokastrë, ALUIZNI Elbasan, Ujësjetllës Kanalizime Lushnje, Spitali Rajonal Korçë, Albpetrol SHA, MSHMS: Projekti “Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës”, AKU: Projekti IPA 2013 “Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri”, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Projekti “Asistencë teknike për përmirësimin e standardeve të sigurisë rrugore”, CFCU: Projekti “Ndërtimi i Sistemit të Kanalizimit në Vlorë, Faza II”, Bashkia Korçë (Auditim Tematik), Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA, Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 Tiranë (me rezervë), Posta Shqiptare SHA, Hekurudha Shqiptare SHA. Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar, Projekti: “Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Plloçe” Autoriteti Rrugor Shqiptar.	<b>22</b>
<b>Opinione të Kundërt <sup>(8)</sup></b>	ZVRPP Lezhë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë, CFCU, FSDKSH, Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, MFE: Drejtoria e Zbatimit të Buxhetit, MFE: Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, Ish Shoqëria e parë Financiare (Agrokredit SHA), MFE: Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit, MFE: Drejtorinë e Koncesioneve, Projekti: “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” ARRSH, ALUIZNI Vlorë dhe Raporti i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2018.	<b>14</b>
<b>Refuzim për Opinion</b>		<b>0</b>

*Burimi: KLSH*

Në vijim do ndalojmë në subjektet në të cilët devijimet dhe paligjishmeritë kanë qenë material duke filluar nga institucionet qendrore, vendore dhe më pas njësi të administrimit të pronës dhe shoqëritë me kapital shtetëror.

#### **II.4.1 Auditimet e përputhshmërisë në Institucionet Qendrore**

**Autoriteti Rrugor Shqiptar** Sistemet e kontrollit: Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit inefficente

Në kundërshtim me Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, gjatë vitit 2018, janë dhënë shpërblime punonjësve të ARRSH-së, me arsyetimin e ndryshimit të statusit të tyre nga

<sup>7</sup> Opinioni i kualifikuar. Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura.

<sup>8</sup> Opinioni i kundërt – Audituesi jep një opinion të kundërt në rastet kur konstatohen devijime materiale dhe të përhapura në prezantimin e rezultateve të aktivitetit dhe/ose pasqyrave financiare

nëpunës civil, në punonjës që marrëdhëniet juridike që rregullohen në bazë të Kodit të Punës. Vlera e këtyre shpërblimeve në dëm të buxhetit të shtetit është 51 milion lekë.

Devijacione në zbatim të dispozitave ligjore në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvine, Loti 7, me fondin limit 2,332 milion lekë, të zhvilluar në korrik 2019. Në këtë procedurë prokurimi, nga 6 operatorët pjesëmarrës, është kualifikuar vetëm BOE “Ircop&Sulova Ndërtim Prodhim”, me ofertën ekonomike në vlerën 2,299 milion lekë dhe janë s`kualifikuar 5 operatorët e tjerë. Një nga operatorët është s`kualifikuar, në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, megjithëse bashkimi i operatorëve kishte paraqitur ofertën ekonomike në vlerën 1,789 milion lekë. Dëmi i buxhetit vetëm nga kjo procedurë është në vlerën 611 milion lekë me TVSH.

Procedura e prokurimit për hartimin e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rreth rrotullimi Shqiponja (Unaza e Re)”, është zhvilluar në kushte të mungesës së konkurrencës, pasi kontrata për realizimin e projektit, nuk është lidhur nëpërmjet procedurave të prokurimit, por është lidhur drejtpërdrejtë me projektuesin, i cili ka marrë përsipër të hartojë projektin dhe preventivin e zbatimit falas në formë dhurimi.

Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vetëm për vitin 2018 është paguar shuma prej 350 milion lekë, vlerë kjo të cilës i është shtuar edhe kosto e përmbartimit në shumën rreth 31.7 milion lekë.

Përgjithësisht nuk janë përcaktuar mekanizma të mirë organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut, efekt që pasqyrohet edhe në rezultatet e treguesve të performancës së buxhetit dhe thesarit duke shfaqur mangësi, gjatë zbatimit të kontratave për punë dhe shërbime dhe rezerva në planifikimin e buxheteve dhe në parashikimin e nevojave për likuiditete, çka ka çuar në rritjen e nivelit dhe të stokut të detyrimeve të prapambetura. Kështu në çdo fund vit pasardhës, ARRSH vazhdon të trashëgoj të njëjtin borxh që shkon nga 3 miliard lekë në 4 miliard lekë.

Në disa procedura prokurimi janë bërë skualifikime të operatorëve ekonomik me oferta me të ulta se fituesit që shkojnë në vlerën totale rreth 442 milion lekë. Skualifikimet nga procedurat e prokurimeve të këtyre operatorëve janë bërë për disa mangësi në dokumentacionet e paraqitura për përmbushjen e kritereve të veçanta të kërkuara në dokumentet e tenderit, mangësi të cilat AK edhe mund t'i konsideronte si devijime të vogla.

Në disa kontrata për ndërtimin e infrastrukturës rrugore, gjatë zbatimit të punimeve janë konstatuar punime të kryera nga

kontraktorët dhe të paguara nga ARRSH, në vlerën totale rreth 224 milion lekë. Por këto punime janë të pa rakorduar me dokumentacionin justifikues teknik si, librezë masash, fatura, analiza laboratorike të materialeve, etj., duke bërë kështu që vlera të menaxhohet pa eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet.

**Agjencia  
Kombëtare e  
Ujësjetës  
Kanalizime**

*Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

Në 2 kontrata të lidhura për ndërtimin e infrastrukturës në ujësjetës kanalizime, gjatë zbatimit të kontratave janë konstatuar punime të pa kryera dhe vonesa në furnizimin me makineri e pajisje, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën totale rreth 5.5 milion lekë.

Në 5 procedura prokurimi janë bërë skualifikime të operatorëve ekonomik me oferta me të ulta se fituesit që shkojnë në vlerën totale rreth 318 milion lekë. Skualifikimet nga procedurat e prokurimeve të këtyre operatorëve janë bërë për disa mangësi në dokumentacionet e paraqitura për përmbushjen e kriterëve të veçanta të kërkuara në dokumentet e tenderit, mangësi të cilat AK edhe mundë ti konsideronte si devijime të vogla. Këta operatorë të skualifikuar kanë hapur procese ligjore të cilat do të impaktojnë buxhetet e ardhshme të këtij institucioni.

Në objektin "Furnizimi me ujë i qytetit të Kukësit dhe 14 fshatrave rreth tij" faza II, kontraktori është likuiduar për punimet e kryera në vlerë 172 milion lekë, por edhe pse kjo kontratë është tej afateve të përfundimit të punimeve, ky investim nuk është ven në funksionim akoma. Për mos realizimin e këtij objekti AKUM ka zgjidhur kontratën me sipërmarrësin. Për këtë zgjidhje kontrate në mënyrë të njëanshme sipërmarrësi ka hapur proces gjyqësor i cili do të impaktojnë buxhetet e ardhshme të institucionit.

Në datën 30.01.2014, është nënshkruar kontrata për përmirësimin e Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së Madhe me kontraktorin "Dondi, Itali & Kubota, Japoni" me vlerën 81 milion Euro. Ky projekt është financuar përmes marrëveshjes së financimit ABA-P3 lidhur midis Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Japoneze dhe është ratifikuar në Kuvend me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008. Kjo kontratë është ndërprerë në datën 04.07.2018 kur punimet arrinin në 70% të vlerës së kontratës ose 56 milion Euro. Ndërprerja (zgjidhja) e kësaj kontratë është bërë në mënyrën të njëanshme nga MIE nëpërmjet AKUKM në kundërshtim me marrëveshjen e financimit dhe me kushtet e kontratës së lidhur me kontraktorin. MIE dhe AKUKM për zgjidhjen e kontratës nuk ka marrë miratim paraprak nga financuesi Banka Japoneze për Zhvillim, dhe nuk ka marrë parasysh sugjerimet dhe vërejtjet që i ka bërë Këshilli i Mosmarrëveshjeve, të cilat kanë të bëjnë, kryesisht për: mungesën

të hapësirave për të kryer punimet; vonesa në likuidim të TVSH dhe pagesat e situacioneve; mungesa apo vonesa të theksuar bashkëpunimi në lidhje me marrjet e lejeve, miratimet e punimeve. etj; probleme të hasura gjatë zbatimit me projektin dhe mungesa e gatishmërisë për korrigjimin apo përmirësimin e tij ,etj. Për prishjen e kësaj kontrate në kundërshtim me marrëveshjen e financimit dhe me kushtet e kontratës, kontraktori ka hapur çështje në gjykatën pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Londër. Duke marrë në konsideratë paligjshmërinë e zgjidhjes në mënyrë të njëanshme të kontratës efektet e kësaj padie në gjykatë do të rëndojnë buxhetet e ardhshme të institucionit.

Në 3 procedura prokurimi, si pasojë e diferencës së krijuar mes vlerës së ofertës së operatorit të shpallur fitues, dhe vlerës së ofertave të operatorëve të tjerë të skualifikuar padrejtësisht kemi konkluduar në menaxhim jo efektiv fondesh në shumën totale rreth 217 milion lekë.

Gjatë zbatimit të punimeve, në 3 kontrata janë bërë rishikime dhe ndryshime të projekteve të zbatimit si dhe për këtë janë lidhur kontrata shtesë në vlerën totale rreth 303 milion lekë. U konstatua se, disa zëra pune të vendosura në projektet e rishikuar, janë të pastudiuar mjaftueshëm dhe janë teknikisht të panevojshëm për funksionimin e këtyre objekteve, duke sjellë shpenzime pa efektivitet dhe ekonomikitet.

Në 2 kontrata për ndërtimin e infrastrukturës në ujësjellës kanalizime, gjatë zbatimit të punimeve janë konstatuar punime të kryera nga kontraktorët dhe të paguara nga AKUM, në vlerën rreth 5 milion lekë. Këto punime janë të pa rakorduar me dokumentacionin justifikues teknik si, librezat masash, fatura, analiza laboratorike të materialeve, etj.

Në zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, janë paguar nga buxheti i shtetit 75 milion lekë, në lidhje me shpronësimet dhe proceset e fituara nga punonjësit e larguar nga puna, për të cilat është paguar edhe tarifë përmbartimore prej 3.5 milion lekë.

**Ministria e  
Shëndetësisë  
dhe Mbrojtjes  
Sociale**

*Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit.

Në programin buxhetor “Rehabilitimi i të përndjekurve politikë”, janë akorduar 2,051 milion lekë vlerë e cila është ulur me akt normativ 49% më pak nga plani fillestar. Ndërkohë që shumica e dëmtshpërblyer e të përndjekurve politikë është ulur, sipas treguesve të raportuar, numri i përfituesve është rritur në 7 144 përfitues, nga 5 000 që ishin planifikuar fillimisht. Ka një mungesë vëmendje në të dhënat që përpunohet siç vijnë nga MFE dhe thesari, fakt që tregon se sistemet e kontrollit të supozuara nuk funksionojnë.

-Për dy nga tre kontrata koncesionare, "Check-Up" dhe "Sterilizimi" që ka në zbatim MSHMS, rezultoi se aplikohet Tatim mbi Vlerën e Shtuar, në masën 20% mbi çmimin e kontraktuar. Ndërsa për shërbimin e "Hemodializës" ky tatim nuk aplikohet. Megjithëse të tre shërbimet e sipërcituar janë pjesë e zinxhirit të ofrimit të shërbimit shëndetësor ndaj pacientit nga institucione shëndetësore të licencuara, si dhe faturojnë njëloj shërbimin drejt institucioneve shtetërore prej dhe nga paguhen, mënyra e faturimit të tyre ndryshon. Aplikimit i TVSH-së mbi vlerën e shërbimit të faturuar nga ana e koncesionarit për këto shërbime shëndetësore, bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", neni 51/c e tij të cilat përcaktojnë se përjashtimin e shërbimeve shëndetësore. Megjithëse KLSH në vijueshmëri ka rekomanduar ndryshimin e mënyrës së faturimit për shërbimin e "Check-Up", situata nuk rezulton të ketë ndryshuar por ajo vijon edhe në koncesionin e "Sterilizimit". Vlera e TVSH-së së llogaritur në shërbimin e sterilizimit prej koncesionarit paraqitet në vlerën rreth 669,5 milion lekë. Kjo mënyrë faturimi e shërbimit shëndetësor nuk rezulton të jetë kundërshtuar nga Autoriteti, apo të jenë marrë nisma për qartësimin e frymës së ligjit me MFE, për zgjidhjen e ngërçit, i cili vijon të rëndoje në vazhdimësi financat publike.

MSHMS i mungojnë kontrollet në vend si dhe monitorimi i termave të tjerë të kontratave koncesionare, konkretisht lidhur me vlefshmërinë e instrumenteve të garancisë rezultoi se, në disa raste formularët e sigurimit të lëshuar, kanë efekt prapaveprues, çka tregon mungesën e mbulimit në kohë, në periudha që shkojnë deri në disa muaj. Formularët paraqiten në gjuhë të huaj, të pa përkthyer si dhe të pashoqëruar me faturën tatimore të primit të paguar apo fletën e udhëzimeve.

Në praktikën e PPP-së "Për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore" rezultoi se, pavarësisht se kishin kaluar mbi tre muaj nga nënshkrimi i kontratës dhe mbi 15 muaj nga shpallja e fituesit, ky i fundit ende nuk ka kryer pagesën e tarifës së zhvillimit të projektit ndaj IFC në shumën 600,000 euro, si dhe nuk ka paraqitur Garancinë e Performancës në vlerën 700,000 euro; Mungon informacioni mbi financimin e partneritetit duke mos përmbushur në kohë kushtet paraprake të kontratës. Nga ana tjetër edhe Autoriteti nuk rezulton të ketë bërë hapa përpara lidhur me këtë angazhim, duke mos plotësuar kushtet e parashikuara si palë në kontratë.

**Ministria e  
Arsimit  
Rinisë dhe**

*Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit jo eficiente dhe jo të pavarura

## **Sporteve**

Në procedurën e prokurimit me objekt "Shërbim Internetit në Sistemin Arsimor Parauniversitar", konstatohet se MARS, nuk ka siguruar mirë përdorim të fondeve publike, nuk ka nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe nuk ka siguruar një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët bazuar kriteret kualifikuese të padrejta, duke bërë që fonde buxhetore në vlerën 39 milion lekë janë të menaxhohen pa efektivitetin e duhur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në procedurën e prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i shkollës së mesme Jakov Xoxa, Bashkia Fier", konstatohet se nga AK janë vendosur kërkesa për kualifikim në mënyrë të tillë që nuk stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, duke bërë që fonde buxhetore në vlerën 7.5 milion lekë të menaxhohen pa efektivitet dhe ekonomikitet.

## **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme**

*Sistemet e kontrollit:* Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit jo eficiente dhe jo të pavarura

Përdorimi dhe raportimi i fondeve të transferuara ndaj përfaqësive prej 1.7 milion lekë, për realizimin e aktivitetit operativ dhe investues të tyre, nuk shoqërohet me evidenca mbështetëse.

Rezultuan thyerje materiale të sistemeve të kontrollit si: përgjatë procesit të monitorimit të buxhetit sa i takon verifikimit dhe saktësisimit të vlerave të raportuara për llogari të MEPJ-së; mos raportim korrekt i realizimit të buxhetit për secilën përfaqësi diplomatike, pasi për çështje raportimi, buxheti i secilës ambasadë ndër të tjera zhvishet nga shpenzime që kryhen për llogari të MEPJ ose tjetër duke deformuar vlerat e buxheteve individuale të përfaqësive.

Për periudhën objekt auditimi përfaqësitë diplomatike kanë funksionuar pa struktura të miratuara, pasi nga strukturat përgjegjëse të MEPJ këto të fundit nuk janë hartuar dhe miratuar asnjëherë. Për pasojë, kanë munguar edhe përshtime për pozicionet e punës, duke mbartur rrisje që vendimmarrja në lidhje me emërimet të jetë subjektive, veçanërisht në kushtet kur nuk parashikohet strukturë fikse .

Ka munguar hartimi i gjurmës së auditimit sa i takon procesit të konvertimit të monedhës për llogari të buxheteve të përfaqësive diplomatike, për të parashikuar rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare, nga fillimi deri në përfundim të tyre, me synimin që të ripërshtojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

## **Avokatura e Shtetit**

Sipas të dhënave të paraqitura prej Avokaturës së Shtetit, rezulton se, që nga viti 2011, janë 10 vendimet e formës së prerë të arbitrazhi ndërkombëtar kundër Shtetit Shqiptar. Vlen të theksojmë se, peshën me të madhe të këtyre vendimeve e ka, çështjen “Francesco Becchetti”, zhvilluar pranë Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimit (ICSID). Për këtë çështje, ICSID ka dënuar Shqipërinë me vlerën 110 milion euro. Qeveria ka aplikuar për anulimin e këtij vendimi dhe Gjykata e ka pranuar aplikimin duke pezulluar përkohësisht zbatimin e tij. Efektet e pritshme të këtij vendimi do kenë impakt të rëndësishëm në buxhetin e shtetit.

Për vendimet e arbitrazhit ndërkombëtar Avokatura e Shtetit nuk disponon informacion të plotë lidhur me shumat e paguara nga institucionet që janë palë në gjykim, e si e tillë vlerat e ekzekutuar dhe të pa ekzekutuar nga buxheti i shtetit nuk mund të konfirmohen nga ky institucion, çka në vlerësimin e KLSH, paraqet nevojë imediate për një qasje ndryshe në dispozitat ligjore lidhur me këto detyrime.

### ***II.4.2 Auditimet e përputhshmërisë në njësitë e vetëqeverisjes vendore***

#### **Bashkia Kurbin**

Sistemet e kontrollit. Struktura e auditit është jo efiçente dhe jo e pavarur. Edhe në rastin kur janë dizajnuar saktë nuk janë efektive dhe nuk njihen nga punonjësit.

Është konstatuar se në një kontrate nuk është kryer oponenta teknike, ndërkohë që në procedurat e prokurimit janë konstatuar mangësi dhe parregullsi me efekte negative në administrimin e fondeve publike për vlerën 2.7 milion lekë.

Nga auditimi i blerjeve të vogla me vlerë kontrate prej 2 milion lekë, dokumentacioni që i shoqëron këto praktika prokurimi nuk është sipas dispozitave ligjore.

Nga verifikimi i katër kontratave të zbatimit të punimeve në terren me punimet e kryera në fakt, librit të masave, situacionit përfundimtar, lidhur me volumet e punës të situacionuar si dhe atyre të kryera në fakt është konstatuar dëm ekonomik në shumën 1 milion lekë.

#### **Bashkia Fushë Arrëz**

Sistemet e kontrollit: Janë konstatuar mangësi si mungesa e politikave dhe praktikave që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit, duke mos hartuar dhe zhvilluar programe trajnimesh; raportimi vjetor i monitorimit të sistemit të kontrollit të brendshëm nuk identifikon pikat e forta dhe të dobëta të këtij sistemi si dhe nuk ka hartuar rregulla për

ruajtjen e aktiveve. Mungojnë njohuritë bazë për MFK dhe strukturat e AB janë jo eficiente dhe jo efektive.

Në auditimin e procedurave të prokurimit publik, u konstatua moszbatim i akteve ligjore e nënligjore me efekte negative në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për arsye të kualifikim të padrejtë dhe shpallje fitues të OE në kushtet e mosplotësimit të kriterëve për kualifikim në 6 raste në shumën 129 milion lekë, veprime në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46 e 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

Dëmi ekonomik i zbuluar nga auditimi i zbatimit të punimeve civile në tre raste është në shumën 1.7 milion lekë.

### **Bashkia Puke**

Në lidhje me MFK, është konstatuar se nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, dhe ka aspekte që nuk njihen. Nga ana tjetër strukturat e AB janë ngritur në kushtet joligjore.

Në lidhje me transferimin në pronësi të pasurive sipas listave të VKM nr.433, datë 8.6.2016, institucioni nuk ka vepruar për marrjen në dorëzim të aseteve të qëndrueshme, nuk ka kryer kolaudimin, vlerësimin, nuk ka kryer inventarizimin kontabël dhe fizik, si dhe nuk ka aplikuar në ZRPP për asetet. Nuk është krijuar struktura e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e kundërligjshme” të ndryshuar, neni 3,

Dëmi ekonomik i konstatuar në fushën e prokurimeve është 4 milion lekë si diferenca në volume pune të pakryera në fakt.

Janë përdorur fonde publike në kundërshtim me kërkesat ligjore, në vlerën 106 milion lekë, e cila përbën 1/2 e numrit të tenderave të zhvilluar, ose 75.5% e vlerës së kontratave të lidhura dhe në zbatim.

5 procedura prokurimi janë kryer në kundërshtim me ligjin 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi OE janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi sipas kërkesave të DST, duke shkaktuar përdorim të fondeve pa efektivitet, ekonomicitet dhe eficiencë për vlerën 94 milion lekë. Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile u konstatua përdorim pa efektivitet i fondeve në shumën 773 mijë lekë pa tvsh.

### **Auditim tematik Bashkia Korçë**

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit ka rezultuar se nga NJP, nuk është përcaktuar në DT, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqesin OE, për përmbushjen e kriterëve për kualifikim. Nuk ka gjurmë mbi mënyrën e përlogaritjes së

çmimeve të preventivuara, nuk kanë kryer analizë çmimesh si dhe mungon procesverbali mbi “Përlllogaritjen e fondit limit”

Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë civile në 2 raste u konstatua dëm ekonomik 1.9 milion lekë pa TVSH, si rezultat i vendosjes së pajisjeve jo sipas specifikimeve teknike dhe jo funksionale.

Nga auditimi u konstatuan shpenzime në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit dhe me efekte negative në shumën 44.6 milion lekë, si pasojë e përlllogaritje më tepër e vlerës limit të kontratës.

#### **Bashkia Mat**

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, nuk ka dizajnim të saktë për sa kohë nuk njihen elementët e tij. Punonjësit nuk kanë njohuri për MFK dhe nuk janë të trajnuar për to. Strukturat AB jo eficiente dhe të pavarura.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultuan efekte negative në administrimin dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike në shumën 164.9 milion lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultuan në 7 raste nuk është bërë anulimi i procedurave megjithëse asnjë nga OE pjesëmarrës nuk plotëson kriteret për kualifikim.

Dëmi ekonomik i konstatuar në këtë Bashki nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të punimeve civile është në shumën 1.4 milion lekë, dëm i cili vjen nga përlllogaritja dhe situacionimi i makineri e pajisje me tvsh, për punime të pakryera në zbatimin e kontratës apo skualifikim i padrejtë i OE me vlerë më të ulët dhe shpallje fituese e atij me vlerë më të lartë në kushtet kur edhe ky OE nuk i plotëson kriteret për kualifikim.

#### **Bashkia Delvine**

Bashkia Delvinë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm. Nuk ka siguruar mbulim me audit të brendshëm në një nga mënyrat e përcaktuara në ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit në 9 raste me vlerë 45 milion lekë, KVO nuk ka kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomik, vlera e të cilave është më e ulët se ofertat fituese, megjithëse si ofertuesi fitues dhe operatorët e skualifikuar kanë të njëjtat mangësi, ndërkohë që KVO duhej të kishte anuluar procedurën e prokurimit, pasi në garë nuk ngelej asnjë ofertë e vlefshme.

Në 7 raste NJHDT nuk ka argumentuar kriteret e vendosura dhe është mjaftuar vetëm me pasqyrimin e përshkrimit të termave në mënyrë të përgjithshme, apo janë vendosur kritere kualifikuese të pa nevojshme e të ekzagjeruar.

Dëmi ekonomik në 4 raste të zbatimit të punimeve civile është 2.9 milion lekë nga diferenca në volume pune të pakryera në fakt, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve.

Në 5 raste në vlerë 27 milion lekë pa tvsh, është vërejtur fenomeni “dorëheqje nga oferta” e ofertës me vlerë më të ulët, ndërkohë që diferenca ndërmjet dy ofertave është disa herë më e lartë se 2% e vlerës së fondit limit ndërkohë që procedura e prokurimit duhej të ishte anuluar, veprim i cili mund të sjell dhe përballje me fenomenin e një marrëveshje të fshehtë ndërmjet OE konkurrues.

## **Bashkia Sarande**

Nuk ka dizajnuar dhe as funksionojnë sistemet e kontrollit. Kërkesat e MFK nuk njihen. Struktura përgjegjëse për AB, nuk ishte e plotë dhe e kualifikuar, duke mos garantuar funksion të plotë të auditimit të brendshëm.

Për asetet e dhëna me qira nuk është bërë përditësimi i sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në AKSH, ato nuk janë pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme duke i hapur rrugë informalitetit. Për asnjë nga objektet e dhëna me qira me kontratë Bashkia Sarandë nuk ka Certifikatë Pronësie duke lidhur kontrata për objekte të cilat nuk i ka në pronësi

Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlera të larta për asnjë rast urdhër prokurimet nuk konfirmohen në Degën e Thesarit

Në auditimin e procedurës së prokurimit me objekt “Pastrim dhe largim i mbetjeve, viti 2018”, u konstatua se Bashkia Sarandë ka realizuar 4 shtesa kontrate me po të njëjtin OE me vlerë sa 84% e vlerës totale të kontratës fazë/fillestare

Dëmi ekonomik në prokurimet publike është 12 milion lekë, pasi në zhvillimin e procedurave të prokurimit janë kualifikuar e shpallur fitues OE që nuk plotësojnë disa nga kriteret e DST.

Nga auditimi u konstatuan efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike në shumën 31 milion lekë.

Në auditimin e rasteve të procedurave blerje me vlera të vogla, u konstatua shmangie nga procedurat e prokurimit dhe shpenzime pa efektivitet në 6 praktika me vlerë 2.7 milion lekë, procedurat nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP, pasi në to mungonin disa nga dokumentet shoqëruese të procedurës.

Nga zbatimi i punimeve civile të një kontrate konstatohet se nuk është argumentuar ndryshimi i disa specifikimeve teknike.

Në një rast nuk ka marrë oponencën teknike nga institucioni përkatës dhe për pasojë ndryshimi i projektit ka sjellë rritjen fiktive të vlerës së zbatimit.

**Bashkia  
Shkodër**

Nuk ka dizajnuar dhe as funksionojnë sistemet e kontrollit. Kërkesat e MFK nuk njihen. Struktura përgjegjëse për AB, nuk është e kualifikuar, duke mos garantuar funksion të plotë të auditimit të brendshëm.

Në auditimin e procedurave të prokurimit është evidentuar se janë vendosur kërkesa të pa argumentuara dhe jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit duke mos përdorur të njëjtin standard mbi dokumentacionin që duhet të paraqitet nga OE.

Dëmi ekonomik i konstatuar nga zbatimi i punimeve civile është në shumën 1 milion lekë si diferenca në volume pune të pakryera në fakt në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve

Shpenzime të realizuara në kundërshtim me kërkesat ligjore të prokurimit me efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet, për shkak të mos zbatimit të kërkesave ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, janë në vlerën 148 milion lekë pa tvsh.

**Bashkia  
Gramsh**

Nuk ka dizajnuar dhe as funksionojnë sistemet e kontrollit. Kërkesat e MFK nuk njihen. Struktura përgjegjëse për AB, nuk është e kualifikuar, duke mos garantuar funksion të plotë të auditimit të brendshëm.

Dëmi ekonomik i konstatuar nga zbatimi i katër kontratave të punimeve civile është 2 milion lekë, në të cilat ka rezultuar diferenca në volume pune të pakryera në fakt në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve

Nga auditimi u konstatuan efekte negative në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në shumën 69.9 milion lekë. Nga NJP rezulton se janë vendosur Kriteret të ekzagjeruar të cilat konsiderohen diskriminuese dhe jo në përputhje me vëllimet e punës duke sjell si pasojë dhe 3 ankesa nga operatorë të ndryshëm.

***II.4.3 Auditimet e përputhshmërisë në shoqëritë publike dhe projektet me financime të huaja***

**Aviacioni  
Civil**

Sistemet e kontrollit: Nuk janë të dizajnuara saktë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit nuk është ngritur në këtë institucion dhe rolin e saj e luan sektori i kontrollit të cilësisë, por që nuk mbulon në mënyrë eficiente punën e auditit të brendshëm dhe kjo është një strukturë jo e pavarur.

Shkeljet kryesore të konstatuar në këtë auditim janë: Referuar dokumentacionit të verifikuar mbi analizën e pasqyrave financiare

rezultoi se, fitimi neto i vitit 2018 paraqitet në shumën 98,071,375 lekë dhe fitimi i vitit të mëparshëm paraqitet në shumën 51,189,279 lekë. Këto të ardhura në vlerën totale 149,260,654 lekë përbëjnë tepricat e mbetura në fund të viteve buxhetore, dhe nga strukturat drejtuese të AAC, nuk janë marrë masa për kalimin e këtyre fondeve për llogari të Buxhetit të Shtetit, në kundërshtim me Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar.

Lidhur me procedurën e marrjes me qira të ambienteve për zyra, u konstatua se, AAC ka nënshkruar një kontratë për marrje ambientesh me qira, e cila nuk është realizuar pasi AAC është tërhequr nga kjo kontratë duke paguar si penalitet shumën prej 20,252.96 Euro, e konsideruar dëm ekonomik që i përket vlerës së garancisë.

Nga auditimi i dokumentacionit për zhvillimin e procedurave të prokurimit rezultoi se janë kryer procedura të cilat mund të mbuloheshin nga stafi i AAC, duke sjellë për pasojë efekte financiare negative për buxhetin e Shtetit në shumën 52,915,679 lekë.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, viti 2019, u konstatua se shuma e likuiduar ndaj OE fitues likuiduar në vlerën 7,358,400 lekë, konsiderohet investim me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit, pasi AAC ka transferuar dy automjetet që ka patur në përdorim tek institucionet e tjera duke i dhuruar ato, pa kryer paraprakisht një analizë dhe vlerësim të nevojave të saj.

## **ALBPETROL**

Sistemet e kontrollit: Nuk janë të dizajnuara saktë dhe në përputhje të plotë me dispozitat ligjore. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit është e strukturuar në formë por nuk ka një performancë eficiente dhe produkti i kësaj strukture ka mangësi dhe nuk mbulon të gjitha fushat e auditimit

Janë konstatuar mangësi në përcaktimin e çmimit të kontratave të gazit, të azhurnuara në kontratat përkatëse, me dëm ekonomik me vlerë 10.8 milionë lekë.

Është konstatuar humbje asetesh me vlerë 65.6 milionë lekë, nga procesi i transferimit të të drejtave dhe detyrimeve në zona në marrëveshje hidrokarbure.

Janë konstatuar mangësi në zbatimin e procedurave të prokurimit me vlerë 2.5 milionë lekë. Si pasojë e largimeve nga puna pa shkaqe të përligjura, Albpetrol SHA është ndëshkuar me vlerë 99.6 milionë lekë, nga procese gjyqësore të humbura.

Shoqëria Albpetrol SHA ka rezultuar me punonjës mbi strukturën e

miratuar, duke shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 13.6 milionë lekë.

Janë blerë programe kompjuterike për menaxhimin e magazinave, programe të cilat nuk janë vënë në funksionim, duke përdorur fonde pa efektivitet me vlerë 19.5 milionë lekë.

Për zonën Patos-Marinëz, bazuar në të dhënat në dispozicion, për periudhën e zbatimit të marrëveshjes hidrokarbure janë krijuar detyrime për pjesën e prodhimit PPE dhe ASP duke filluar nga viti 2011. Bazuar në çmimet e shitjes së naftës nga Kontraktori dhe çmimet e shitjes në momentin e likuidimit të këtyre sasive, Albpetrol SHA, ka pësuar humbje me vlerë 6,670,842 USD. Albpetrol SHA i është drejtuar Kontraktorit dhe për dijeni Ministrisë dhe AKBN, në lidhje me auditimin e llogarive të Kontraktorit për raportet 3-mujore nr. 1, 2, 3 dhe 4 të vitit 2015, realizuar sipas njoftimit për auditim nr. 701 prot., datë 08.01.2018. Bazuar në këtë shkresë, i është kërkuar kontraktorit zbritja nga kostot hidrokarbure të vlerës 97,981,667 USD.

Nga auditimi ka rezultuar që për periudhën janar-shtator 2017, janë përfshirë në kosto hidrokarbure shpenzime në kundërshtim me marrëveshjen hidrokarbure me vlerë 46,211,029 USD. Është rekomanduar që Albpetrol SHA, t'i kërkojë Kontraktorit zbritjen e shpenzimeve të përfshira në kostot hidrokarbure në kundërshtim me marrëveshje hidrokarbure me vlerë 144,192,696 USD. Pas zbritjes së kësaj vlere (duke shtuar edhe shpenzimet për 3 mujorin e 4 të vitit 2017), të rillogaritit Koeficienti R, i cili për gjysmën e fitimit të krijuar i detyrohet Qeverisë Shqiptare vlerën 17,214,348 USD dhe "Albpetrol" SHA sasinë 82372 ton naftë brut, ose vlerën 27,185,231 USD.

Edhe në marrëveshje të tjera kontraktorët kanë krijuar detyrime ndaj Albpetrol për sasinë e naftës brut, nga ndarja e prodhimit. Deri në fund të 3 mujorit I, të vitit 2019, kontraktori i detyrohet Albpetrol SHA sasinë 81.59 ton naftë brut, ose shprehur në vlerë në shumën 26,929 USD, si dhe pagesa të pa realizuara për llogari të bonuseve të trajnimit vjetor në vlerën 151,586 USD.

**Posta  
Shqiptare**

Sistemet e kontrollit: Sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga shoqëria nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për shkak të mungesës së kuptimit të këtyre kriterëve, mosplotësimin të kërkesave për dorëzimin e deklaratave për cilësinë e kontrolleve të brendshme, mosplotësimin dhe mosdorëzimit pyetësorëve të vetëvlerësimit, regjistrin të risqeve, rregullores pa mbështetje në strukturën organizative, veprimeve rregulluese të kryera nga jashtë. Strukturat e auditit është e krijuar në përputhje me dispozitat ligjore, është efciente dhe e pavarura dhe ka një mbulim të plotë në fushat e auditimit.

## **Hekurudha Shqiptare**

Nga shoqëria, referuar realizimit të treguesve ekonomik për tre vite, ka rezultuar se investimet janë planifikuar tej mundësive reale të menaxhimit të fondeve. Ky realizim paraqitet në nivele shumë të ultë, që tregon për planifikime optimiste dhe të paargumentuara të tyre. Nga shoqëria, referuar realizimit të treguesve ekonomik për tre vite, ka rezultuar se investimet janë planifikuar tej mundësive reale të menaxhimit të fondeve. Ky realizim paraqitet në nivele shumë të ultë, që tregon për planifikime optimiste dhe të paargumentuara të tyre.

Dëmet ekonomike të konstatuara ardhur si pasojë e keq menaxhimit në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave, kryesisht të kontratatve të mirëmbajtjes së sistemeve online që shoqëria ka në përdorim për shërbimin e ofruar për publikun.

Efekte negative financiare kanë ardhur si pasojë e mos zbatimit dhe interpretimit jo korrekt të legjislacionit në fuqi si dhe mos argumentimit të nevojës për publicitetin dhe marketingun e shërbimeve të Postës Shqiptare sha.

Sistemet e kontrollit: Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit është e pavarur por është jo efiçente.

Nga auditimi u konstatua se shkeljet kryesore, dëmi ekonomik dhe efekti negativ/shpenzime jo në përputhje me parimin e 3-E-ve, është në këto drejtime:

Performanca e treguesve ekonomiko-financiare për periudhën objekt auditimi, si dhe detyrimet e prapambetura ndaj të tretëve, kredi afatshkurtër e afatgjatë, për principial dhe interesa, fatura për blerje etj., pasqyrojnë qartazi jo vetëm një krizë të mprehtë likuiditeti të Shoqërisë Hekurudha Shqiptare, por vazhdimësia në këto tregues performance për një periudhë të gjatë po e çon shoqërinë drejt falimentimit.

Problematikë e konstatuar në funksionimin e kësaj shoqërie është transporti hekurudhor privat. Moszbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore nga transportuesit hekurudhor privat që operojnë në rrjetin hekurudhor pronë e Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, sjell një risk të lartë dhe mund të cenojë sigurinë e lëvizjes së trenave, të jetës së udhëtarëve dhe të mallrave, të ruajtjes së pronës, mbrojtjes së mjedisit dhe shfaq një rrezik potent në ecurinë e veprimtarisë së vetë shoqërisë.

Po ashtu, shoqëria “Hekurudha Shqiptare” SHA, Durrës nuk ka kryer likuidimi në kohë të detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaj. Konkretisht për periudhën 01.01.2018 deri me 31.05.2019, detyrimi i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” SHA, Durrës ndaj hekurudhave të huaja është në vlerën 3,560,884 euro ose 439,498 mijë lekë dhe nga moskryerja e pagesave në kohë vlera e penaltetit të akumuluar është në shumën 476,545 euro.

## **Ujësjiellës**

### **Shkodër**

Sistemet e kontrollit: Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit është e pavarur por është jo efiçiente.

Nga auditimi u konstatua se shkeljet kryesore janë:

Shoqëria "Ujësjiellës Kanalizime" SHA Shkodër ka bërë rivlerësimin e të gjitha aktiveve të shoqërisë dhe nga procesi i rivlerësimit, kapitali i shoqërisë ka rezultuar në vlerën 2,698,774 mijë lekë dhe nuk është miratuar ndryshimi i kapitalit në Asamblenë së Përgjithshme, nuk është bërë ndryshimi në statut QKB.

Një nga problemet e trashëguara në UK Shkodër janë humbjet e ujit në rrjet, sipas bilancit të ujit për vitin 2018 volumi i ujit të prodhuar i vlerësuar nga shoqëria rezulton se humbjet janë në masën 61 % nga lidhje të paligjshme.

Dëmi ekonomik i konstatuar është në fushën e prokurimeve publike, gjatë fazës së zhvillimit të prokurimit (perlllogaritja e fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike, vlerësimi i ofertave) dhe në zbatimin e kontratave, ku në disa raste janë marrë në dorëzim mallra të cilat nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të sanksionuar në kontratë.

## **Ujësjiellës**

### **Lushnjë**

Sistemet e kontrollit: Nuk janë të dizajnuara saktë. Edhe në rastin kur janë dizajnuar nuk janë efektive. Nuk njihen nga punonjësit. Strukturat e auditit është e pavarur por është jo efiçiente.

Shkeljet dhe mangësitë kryesore në këtë shoqëri janë të njëjta si dhe në shoqëritë e ujësjiellësve të tjerë, dhe kanë të bëjnë me mos arritjen e realizimit të treguesve kryesor ekonomik. Shoqëria nuk arrin që të vjel të ardhurat në raport me sasinë e ujit të prodhuar dhe faturuar te konsumatorët. Mos marrja e masave për reduktimin e humbjeve në rrjete si për zvogëlimin/uljen e humbjeve teknike, por edhe për reduktimin e lidhjeve të paligjshme. Hartimi i plan bizneseve vjetor dhe planeve afatmesëm, rezulton se janë të paargumentuar dhe jo të mbështetur në një studim të hollësisht pa identifikuar saktë lindjen e nevojës dhe mundësinë e realizimit. Në shumë raste ka mos realizim të investimeve dhe të të ardhurave.

## **Projekt**

### **IPA 2012 në AKU**

#### **"Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri"**

Sistemet e kontrollit: Në projekte nuk ka një strukturë auditimi, për arsye se në bazë të marrëveshjeve financiare përkatëse (ratifikuar në parlament me ligje) është vetë huadhënësi, Njësitë e Zbatimit/Menaxhimit të Projektit, strukturat e tjera të përcaktuara në marrëveshjet financiare dhe konsulentit, të cilët luajnë rolin e strukturave të auditimit, si dhe janë këto strukturat të cilat dizenojnë dhe zbatojnë sistemet e kontrollit, në përputhje me Manualin operacional të projekteve.

Nga auditimi është konstatuar dhe janë nxjerr ne pah mangësitë në implementimin e fondeve IPA, ku rezulton se strukturat e përfshira në zbatimin e projektit kanë mangësi të theksuara në koordinimin e punëve, kështu CFCU (Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve

dhe Kontraktiveve) e cila është përgjegjëse për menaxhimin e fondeve nuk bashkëvepron me strukturat të cilat janë përfituesit fundor të investimit, ku në shumë raste këto të fundit janë të përfshira më tepër në aspektin formal dhe në momentin kur duhet të marrin në dorëzim investimin përkatës ka rezultuar se janë shfaqur probleme si administrative ashtu dhe teknike. Agjencia Kombëtare e Ushqimit (AKU) është përfituesja fundore e benefiteve të projektit, por AKU nuk ka arritur të përfitoj sa është synuar në këtë projekt duke mos siguruar përmirësimin e kapacitetit të rrjetit laboratorik për të kryer monitorimin dhe analizën e ushqimit dhe produkteve ushqimore me referencë specifike në fushat e monitorimit të mbetjeve të pesticideve, diagnostikimin mikrobiologjik në ushqim dhe ushqim për kafshë, standardet e cilësisë së ushqimit, sëmundjet e kafshëve, në përputhje me përmirësimin e standardeve kombëtare.

Kontrata për blerjen e pajisjeve është lidhur nga CFCU dhe pagesat janë kryer prej saj duke bërë kështu miratimin e tyre, përmes një procedure jo normale (me rezultatet e saj) duke u mjaftuar me dorëzimin e pajisjeve dhe specifikimeve teknike të kontratës, në një kohë kur nuk arriheshin rezultate të pritshme nga pajisjet e instaluara dhe për rrjedhojë nuk mund të siguroheshe funksionaliteti i pajisjeve për dhënien e analizave të sakta. Gjithashtu pajisjet nuk janë të regjistruar në kontabilitet.

**Projekti**  
**IPA**  
**2013“Ndërtimi i Sistemit të Kanalizimit në Vlorë, Faza II”, IPA 2013**

Sistemet e kontrollit: Në projekte nuk ka një strukturë auditimi, për arsye se në bazë të marrëveshjeve financiare përkatëse (ratifikuar në parlament me ligje) është vetë huadhënësi, Njësitë e Zbatimit/Menaxhimit të Projektit, struktura të tjera të përcaktuara në marrëveshjet financiare dhe konsulenti, të cilët luajnë rolin e strukturave të auditimit, si dhe janë këto struktura të cilat dizajnojnë dhe zbatojnë sistemet e kontrollit, në përputhje me Manualët operacional të projekteve.

Efekt negativ financiar/shpenzime jo në përputhje me 3-E në shumë 19,100 mijë lekë.

Nga auditimi rezultoi se projekti “Ndërtimit i sistemit të kanalizimit në Vlorë, Faza II”, ka probleme të dukshme në tërësinë e tij dhe “nuk ka realizuar objektivat e kontratës së nënshkruar.”

Në projektin fillesat, të financuar nga fondet IPA të BE-së, parashihej ndërtimi i një impianti për trajtimin e ujërave të ndenjura. Ky impiant është ndërtuar, por nuk e kryen funksionin për të cilin është akorduar financimi. Ai funksionon vetëm për largimin e mbetjeve mekanike dhe yndyrat/vajrat nga ujërat e ndotura por jo nga elementët kimikë dhe bakteriologjikë, që janë

problemi kryesor i ndotjes së ujërave që derdhen në det. Kjo mangësi ka ardhur për shkak të mungesës së komunikimit ndërmjet zbatuesit dhe përfituesit final të projektit, Ujësjetës Kanalizime SHA Vlorë. Palët kanë nisur të ftillohen për problemet, vetëm në fazën e fundit të punimeve, pra “kur kishte përfunduar ndërtimi i impiantit. “Koordinatorët e IPA, kanë ndërprerë financimet dhe fondi prej 3.4 mln euro nuk mund të përfitohet, pa u plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në kontratë.

Kjo situatë është shkaktuar së pari nga paaftësia e autorëve të projektit të cilët kanë parashikuar një impiant vetëm për ujërat e zeza, ndërsa duhet të bëhej një projekt i llogaritur “për një rrjet të kombinuar të ujërave të bardha me atë të ujërave të zeza, siç edhe është faktikisht rrjeti i kanalizimeve të qytetit të Vlorës.”

**Projekti  
“Ndërtimi i  
Rrugës  
Qukës-Qafë  
Plloçë”**

Sistemet e kontrollit: Në projekte nuk ka një strukturë auditimi, për arsye se në bazë të marrëveshjeve financiare përkatëse (ratifikuar në parlament me ligje) është vetë huadhënësi, Njësitë e Zbatimit/Menaxhimit të Projektit, struktura të tjera të përcaktuara në marrëveshjet financiare dhe konsulenti, të cilët luajnë rolin e strukturave të auditimit, si dhe janë këto struktura të cilat dizenojnë dhe zbatojnë sistemet e kontrollit, në përputhje me Manualët operacional të projekteve.

Projekti “Ndërtimi i rrugës Qukës Qafë Plloçë” është projekt i cili është i strukturuar në tre lote me bashkë financimi nga Banka Botërore (IDA) për lotin I dhe II në shumën 125 milionë USD, ndërsa për lotin III financimi është I Bankës Islamike në shumën 25 milionë USD. Ky projekt rezulton se ka një vonesë të konsiderueshme në zbatimin e tij dhe kjo vjen kryesisht për mos përfundimin dhe pezullimin e punimeve për lotin III, si pasojë e mungesës së fondeve nga pala shqiptare. Për këtë lot në marrëveshjen financiare midis BI dhe palës shqiptare është përcaktuar se shuma e dhënë në formë huaje është në shumën 25 milion USD dhe pjesa tjetër e financimit do të përballohet nga shteti shqiptar.

Projekti duhet të përfundonte në vitin 2018, ndërkohë që deri në fund të muajit tetor 2019, nuk është realizuar më shumë se 57 % e disbursimeve. Referuar ndryshimeve të miratuara deri në momentin e auditimit dhe ato në proces miratimi, kosto e projektit rritet me vlerë mbi 59 milionë USD, vlerë e cila pritet të rritet deri në përfundim të projektit, duke i kushtuar shumë buxhetit të shtetit në investimet me financime të huaja.

Mbështetur në gjetjet nga auditimi, kemi arritur në konkluzionin se nga strukturat drejtuese të projektit nuk janë marrë hapat e duhur për njoftimin në kohë të pasojave që sjell mos financimi i plotë i projektit, veçanërisht i lotit 3. Janë krijuar vonesa kryesisht në zbatimin e kontratave të punimeve civile, vonesa të cilat kanë

rezultuar me vonesë të projektit në tërësi, ndryshimin herë pas here të planit të disbursimeve, si dhe kosto shtesë kryesisht si pasojë e zgjatjes së afatit të kontratave të shërbimeve konsulentë, konkretisht për mbikëqyrjen e punimeve. Nga ana e ARRSH nuk janë marrë masat e duhura për realizimin e prokurimeve për shërbimin e projektimit, pasi projekt-zbatimi ka rezultuar me mangësi të theksuara. Nga auditimi kanë rezultuar efekte negative financiare me vlerë 582.5 mijë USD, vlerë e cila përbën pagesa për mjete transporti të pa nevojshme, punime të dëmtuara nga rrëshqitjet e skarpateve si dhe dëm ekonomik me vlerë 37.4 mijë USD, i cili rezulton nga pagesa për shërbime të pa realizuara për transport personeli.

**Projekti**  
**“Fuqizimi i**  
**Qendrës**  
**Traumatologjik**  
**e Kombëtare**  
**të Tiranës”**

Sistemet e kontrollit: Në projekte nuk ka një strukturë auditimi, për arsye se në bazë të marrëveshjeve financiare përkatëse (ratifikuar në parlament me ligje) është vetë huadhënësi, Njësitë e Zbatimit/Menaxhimit të Projektit, struktura të tjera të përcaktuara në marrëveshjet financiare dhe konsulenti, të cilët luajnë rolin e strukturave të auditimit, si dhe janë këto struktura të cilat dizenojnë dhe zbatojnë sistemet e kontrollit, në përputhje me Manualet operacional të projekteve.

Mangësitë dhe shkeljet kryesore të konstatuara në këtë projekt, i cili është financim i Qeverisë Shqiptare në shumën 5,000,000 Euro akorduar në formë kredi dhe një donacion në shumën 150,000 Euro, në mënyrë të përmbledhur janë:

U konstatuan devijime nga kuadri rregullator përse i përket, përcaktimeve të bëra në marrëveshjet e financimit duke zbatuar ndryshimet e marrëveshjes qeveritare ende pa hyrë në fuqi këto ndryshime. Në lidhje me detyrimet e kontraktorëve për pagesat e tatimit mbi fitimin në Republikën e Shqipërisë të cilët nuk kanë aplikuar për eliminimin e tatimit të dyfishtë, konfirmuar kjo edhe nga komunikimi zyrtar me e-mail me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë veprim i cili është në kundërshtim me nenin 17 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në total detyrimi i papaguar është në shumën 608,041.95 Euro.

Në lidhje me zbatimin e kontratave u konstatuan mos respektimi i afateve të lëvrimit të mallit dhe mos aplikimi i penalteteve për këto vonesa në vlerën 195,312.5 Euro. Projekti deri në fund të periudhës së auditimit ka përfunduar zbatimin e tij në terren, por në lidhje me disbursimet (pagesat) është në masën 80%. Një problematikë tjetër e hasur në këtë projekt, por që jo rrallë herë shoqëron edhe projekte të tjera me financime të huaja, lidhet me faktin e ndryshimit të strukturave të zbatimit të projektit. Kështu ky projekt ka filluar me një NJZP të ngritur në Ministrinë e Mbrojtjes, por duke qenë se përfituesi fundor Spitali i Traumës

kaloi nën vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë, u ngrit një strukturë e re në MSH, dhe ky fakt ka shoqëruar projektin si në vonesën e imlementimit të tij por edhe të mangësisë së dokumentacionit dhe praktikave të ndryshme shkresore.

#### ***II.4.4 Auditimet e përputhshmërisë në fushën e menaxhimit të pronave***

KLSH në përmbushje të misionit të tij në auditimet e përputhshmërisë në ish ZVRPP-të i ka kushtuar një rëndësi të veçantë procesit të regjistrimit të pronave, ligjëshmërisë së transaksioneve të kryera me to, tjetërsimit të pronave publike, falsifikimit të dokumentacionit të pronësisë me qëllim përfitimin padrejtësisht të titujve të pronësisë në zonat turistike dhe bregdetare, si dhe mënyrës së marrjes së shërbimit të ofruar qytetarëve nga zyrat e regjistrimit me qëllim rritjen e transparencës për publikun dhe forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë në administratën publike.

*- Nga auditimi në ish-Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme gjatë vitit 2019 KLSH ka konstatuar një sërë shkeljesh e mangësish në pothuajse të gjitha auditimet e zhvilluara. Në mënyrë të përmbledhur, shkeljet e konstatuara në auditimet e zhvilluara nga KLSH, konsistojnë në:*

- ✚ Vonesa në administrimin e praktikave dhe kërkesave në proces, mungesa e transparencës për publikun;
- ✚ Mos evidentimi dhe mos respektimi i procedurave të regjistrimit të pronave me mbivendosje;
- ✚ Regjistrimi i lejeve të legalizimit në kundërshtim me kriteret ligjore, distancat nga rrugët, detet dhe lumenjtë, në prona publike, në zona të mbrojtura, mbi pronën e objekteve të kultit;
- ✚ Regjistrimi i lejeve të ndërtimit në kundërshtim me kriteret ligjore, mbi truall shtetëror;
- ✚ Regjistrime pasurish me ndryshime të zërave kadastral;
- ✚ Regjistrimi në bashkëpronësi të paligjshme të pasurive bujqësore;
- ✚ Regjistrimi i pasurive të përfituara me AMTP të parregullta;
- ✚ Mos bërja e bilancit AMTP-LN, printim III dhe regjistrime të pasurive truall dhe ndërtesë në zonat urbane të fshatrave, në mungesë të listave të trojeve sipas kryefamiljarëve;
- ✚ Tjetërsimi i pronave publike, falsifikimit të dokumentacionit të pronësisë me qëllim përfitimin padrejtësisht të titujve të pronësisë, kryesisht për tokat bujqësore;
- ✚ Regjistrimi me mangësi i pasurive të përfituara nga kontratat e privatizimit me Entin Kombëtar të Banesave;
- ✚ Regjistrimi me mangësi i pasurive të përfituara;
- ✚ Keqmenaxhim dhe keqadministrim i pronave publike të transferuara me VKM njësive të qeverisjes vendore.

Në auditimet e kryera në ish Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t, janë evidentuar këto problematika:

- ✚ Janë legalizuar objektet pa u arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë, ku mungon bashkëpunimi me Bashkitë duke krijuar një mungesë të ardhurash ne buxhetin e shtetit 69,193 mijë lekë;
- ✚ Në rreth 50 % e tyre lejet e legalizimit janë lëshuar vetëm për objektin me shënimin në lejen e legalizimit “Kalimi i pronësisë për parcelën ndërtimore do miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave” pa u arkëtuar detyrimi i parcelës ndërtimore;
- ✚ Janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët, është cenuar trupi i rrugës, nuk ka korrespondencë shkresore me ARRSH si organi kompetent;
- ✚ Janë kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të lumit, përroi, kanal dhe digë pa respektuar distancat nga brigjet dhe në këtë rast procesi i legalizimit duhej të ishte kushtëzuar prej autoriteteve të ujit;
- ✚ Në regjistrimin e dokumentacionit të pronësisë lëshuar nga ZVRPP, parcela ndërtimore e zënë ndodhet e regjistruar në pasurinë e llojit “Arë, Pyll”, duke ndryshuar zërin kadastral, regjimin e tokës në llojin e pasurisë “Truall”
- ✚ Leje legalizimi janë dhënë për objektet informale poshtë linjës së tensionit të lartë;
- ✚ Janë kryer legalizimi të objekteve informale të ndërtuar më pas nga periudha e përcaktuar ligjore;
- ✚ Vazhdojnë kryerja e legalizimit për objekte që ndodhet në Zonën Arkeologjike dhe Zonave të Mbrojtura;
- ✚ Janë legalizuar objekte në pronë të objekteve të kultit (Kryegjyshatës Botërore Bektashiane);
- ✚ Nuk është respektuar afati 60 ditor për marrjen e vendimit për kualifikimin ose shkualifikimin e praktikës së legalizimit, ndërkohë që nuk është respektuar afati 30 ditor për lëshimin e lejes së legalizimit nga data e kualifikimit.

- Nga auditimet në fushën e mjedisit kanë rezultuar problematikat e mëposhtme:

- ✚ Performancë e ulët në kryerjen e inspektimeve, shoqëruar me mungesë dokumentacioni, mungesë inspektimi në të gjithë territorin, të vendosjes së sanksioneve për shkeljet, mosndjekje të arkëtimit të gjobave;
- ✚ Nuk ka patur bashkëpunim të sektorëve të inspektimit të policisë pyjore të ISHMP me strukturat e tjera policore e shtetërore dhe drejtoritë përkatëse të menaxhimit të pyjeve të pushtetit vendor, lidhur me shkëmbimin e informacionit, për të bërë të mundur parandalimin e kundërvajtjeve, si dhe zbulimin e rasteve të konstatuara pa autor, për dëmet e shkaktuara në ekonominë pyjore;
- ✚ Për periudhën e audituar, janë marrë vendime administrative “gjobë” në vlerën 17,640 mijë lekë, janë përcjellë me shkresa në Gjykatën Administrative për kthim në titull ekzekutiv, por nuk ka arkëtim të tyre;
- ✚ Nuk ka kryer asnjë inspektim në monumente të natyrës shqiptare, si një resurs i madh me funksion nxitës për turizmin dhe do kishte ndikim në mbrojtjen dhe ruajtjen e tyre.

Më të detajuar problematikat sipas subjekteve janë si më poshtë vijon:

## ZVRPP Bulqizë

*Dëmi i konstatuar: 341 mijë lekë, si pasojë e regjistrimit të titullit të pronësisë në mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Në **8 raste** është konstatuar regjistrimi i pasurive të paluajtshme në bazë të lejes së legalizimit, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, ka ndodhur tjetërsimi i pasurive ndërtesë të regjistruara në pronësi “shtet, duke fshirë të drejtën e pronësisë së shtetit dhe tjetërsuar tek personat posedues të lejeve të legalizimit, në mungesë të dokumentacionit ligjor.

-Në **17 raste** është konstatuar regjistrim i pasurive të paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve përkatëse, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, duke përfutur në mënyrë të padrejtë rreth 90000 m<sup>2</sup>.

-Në **10 raste** është konstatuar regjistrimi i pasurive të paluajtshme me parregullsi dhe në mungesë të dokumentacionit urbanistik tekniko ligjor, si dhe në mungesë të marrëdhënieve me truallin.

-Në **5 raste** është konstatuar regjistrimi i pasurive të paluajtshme të shoqërive tregtare, të krijuara nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore, ku mungon dokumentacioni.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit është përgatitur **kallëzim penal për 5 punonjës** të ish ZVRPP Bulqizë. Gjithashtu janë rekomanduar **1 masë** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **49 masa** organizative, **1 masë** për eliminimin e efekteve negative financiare si dhe **3 masa** disiplinore.

## ZVRPP Tropojë

*Dëmi i konstatuar: 300 mijë lekë, si pasojë e kamatëvonesave për regjistrime të aktit të fitimit të pronësisë jashtë afateve ligjore.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Në 15 raste është konstatuar regjistrimi i pasurive toka bujqësore dhe kryerjen e transaksioneve, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi për një trung familjar janë lëshuar 2 e më shumë AMTP, duke shkelur kriterin e ndarjes së tokës sipas normës për frymë të çdo fshati, dhe ndarë tokë në mënyrë jo të barabartë.

- Në 39 raste, ka kryer regjistrime sipas të dhënave të Librit të Ngastrave, të vitit 1998 dhe referencave përkatëse, ka regjistruar pasuri tokë “Arë” dhe ka lëshuar certifikata pronësie, në mungesë të (AMTP).

-Në 2 rast, në fshatin Valbonë, ZVRPP Tropojë ka regjistruar leje ndërtimi për objekte me sipërfaqe 452m<sup>2</sup> në favor të Bashkisë Tropojë në Zonën e Mbrojtur të Valbonës.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **1 masë** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **26 masa** organizative, si dhe **2 masa** disiplinore.

## ZVRPP Gramsh

*Dëmi i konstatuar: 858 mijë lekë, si pasojë e moslogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Në **22 raste** është konstatuar se Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), ka vijuar me regjistrimin e lejeve të legalizimit të objekteve informale mbi troje të zëna nga objekte të vjetra, me mangësi në dokumentacionin e paraqitur për regjistrim, pasi gent plani dhe planimetrit e objekteve informale.

-Në **7 raste** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gramsh (ish-ZVRPP Gramsh), nuk ka respektuar afatet e përcaktuara ligjore për dhënien e shërbimit të kërkuar qytetarëve, duke krijuar vonesa në disa raste deri në një vit,.

-Në **5 raste**, regjistrimi i AMTP është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore, pasi AMTP nuk është e rregullt, nënshkrimi i marrësit në pronësi dhe Kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës nuk janë e rregullta, pa u bërë verifikimi i elementëve të formës dhe të përmbajtjes i dokumentacionit.

-Në **10 raste** nuk janë ndjekur rregullisht proceset gjyqësore, duke rezultuar “në mungesë”, në seancat përfundimtare të procesit gjyqësor, duke riskuar ankimimin brenda afateve të vendimeve të gjykatave, për të bërë të mundur ndjekjen e të gjitha shkallëve të gjykimit.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **4 masa** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **36 masa** organizative dhe **1 masë** disiplinore.

## ZVRPP Lushnjë

*Dëmi i konstatuar: 13,114 mijë lekë si pasojë e mungesës së dokumentacionit që konfirmon shlyerjen e detyrimeve për blerjen e objektit të privatizuar, nga mos pagesa e Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, nga mungesa e pagesës së taksës së shërbimit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-ZVRPP Lushnje në **27 raste** ka regjistruar pasuritë e paluajtshme për poseduesit e AMTP-ve, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, në mungesë të dokumentit ligjor “Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive”, që shërben për regjistrimin e pasurisë.

-Në **12 raste** është konstatuar se janë kryer regjistrime të pasurive të paluajtshme, në favor të poseduesve të AMTP-ve, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi është regjistruar një sipërfaqe toke prej 27070 m<sup>2</sup>, më tepër se sipërfaqja takuese përcaktuar në AMTP-të përkatëse.

- Në **8 raste** konstatohet se regjistrimi është, pa dokumentacioni urbanistik tekniko ligjor nuk është i saktë dhe nuk është i plotë, si dhe regjistrimi i objektit, është kryer në mungesë të marrëdhënieve

më truallin, pasi trualli është në pronësi “shtet”.

-Në **3 raste** ZVRPP Lushnje, ka regjistruar pasuritë në bazë të lejeve të legalizimit, jo në përputhje me kërkesat ligjore, pasi ka mospërputhje të dhënash lidhur me sipërfaqen e ndërtimit, numrin e kateve.

-Janë konstatuar 654 praktika të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të pa përfunduara që prej 5-10 vite, pa dhënë shërbimin e faturuar të cilat kanë sjellë si pasojë mungesën e transparencës së punës së ZVRPP-ve ndaj publikut.

-Në **6 raste** nuk janë ndjekur rregullisht proceset gjyqësore, duke rezultuar “në mungesë”, në seancat përfundimtare të procesit gjyqësor, në të cilat ish ZVRPP-ët kanë qenë palë e paditur apo palë e trete.

*Të tjera:* Në përfundim është dërguar materiali për indicie penale. Gjithashtu janë rekomanduar **61 masa** organizative, **6 masa** për zhdëmtimin e dëmit ekonomik, **1 masë** për eliminimin e efekteve negative financiare si dhe **11 masa** disiplinore.

## ZVRPP

### Gjirokastër

*Dëmi i konstatuar: Në këtë auditim nuk është konstatuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Në **32 raste** është konstatuar regjistrimi i pasurive të paluajtshme tokë bujqësore në pronësi “shtet”, të tjetërsuara me AMTP të lëshuara nga Këshilli i Qarkut, që nuk ka asnjë kompetencë apo tagër ligjor për të lëshuar këto akte.

-Në **38 raste** ose në 150 mijë m<sup>2</sup> është konstatuar regjistrimi i pasurive me ndryshime të zërave kadastral pa dokumentacionin përkatës, duke sjellë si pasojë zhvlerësim të paligjshëm të vlerës së aseteve, resurseve nga zbritja në kategori e zërit kadastral.

-Në **18 raste** ZVRPP Gjirokastër ka regjistruar pasuritë e paluajtshme përfituar me leje legalizimi, duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi lejet e legalizimit kanë miratuar parcela ndërtimore, me sipërfaqe më tepër se sipërfaqja takuese sa trefishi i sipërfaqes së bazës së objektit.

-Në **17 raste** ZVRPP Gjirokastër ka regjistruar pasuritë e paluajtshme bazuar në dokumentacionin urbanistik, ku rezulton se regjistrimi është kryer me parregullsi, pasi dokumentacioni ligjor urbanistik nuk është origjinal, por fotokopje e pa noterizuar, si dhe është kryer në mungesë të marrëdhënieve me truallin.

-Në **12 raste** është konstatuar se regjistrimi i pasurive të paluajtshme të përfituara me vendime të pushtetit vendor (rastet kur zotërohen akte pronësie, por nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen), është kryer duke mos zbatuar kërkesat ligjore, pasi ka mungesë të dokumentacioni, si dhe në disa raste është përfituar truall në mënyrë të pa drejtë.

-Në **5 raste** është konstatuar se regjistrimi i pasurive të paluajtshme

truall në pronësi “shtet”, është kryer *duke mos zbatuar kërkesat ligjore*, të tjetërsuara me kontratë shitje nga pushteti vendor, *që nuk ka asnjë kompetencë apo tagër ligjor* për të kryer shitjen e truallit me pronar “shtet”.

-Në janë ZVRPP Gjirokastrë konstatuar **1236 praktika** të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të pa përfunduara që prej 5-10 vite, pa dhënë shërbimin e faturuar publikut.

-Në **6 raste** nuk janë ndjekur rregullisht proceset gjyqësore, duke rezultuar “në mungesë”, në seancat përfundimtare të procesit gjyqësor, *në të cilat ZVRPP Gjirokastrë, ka qenë palë e paditur apo palë e trete*, duke riskuar ankimimin brenda afateve të vendimeve të gjykatave, për të bërë të mundur ndjekjen e të gjitha shkallëve të gjyqimit.

*Të tjera:* Në përfundim është përgatitur **kallëzim penal për 7 punonjës**. Gjithashtu janë rekomanduar **69 masa** organizative dhe **7 masa** disiplinore.

## **ZVRPP Lezhë**

*Dëmi i konstatuar: 3,172 mijë lekë, si pasojë e të ardhurave të munguara nga mos llogaritja Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Nga auditimi i hartave të ZVRPP, janë konstatuar mbi **34 pasuri objekte** mbi sipërfaqet e lulishteve, që kanë sjellë si pasoje mosregjistrime, vështirësi në identifikimin e gjendjes juridike fizike dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

-Në **43 raste** nga verifikimi i hartës dixhitale nëpërmjet portalit ASIG si dhe HTR-ve, rezulton se objektet e legalizuara të cilat janë regjistruar dhe për të cilat janë lëshuar certifikata pronësie ndodhen brenda zonës së mbrojtur të Kune-Vain-Tale, Rezervat Natyror i Menaxhuar Park Natyror (Kategoria IV).

-Në **10 raste** në regjistrimin e pasurive shtetërore e publike, rezulton një indiferencë nga institucionet përkatëse, pushteti vendor dhe mungesë bashkëpunimi me zyrat e regjistrimit, për rrjedhojë është regjistruar një numër shumë i vogël i pasurive të transferuara me VKM-të përkatëse.

- Në **15 raste** janë tjetërsuar në mënyrë të paligjshme në favor të personave privatë sipërfaqja e tokës bujqësore prej 132565m<sup>2</sup> (13.25 ha) mbi bazën e AMTP-ve në përdorim apo të cilat nuk ka vulë apo nënshkrimin e kryetarit të Komisionit të Ndarjes së Tokës apo kanë qenë fotokopje të panjësuar me origjinalin nga organet përkatëse.

-Në **10 raste** janë regjistruar sipërfaqe 20029m<sup>2</sup> të llojit pemëtores, në kundërshtim me nenin 6 të Dekretit nr. 7011, dt. 03.12.1985, “*Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave.*”

-Janë kryer regjistrime të paligjshme pasurive të përfituara me AMTP, me shkelje të dispozitave ligjore, pasi janë regjistruar pasuri që nuk janë të llojit tokë bujqësore, për të cilat AMTP-ja nuk mund

të shërbejë si Titull Pronësie, janë ndryshuar zëra kadastral nga “Truall” në tokë “Arë” dhe “Ullishte” pavarësisht faktit se nuk kanë qenë objekt i ndarjes së tokës, apo në mungesë të konfirmimit të zërit kadastral nga DAMT.

-Në **3 raste** është konstatuar se ZVRPP Lezhë ka ndryshuar zërin kadastral nga ranishte në moçal.

*Të tjera:* Në përfundim materiali i auditimit ka shkuar **për indicie penale**. Gjithashtu janë rekomanduar **1 masë** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **42 masa** organizative dhe **3 masa** disiplinore.

## ALUIZNI

### Elbasan

*Dëmi i konstatuar: 69,193 mijë lekë të ardhura të munguara nga mos llogaritja Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë, nga penalitete të pavendosura për ndërtime informale.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

- Është bërë legalizimi në kundërshtim me përcaktimet ligjore për **1616 objekte informale**, pa marrë konfirmim mbi pagesën e Taksës së ndikimit në infrastrukturë për dalje me vendim kualifikimi;

- Në **6 raste**, janë legalizuar objekte social-ekonomikë, të kombinuara, banimi, të objekteve që ndodhen në Zonën e Mbrojtur të Parkut Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”;

- Në **5 raste**, janë lëshuar leje legalizime për objekt social-ekonomik të ndodhur brenda pasurisë “Pyll” dhe “Shkëmb”, me status juridik “Shtet”;

- Në **2 raste**, janë legalizuar objekte social-ekonomike dhe banimi, të cilat ndodhen pjesërisht në territore të institucioneve publike dhe shtetërore;

- Në **2 raste**, janë legalizuar objekte informalë, konstatua se legalizimi i këtyre objekteve ishte kryer në pozicionimin e pronës, në një distancë prej 69-94 m nga bregu i Lumit Devoll, me të cilin kufizohen objektet e legalizuara;

- Në **3 raste**, janë legalizuar objekte informalë, në një distancë prej 12 m – 21 m nga bregu i përrenjve;

- Në **3 raste**, konstatohet se objektet e legalizuara ndodhen në distancë me të vogël se 10 m nga rrugët nacionale të kategorisë “C”, dhe më pak se 5 m prej rrugës rajonale të kategorisë “F”.

- Në **3 raste**, janë legalizuar objekte informalë, në kushtet kur janë ndërtuar në një distancë shumë afër hekurudhës më pak 25 m;

- Në **13 raste**, janë legalizuar objekte informalë në kushtet kur parcelat ndërtimore janë në zërat kadastrale “Arë”, “Vreshtë”, “Pemishte”, Ullishte”, “Ledh”, etj;

- Në **7 raste**, janë legalizuar objekte informalë, të cilat sipas shkresave të ZVRPP-së, figurojnë të regjistruara në pronësi “Shtet”;

- Në **1 rast**, rezulton se kemi të bëjmë me shtesa (anësore apo në lartësi) tej lejes së ndërtimit, siç del nga leja e legalizimit, për rrjedhojë duhej që investitori të paguante për efekt të legalizimit, 2 përqind të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe 5

përqind për veprimtari social ekonomike. Gjithsej investitori duhej të paguante **2,068 mijë lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **2 masa** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **33 masa** organizative, **21 masa** disiplinore, si dhe **2 masa** për eliminimin e efekteve negative financiare.

## ALUIZNI

### Vlorë

*Dëmi i konstatuar:* **157,280 mijë lekë** si pasojë e moslogaritjes së taksës së infrastrukturës dhe si pasojë e përfitimit të padrejtë të vlerës së truallit.

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Në **4 raste**, rezulton se objekti është pa funksion dhe është i paqendrueshëm;

- Në **3 raste**, është kryer legalizimi i objektit informal të ndërtuar në buzë të detit pa respektuar distancat nga brigjet;

- Në **6 raste** kemi të bëjmë me një rritje fiktive të bazës së ndërtimit me një sipërfaqe prej 1053m<sup>2</sup>, si pasojë e të cilës është rritur fiktivisht edhe sipërfaqja e parcelës ndërtimore me 3159m<sup>2</sup>;

- Në **3 raste** objekti ndodhet brenda kufirit të brezit bregdetar të miratuar dhe distanca e tij nga bregu i detit është 23 m;

- Në **1 rast** objekti është legalizuar mbi një truall me leje ndërtimi;

- Në **13 raste** objektet janë legalizuar në kundërshtim me Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar;

- Në **3 raste** objektet janë legalizuar pasi janë ndërtuar jashtë afatit të përcaktuar ligjërisht;

- Në **4 raste**, janë kryer legalizime të objekteve pa respektuar distancat nga rrugët;

- Në **43 raste**, është kryer legalizimi i objekteve informale, duke mos zbatuar kërkesat ligjore lidhur me kalimin e pronësisë së parcelave ndërtimore, të miratuar në lejet e legalizimit përkatëse;

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit është përgatitur **kallëzim penal për 1 punonjës**. Janë rekomanduar **3 masa** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **23 masa** organizative, **10 masa** disiplinore, si dhe **1 masë** për eliminimin e efekteve negative financiare.

## Agjencia

### Kombëtar e Mjedisit

*Dëmi i konstatuar:* **1,976 mijë lekë** si pasojë e mosvendosjes së penaltetit për subjektet që nuk kanë respektuar detyrimet mjedisore, shpenzime për dietat si dhe penaltete për kontratat e monitorimit në mjedis.

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Nga AKM në 16 raste nuk janë respektuar procedurat ligjore të përcaktuara, në shqyrtimin dhe akt-miratimin e aplikimeve të bëra për pajisjen me leje mjedisore të tipit A dhe B.

-Në 8 raste, referuar regjistrin të raportimeve, 8 subjekte të cilët janë

pajisur me Leje Mjedisore të Tipit A, nuk kanë raportuar për shkarkimin e ndotësve, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore të miratuar për subjektin. Nga AKM nuk është marrë asnjë masë, me qëllim vendosjen e penaltetit për mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën rreth 135,900 mijë lekë.

-Në 6 raste, referuar regjistrin të raportimeve, 8 subjekte të cilët janë pajisur me Leje Mjedisore të Tipit A, nuk kanë raportuar për shkarkimin e ndotësve, për të cilat nga AKM nuk është marrë asnjë masë, me qëllim vendosjen e penaltetit për mosrespektimin e kushteve të lejes mjedisore, duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën rreth 123,840 mijë lekë;

-Rritje të paargumentuar të kostos financiare në vlerën 4,078 mijë lekë për kryerjen e shërbimit të monitorimit të ujërave nëntokësor për periudhën 2016-2019, nga projekti i përbashkët midis AKM-SHGJSH, për të cilën u rekomandua ndërprerja e këtyre projekteve.

-Në prokurimin publik me objekt "Për mirëmbajtjen e pajisjeve të monitorit" për vitin 2016, kanë kualifikuar ofertues i cili nuk i plotëson kriteret për kualifikim. përdorim i fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën 8,186,060 lekë pa tvsh.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **10 masa** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **24 masa** organizative, **24 masa** disiplinore, si dhe **3 masa** për eliminimin e efekteve negative financiare.

### **Shërbimi Gjeologjik Shqipëtar**

*Dëmi i konstatuar: Në këtë auditim nuk është konstatuar dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, por vetëm efekte negative financiare në buxhetin e shtetit në vlerën 4,078 mijë lekë.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

- Megjithëse SHGJSH e ka detyrim ligjor monitorimin e ujërave nëntokësor si dhe vendosjen e të dhënave të monitorimit në dispozicion të Ministrisë së Mjedisit, përgjatë periudhës 2016-2018, ka menaxhuar jo në përputhje me 3 E-të vlerën prej **4,078mijë lekë**, si rrjedhojë e kontratave të lidhura me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;

-SHGJSH për 3 vite nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për vënien në dispozicion të dhënave të gjeneruara nga projekti i monitorimit të ujërave nëntokësorë me fondet e veta;

-Për vitet 2016-2019 nga SHGJSH, është vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në kapitullin 1.2.1 "Vlerësimi i kostove të monitorimit" dhe më konkretisht i kostove për njësi për analizat laboratorike, ku nga SHGJSH në projekt-propozimin është dhënë vetëm vlera totale e shpenzimeve për analiza laboratorike, nuk ka analizë kostoje për njësi (analizë), sa reagentë do konsumohen për çdo analizë, duke rritur mundësitë për abuzime me fondet e buxhetit të shtetit.

-Nga shqyrtimi i raporteve teknike të dërguara në Ministrinë e Mjedisit për periudhën 2016-2018, nga SHGJSH, me të dhënat nga projekti i monitorimit të ujërave nëntokësor, kryer nga vet institucioni, rezulton se në këto raporte pasqyrohet informacion pjesor dhe jo i plotë.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **5 masa** organizative, **8 masa** disiplinore, si dhe **1 masë** për eliminimin e efekteve negative financiare.

**Drejtoria  
Rajonale  
e  
Inspektor  
atit  
Shtetëror  
të  
Mjedisit  
Pyjeve  
dhe  
Ujërave,  
Tiranë**

*Dëmi i konstatuar: 54,972 mijë lekë si pasojë e mosvendosjes së penaltetit për subjektet që nuk kanë respektuar detyrimet mjedisore.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

- Performancë e ulët në kryerjen e inspektimeve, shoqëruar me mungesë dokumentacioni, mungesë inspektimi në të gjithë territorin, të vendosjes së sanksioneve për shkeljet, mosndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e gjobave;

-Nuk ka patur bashkëpunim efektiv ndërmjet sektorëve të inspektimit të policisë pyjore të ISHMP, me strukturat e tjera policore e shtetërore dhe drejtoritë përkatëse të menaxhimit të pyjeve të pushtetit vendor, lidhur me shkëmbimin e informacionit.

- Mungesa e ri-inspektimeve ka sjellë mosverifikimin deri në pajisjen me leje mjedisore të subjekteve në proces licencimi dhe mosevidentimin e rasteve të refuzimeve, e llogaritur për 16 rastet me masën minimale të gjobës rezulton vlerën prej 4,800 mijë lekë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit.

-Në sektorin pyjor për 3/mujorin e IV, viti 2016 deri 2017 lidhur me dëmtimet në pyje nga kundravajtësit nga 23 raste me vlerë dëmi 43,492 mijë lekë, vetëm në 5 raste në vlerën prej 30,878 mijë lekë ka hartuar Procesverbale Vlerësimi Dëmi (PVD), të cilat i ka kallëzuar në prokurori, ndërsa në 18 raste me vlerën 12,614 mijë lekë, nuk janë hartuar PVD dhe nuk janë dërguar për arkëtim, që kanë sjellë pasojë mos arkëtime në vlerën 12,614 mijë lekë.

-Nga auditimi i kryerjes së inspektimeve rezultuan me mangësi e shkelje 432 praktika inspektimi (në mjedis 250 inspektime dhe në Pyje-kullota 162 inspektime), kundrejt 2435 inspektime të kryera ose në 17,7% të totalit të inspektimeve.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **2 masa** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **38 masa** organizative, si dhe **15 masa** disiplinore.

**Drejtoria  
Rajonale  
e  
Inspektor  
atit  
Shtetëror**

*Dëmi i konstatuar: 1,640 mijë lekë si pasojë e mosvendosjes së penaltetit për subjektet që nuk kanë respektuar detyrimet mjedisore.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

- Performancë e ulët në kryerjen e inspektimeve, shoqëruar me mungesë dokumentacioni, mungesë inspektimi në të gjithë territorin,

**të  
Mjedisit  
Pyjeve  
dhe  
Ujërave,  
Fier**

të vendosjes së sanksioneve për shkeljet, mosndjekje të procedurave ligjore për arkëtimin e gjobave;

-Nuk ka patur bashkëpunim efektiv ndërmjet sektorëve të inspektimit të policisë pyjore të ISHMP me strukturat e tjera policore e shtetërore dhe drejtoritë përkatëse të menaxhimit të pyjeve të pushtetit vendor;

-Për periudhën e audituar, janë marrë vendime administrative “gjobë” në 49 raste në vlerën **17,640 mijë lekë**, të ndara për sektorin e Inspektimit të Mjedisit 23 gjoba në vlerën 10,450 mijë lekë dhe për sektorin e Inspektimit të Pyjeve janë 26 gjoba në vlerën 7,190 mijë lekë. Nga këto 9 gjoba në vlerën **prej 980 mijë lekë**, janë përcjellë me shkresa në Gjykatën Administrative për kthim në titull ekzekutiv, Gjoba në ankimim gjyqësor në proces 2, gjoba në pritje të ankimimit gjyqësorë 5, gjobat të shfuqizuara si dhe gjoba në zyrën e përmbarimit 26, si dhe një gjobë e shlyer vullnetarisht.

-DR ISHMPUT Fier, në periudhën 3/Mujori IV-rë 2016 deri 31.12.2018, nuk ka parashikuar, planifikuar e nuk ka kryer asnjë inspektim në **31 monumente të natyrës shqiptare**, si një resurs i madh me funksion nxitës për turizmin në juridiksionin e Qarkut Fier shpërndarë përkatësisht: *Fier 5 objekte, Lushnjë 15 objekte, Mallakastër 11 objekte.*

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **2 masa** për përmirësim ligjor, **2 masa** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **28 masa** organizative, **2 masa** për eliminimin e efekteve negative financiare, si dhe **18 masa** disiplinore.

**Drejtoria  
Rajonale  
e  
Mjedisit,  
Elbasan**

*Dëmi i konstatuar: 825 mijë lekë si pasojë e mosvendosjes së penalitetit për subjektet që nuk kanë respektuar detyrimet mjedisore.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Raportet e vetëmonitorimit nuk janë vlerësuar teknikisht për shkarkimet apo ndërhyrjet që kanë në mjedis, në varësi të aktivitetit/veprimtarisë që ushtrojnë subjektet e ndryshme me Leje Tipi C, referuar dispozitave ligjore të mjedisit,

-Ka pajisur dhe miratuar leje mjedisore të tipit (C) gjithsej për 269 subjekte; nga të cilat kanë kryer pagesat e tarifave për 244 subjekte në vlerë 408 mijë lekë, ndërsa nuk kanë arkëtuar dhe janë debitorë 25 subjekte duke krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën **825 mijë lekë**;

-Në DRM Elbasan u konstatua se subjektet që paraqesin raportet e vetëmonitorimit, nuk kanë saktësinë dhe besueshmërinë e analizave, pasi mungojnë paralel laboratorët shtetërorë të certifikuar me ndihmën e të cilave do të mund të sigurohej verifikim dhe një informacion mbi saktësinë e raporteve sipas të dhënave teknike të laboratorëve të akredituar.

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **1 masë** për zhdëmtim të dëmit ekonomik, **13 masa** organizative, **1 masë** për

eliminimin e efekteve negative financiare, si dhe **6 masa** disiplinore.

#### **Drejtoria**

#### **Rajonale**

**e**

#### **Mjedisit,**

#### **Durrës**

*Dëmi i konstatuar: Nuk është konstatuar dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit.*

*Paligjshmëritë dhe parregullsitë:*

-Gjatë auditimit të kryer në DRM Durrës ka diferenca mes të dhënave që subjektet paraqesin në raportet e vetëmonitorimit dhe ndotjes reale të mjedisit prej tyre, kjo pasi në disa raste analizat e sjella prej tyre nuk kanë saktësi dhe besueshmëri të lartë;

-Raportet e vetëmonitorimit nuk janë vlerësuar teknikisht për shkarkimet apo ndërhyrjet që kanë në mjedis, në varësi të aktivitetit/veprimtarisë që ushtrojnë subjektet e ndryshme me Leje Tipi C;

-Në DRM Durrës për 112 subjekte për të cilët është bërë pezullimi lejes mjedisore për mos pagesë të tarifës vjetore të lejes mjedisore në total 265 subjekte, janë krijuar të ardhura të munguar për buxhetin e shtetit shuma 530 mijë lekë;

*Të tjera:* Në përfundim të auditimit janë rekomanduar **13 masa** organizative dhe **6 masa** disiplinore

## **II.5 Auditimet e performancës**

Tashmë auditimi i performancës është shndërruar në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Institucioni po e përqendron me sukses punën tek ky lloj auditimi dhe kjo vihet re, ndër të tjera, në aplikimin e elementëve të performancës edhe në auditime tradicionale, si ai i përputhshmërisë dhe financiar, të cilat shprehen gjithnjë e më tepër për ndikime dhe efekte në ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet; në ngritjen e auditimit të ri të Teknologjisë së Informacionit, me theks në performancën e sistemeve, platformave dhe programeve të transmetimit, ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave dhe informacionit, si edhe në impaktin që auditimi i performancës ka dhënë në media, publik dhe palë interesi, përmes punës audituese dhe publikimit të raporteve.

Gjatë periudhës Qershor 2018 – Dhjetor 2019, KLSH ka incijuar, realizuar dhe evaduar në total 22 auditime performance nga Departamenti i Auditimit të Performancës dhe 1 nga kapacitete audituese jashtë departamentit. Fushat ku është përqëndruar puna e departamentit kanë vijuar të jenë:

1. Reformat qeveritare;
2. Projektet & shërbimet social-ekonomike;
3. Projektet infrastrukture;
4. Projektet mjedisore & energjitike;
5. Projektet & shërbimet social-kulturore.

16 auditimet e evaduara vetëm për vitin 2019 u kryen në mbi 70 subjekte, me një numër gjetjesh, konkluzionesh e rekomandimesh, respektivisht mbi 500, 400 dhe

350. Mesatarisht për çdo auditim u realizuan 35 gjetje, 25 konkluzione dhe 25 rekomandime, shifra këto pak a shumë të njëjta me një vit më parë.

Nga pikëpamja e 3E-ve, gjetje, konkluzione e rekomandime që adresonin ekonomikitetin ishin 150, eficiensën 450 dhe efektivitetin 650.

Për çdo auditues efektiv performance apo që ka realizuar auditime performance (konvertuar audituesit part-time të dept. të tjera në raportin 2 me 1), gjetjet mesatare për auditues janë 31, konkluzionet 25 dhe rekomandimet 23.

Lidhur me raportin klasik të eficiensës së punës audituese, atë që krahason paratë e kursyera nga puna audituese, me paratë e shpenzuara për këtë punë, dept., për shkak të pamundësisë për të monetarizuar në çdo rast dhe aktualisht 3E-të e munguara, nuk është llogaritur si parametër.

Nga pikëpamja e lëvrimin kohor, 7 nga 16 auditime u evaduan gjatë 6-mujorit të parë të vitit, ndërsa pjesa tjetër në gjysmën e dytë të tij.

Për sa i përket cilësisë së auditimeve, konstatohet se:

- a) Departamenti po konvergon gjithnjë e më tepër drejt strukturës raportuese të unifikuar në manual;
- b) Temat e përzgjedhura priren të reflektojnë problematikën qytetare dhe kritere të tjera të qenësishme, si materialitetin, auditueshmërinë, testimin e teknikave të reja, auditimet rajonale e evropiane, etj.
- c) Njohja dhe respektimi i standardeve ISSAI të performancës është në nivelin e duhur dhe kryesisht kjo bie në sy kur evidenca audituese nuk merret e gatshme nga subjekti (gjenerohen të dhëna parësore) dhe konkludohet pas një analize të mbështetur në teknika të procesimit të informacionit.
- d) Analiza e riskut ka ende vend për t'u përmirësuar në një pjesë të mirë të auditimeve. Grupet audituese kryejnë analizën SWOT ose PESTLE, duke bërë vlerësimin, kategorizimin dhe renditjen e riskut, që më pas të fokusojnë natyrshëm problemin e performancës. Në këtë aspekt, një rol kyç ka luajtur edhe dept. i metodologjisë, me punën e tij trajnuese e testuese.
- e) Një pjesë e mirë e grupeve të auditimit duhet ende të shkathtësohen në ndërtimin e piramidës së çështjeve që duhen audituar, kjo edhe si pasojë e vlerësimit disi fiktiv të risqeve. Sikurse është theksuar edhe në vlerësimet e dosjeve audituese, kjo piramidë duhet të markohet me teknikat e vjeljes, përpunimit dhe analizimit të informacionit për pyetjet e nivelit më të ulët, kalendarin kohor të realizimit të punës apo alokimit të burimeve të tjera për kthimin e përgjigjes dhe audituesin që mban përgjegjësi për cilësinë e punës me atë çështje. Të gjitha këto, jo vetëm që orientojnë më mirë punën, por kursejnë kohën dhe rrisin produktivitetin.
- f) Nga pikëpamja e kritereve, çdo grup auditimi ka referenca me bollëk në auditimet që kryhen, duke vendosur jo thjesht kriteret ligjore, por edhe kritere të tjera të BE-së apo praktika të mira.
- g) Përgjithësisht observacionet e subjekteve vlerësohen dhe reflektohen me kujdesin dhe seriozitetin e duhur dhe në këtë drejtim stimulohen audituesit të bëjnë më tepër takime ballafaqese me subjektet dhe të mos mjaftohen vetëm me anën shkresore.
- h) Garantimi i cilësisë së punës audituese mund të përmirësohet edhe më tej.
- i) Së fundmi, gjuha dhe stili i të shkruarit në hartimin e programeve, projekt-raporteve dhe raporteve është përmirësuar ndjeshëm, por gjithsesi aksesimi i





përmbajtjes së raporteve nga një lexues mesatar mund të bëhet edhe më mirë, fragmentimi i raportit në shumë çështje humbet interesin e audiencës dhe mungesa e një strukture të specializuar në KLSH për redaktim gjuhësor, përkthim në anglisht dhe formatim, ia zbeh në shumë raste vlerën disa raporteve që në të kundërt do të kishin impakt në opinion dhe SAI të tjera partnere.

Të gjitha auditimet e performancës të vitit të kaluar tjerin problematika të mprehta, ku spikat auditimi mbi: Cilësinë dhe Sigurinë e Barnave, Akuakultura, Mbikëqyrja e tregut të telefonise celulare, Monitorimi i projekteve të huaja, etj.

### Auditimet e evaduara

Për periudhën Qershor 2018-Dhjetor 2019, auditimet e evaduara klasifikohen konkretisht sipas fushave të mëposhtme:

Skema nr.1 Auditimet e performancës sipas fushave

	Reformat qeveritare	1. Performanca e ISSH 2. Monitorimi i projekteve të huaja
	Ekonomia	3. Menaxhimi i plazheve publike 4. Performanca e AMF-së 5. Programet sociale të strehimit 6. Performanca e Zyrave të Punës 7. Akuakultura dhe MBZHR 8. Kasat fiskale
	Infrastruktura	9. Përmbytjet – parandalimi dhe mbrojtja 10. Shërbimet studentore 11. Siguria rrugore 12. Cilësia e veprave rrugore 13. Mbikëqyrja e tregut të telefonisë
	Mjedisi & Energjia	14. Inceneratori Fier 15. Ndotja akustike 16. Fondi Pyjor dhe Kullosor 17. Ndotja e deteve
	Shoqëria & Kultura	18. Klubet shumë-sportësh 19. Parqet rekreative në Tiranë 20. Performanca e Agjencisë së Barnave 21. Politikat për Barazinë Gjinore 22. Shërbimet e Kujdesit Social 23. Performanca e çerdheve dhe kopshteve

Burimi: KLSH

## AUDITIMET E PERFORMANCËS TË EVADUARA GJATË VITIT 2019

### REFORMAT QEVERTITARE

#### 1. Performanca e Institutit të Sigurimeve Shoqërore

##### *Konteksti auditues*

Sistemi i pensioneve është forma më e mirë e mbrojtjes shoqërore për personat të cilëve u reduktohen të ardhurat si pasojë e paaftësisë për punë për arsye moshe apo arsye të tjera. Aktualisht në Shqipëri përfitojnë pensione 621,2 mijë pensionistë dhe paguajnë kontribute 752,4 mijë kontribues. Norma e varësisë së sistemit është 1,22, që do të thotë se 122 kontribues mbulojnë 100 pensionistë. Të ardhurat e mbledhura nga kontributet janë të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet për përfitime dhe për rrjedhojë diferenca mbulohet nga buxheti i shtetit. Defiçiti i skemës në vitin 2018 përbën 20% të fondit të ISSH-së dhe 5,12% të total buxhetit të shtetit apo 1,6% të GDP-së. Edhe pse në vitin 2014 u ndërmor një reformë e re në sistemin e sigurimeve shoqërore ku një nga objektivat e saj ishte ulja e deficitit në 1% të GDP-së deri në vitin 2018, reforma nuk ka rezultuar e suksesshme në përmbushjen e këtij objekti.

Është kompetencë e ISSH-së, si institucioni përgjegjës në administrimin e sigurimeve shoqërore, të trajtojë këto çështje, për të siguruar qëndrueshmërinë afatgjatë të sistemit të sigurimeve shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik i pavarur, i cili drejton dhe administron fondin e sigurimeve shoqërore.

Buxheti i shtetit financon një pjesë të konsiderueshme të kësaj skeme. Nëse shohim peshën që zë financimi i skemës së pensioneve në total në buxhetin e shtetit, kjo vlerë është 8,89% në vitin 2015, 10,8% në vitin 2016, 10,42% në vitin 2017 dhe 9,82% në vitin 2018. Nëse këtë peshë e ndajmë në dy kategoritë që financon buxheti i shtetit, pra defiçitin dhe programet e shpenzimet e veçanta, rezulton se pjesa më e madhe shkon për mbulimin e deficitit.

Nxitja për ndërmarrjen e këtij auditimi performace erdhi si pasojë e problematikave të evidentuara nga skema e sigurimeve shoqërore, pavarësisht reformave të ndërmarra me qëllim përmirësimin e parametrave aktualë.

Pas ngritjes së pyetjes kryesore të auditimit “A ka qenë efiçente dhe efektive veprimtaria e ISSH-së gjatë periudhës 2015-2018?” dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi i auditimit arriti në këtë përfundim:

##### *Mesazhi auditues*

“Instituti i Sigurimeve Shoqërore për periudhën nën auditim 2015-2018, nuk ka përmbushur me efektivitet misionin institucional gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.”

Reforma e vitit 2014, pavarësisht qëllimeve të mira nuk ka rezultuar efektive. Kjo reformë paraqitet e vakët, pasi nuk pasqyron ndryshime thelbësore të ligjit ekzistues dhe nuk ka reflektuar zgjidhje për problematikat e konstatuara përpara hartimit të saj. ISSH nuk ka një strategji institucionale dhe plane veprimi, si dhe nuk disponon një rregullore të brendshme në përputhje me strukturën organizative.

Organet e ISSH-së nuk janë treguar eficiente në përmbushjen e funksioneve të tyre. Si pasojë e moskryerjes së analizave kosto/përfitim lidhur me alternativat e mundshme të investimit të fondit rezervë nga KA, ISSH ka të ardhura të munguara në vlerën 710 milion lekë.

ISSH duhet të zbatojë me efektivitet marrëveshjet e bashkëpunimit me DPT-në dhe Postën Shqiptare. Aktualisht, borxhi nga debitorët për kontribute të papaguara është 12 miliard lekë dhe DPT nuk ka dërguar në ISSH 1.4 milion listëpagesa.

ISSH nuk ka vepruar në mënyrë të koordinuar me institucionet e varësisë dhe marrëdhënia e tyre paraqitet evazive duke mos u mbështetur në një akt nënligjor.

ISSH, pavarësisht përpjekjeve, nuk ka arritur të ofrojë një shërbim cilësor kah qytetarëve duke mos iu vënë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm dhe duke reflektuar vonesa dhe tejkalim afatesh në lidhjen e pensioneve. Procedura e lidhjes së pensionit është burokratike dhe me afate të tejzgjatura dhe të pajustificuara. DRSSH-të nuk kanë një format për paraqitjen e ankesave nga qytetarët duke mos marrë në konsideratë të gjitha pretendimet e paraqitura prej tyre.”

---

## **2. Monitorimi i Projekteve të Huaja**

### *Konteksti auditues*

Mbështetja me fondet IPA ka si qëllim përgatitjen e vendeve kandidate potenciale dhe atyre kandidate në menaxhimin e fondeve të ardhshme, pasi ato të bëhen vende anëtare. Fondet janë dhënë në bazë të Dokumenteve Strategjike dhe në koherencë me politikat e BE-së, në mbështetje të përafrimit të legjislacionit me atë të Unionit. Kuadri rregullator për krijimin dhe funksionimin e autoriteteve dhe strukturave në sistemin e menaxhimit të fondeve të BE ekziston, por kërkohet më shumë zbatim dhe një koordinim më i mirë midis këtyre institucioneve.

Nisur nga eksperiencia e menaxhimit të fondeve IPA I dhe problematikat e shfaqura gjatë zbatimit të projekteve, fokusi i auditimit u drejtua në sistemin e menaxhimit indirekt të fondeve gjatë asistencës IPA II. Në modalitetin e menaxhimit indirekt, përgjegjësia për implementimin e buxhetit (fondeve IPA) transferohet nga KE tek strukturat e menaxhimit indirekt të fondeve IPA, të ngritura për këtë qëllim, në vendin përfitues të fondeve. Me qëllim menaxhimit efektiv dhe eficient të fondeve IPA të besuara vendit tonë, është e nevojshme që të përmirësohen kapacitetet e strukturave të dedikuara këtij procesi.

### *Mesazhi auditues*

Projektet IPA janë konceptuar si një instrument orientues e lehtësues drejt anëtarësimit në BE të një vendi me perspektivë evropiane. Ndonëse në Shqipëri projekte të tilla po aplikohen prej më se 10 vjetësh dhe në shumta të konsiderueshme financiare, progresi real i vendit tonë drejt anëtarësimit në BE vijon të jetë i vakët.

Pala shqiptare në përgjithësi dhe MEPJ e MFE në veçanti, kanë dëshmuar: a) pasivitet në aplikimin për projekte të tilla, duke treguar se qasja jonë europiane vijon të mbështetet më shumë në slogane sesa në punë; b) menaxhim të dobët në nivel strategjik, taktik e operacional të projekteve të ndërmarra, ku mungojnë struktura që duhet të ishin ngritur me kohë, njësi të dedikuara IPA në përputhje

me prioritetin politik e social, monitorim eficient në dimensionin financiar dhe atë performant, duke treguar rrjedhimisht për një proces më së shumti fiktiv të rritjes së kapaciteteve administrative dhe integrimi europian; c) proces i mangët feedback-u në nxjerrjen e mësimëve nga gabimet e kaluara, korrigjimin e tyre në kohë dhe parandalimin e rindodhjes së tyre në ardhmen, duke treguar mungesë përgjegjësie dhe shkaktuar dëme financiare.

Në linjë me Marrëveshjen Kuadër dhe investimin e fuqishëm financiar të BE-së për integrimin europian të Shqipërisë, projektet IPA mund dhe do ta japin efektin e tyre të plotë vetëm pasi të ngrihen të gjitha strukturat e nevojshme, të dedikohen ato në përputhje me rëndësinë strategjike që kanë dhe të monitorohen e auditohen me përgjegjshmëri, koordinim dhe qasje proaktive.

---

## **EKONOMIA**

### **3. Programet sociale të strehimit**

#### *Konteksti auditues*

Në kontekstin shqiptar, marrë parasysh periudhën e gjatë të tranzicionit dhe dinamikën e vazhdueshme politike, demografike dhe ekonomike të vendit, programet sociale të strehimit kanë qenë në periferi jo vetëm të politikëbërjes, por edhe të ushtrimit dhe zbatimit të kuadrit rregullator. Pas viteve 1990, në Shqipëri ndërmerret një reformim i strehimit, që derivonte kryesisht nga pasojat që la sistemi komunist sesa nga shtypa për të afirmuar një politike sociale, ku banesat shtetërore u privatizuan nga banorët përdorues të tyre kundrejt një shumë simbolike. Në kuadër të kësaj, u themelua edhe Enti Kombëtar i Banesave në 1993. Këto banesa përbënin rreth 96% të stokut në zonat urbane . Fill pas përfundimit të këtij procesi, njësitë e pushtetit vendor krijuan një listë me rreth 46.196 familje të pastrehë. Mes viteve 1993 dhe 2016, afërsisht 20.000 familje u strehuan përmes mbështetjes nga shteti . Megjithatë, përgjatë viteve të tranzicionit, si pasojë e urbanizimit dhe luhatjeve ekonomike, problemi i strehimit në kontekstin aktual shfaqet si një pasojë e shumë faktorëve socialë.

Sipas Anketës së Cilësisë së Jetës të zhvilluar nga Komisioni Europian, ndonëse shqiptarët janë ndër vendet me përqindjen më të lartë në Europë për pronësinë e shtëpive të tyre (87% e të pyeturve kanë pohuar se janë pronarë të shtëpive të tyre), ata kanë problemet më të mëdha për sa i përket kushteve optimale që duhet të ofrojë një banesë si hapësira e mjaftueshme, mungesë të tualeteve me ujë të rrjedhshëm, dusheve, apo të shtëpive me lagështirë dhe pa ngrohje.

#### *Mesazhi auditues*

Programet e strehimit nuk janë zbatuar plotësisht si politika sociale, duke adresuar vetëm raste individuale, por jo fenomenin social të të pastrehëve. Mungojnë regjistri kombëtar mbi numrin e të pastrehëve dhe investimet në banesa sociale, stoku i të cilave është inekzistent në shumicën e bashkive dhe i pamjaftueshëm në disa të tjera.

‘Asgjësimi’ i strehimit në nivel qendror bashkë me Ministrinë e Zhvillimit Urban, në një kohë kur kjo ministri kishte krijuar një profil institucional mbi çështjet e strehimit dhe kishte përgatitur një strategji për strehimin 2016-2025, ka ndikuar negativisht në financimin dhe zbatimin e programeve sociale.

Aksesi në programet sociale është mjaft i kufizuar. Bashkitë stepen në ofrimin e një informacioni të plotë për qytetarët nga risku i dyndjeve të papërballueshme në skemën e strehimit social.

Ligji i ri Nr. 22/2018 “Për strehimin social”, ndonëse ndjek modele të mira europiane, rrezikon të mos ofrojë një zgjidhje reale për zbatimin e plotë të programeve sociale të strehimit, pasi shtrihet përtej asaj që përballojnë kapacitetet e bashkive. Në kushtet kur burimet e tyre financiare qenë të kufizuara për të menaxhuar një skemë strehimi me 3 programe, dinamika që ofron ligji i ri e bën më riskoz zbatimin e një skeme strehimi të ngarkuar me 5 programe.

Bashkitë duhet të kenë një qasje proaktive, jo pasive, ndaj strehimit social duke filluar me inkuadrimitin e strehimi social në planifikimet urbane dhe duke aplikuar metoda bashkëkohore europiane, në bashkëpunim me sektorin privat të ndërtimit, për të kultivuar banesa sociale.

---

#### **4. Performanca e zyrave të punës**

##### *Konteksti auditues*

Papunësia në vendin tonë, pas kalimit nga një ekonomi e centralizuar në një ekonomi tregu, ka qenë vazhdimisht një nga “plagët” e ekonomisë dhe të vetë shoqërisë. Ndikimi që ka një punësim fitimprurës dhe dinjitoz në çdo familje është krejt i qartë. Të diktuar nga faktorë të ndryshëm socio-ekonomikë, papunësia dhe informaliteti kanë qenë në nivele të larta. Megjithatë, sipas raportimeve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, periudha nën auditim 2016-2018, krahasuar me vitet e mëparshme, na sjell përpara disa të dhëna pozitive për rimëkëmbjen e tyre dhe rritjen e punësimit.

Sipas certifikuesit zyrtar të shifrave dhe anketimeve, INSTAT, në tremujorin e tretë të vitit 2018 shkalla e puënsimit për popullsinë 15-64 vjeç është 59,7%. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2017, numri i të punësuarve u rrit gjithsej me 2,3% dhe krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2018, ky tregues u rrit me 0,4%. Po kështu, nga i njëjti anketim, shkalla zyrtare e papunësisë për popullsinë 15 vjeç e lart ishte 12,2%. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2017, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 1,4%. Krahasuar me tremujorin e dytë të 2018, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rënie prej 0,2%.

##### *Mesazhi auditues*

Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Zyrat e Punës duhet të bëjnë përpjekje serioze dhe konsistente sa i përket shërbimeve të informimit, këshillimit dhe ndërmjetësimit në punë, sidomos në drejtim të punësimit të kategorive të veçanta dhe atij afatgjatë. Punësimi duhet të shihet në mënyrë të integruar edhe me fenomenin shqetësues të emigracionit, ku, sipas INSTAT dhe EUROSTAT, pjesa dërrmuese e shtetasve shqiptarë largohen për mundësi të reja pune.

Ministria përkatëse për çështjet e punësimit nuk ka krijuar ndër vite Fondin Kombëtar të Punësimit për shkak të mungesës së akteve nënligjore. Kjo i ka sjellë të ardhura të munguara të konsiderueshme buxhetit të shtetit, që në mënyrë indikative dhe mesatarisht për një vit, shkojnë deri në shumën 6,2 miliardë lekë, vetëm për subjektet e regjistruara në SHKP dhe që kanë detyrimin të paguajnë pagat minimale për çdo Punëkërkues të Papunë me Aftësi të Kufizuar.

Procedura dhe mbarëvajtja e programit të nxitjes së punësimit sipas VKM 47 është zbatuar në shumicën e rasteve të shqyrtuara nga KLSH, por ka patur edhe punëdhënës që kanë shkelur kontratën dhe nuk kanë realizuar punësimet pas trajnimit. Rasti i Shkodrës tregon për nevojën e një filtrimi dhe përzgjedhjeje më të kujdesshme nga ana e SHKP të punëdhënësve dhe punëkërkuësve që kërkojnë të mbështeten me fonde publike nëpërmjet programeve.

---

## **5. Performanca e MBZHR-së në peshkim dhe akuakulturë**

### *Konteksti auditues*

Peshkimi është një burim i rëndësishëm i ushqimit, punësimit, ekonomisë, aktivitetit çlodhës apo argëtues për njerëzit. Menaxhimi i burimeve të peshkimit është jetik për gjeneratat aktuale dhe të ardhshme. Në zonat bregdetare varësia nga peshkimi si një burim ushqimi është mjaft e lartë, pavarësisht kushteve të vështira që ofron Shqipëria. Një masë e konsiderueshme e popullsisë, veçanërisht ata që banojnë në zonat ku është e mundur të ushtrohet ky aktivitet, peshkimin e kanë si një nga burimet kyçe të jetesës. Peshkimi në ujërat e brendshme është veçanërisht i rëndësishëm për sigurinë e ushqimit të komuniteteve të varfra, pasi shumica e prodhimeve të peshkut në ujërat e brendshme prodhohen për mbijetesë ose konsum lokal.

Akuakultura është e ngjashme me shumë sektorë të tjerë të bujqësisë, ajo përdor burimet natyrore dhe metodat organike të bujqësisë dhe ndërvepron me mjedisin. Megjithatë, ka shumë polemika që dalin nga ambientalistët, për shkak të shqetësimeve në rritje të ndikimeve negative në botë. Në përgjithësi, angazhimi për bujqësinë dhe akuakulturën e qëndrueshme që nuk ndikon negativisht në mjedis është zgjidhja kryesore për këto çështje. Të nevojshme janë ndërgjegjësimi i publikut, si dhe pjesëmarrja nga të gjithë sektorët, duke përfshirë konsumatorët dhe prodhuesit. Aktualisht, ndërgjegjësimi i ndikimeve negative në botë dhe njohja e ndikimeve të mundshme ekologjike janë në rritje në mesin e të gjithë sektorëve.

### *Mesazhi auditues*

MBZHR nuk ka hartuar dhe miratuar një sërë aktesh nënligjore, duke dështuar në plotësimin e kuadrit ligjor të peshkimit dhe akuakulturës. Ligji i Akuakulturës i miratuar në vitin 2016 ende nuk ka gjetur zbatim si rezultat i mosmiratimit të Zonave të Përcaktuara për Akuakulturë, duke penguar kështu zhvillimin e këtij sektori.

Bashkëpunimi jo i mirë midis MBZHR-së dhe institucionit në varësi të saj DSHPA-së, si dhe komunikimi i dobët institucional brenda MBZHR-së, janë tregues direkt të mosmenaxhimit efektiv të veprimtarisë së peshkimit dhe akuakulturës.

Pamjaftueshmëria në mjete logjistike dhe burime njerëzore bën që DSHPA të mos jetë efektive në inspektimin e aktiviteteve lidhur me peshkimin dhe akuakulturën. Mungesa e sistemit të sinjalizimit satelitor për monitorimin e anijeve të peshkimit bën të pamundur identifikimin e lëvizjes së anijeve, kontrollin e peshkimit të paligjshëm dhe regjistrimin e të dhënave në format elektronik.

Portet e peshkimit të vendit tonë menaxhohen në mënyrë joefektive dhe kanë mungesë të hapësirave ankoruese, kantierëve për riparimin e anijeve të peshkimit, si dhe furnizimit me ujë dhe energji elektrike. Ekonomitë e rritjes së rasatit të

koranit në Lin dhe krapit në Zvezdë nuk furnizohen mjaftueshëm me ujë dhe cilësia e tij nuk është në parametrat e duhura. QGDM Sarandë nuk siguron që e gjithë sasia e prodhuar e midhjeve të kalojë në qendër për certifikim, etiketim apo depurim sipas klasifikimit.

Masat e marra nga MBZHR në vitet 2016-2018 për menaxhimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës nuk kanë qenë të mjaftueshme. Moszbatimi i “Objektivave Specifikë Zhvillimorë” të Strategjisë Kombëtare të Peshkimit ka bërë që politikat e ndërmarra nga qeveria për këtë sektor të mos jenë efektive në drejtim të garantimit me cilësi të aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës.

Rekomandimet për problematikat e identifikuara në këtë auditim kanë konsistuar në plotësimin e kuadrit ligjor të peshkimit dhe akuakulturës, riorganizimin e duhur strukturor të MBZHR-së në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit, mbulimin me inspektim të të gjithë zinxhirit të aktivitetit të peshkimit dhe sigurimin e mjeteve logjistike në dispozicion të inspektorëve të peshkimit si dhe përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme të porteve të peshkimit dhe ekonomive të akuakulturës.

---

## **6. Efektiviteti i kasave fiskale në rritjen e të ardhurave tatimore**

### *Konteksti auditues*

Implementimi i kasave fiskale ka qenë një përpjekje e hershme e shtetit shqiptar pas viteve '90. Përpjekjet e para u bënë në vitin 1994, por dështuan. Në vitin 2007, administrata tatimore vendosi të krijojë një sistem të kontrollit të pagesave me para në dorë, në të cilin të dhënat nga arkëtimet transferohen në sistemin qendror përmes sistemit GPRS në fund të ditës së punës. Në këtë kuadër, tatimpaguesit, të cilët shesin mallra, prodhime, apo kryejnë furnizime të shërbimeve në lokale apo njësi të hapura për publikun, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të përdorin pajisje fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe të lëshojnë, në mënyrë të detyrueshme, kuponin tatimor. Një sistem i tillë lejon tatimpaguesve të bëjnë ndryshime dhe të përshtaten sipas nevojës, përpara se të dhënat të dërgohen në sistemin qendror.

Bizneset dhe mediat kanë shfaqur rezervat e tyre mbi implementimin e kasave fiskale. Për biznesin, shpenzimet e blerjes së një kase, mesatarisht 300 euro dhe pagesat e përvitshme të kolaudit prej 8.000 lekë, përbënin kosto shtesë, veçanërisht për biznesin e vogël. Duke i bërë jehonë këtyre shqetësimeve të biznesit, mediat kanë hedhur hije dyshime mbi efektivitetin e tyre. Restorantet dhe lokalet u ankuan se kasa fiskale nuk mundësonte ndarjen e llogarive sipas kamerierëve apo banakierëve dhe nuk i shërbente biznesit për funksione të tjera të rëndësishme, si mbajtja e llogarive apo gjendja e inventarit. Me frikën se kasat ishin të manipulueshme, qeveria urdhëroi moslejimin e mbajtjes krahas kasave fiskale, të printerëve jofiskalë të lidhur me programe kompjuterike në ndihmë të menaxhimit të përditshëm të një biznesi .

Ndërkohë, megjithëse kasat fiskale kanë përthithur një sërë investimesh, përfshirë ato të ndërtimit, përmirësimit dhe mirëmbajtjes, në administratën tatimore po kryhet një investim i ri për krijimin e faturës elektronike ose e njohur ndryshe si “fiskalizimi” nëpërmjet së cilës synohet gjurmimi në kohë reale i transaksioneve të biznesit. Projekti parasheh një ndryshim rrënjësor, nga transmetimi i xhiros në

fund të ditës sikurse ndodh aktualisht, në raportimin e çdo shitjeje dhe blerjeje malli në kohë reale, duke i mundësuar administratës tatimore një ndjekje automatike të çdo transaksioni.

#### *Mesazhi auditues*

Në përpjekjet e Qeverisë për të luftuar evazionin fiskal, veçanërisht lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), Administrata Tatimore Qendrore ka implementuar pajisjet fiskale për evidentimin e xhiros nga subjektet tatimpaguese. Implementimi i pajisjeve fiskale kërkon përpjekje të vazhdueshme dhe kushton si për administratën, ashtu edhe për subjektet tatimpagues që duhet të zbatojnë kërkesat e përdorimit të pajisjeve fiskale.

MFE dhe DPT nuk kanë patur objektiva dhe një Strategji për pajisjet fiskale si pjesë e një përmirësimi gjithëpërfshirës të luftës kundër evazionit fiskal, që do të përcaktonte qartë risqet për segmentet e ndryshme të tatimpaguesve dhe parashikonte masa për zbutjen e këtyre risqeve.

Instalimi dhe përdorimi i pajisjeve fiskale është interpretuar nga organet shtetërore si "shkopi magjik" për rritjen e të ardhurave tatimore dhe uljen e evazionit fiskal, por megjithë koston e konsiderueshme në implementimin e tyre, pajisjet fiskale nuk kanë patur efektivitet në rritjen e të ardhurave tatimore në Buxhetin e Shtetit. Kontrollat e ushtruara nga Administrata Tatimore Qendrore në subjektet tatimpagues për përdorimin e pajisjeve fiskale, janë organizuar me fushata, ndërsa masat shtrënguese nuk kanë dhënë efektin e pritshëm në uljen e evazionit tatimor nëpërmjet rritjes së të ardhurave tatimore nga TVSh e brendshme apo tatimi mbi fitimin."

---

## **INFRASTRUKTURA**

### **7. Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare**

#### *Konteksti auditues*

Në epokën e digjitalizimit, telefonat celularë janë një mjet i domosdoshëm komunikimi dhe janë bërë pjesë e pandashme e çdo individ. Në vitin 2018, numri i përdoruesve të shërbimeve celulare në mbarë botën ishte 5,1 miliardë, duke zënë 67% të popullsisë globale. Në Shqipëri, numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare në vitin 2018 ishte rreth 2,7 milionë (nga 2,85 milionë banorë që ka Shqipëria), duke gjeneruar rreth 6 miliardë minuta në vit. Gjithashtu, një përdorues celular aktiv gjatë vitit 2018 ka kryer mesatarisht 158 minuta thirrje dalëse, ka dërguar 31 mesazhe SMS dhe ka konsumuar rreth 2,6 GB në Internet broadband.

Përveç tarifave në dukje të larta, një problematikë tjetër është edhe niveli i ulët i konkurrencës së tregut të telefonisë celulare. Dalja nga tregu e operatorit Plus Communication e ka ndryshuar strukturën e tregut nga 4 në 3 operatorë, duke vijuar trendin rritës të indeksit të përqendrimit.

#### *Mesazhi auditues*

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për periudhën nën auditim 2017-2018 nuk ka përmbushur me efektivitet mbikëqyrjen e tregut të telefonisë celulare kah ruajtjes së konkurrencës së lirë dhe të ndershme në tregun e telefonisë celulare.

Pavarësisht rëndësisë, bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet AKEP dhe AK, nuk ka qenë frytdhënës. Gjithashtu, edhe nga bashkëpunimi ndërmjet AKEP dhe MIE nuk janë arritur rezultatet e pritshme, pasi ende nuk është ndërmarrë asnjë veprim me qëllim implementimin dhe realizimin e ofrimit të shërbimit universal.

AKEP dhe Qeveria në tërësi nuk kanë kryer një analizë paraprake lidhur me pasojat dhe efektet që do të sjellë implementimi i teknologjisë 5G në vendin tonë. Përfitimet ekonomiko-sociale duhet të ecin krahas krahas me ato të Sigurisë Kombëtare. Implementimi i teknologjisë së gjeneratës së 5-të (5G) në Shqipëri mbart me vete një risk të lartë të thyerjes së sigurisë së informacionit dhe kërkon domosdoshmërisht të kryhet duke u bazuar në një plan-veprimi kombëtar, të detajuar qartë dhe gjithëpërfshirës, me qëllim mbrojtjen e padiskutueshme nga aksesit i paautorizuar, tjetërsimi, keqpërdorimi apo mos-disponueshmëria, e një aseti të çmuar për konsumatorin shqiptar, siç është informacioni. Për më tepër, si një vend anëtar i NATO-s dhe me aspirata për integrim në BE, Qeveria shqiptare duhet të tregohet tejet e përgjegjshme në vlerësimin e risqeve që bart për Shqipërinë dhe partnerët strategjikë implementimi i teknologjisë 5G me burim kompanitë kineze.

Përsa i përket mbrojtjes së konsumatorëve, AKEP nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t'iu mundësuar përdoruesve me aftësi të kufizuara dhe me të ardhura shumë të ulëta çmime të përbalueshme siç përcakton Ligji nr. 9918/2008 i AKEP dhe Direktiva 2018/1972 e BE-së, nuk ka kryer asnjë inspektim pranë kompanive të telefonisë celulare për të vlerësuar zbatimin e detyrimeve të tyre ndaj pajtimtarëve, si dhe nuk ka përmbyshur objektivat e vendosura për mbrojtjen dhe rritjen e përfitimeve të konsumatorëve.

Në lidhje me rregullimin e tarifave, AKEP nuk përdor metoda të orientuara në kosto, duke ndikuar kështu që Shqipëria të ketë tarifatat e terminimit të thirrjeve celulare MTR më të larta sesa mesatarja e vendeve të rajonit, BE-së dhe BEREC, të cilat ndikojnë në mënyrë indirekte në çmimet që paguajnë konsumatorët.

---

## **8. Siguria rrugore në Shqipëri**

### *Konteksti auditues*

Përmirësimi i sistemit të sigurisë rrugore, ka rëndësi si një element i domosdoshëm i një bashkëjetese normale qytetare, përsosja e të cilit është rezultat i shumë aspekteve dhe ndërveprimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës e të shërbimeve, me rendin ligjor, vetëdijen qytetare dhe me qeverisjen në tërësi.

KLSH ka ndërmarrë këtë auditim performance në rritjen e besimit qytetar sepse në shumë raste performancat e shërbimeve maten vetëm me shifra, por harrojmë se mënyra sesi i menaxhojmë ato reflekton qasjen sociale për brezat e ardhshëm. Dhënia e opinioneve, për përmirësimin, modernizimin e sistemit të sigurisë rrugore, është prioritarë sot më shumë sepse nuk është plotësisht në harmoni të plotë me kërkesat e përdoruesve të rrugës në drejtim të:

- minimizimit të shanseve për shfaqjen e aksidenteve në rrjetin rrugor;
- uljes së shkallës së aksidenteve dhe rrjedhimisht dhe e kostove të komunitetit;
- dhënies përparësi të sigurisë rrugore;

- mundësisë së minimizimit të nevojave për punime riparuese të kushtueshme (është më e lehtë të ndryshosh një projekt se të modifikosh një seksion me rrezik të lartë të një rruge pasi është ndërtuar)

#### *Mesazhi auditues*

Me moton “Siguria rrugore fillon nga ne” Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Brendshme, Autoritetin Rrugor Shqiptar, të rrisin bashkëpunim nëpërmjet një procesi dinamik të ndërsjellë, shtojnë investimet dhe financimet, realizimin e auditimeve nga projektimi, ndërtimi shfrytëzimi për rrugët e reja, shtimin e inspektimeve për rrugët ekzistuese, përmirësimin dhe forcimin e sistemit të kontroleve policore në zbatim të ligjit, për rritjen e sigurisë rrugore, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe shmangies fataliteteve të përdoruesve të rrugës.

### **9. Sigurimi i cilësisë së veprave ndërtimore**

#### *Konteksti i auditimit*

Ky auditim është fokusuar në nivelin me të cilin janë arritur objektivat e kontrollit të cilësisë së projekteve dhe produkteve të ndërtimit, si dhe në ndikimet që ato japin në sigurimin e cilësisë së veprave ndërtimore, me synimin e parandalimit të situatave të kolapsit në raste të jashtëzakonshme. Në këtë auditim jemi përqëndruar në Institutin e Ndërtimit, si institucion i ngritur për të siguruar një nivel të lartë të mbrojtjes së qytetarëve, për të krijuar besim dhe garanci për qëndrueshmërinë në objektet e ndërtimit në vendin tonë në mbrojtje të shëndetit të qytetarit dhe të mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si institucion epror, si dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit si dy institucione të rëndësishme që menaxhojnë fondet publike për ndërtimin e objekteve.

#### *Mesazhi i auditimit*

Veprimtaria e Institutit të Ndërtimit për të ndikuar në sigurimin e cilësisë në objektet ndërtimore nuk ka qenë efektive. Çështjet e sigurisë së cilësisë për veprat e ndërtimit duhet t’i besohet një institucioni kompetent dhe të garantohet me ligj, i cili do të ishte i domosdoshëm për ngritjen e këtij institucioni. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë duke mos u angazhuar në plotësimin e kuadrit ligjor mbi organizimin dhe funksionimin e Institutit të Ndërtimit, i cili prej 15 vjetësh funksionon në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Punëve Publike nr. 225, datë 29.06.2014 “Për Krijimin e Institutit të Ndërtimit”, ka dështuar të plotësojë kuadrin ligjor që do të ndikonte në sigurimin e cilësisë së objekteve të ndërtimit, nëpërmjet kontrollit të cilësisë së produkteve dhe dhënies së oponencave teknike për objektet ndërtimore. Mungesa e një stafi të kompletuar teknikisht, rekrutimi i punonjësve jashtë profili dhe pa eksperiencën e domosdoshme, si dhe mungesa e një laboratorit të paakredituar, ka sjellë dhënien e oponencave jocilësore dhe mungesën e kontrollit të produkteve ndërtimore, duke e kthyer këtë institucion në një zyrë të thjeshtë punësimi që siguron të ardhurat për vetfinansim.

Baza ligjore e funksionimit të Institutit të Ndërtimit është e pamjaftueshme. Krijimi i këtij institucioni (me objekt kryesor të punës, një fushë shumë të rëndësishme), me një urdhër të ministrit, si dhe funksionimi i tij në zbatim të një rregulloreje të

miratuar vetëm nga Drejtori i Përgjithshëm, krijojnë mundësinë e mosfunksionimit normal të IN.

Materiali i hartuar për rregullat dhe hapat që ndiqen gjatë kryerjes së oponentëve teknike është i pa detajuar dhe nuk arrin t'i shërbejë dhënies së një oponente teknike cilësore dhe profesionale, lidhur me projektet e hartuara, për t'i shërbyer sa më mirë garantimit të sigurisë së objekteve ndërtimore.

---

## MJEDISI DHE ENERGJIA

### **10. Planifikimi i impiantit të përpunimit dhe djegies së mbetjeve për prodhim energjie në Bashkinë Fier**

#### *Konteksti auditues*

Administrimi dhe përpunimi i mbetjeve të ngurta urbane në vendin tonë është i decentralizuar. Në pjesën më të madhe të bashkive, shërbimet e mbledhjes, transportit dhe përpunimit të mbetjeve kryhen nga kompani private të menaxhimit dhe përpunimit të mbetjeve (në landfille ose pika depozitimi), të cilat janë të kontraktuara nga bashkitë dhe monitorohen nga Ministria e Turizimit dhe Mjedisit si dhe Drejtoritë Rajonale të Mjedisit në Qarkun përkatës. Në shumicën e bashkive të vendit, tarifa për menaxhimin e mbetjeve përfshin grumbullimin dhe transportin e tyre deri në vend-depozitim ose impiant përpunimi. Aktualisht, vetëm bashkia Elbasan ka impiant bashkëkohor për djegien e mbetjeve të ngurta e kthimin e tyre në energji të shfrytëzueshme. Zonat rurale të vendit nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve, megjithëse është kryer Reforma Administrative në vitin 2015. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj, gropa të improvizuara në përrenj e gropa mes kodrinash ose në anë të rrugëve. Këto lloj depozitimesh apo grumbullimesh, pa kryer proceset e nevojshme sipas standarteve për përpunimin e tyre, me kalimin e kohës, pastrohen nga ujërat sipërfaqësore e nëntokësore, duke zhvendosur në një pjesë tjetër toke, në rrjedhat ujore dhe në fund përfundojnë në zonat bregdetare, si dhe ujërat nëntokësore, duke krijuar ndotje të rrezikshme të ujit industrial që shfrytëzohet me shpime afër këtyre vendgrumbullimeve të mbetjeve të ngurta.

#### *Mesazhi auditues*

Në zhvillimin e projektit për incenerimin e mbetjeve urbane për përfundimin e energjisë, palët e interesit janë konsultuar në mënyrë formale, si publiku, i cili ka qenë vazhdimisht kundër, dhe institucionet zyrtare lokale të cilat nuk kanë dhënë mendimin e tyre profesional dhe nuk kanë përfaqësuar publikun e tyre, por projekti është vendosur për tu zhvilluar pavarësisht kësaj situate. Projekti është ngritur dhe po ecën përpara duke krahasuar vetëm 2 alternativa, atë ekzistente pa projekt dhe atë që mund të jetë sipas këtij projekti. Gjatë zgjedhjes së kësaj alternative nuk janë konsideruar alternativa të tjera të mundshme, duke anashkaluar proceset e ripërdorimit dhe riciklimit të mbetjeve, e duke mos zbatuar kësajsoj Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve.

---

### **11. Ndotja akustike**

#### *Konteksti auditues*

Raportimet zyrtare të Bashkimit Evropian dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë konfirmojnë se ndotja akustike është kthyer në një problem për jetën e qytetarëve për shkak të pasojave që shkakton në shëndetin e tyre. Numri i njerëzve që vuajnë nga shqetësimet për shkak të tejkallimit të normës së zhurmës, në Evropë arrin edhe deri në 20 milionë. Po ashtu, çdo vit shkaktohen mbi 900 mijë raste të hipertensionit për shkak të ndotjes akustike në Evropë. Edhe në Shqipëri ndotja akustike është një nga problemet dhe shqetësimet më kryesore të qytetarëve në vitet e fundit dhe sidomos në kryeqytet dhe në qytetet bregdetare në periudhën e verës ku turistët janë të shumtë në numër. Të gjithë jemi dëshmitarë sesi ky shqetësim po rritet nga dita në ditë e në jo pak raste qytetarët duke mos patur zgjidhje nga instancat përgjegjëse shtetërore kanë shkuar deri në zgjidhje personale të konflikteve të nisura nga zhurmat e krijuara nga aktivitete të ndryshme si lokale nate, lavazho, fabrika etj. Efektet në shëndet të ndotjes nga zhurma, janë të ndara sipas efekteve specifike: bezdisja, çrregullimet e gjumit, interferenca në komunikim, ulje të performancës, risk për sëmundjet kardiovaskulare, dëmtim të dëgjimit etj. Për një pjesë relativisht të vogël të popullatës këta faktorë mund të kalojnë në simptoma klinike si pagjumësi dhe sëmundje kardiovaskulare të cilat, si pasojë, mund edhe të rrisin shkallën e vdekshmërisë. Shpenzimet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (i cili është institucioni përgjegjës për monitorimin e zhurmave) për vitet objekt auditimi 2016-2018 dhe që lidhen direkt me monitorimin e zhurmave kanë qenë në total 5,316,000 lekë. Sa i takon shpenzimeve për sektorin përgjegjës për zhurmat në Institutin e Shëndetit Publik ato kanë në total 13,639,844 lekë.

#### *Mesazhi i auditimit*

Masat e marra nga MTM dhe MSHMS si dhe Bashkia Tiranë për manaxhimin e zhurmave mjedisore në vendin tonë nuk kanë qenë efektive. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duke mos miratuar një sërë udhëzimesh ka dështuar të plotësojë kuadrin ligjor mbi zhurmat mjedisore me akte nënligjore edhe pse kanë kaluar 12 vite që nga krijimi i ligjit kryesor të zhurmave. Bashkia Tiranë nuk ka hartuar politika të përshtatshme lidhur me manaxhimin e zhurmave mjedisore. Plani Vendor i Veprimit të zhurmave, hartëzimi i zhurmave, shpallja e zonave të qeta urbane janë disa nga detyrimet ligjore të cilat Bashkia Tiranë nuk ka arritur t'i përmbushë. Nga ana tjetër, monitorimi i zhurmave nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të dhëna përfaqësuese dhe të besueshme për qytetet përkatëse si pasojë e buxhetit të vogël të alokuar nga MTM, çka evidentohet edhe në mos përmbushjen e objektivave që vetë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit vendos. Mosakreditimi i procesit të monitorimit të zhurmave ndikon gjithashtu në besueshmërinë e ulët të të dhënave. Mungesa e aparaturave të matjes së zhurmave në ISHMPUT, sjell vështirësi në inspektim dhe marrjen e masave konkrete kundrejt subjekteve që lëshojnë zhurma sipër normave të lejuara. ISHP nuk ka kryer asnjë studim epidemiologjik që të vlerësojë lidhjen shkak pasojë mbi ndikimin e zhurmave mjedisore në shëndetin e popullatës. Megjithatë, situata mund të përmirësohet nëse të gjitha institucionet subjekt auditimi do të zbatojnë rekomandimet e lëna në këtë auditim.

---

## **12. Efektiviteti i menaxhimit dhe administrimit të fondit pyjor dhe kullor**

### *Konteksti auditues*

Pyjet janë një pasuri botërore, e cila mbulon rreth 1/3 e planetit tonë, me një sipërfaqe prej rreth 4 miliard ha. Viti 1985 shënon inventarizimin më të fundit të fondit pyjor në Shqipëri, ku rezultoi se zinte një sipërfaqe prej 1,048,000 ha dhe një volum prej 85 milion m<sup>3</sup>. Natyrisht që kjo shifër është tërësisht e pa përditësuar dhe jo aktuale, duke pasur parasysh edhe ndryshimet e shumta strukturore apo prerjet e paligjshme që kanë ndodhur në pyje gjatë këtyre dekadave. Gjatë 30 viteve të fundit, sektori i pyjeve në Shqipëri ka qenë vazhdimisht objekt ndryshimesh të shpeshta, si rezultat i politikave të përcaktuara nga qeveritë. Për më tepër, në këtë sektor ka munguar një strategji e qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe me objektiva konkrete e të mirëpërcaktuara. Në kuadër të reformës territoriale-administrative të vitit 2014, tashmë pronësia e pyjeve publike në vend i ka kaluar bashkive përkatëse, duke synuar decentralizimin e sistemit të administrimit të fondit pyjor. Në vitin 2016, u miratua edhe moratoriumi i pyjeve, i cili synonte reduktimin e ndërhyrjeve mbi fondin pyjor.

Reformat e vazhdueshme në administratë janë shoqëruar edhe me dëmtime të fondit pyjor e prerje të paligjshme në pyje. Këto të fundit kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme ndër vite, duke përfituar edhe nga pafuqia e strukturave të shtetit për të parandaluar këtë situatë. Dinamika historike e këtij sektori reflektohet edhe në shifra konkrete, teksa sipërfaqja e fondit pyjor llogaritet pak a shumë e njëjtë si më parë, rreth 1 milionë ha apo rreth 36% të sipërfaqes së vendit, ndërsa volumi rezulton aktualisht në më pak se 55 milion m<sup>3</sup>. Kjo do të thotë se krahasuar me vitin 1985, volumi i fondit pyjor është zvogëluar me rreth 35%. Këto shifra alarmante kanë ardhur si pasojë e dëmtimeve të vazhdueshme dhe prerjeve pa kriter në fondin pyjor, shoqëruar kjo edhe me neglizhencën apo pafuqinë e strukturave përgjegjëse për të siguruar mbrojtjen dhe mbarëvajtjen e pyjeve.

### *Mesazhi i auditimit*

Kontrolli i Lartë i Shtetit konstaton se problemet me kuadrin strategjik, rregullator dhe burimet njerëzore të reduktuara kanë cenuar realizimin me efektivitet dhe eficiencë të detyrave të MTM në sektorin e pyjeve. Strategjia për zhvillimin e sektorit të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri ka qenë tërësisht e pa përditësuar e rrjedhimisht jofunksionale, duke bërë që prej disa vitesh sektori i pyjeve të funksionojë pa objektiva dhe drejtime të qarta strategjike.

Numri i lartë i shkeljeve të konstatuara dhe niveli shumë i ulët i arkëtimit të sanksioneve administrative kanë cenuar zbatimin e moratoriumit për pyjet në Shqipëri. Mungesa e strukturave profesionale në bashkitë, bashkëkomunikimi dhe bashkëpunimi pasiv me ministrinë, mosshfrytëzimi i burimeve dhe të ardhurave që fondi pyjor gjeneron, duke e çuar atë në degradim, tregon qartë për mungesë efieciencie dhe efektiviteti të bashkive në administrimin e pyjeve si pasuri kombëtare. Për më tepër, mungesa e inventarizimit të pyjeve për një periudhë prej më shumë se tre dekadash, ka bërë që informacioni mbi fondin pyjor të jetë jo plotësisht i saktë dhe i pa përditësuar.

### **13. Ndotja e deteve**

#### *Konteksti auditues*

Sot sfida e mbrojtjes deteve nga ndotjet qëndron në menaxhimit e tij në mënyrë gjithë përfshirëse duke ofruar përfitime të barabarta, sipas parimeve të politikave mjedisore dhe ujore të BE-së. Menaxhimi sa më efikas i ujit të deteve qëndron në rritjen e transparencës, besimit dhe shmangies abuzimeve sepse, përmirësimi i sistemit të menaxhimit, ka rëndësi si një element i domosdoshëm i një bashkëjetese normale qytetare, përsosja e të cilit është rezultat i shumë aspekteve dhe ndërveprimeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës e të shërbimeve, me rendin ligjor, vetëdijen qytetare dhe me qeverisjen në tërësi.

Administrimi dhe menaxhimi i ujërave të deteve nënkupton, ruajtjen, përdorimin e burimeve natyrore e biologjike, lehtësimin e kushteve për zhvillimin e turizmit, informimin dhe edukimin e publikut e sektorit publik e privat, për përfitime ekonomike. Sot sfida në çështjet mjedisore qëndron në të drejtën e publikut për akses në informacionin mjedisor, akses në drejtësi për çështjet mjedisore dhe pjesëmarrja e publikut të interesuar në vendim-marrjet mjedisore.

KLSH ka ndërmarrë këtë auditim performance në rritjen e besimit qytetar sepse në shumë raste mënyra e menaxhimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë institucioneve shtetërore maten vetëm me shifra, por harrojmë se mënyra sesi ato menaxhojnë shërbimet, reflekton qasjen sociale për brezat e ardhshëm. Dhënia e opinionëve, për përmirësimin, modernizimin e sistemit të mbrojtjes deteve, është prioritarë sot më shumë se kurrë.

#### *Mesazhi auditues*

Agjencia Kombëtare të Bregdetit të krijojë një qasje të re ligjore në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare të Mjedisit pushtetin vendor, specialistë të fushës, institucionet ligjvënëse e grupet e interesit, në rritjen e kompetencave të saj për ruajtjen mjedisore të ujërave detare, zhvillimit të ekonomisë dhe turizmit detar, ruajtjes florës e faunës në dete dhe rritjes besimit qytetar.

---

## **SHOQËRIA DHE KULTURA**

### **14. Cilësia dhe siguria e barnave në rrjetin e hapur farmaceutik dhe shërbimin spitalor**

#### *Konteksti auditues*

Reforma e nisura në shërbimin farmaceutik, dhe e kurorëzuar me miratimin e ligjit për barna ka në thelbin e vet përpjekjet për t'u përafuar me kuadrin ligjor të vendeve të BE-së, si dhe rregullimin e tregut farmaceutik dhe mënyrën e vendosjes së barnave në treg. Ligji i barnave, i miratuar në vitin 2014, parashikon që, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të rrisë sigurinë dhe cilësinë e barnave që qarkullojnë në vend.

Por cilësia dhe siguria barnave mbeten ende ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve shqiptarë dhe një problem i vazhdueshëm i sistemit shëndetësor në Shqipëri. Problematika këto që shërbyen si indicie për Departamentin e Auditimit të Performancës në KLSH për fillimin e auditimit "Cilësia dhe siguria e barnave në rrjetin e hapur farmaceutik dhe shërbimin spitalor".

Një vend të rëndësishëm në këtë auditim zuri vlerësimi i efektivitetit të institucioneve përgjegjëse për garantimin e sigurisë dhe cilësisë së barnave që qarkullojnë në vend, por dhe efienca e veprimtarisë së inspektimit të tregut të barnave, analizave të laboratorit, si dhe masave të marra për ruajtjen dhe transportimin e barnave sipas praktikave të mira, në të gjithë proceset dhe strukturat.

Nevoja e implementimit të sistemit elektronik "Track and Trace", akreditimi dhe modernizimi i laboratorit të analizave, si dhe fuqizimi i rolit të sistemit të farmakovigjilencës do të ndikonin në mënyrë të ndjeshme në rritjen e sigurisë dhe cilësisë së barnave që qarkullojnë në vendin tonë.

#### *Mesazhi auditues*

Mungesa e objektivave strategjike për shërbimin farmaceutik në vend ka bërë që politikat e ndërmarra nga qeveria për këtë sektor të mos jenë efektive në drejtim të garantimit të cilësisë dhe sigurisë së barnave. Ndërkohë, heqja e detyrimit ligjor për importin e medikamenteve të prodhuara në vendet e Ballkanit, "që ato të qarkullojnë në një nga vendet e BE", duke u mjaftuar vetëm që ato të kenë regjistrim lokal në vendet e origjinës e kanë ekspozuar publikun shqiptar ndaj barnave të cilat vijnë nga vende që nuk kanë standardet e BE-së në drejtim të garantimit të cilësisë dhe sigurisë së barnave.

AKBPM si një institucion përgjegjës për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së barnave vijon të jetë jo efektive në veprimtarinë e saj edhe si rezultat i mungesës së certifikimit dhe akreditimit të laboratorit të analizave shfaqur kjo në numrin e papërfillshëm të analizave të kryera, ku për periudhën 2017-2018 janë analizuar vetëm 12% e barnave që duheshin analizuar. Gjithashtu edhe sistemi i farmakovigjilencës është pothuajse inekzistent në veprimtarinë e tij, duke mos patur fare ndikim në garantimin e sigurisë së barnave në vend.

Shërbimet farmaceutike pranë spitaleve vazhdojnë të jenë të pa akredituara dhe në kushte jo optimale sipas praktikave të mira të ruajtjes dhe qarkullimit të barnave. Spitalet publike vijnë të akumulojnë barna jashtë afatit të skadencës, si rezultat i planifikimeve të gabuara dhe të keqmenaxhimit të tyre.

Cilësia dhe siguria barnave mbeten ende ndër shqetësimet kryesore të qytetarëve shqiptarë dhe një problem i vazhdueshëm i sistemit shëndetësor në Shqipëri, perceptimi i tyre është që cilësia dhe siguria e barnave është e pa garantuar nga institucionet përgjegjëse.

---

## **15. Efektiviteti i Politikave për Nxitjen e Barazisë Gjinore dhe Forcimin e Rolit të Gruas**

### *Konteksti auditues*

Barazia gjinore është një e drejtë njerëzore dhe gjithashtu një parakusht për avancimin e zhvillimit dhe reduktimin e varfërisë. Gratë e fuqizuara kontribuojnë në shëndetin dhe produktivitetin e familjeve dhe komuniteteve të tëra dhe përmirësojnë perspektivat për gjeneratën e ardhshme. Barazia gjinore synon të përmirësojë ato struktura të shoqërisë, të cilat ndikojnë në mos balancimin e fuqizimit dhe pjesëmarrjes mes grave dhe burrave. Arritja e këtij qëllimi është thelbësore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, funksionimin e demokracisë,

respektin e ligjit, rritjen ekonomike dhe konkurrencën. Ashtu si edhe në vendet europiane, veprimtaritë për nxitjen e BGj kanë rezultuar në zhvillimin e një sistemi gjithëpërfshirës ligjor dhe politik. Megjithatë, de facto, barazia gjinore është larg nga të qenit një realitet. Dhuna dhe diskriminimi vazhdojnë në shumë fusha, duke i mbajtur gratë dhe burrat në rolet e tyre tradicionale dhe duke parandaluar realizimin e plotë të të drejtave të grave. Gratë shqiptare përballen ende me pabarazi, hendeq në paga, dhunë gjinore, diskriminim dhe stereotipe në tregun e punës. Ky auditim kishte për qëllim të paraqesë një studim mbi efektivitetin e politikave të ndjekura nga shteti shqiptar për forcimin e rolit të gruas dhe arritjen e barazisë gjinore në nivele sa më optimale. Kjo temë është përzgjedhur si një nga objektivat parësore të OKB për zhvillimin e qendrueshëm, si dhe duke marrë parasysh impaktin madhor që ka në shoqërinë shqiptare, duke qenë një plagë sociale tepër prezente dhe thuajse “e zakonshme” në ditët e sotme.

#### *Mesazhi i auditimit*

Me gjithë përpjekiet e vazhdueshme dhe aplikimin e programeve nxitëse, fokusi ka mbetur thjeshtë tek zbatimi dhe mungon monitorimi në kuptimin e rezultateve. Përmirësimet hasen më së shumti në procesin e hartimit të kuadrit rregullator e politik dhe ngritjen e strukturave, ndërkohë që progresi në aspektin e treguesve gjinor ka vështirësi në matje pasi mungojnë analizat sasiore dhe krahasuese me relacione mbështetëse mbi arsyet e hendeqeve, pasojat që ato sjellin dhe rekomandimet për përmirësim. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin e organit kryesor përgjegjës për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave që lidhen me çështjet gjinore, nuk arrin të mbledhë apo prodhojë tregues progresiv të qendrueshëm për çështjet gjinore, kjo si pasojë edhe e mungesës së një raportimi të standardizuar statistikor dhe krahasues nga aktorët e përfshirë në këtë çështje. Me gjithë përpjekiet pozitive, në të ardhmen fokusi më i madh duhet të jetë mbi procesin monitorues të përbashkët dhe të orientuar drejt rezultateve që i vijnë në ndihmë vendimarrjes, jo thjeshtë detyrimit për të zbatuar një plan masash.

---

## **16. Performanca e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara**

### *Konteksti i auditimit*

Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë periudhës janar-qershor 2019, ka realizuar auditimin e performancës mbi zhvillimin e shërbimeve sociale për PAK. Ky auditim ka pasur si objektiv matjen e performancës dhe efektivitetit të veprimtarisë për subjektet: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Bashkinë Tiranë dhe Bashkinë Vlorë. Auditimi i performancës mbi “Zhvillimin e Shërbimeve Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuar” ka rëndësi të veçantë për shkak të problematikave dhe vështirësive të shumta me të cilat ky grup shoqëror përballlet në përpjekjet për tu përfshirë në jetën sociale, politike, kulturore dhe ekonomike, me të drejta dhe mundësi reale si cdo qytetar tjetër.

Periudha në të cilën u fokusua puna audituese, ishin vitet 2017 dhe 2018. MSHMS është institucioni politikbërës që përcakton politikat dhe vënien në zbatim të tyre për përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuar, të cilat ndiqen dhe zbatohen nga institucionet ligjzbatuese që pjesë të veprimtarisë së tyre kanë edhe këtë fushë. Qeverisja vendore gjithashtu ka në funksionet e saj, kryerjen e një

vlerësimi të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, vënien në zbatim të politikave shtetërore dhe vazhdimin e koordinimit me MSHMS-në për vënien në zbatim të këtyre politikave.

Grupi auditues ka vlerësuar, Efektivitetin e subjekteve, si një nga komponentët kryesorë të performancës së institucioneve por sidomos, si hapin e parë që institucionet përgjegjëse duhet të përmbushin në zbatim të detyrimeve të tyre.

#### *Mesazhi auditues*

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për periudhën 2017-2018, nuk ka qenë efektive në rolin e vet garantues të shërbimeve sociale cilësore dhe të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta. MSHMS, nuk ka arritur të realizojë një koordinim efektiv të institucioneve të tjera shtetërore për të mundësuar dhënien në kohë dhe me cilësi të shërbimeve sociale që personat me aftësi të kufizuar i kanë të garantuara me ligj. MSHMS, ka arritur të jetësojë deri diku Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 dhe Planin Kombëtar të veprimit për personat me Aftësi të Kufizuar 2016-2020, por ende është mbrapa me arritjen e afateve dhe realizimin e të gjitha qëllimeve strategjike. Në fund të periudhës nën auditim, jetesa e personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri, NUK është cilësisht më e mirë prej shërbimeve sociale të marra nga institucionet shtetërore krahasuar me fillimin e periudhës nën auditim.

Për sa i takon Bashkisë Tiranë mungon një plan masash për zbatimin e ligjit 93/2014. Mungon një studim mbi aksesueshmërinë e qytetit nga personat me AK. Kjo ka sjellë si rezultat një qytet që zhvillohet pa marrë parasysh nevojat aktuale dhe urgjente të këtij grupi të anashkaluar njerëzish. Këto mungesa, pamundësojnë lëvizjen autonome të PAK në qytet dhe për rrjedhojë edhe mungesën e përfshirjes sociale dhe integritit në të gjitha fushat e jetës.

Për sa i takon Bashkisë Vlorë, ka mungesë të theksuar e të dukshme të aksesueshmërisë në infrastrukturën e qytetit, madje edhe në projekte madhore si “Lungo Mare”. Në mjediset e Bashkisë dhe të vetë Drejtorisë së Shërbimit Social, mungojnë standardet minimale për aksesueshmërinë e institucionit nga PAK. Kjo parashtron një situatë emergjente, e cila ka sjellë edhe mungesën e përfshirjes sociale të PAK në jetën e qytetit.

---

## **17. Performanca e Çerdheve dhe Kopshteve**

### *Konteksti auditues*

Vitet e para të jetës së fëmijës janë më të rëndësishmet, pasi në këtë fazë hidhen themelet e para të sjelljeve dhe zakoneve të tyre. Shumë fëmijë në Shqipëri nuk e arrijnë potencialin e tyre të plotë, sepse rriten në mjedise të kufizuara. Në mungesë të programeve të prindërimit, prindërit nuk kanë informacionin e duhur për rëndësinë e mësimin dhe zhvillimit të hershëm . Nën at beqare mund të duhet të përballen me barrën e shtuar të kujdesit për fëmijët, ndërkohë që ndodhen edhe në rolin e kryefamiljareve, me qasje në burime të kufizuara financiare për tarifatat parashkollore.

Ndër vite, në vendin tonë ka rezultuar problematike mungesa e kapaciteteve, kushteve të mjediseve të jashtme dhe të brendshme, cilësia e ushqimit, apo mangësitë në mjetet didaktike. Me gjithë përpjekjet e bëra, situata mbetet ende shqetësuese, kryesisht sa i takon tejkalimit të kapaciteteve dhe bazës materiale, e cila është e varfër dhe larg standardeve të përcaktuara . Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj fëmijëve në çerdhe e kopshte është domosdoshmëri, e cila mund të arrihet maksimalisht nëpërmjet shtimit dhe menaxhimit më të mirë të fondeve nga pushteti vendor e qendror, të cilat kanë si qëllim transformimin e infrastrukturës; rindërtimin dhe ndërtimin e objekteve të reja; rritjen e cilësisë së ushqimit, trajtimin e fëmijëve nga ekipi edukator, mjekësor dhe punonjës social, çka do të sillte një impakt pozitiv në investimin e kryer për të ardhmen e brezit që rritet në shërbim të vendit. Ndërveprimi social përbën rrënjët e zhvillimit të shëndetshëm dhe një ndër kushtet më të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit të tyre, pasi përvoja e parë e jetës kolektive për fëmijët është hyrja në shërbimin parashkollor. Duke i kushtuar vëmendjen e duhur mirërritjes dhe zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve, theksi duhet vënë te një shërbim parashkollor efektiv që promovon mirëqenien fizike, emocionale dhe sociale të fëmijës. Kujdesi për fëmijërinë e hershme është faktori thelbësor që siguron shëndetin fizik e mendor, si dhe edukimin e zhvillimin e përgjithshëm të tyre.

### *Mesazhi auditues*


Bashkitë Tiranë dhe Vlorë nuk kanë arritur të garantojnë një shërbim efektiv në kopshte dhe çerdhe. Sa i takon Bashkisë Tiranë, për çështjet që administron, përpjekjet janë bërë vetëm në drejtim të rikonstruksionit të godinave, ndërkohë që në Vlorë gjendja paraqitet e mjerueshme. Pothuaj të gjithë elementët që garantojnë mirërritjen dhe zhvillimin e fëmijëve janë jashtë standardeve, duke filluar që nga mungesa e hapësirave të përshtatshme, mbi popullimi tej kapaciteteve, raporti i cënuar edukator/fëmijë, kushtet higjieno-sanitare, inekzistenca e shërbimit të mjekut dhe psikologut me përjashtim të çerdheve të Tiranës, etj.

Në një kohë kur vendet që ne synojmë të kemi shembull i kanë përqendruar tashmë përpjekjet vetëm drejt përsosjes së teknikave edukuese dhe zhvilluese të fëmijës, vendi ynë ende nuk ju siguron dot kushtet elementare të nevojshme për qëndrimin në një institucion “përgjegjës për të ardhmen”. Ndërkohë, për periudhën objekt auditimi evidentohen përmirësime sa i takon kompetencave që ka QEZHEF.

## **II.6 Auditimet e sistemeve të informacionit**

Numri i auditimeve të Teknologjisë së Informacionit të realizuara nga KLSH, për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2019 në përmbushje planin vjetor është 7 auditime në subjekte të qeverisë qendrore dhe të vetëqeverisjes vendore dhe në entitete të tjera publike duke realizuan në masën 100% objektivat. Trendi i Auditimeve të teknologjisë së Informacionit ka ardhur në rritje nga viti në vit. Në grafikun e mëposhtëm paraqiten Auditimet e teknologjisë së informacionit 2015-2019 ku vërehet se hapat e hedhur në konsolidimin e këtij lloji auditimi.


Grafiku nr.7 Numri i auditimeve IT në vite



Numri i auditimet IT vite.

Burimi: KLSH

Grafiku nr.8 Numri i gjetjeve në auditimet IT



Numri i gjetjeve në auditimet IT vite.

Burimi: KLSH

Departamenti i Auditimit IT ka arritur që për vitin 2019, për çdo auditim të kryer të mbulojë mesatarisht 2.1 subjekte. Nga auditimet e kryera konstatohet se fushat më problematike të teknologjisë së informacionit (75% të gjetjeve) janë në fushat:

1. Siguria e Informacionit
2. Qeverisja TI
3. Zhvillimi dhe blerja

Për vitin 2019, gjetjet kryesore sipas subjekteve të audituara paraqiten në vijim:

## **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**

### **Përshkrimi i Auditimit:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, (MFE), Njësinë e Teknologjisë së Informacionit e AKSHI-t atashuar për MFE, nga data 06.06.2019 deri më datë 22.07.2019.

Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, (MFE), është pjesë e Planit Vjetor të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH me vendimin nr. 256, datë 31.12.2018. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që MFE disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendimmarrjen.

### **Mesazhi i auditimit**

*KLSH mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH" datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e Strategjisë në drejtim të teknologjisë informacionit, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të*

*nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së MFE. Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin shërbimeve dhe garantimin e sigurisë së të dhënave si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm. Në këtë drejtim, përdorimi i sistemeve në MFE mbart një risk të lartë në mbarëvajtjen e funksionaliteteve të ndërtuara në shërbim të qëllimit dhe objektivave institucionale. Ndërveprimi dhe bashkëpunimi i sistemeve të informacionit në lidhje me automatizimin e të dhënave me rëndësi të veçantë nuk është e konsoliduar.*

**Ndër gjetjet më kryesore të auditimit TI në MFE (për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes) po rendisim :**

- Teknologjia e informacionit në MFE zhvillohet pa Plan Strategjik.
- Ka mospërputhje në përcaktimet në VKM nr.352, datë 11.05.2016 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të SIFQ” dhe VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e AKSHI-t për sa i përket përcaktimit të institucionit administrues.
- Manuali IT, për mirëmbajtjen dhe administrimin e infrastrukturës dhe sistemeve të informacionit të Drejtorisë TIK pranë në MFE është i pa miratuar. Struktura e IT është e pa plotësuar me personel dhe e pa trajnuar.
- MFE nuk ka regjistër të menaxhimit të incidenteve.
- Nuk ka raporte monitorimi të MNSH midis MFE dhe AKSHI
- U konstatuan problematika në transferimet e pronësisë së aseteve teknologjike të MFE në drejtim të AKSHI-t.
- Nga auditimi mbi sigurinë e aksesit të network-ut u konstatuan shkelje të rregullave të sigurisë
- Shkëmbimi i drejtpërdrejtë i të dhënave ndërmjet sistemit të DPT dhe sistemit të thesarit (SIFQ) nuk kryhet në mënyrë automatike.
- MFE nuk administron përdoruesit e sistemit duke cenuar sigurinë e sistemit
- Mungojnë kontrollet periodike të output-it SIFQ.
- MFE nuk ka zhvilluar burimet njerëzore të Auditit të brendshëm me njohuri të mjaftueshme mbi teknologjinë e informacionit dhe nuk ka planifikuar, kryer misione auditimi në sistemet e TI-së,
- Auditit të brendshëm nuk ka akses dhe nuk shfrytëzon për auditim informacion nga sistemet informatike të MFE-së.
- Auditit të brendshëm nuk përdor teknika të auditimit të bazuara në teknologji informacioni, edhe pse në dispozicion të njësisë është edhe programi IDEA, i cili shërben për auditim të bazave të të dhënave.
- Problematika u konstatuan në degët e thesarit, Vlorë, Fieri, Lezhë dhe Shkodër si rezultat i shkallës së lartë të amortizimit të pajisjeve.

**Përshkrimi i Auditimit:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" datë 27.11.2014, nga data 28.01.2019 deri më datë 20.05.2019 zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në FSDKSH, është pjesë e Planit Vjetor të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH me vendimin nr. 256, datë 31.12.2018. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që institucioni disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendim-marrjen.

**Mesazhi i auditimit**

*KLSH mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310, neneve 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH " datë 27.11.2014 si dhe kuadrin ligjor e nënligjor të funksionit të FSDKSH konstaton se, mungesa e Strategjisë së Teknologjisë së Informacionit, ka çuar në keq adresimin e burimeve për mbështetjen e veprimtarisë së FSDKSH nga sistemet e teknologjisë së informacionit.*

*Teknologjia e Informacionit në FSDKSH nuk është në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore. Masat organizative të lidhura me sigurinë e informacionit nuk janë të mjaftueshme dhe trajtuar në mënyrë të përshtatshme, gjë që mbart riskun të lartë në keqtrajtimin e aseteve të informacionit, cenim të integritetit të të dhënave, qasje të paautorizuara. Masat e marra nga FSDKSH për sigurimin e Vazhdueshmërisë së Punës dhe Rimëkëmbjes nga Katastrofat kanë dështuar.*

*Të dhënat e ruajta në sistemet e FSDKSH janë të pa sigurta.*

**Ndër gjetjet më kryesore të auditimit TI në FSDKSH (për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes) po rendisim :**

- FSDKSH po zhvillon teknologjinë e informacionit pa strategji, dhe nuk menaxhon riskun institucional për teknologjinë e Informacionit.
- Nga auditimi konstatohet se DIAS nuk ka akses në bazën e të dhënave të sistemit e-Receta (as me të drejta lexuesi) dhe as në modulën audit vaut.
- Rrjeti i brendshëm i FSDKSH është i pasigurt dhe mbart riskun e sulmeve të jashtme.

- Për vitin 2018 serverat e FSDKSH janë mbajtur në ambiente që nuk plotësojnë standardet e miratuara nga AKSHI “Për ndërtimin e dhomës së serverëve”. DRC nuk plotëson standardet e miratuara nga AKSHI “
- FSDKSH nuk po zhvillon teknologji të cilat do ti përgjigjen fluksit në rritje të të dhënave (big data) mbështetur në të ashtuquajturin “programim logjik” i cili mbështetet në logjikën e vetë zhvilluesve të softuerëve për përzgjedhjen, grupimin e ndërlidhjen e informacioneve.
- Teknologjia e Informacionit në FSDKSH nuk është në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore. Masat organizative të lidhura me sigurinë e informacionit nuk janë të mjaftueshme dhe trajtuar në mënyrë të përshtatshme, gjë që mbart riskun të lartë në keqtrajtimin e aseteve të informacionit, cënim të integritetit të të dhënave, qasje të paautorizuara. Masat e marra nga FSDKSH për sigurimin e Vazhdueshmërisë së Punës dhe Rimëkëmbjes nga Katastrofat kanë dështuar.
- Të dhënat e ruajta në sistemet e FSDKSH janë të pa sigurta.

**Performanca në përdorim të internetit në Administratën Qendrore**

**Përshkrimi i Auditimit:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi auditimin IT mbi Performancën e Përdorimit të Internetit në Administratën Publike në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Kulturës, Agjencinë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Bashkitë Fier, Korçë, Lezhë dhe Vlorë, nga data 09.10.2019 deri më datë 18.11.2019 në zbatim të Programit të Auditimit nr. 779/11, datë 24.10.2019, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 09.10.2019 deri në 18.11.2019, periodha e audituar 01.01.2018 deri në 30.09.2019.

Komunikimi dhe shpërndarja e informacionit ndërmjet institucioneve shtetërore, private dhe informimi i publikut në epokën e zhvillimeve teknologjike ka qenë dhe do të jetë një sfidë për shoqëritë në të gjithë vendet e botës për të kaluar në ato që quhen shoqëri të informatizuara.

Përdorimi masiv i teknologjisë së informacionit në vitet e fundit tregon dobishmërinë e lartë publike e cila bazohet në modelin e ngritjes së rrjeteve të integruara me të gjitha garancitë e sigurisë së ruajtjes dhe përpunimit të informacionit sipas përcaktimeve ligjore të së drejtës së informimit, mbrojtjes së të dhënave personale, informacionit të klasifikuar.

Spektori publik bëhet kështu më transparent dhe i hapur, rritet si përgjegjshmëria ndaj qytetarëve ashtu dhe pjesëmarrja e tyre në

procesin e politikë bërjes, administrata orientohet duke vënë në qendër qytetarin, duke i siguruar shërbime online 24 orë, 7 ditë të javës.

Qeveria shqiptare në kuadrin e përmirësimit të shërbimeve qeverisëse ndaj qytetarëve, bizneseve si dhe përmirësimit të punës në administratë, ka implementuar dhe vazhdon të implementojë projekte të rëndësishme në fushën e tre grupeve të mëdha të e-Qeverisjes:

- Shërbime ndaj qytetarëve G2C (Government to Citizen).
- Shërbime ndaj biznesit G2B (Government to Business).
- Shërbime për punën e administratës shtetërore G2G (Government to Government).

Kontrolli i Lartë i Shtetit me objektiv vlerësimin e situatës së përgjithshme të rezultuar në institucionet e sipërpërmendura ndërmori procesin e auditimit me temë “Performanca e Përdorimit të Internetit në Administratën Publike”. KLSH ka propozuar rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës dhe shfrytëzimin e mundësive për bashkëpunim ndërmjet institucioneve të qeverisjes qendrore, autoriteteve, agjencive dhe vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera në mënyrë që të arrihen standarde të njëjtë dhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor, profesional, transparent dhe të përgjegjshëm nga administrata dhe ndaj qytetarëve kundrejt përdorimit të internetit si burim kryesor të qeverisjes elektronike.

### **Mesazhi i auditimit**

*KLSH mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH” datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e akteve rregullatore mbi përcaktimin e nevojave, përdorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të internetit, ka sjellë përdorimin pa ekonomikitet të fondeve, si dhe aksesin e pakontrolluar brenda institucioneve dhe jashtë tyre.*

*Mungesa e kontrolleve të nevojshme, nuk jep siguri të arsyeshme mbi mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit që realizojnë shërbimet kryesore të e-qeverisjes G2C (Government to Citizen), G2B (Government to Business) G2G (Government to Government).*

*Mungesa e dokumentacionit të nevojshëm dhe të mjaftueshëm për këtë shërbim dhe devijimet e konstatuara, ndikuar edhe nga fusha e audituar, janë jo të përhapura.*

*Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimit të internetit dhe vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi pa ndërprerje është i pa pamjaftueshëm.*

**Ndër gjetjet më kryesore të auditimit TI në 11 subjekte (për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e**

### **gjendjes) po rendisim :**

- Në këto subjekte u evidentuan: mungesa e akteve rregullatore mbi përcaktimin e nevojave, përdorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të internetit, përdorimin pa ekonomikitet të fondeve, si dhe aksesin e pakontrolluar brenda institucioneve dhe jashtë tyre.
- Mungesa e kontrolleve të nevojshme, nuk jep siguri të arsyeshme mbi mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit që realizojnë shërbimet kryesore të e-qeverisjes G2C (Government to Citizen), G2B (Government to Business) G2G (Government to Government).
- Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin e shërbimit të internetit dhe vazhdimësisë së ofrimit të këtij shërbimi pa ndërprerje është i pa pamjaftueshëm. Nga analizimi i të dhënave për vitin 2019, për të gjithë institucionet që janë pjesë e GOVNET rezulton se 85.53% e trafikut të internetit përdoret për të bërë update sistemeve operative të Microsoft, ndërsa 14.47 % e tij shkon për rrjetet sociale, filma, muzike, radio, shkarkime dhe lojëra.
- Nga auditimi u konstatua se në Bashkitë Fier, Korçë dhe Vlorë nuk ka dokumentacion mbi zbatimin e kontratës MNSH-s. Per shërbimin e Internetit ndërsa në Bashkinë Korçë, nuk ka raporte monitorimi për këtë shërbim
- Nga auditimi u konstatua se asnjë nga Bashkitë audituara nuk kryen kontrolle mbi aktivitetin e përdoruesve.
- Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit (Service Level Agreement), të lidhura midis AKSHI-t me MBZHR dhe MK, nuk janë hartuar sipas kërkesave të Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 për Hartimin e Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit.
- Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk disponojnë procedura mbi administrimin e incidenteve dhe problemeve, këto institucione nuk kanë të dokumentuar një plan masash për trajtimin e problemeve dhe incidenteve që mund të ndodhin. Në mungesë të këtyre procedurave të shkruara, problemet dhe incidentet për periudhën nën auditim menaxhoheshin mbi bazë ngjarjesh të cilat raportoheshin nëpërmjet email-eve.
- Gjithashtu këto subjekte nuk kanë realizuar identifikimin e problemeve dhe incidenteve, si dhe nuk disponojnë një bazë të të dhënave të gabimeve të njohura dhe historikun e incidenteve të mëparshme, siç edhe kërkohet në MNSH-t respektive.
- Nga analizimi i të dhënave për vitin 2019 për të gjithë institucionet që janë pjesë e GOVNET rezulton se 85.53% e trafikut të internetit përdoret për të bërë update sistemeve operative të Microsoft, ndërsa 14.47 % e tij shkon për rrjetet sociale, filma, muzike, radio, shkarkime dhe lojëra.
- Nga auditimi u konstatua se në Bashkitë Fier, Korçë dhe Vlorë

- nuk ka dokumentacion mbi zbatimin e kontratës MNSH-s.
- Nuk ka plane, përgjegjësi, dhe procedura të mirëpërcaktuara ndaj incidenteve të mundshme në drejtim të ofrimit të shërbimit të internetit. Gjithashtu nuk janë të përfshirë të gjithë elementët e MNSH-së, sipas Udhëzimit Nr. 1159, datë 17.3.2014 “Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit”.
- Bashkitë Fier, Lezhë dhe Vlorë, nuk kanë ngritur grupe për marrjen në dorëzim të shërbimit të internetit apo grupe për monitorim të kontratës.
- Ndërsa në Bashkinë Korçë, edhe pse ka grup monitorimi dhe mbahet një procesverbal për marrjen në dorëzim, përsëri nuk ka raporte monitorimi për këtë shërbim.
- Nga auditimi u konstatua se asnjë nga Bashkitë audituara nuk kryen kontrole mbi aktivitetin e përdoruesve. Në Bashkitë Fier, Lezhë e Vlorë, log-et nuk janë të ruajtura as nga Bashkitë dhe as nga operatorët ekonomik. Ndërsa në Bashkinë e Korçës, log-et ruhen në mikrotik, por edhe në këtë rast ruhen vetëm log-et e IP-ve statike të cilat po ashtu humbasin në rast rindezjeje të pajisjes. Gjithashtu këto institucione nuk ka marrë masat për krijimin e një active directory dhe Domani controller për menaxhimin e user-ave.
- KLSH vlerëson se kjo qasje rrit riskun e pasigurisë në përdorimin e internetit si dhe ndërhyrjeve të mundshme në rrjetin e Bashkive.

**Korporata  
Elektroenergji  
ke Shqiptare –  
(KESH) SHA**

**Përshkrimi i Auditimit:**

Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në KESH sh.a., është pjesë e Planit Vjetor të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH me vendimin Nr.256, datë 31.12.2018. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që shoqëria disponon, për të garantuar vazhdimësi dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendim-marrjen.

**Mesazhi i auditimit**

*KLSH mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH" datë 27.11.2014 KESH sh.a ka zhvilluar teknologjinë e informacionit në mungesë të një Strategjie që mbështet objektivat e shoqërisë.*

*Masat organizative të lidhura me sigurinë e informacionit nuk janë të mjaftueshme dhe nuk janë trajtuar në mënyrë të përshtatshme, gjë që mbart riskun të lartë në keqtrajtimin e aseteve të informacionit, cënim të integritetit të të dhënave, qasje të paautorizuara. Masat e marra për*

*sigurimin e Vazhdimësisë së Punës dhe Rimëkëmbjes nga Katastrofat nuk janë të mjaftueshme.*

**Ndër gjetjet më kryesore të auditimit TI në KESH (për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes) po rendisim :**

- Teknologjia e Informacionit në KESH sh.a është zhvilluar në mungesë të një plani strategjik i cili të mbështesë arritjen e objektivave të vetë institucionit.
- Nuk disponon një regjistër risku për identifikimin, kategorizimin, ndjekjen dhe minimizimin e risqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit.
- Nuk disponon një plan vazhdimësie për ofrimin dhe garantimin e shërbimit në rast ndërprerje nga shkaqe natyrore apo njerëzore.
- Nuk disponon rregullore të përdorimit të sistemeve, përcaktimit të proceseve të automatizuara dhe detyrat dhe përgjegjësitë që vijnë si rezultat i përdorimit të sistemeve.
- Masat organizative të lidhura me sigurinë e informacionit nuk janë të mjaftueshme dhe nuk janë trajtuar në mënyrë të përshtatshme, gjë që mbart riskun të lartë në keqtrajtimin e aseteve të informacionit, cënim të integritetit të të dhënave, qasje të paautorizuara.
- Masat e marra për sigurimin e Vazhdimësisë së Punës dhe Rimëkëmbjes nga Katastrofat nuk janë të mjaftueshme.

**Përshkrimi i Auditimit:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" datë 27.11.2014, nga data 03.09.2018 deri më datë 15.10.2018 zhvilloi një Auditim të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit në Ujësjiellës Kanalizime Lushnje Sh. A.

Ujësjiellës Kanalizime Lushnje Sh. A është shoqëri aksionare e licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me kapital 100 % të Bashkisë Lushnje që zhvillon aktivitetin e saj në territorin që shtrihet në lindje të fushës së Myzeqesë, buzë kodrave të Darsisë me një sipërfaqe prej 37 km<sup>2</sup> për një popullsi prej rreth 60000 banorë.

Auditimi i sistemeve TI u krye me objektivin për tu garantuar nëse ekzistojnë strukturat, politikat dhe procedurat në strukturat IT që mundësojnë Ujësjiellës Kanalizime Lushnje Sh.A. të arrijë objektivat në funksion të plotësisë të misionit.

**Mesazhi i auditimit**

*KLSH duke vlerësuar rolin e teknologjisë së informacionit në përmbushjen e misionit të Ujësjiellës Kanalizime Lushnje Sh. A., duke mbështetur auditimin në Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 1 Neni 22, Ligjin e KLSH Nr.154/2014 Neni 3 dhe 14, Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (WGITA), COBIT 4.1, ISSAI 5300.6, 8 dhe 12.2, 16.19, 21.1, 23, ISSAI 100.36,48, ISSAI*

**Ujësjiellës  
Kanalizime  
Lushnje**

5310), pas shqyrtimit të të dhënave dhe dokumentacionit TI të vënë në dispozicion nga Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A., arriti në konkluzionin se:

Ujësjetllës Kanalizime Lushnje Sh. A. ka zhvilluar sisteme të Teknologjisë së Informacionit pa hartuar bazën e nevojshme rregullatorë për funksionimin e tyre dhe të pa mbështetura me burimet e nevojshme njerëzore.

Investimet në sistemet e informacionit nuk kanë zgjidhur përfundimisht problemet e sigurisë së informacionit, sigurimin e Vazhdueshmërisë së Biznesit dhe nuk kanë siguruar Rimëkëmbjen nga Katastrofat. Zhvillimi i shërbimeve dhe infrastrukturës duhet të mbështetet në praktikat më të mira si dhe rekomandimet e AKSHIT.

Sistemet TI janë të komprometuara nga mungesa e Strategjisë TI, dhe mbartin riskun e keq adresimit të burimeve të limituara financiare që ka UKL Sh. A. për mbështetje e veprimtarisë së saj.

**Ndër gjetjet më kryesore të auditimit TI në UKL (për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes) po rendisim :**

- Ujësjetllës Kanalizime Lushnje sh.a. nuk ka politika të ruajtjes së dokumenteve dhe nuk ka të dokumentuar një plan masash për identifikimin, trajtimin e gabimeve dhe incidenteve. Subjekti përdor Sistemin e Faturimit “Al Billing”, i cili rezulton a) i pa regjistruar si asset dhe b) në kushtet e mungesës së suportit. Konstatuam gjithashtu se funksionimi i sistemit nuk mbështetet në rregullore.
- Struktura IT-së nën Sektorin e Burimeve Njerëzore, nuk i përgjigjet shtrirjes së teknologjisë së informacionit në UKL.
- Sistemi i menaxhimit gjeospacial të aseteve (web Gis) i është populluar në një përqindje të ulët
- Nuk ka kontroll e rakordim me drejtorine rajonale tatimore për faturat e leshuara nga ky subjekt nga Sistemin e Faturimit “Al Billing”.

**Ujësjetllës  
Kanalizime  
Berat Kuçovë**

**Përshkrimi i Auditimit:**

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një Auditim të Teknologjisë së Informacionit në UKBK sh.a me Fokus Auditimin e Sistemeve të Teknologjisë të Informacionit, nga data 07.01.2019 deri më datë 15.03.2019.

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në UKBK sh.a, është pjesë e Planit Vjetor të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH me vendimin nr.256, datë 31.12.2018. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH, ka vlerësuar

si të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë që shoqëria disponon, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave me të cilat bazon vendimarrjen.

### **Mesazhi i auditimit**

*KLSH mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit përkatësisht në ISSAI 100, ISSAI 5300, ISSAI 5310 si dhe nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH " datë 27.11.2014 konstaton se, mungesa e Strategjisë në drejtim të teknologjisë, mbart riskun e keq adresimit të burimeve të nevojshme për mbështetjen e veprimtarisë së UKBK sh.a.*

*Në gjykimin tonë, identifikimi dhe administrimi i elementëve kritikë në ofrimin dhe garantimin e sigurisë së të dhënave, ofrimin si dhe vazhdimësisë në ofrimin e shërbimit nëpërmjet teknologjisë së informacionit është i pa pamjaftueshëm, çfarë mbart një risk të lartë në mbarëvajtjen e funksionaliteteve të ndërtuara në shërbim të qëllimit dhe objektivave institucionale.*

### **Ndër gjetjet më kryesore të auditimit TI në UKBK (për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes) po rendisim:**

- UKBK sh.a nuk ka një strategji të shkruar e miratuar për Teknologjinë e Informacionit duke mos pasqyruar qartë objektivat lidhur me infrastrukturën, burimet e nevojshme si dhe instrumenteve të nevojshëm për matjen e objektivave.
- Mungon një strukturë e mirëpërcaktuar e TI-së me personel të kualifikuar duke mbartur kështu riskun e performancës së dobët të personelit ekzistues si rezultat e mbingarkesës, me pasojë mosarritjen e objektivave dhe mosplotësimin e kërkesave për dhënien e shërbimeve.
- UKBK sh.a nuk disponon një regjistër risku për minimizimin e risqeve që lidhen me teknologjinë e informacionit.
- UKBK sh.a u konstatuan mungesa të akteve rregullative në lidhje me përdorimin e sistemit, veprimeve operacionale për garantimin e saktësisë dhe plotësisë së të dhënave.
- UKBK sh.a nuk ka kryer marrjen e masave organizative në lidhje me sigurinë e të dhënave, të drejtat dhe menaxhimin e përdoruesve dhe vazhdueshmërinë e ofrimin të shërbimit.
- UKBK sh.a nuk kryen hartimin në kohë të nevojave për mjete e shërbimeve IT.

## **II.7 Kallëzimet penale dhe proceset gjyqësore**

Gjatë vitit 2019 KLSH ka bërë **28** kallëzime penale dhe **2** në proces, për **40** drejtues të nivelit të mesëm dhe të lartë. Gjatë kësaj periudhe KLSH është angazhuar në **101** procese gjyqësore, nga këto **28** procese gjyqësore penale me objekt "Kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë" dhe **73** procese gjyqësore administrative

dhe civile, ku KLSH ka qenë në cilësinë e të paditurit dhe personit të tretë. Proceset gjyqësore kanë pasur një shpërndarje të madhe gjeografike, ku përfshihen gjykata si Tiranë, Durrës, Kavajë, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë, Përmet, Gjirokastër, Lezhë, Shkodër, Kukës, Dibër, Pukë, Mat, Tropojë, Korçë.

Duhet theksuar se KLSH në 8 vitet e fundit, 2012-2019, ka përcjellë 336 kallëzime penale për 999 persona, ose thënë ndryshe ka adresuar çdo javë një Kallëzim penal, për zyrtarët e nivelit të mesëm dhe të lartë, të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH. Gjithashtu, numri i kallëzimeve penale dhe i personave të kallëzuar gjatë kësaj periudhe është 2 herë më i lartë krahasuar me periudhën 10 vjeçare 2002-2011.

Gjatë vitit 2019 prioritet i KLSH-së, ndër të tjera ka qenë ndjekja e proceseve gjyqësore për të cilat KLSH ka iniciuar kallëzimet/indiciet penale. Referuar numrit të vendimeve të pushimit të ardhura në KLSH evidentohet fakti se këto vendime janë ankimuar në masën **100%**.

Janë ndjekur 28 procese gjyqësore penale me objekt procedimet penale të regjistruara nga kallëzimet penale të referuara nga KLSH. Janë shqyrtuar 23 kërkesa për pushim të procedimeve penale, 14 prej të cilave janë pranuar nga gjykatat, duke vendosur rrjedhimisht pushimin e këtyre procedimeve dhe 11 prej tyre janë rrëzuar nga gjykatat, për shkak të hetimeve të mangëta, duke i kthyer aktet prokurorive përkatëse, për hetime të mëtejshme. Po kështu, janë shqyrtuar gjyqësisht 5 kërkesa për gjykim, në lidhje me këto procedime penale. Për 3 prej tyre gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesë së organit të Prokurorisë dhe për 2 prej tyre ka vendosur pranimin.

Janë zhvilluar 8 procese gjyqësore administrative/civile, ku KLSH ka patur cilësinë e paditësit/të paditurit, ku 3 prej tyre kanë lidhje me padi të ngritura nga ish-punonjës (marrëdhënie pune) dhe 5 prej tyre kanë objekte të ndryshme.

Janë zhvilluar 65 procese gjyqësore ku KLSH ka qenë palë në këto procese gjyqësore, në cilësinë e personit të tretë, në lidhje me proceset gjyqësore të iniciuara si pasojë e rekomandimeve të lëna nga KLSH në subjektet e audituar.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2019 janë të shumta vendimet gjyqësore të cilat konfirmojnë rekomandimet e lëna nga KLSH në subjektet e audituar.

Në proceset gjyqësore KLSH ka insistuar në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, arkëtimit të dëmit dhe parandalimit të efekteve negative financiare.

Gjatë këtij aktiviteti KLSH ka evidentuar disa problematika që lidhen me neglizhenca dhe mosveprime të subjekteve shtetërore përgjegjëse si vijon:

- Kërkesë padi me të meta, të subjekteve të audituara;
- Jurist jo kompetent për mbrojtje efektive;
- Mosprezenca e juristëve të subjekteve të audituara në seancat gjyqësore.
- Ngritja e padive jashtë afateve ligjore;
- Mos ankimim i vendimeve në disfavor të subjekteve shtetërore;
- Mosparaqitja e provave (detyrimi i subjektit shtetëror, sipas Ligjit “Për gjykatat administrative”) etj.

### **III. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit**

#### **III.1 Komunikimi dhe Transparenca**

Komunikimi perifrazohet nga shumë specialistë si një tërësi objektivash strategjike dhe veprimesh që supozohet se do të sjellin rritjen e profilit të institucionit dhe besueshmërinë e tij në publik. Komunikimi është një mjedis kompleks dhe zotërimi i disa kanaleve është thelbësor për arritjen e objektivave. Studimet mbi komunikimin tregojnë se është pothuajse e pamundur të arrihen qëllimet e një kompanie/institucioni pa përcaktuar një strategji të mirë komunikimi. Duke kuptuar dhe vlerësuar rëndësinë e komunikimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka hartuar një dokument shumë të rëndësishëm për institucionin Strategjinë e Komunikimit të KLSH-së për vitet 2017-2019, në të cilën janë përfshirë 6 objektiva kryesorë :

**Objektivi Nr. 1:** Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.

**Objektivi Nr. 2:** Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.

**Objektivi Nr. 3:** Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinionin publik rezultatet dhe dobietë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.

**Objektivi Nr. 4:** Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rrumbullakëta.

**Objektivi Nr. 5:** Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.

**Objektivi Nr. 6:** Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit.

Nga monitorimi i implementimit të “Strategjisë së komunikimit të KLSH-së 2017-2019” rezulton që KLSH ka realizuar të gjashtë objektivat e mësipërm në masën 90%, duke evidentuar në detaje pikat e forta dhe pikat e dobëta, në mënyrë që elementët e pa realizuar të përfshihen në Strategjinë e re të komunikimit që po përgatitet nga institucioni.


##### **III.1.1 Aktiviteti i KLSH në media**

Referuar objektivave të strategjisë së Komunikimit të institucionit dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vënë theksin tek komunikimi me publikun dhe tek transparenca e aktivitetit auditues, me qëllim përcjelljen e mesazhit tek qytetarët.

Gjatë vitit 2019, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp të KLSH-së në një numër prej 405 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike. Situata është përmirësuar ndjeshëm në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2019,

periudhë gjatë së cilës media ka pasqyruar aktivitetin e KLSH-së me 332 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike, ndërkohë që gjatë gjashtë mujorit të parë ka pasur vetëm 73 të tillë. Komunikimi dhe bashkëpunimi me median vijon me të njëjtën frymë dhe intensitet dhe të gjitha mediat janë ftuar të marrin pjesë edhe në analizat vjetore të Departamenteve të auditimit, duke rritur në këtë mënyrë transparencën e veprimtarisë së KLSH-së.

Grafiku nr. 9 Shkrime për KLSH




Burimi: KLSH

### III.1.2 Prezenca e audituesve në median e shkruar

Për periudhën shtatë-vjeçare 2013-2019 të gjithë audituesit e KLSH-së kanë botuar në total 764 artikuj pothuajse në të gjitha gazetat e vendit. Për të kuptuar dinamikën, mund të përmendim se për vitin 2019, 90 auditues, prej të cilëve rreth 30% janë auditues të rinj, kanë qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 122 shkrime (numri i shkrimeve u rrit ndjeshëm gjatë gjashtë mujorit të dytë). Shkrimet e audituesve janë botuar në 12 volume dhe përfaqësojnë fytyrën e punës sonë audituese për gjetje dhe problematika të dala gjatë auditimit duke i shërbyer drejtpërsëdrejti qytetarit. Temat e trajtuara nga audituesit e KLSH-së në shkrimet e tyre kanë qenë shumë të larmishme dhe kanë prekur çështje të arsimit publik, të parajsave fiskale, të strategjisë antikorruption të qeverisë shqiptare, të partneritetit publik-privat dhe koncesioneve, keq-menaxhimit të plazheve publike, reformës territoriale, programeve sociale të strehimit etj.

Grafiku nr. 10 Shkrime për KLSH



Burimi: KLSH

### III.1.3 Trajtimi i letrave të qytetarëve dhe kërkesave për informim


Gjatë vitit 2019, KLSH ka trajtuar 300 letra dhe ankesa nga të cilat 148 kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit. Të gjitha këto kërkesa janë adresuar për kompetencë në institucionet përkatëse. Në pritje të marrjes së përgjigjes nga institucionet e adresuara, qytetari vihet në dijeni nga KLSH dhe informohet pas ardhjes së përgjigjeve zyrtare. Nga 152 ankesa në kompetencë të KLSH, 127 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigje, ndërsa 25 janë në ende në proces verifikimi.

Jemi në vitin e pestë të zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe natyrisht kemi një bilanc dhe një eksperiencë pune të konsoliduar. Ky legjislacion për ne është e drejtë elementare e çdo individi në një shoqëri demokratike. Gjatë vitit 2019 kemi pasur një rritje të numrit të kërkesave për informim. Këto kërkesa janë adresuar kryesisht me email në adresë të koordinatorit, në rrugë postare dhe nëpërmjet portalit “Pyet shtetin.al”.

Numri i shkresave të ardhura në adresë të Koordinatorit për të drejtën e informimit dhe të shqyrtuara prej tij për vitin 2019 ka qenë 37 dhe gjatë këtij viti nuk kemi pasur raste për të cilat është refuzuar dhënia e Informacionit.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohen fushat kryesore të shqetësimit publik për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 21% e ankesave të adresuara KLSH-së i takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; 37% privatizimit dhe kthimit të pronës; 4% në tatime e dogana dhe 31% fushave të tjera dhe 7% trajtojnë çështje të ndryshme.

Grafiku nr. 11 Letrat e qytetarëve



Burimi: KLSH

### III.1.4 Muaji i hapur

Edhe në vitin 2019, në zbatim të një prej objektivave të Strategjisë së Komunikimit të institucionit, KLSH organizoi për të tretin vit radhazi **Muajin e Hapur** për qytetarët në datat 1 nëntor-6 dhjetor 2019<sup>9</sup>. Gjatë muajit të hapur audituesit e KLSH-së morën pjesë në shumë aktivitete brenda dhe jashtë institucionet, si më poshtë:

<sup>9</sup> Me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, një pjesë e aktiviteteve të Muajit të hapur u shtynë për në një periudhë të dytë për shkak të tërmetit që goditi vendin në 26 nëntor 2019. Muaji i hapur u mbyll në datën 10 janar 2020.

- Takimi mbi **“Parimet e barazisë gjinore dhe buxheti i përgjegjshëm gjinor”**, zhvilluar në qytetin e Durrësit. Ky aktivitet u organizua nga UN Women Albania dhe në të merrnin pjesë institucionet e pavarura të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Avokatit të Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Audituesit e KLSH-së vizituan **ekspozitën “Vetmia e Engjëllit”**, e cila u çfaq në Tiranë si bashkëpunim i Muzeut Historik Kombëtar dhe Akademisë *Torre Carrara* dhe Arte Mondadori. Giammarco Puntelli, autor dhe kritik arti, përzgjedhi 37 prej artistëve më të rëndësishëm dhe të vlerësuar si në Itali ashtu edhe jashtë saj, në një temë shumë të veçantë;
- **Në datën 4 nëntor 2019, në sallën “Gene Dodaro”, në KLSH, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj** prezantoi përpara drejtuesve dhe audituesve të KLSH-së, rezultatet e punës së periudhës janar-shtator të vitit 2019. Kryetari Leskaj theksoi që për periudhën janar – shtator 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit nga 122 auditime të planifikuara ka kryer 122 auditime dhe ka përfunduar dhe evaduar 85 të tillë. Auditimet janë shtrirë në institucione qendrore dhe njësi të varësisë për të pasur një mbulim të kënaqshëm dhe për të garantuar një sistem menaxhimi financiar dhe kontrolli sa më efektiv.
- Në datën 8 nëntor 2019 në kuadër të aktiviteteve të Muajit të Hapur në KLSH, nga **Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore u organizua prezantimi dhe diskutimi mbi auditimet me impakt për publikun** si dhe të trajtuara gjerësisht në median e shkruar për shkak të problematikës tepër të ndjeshme që është trajtuar në këto auditime të kryera nga ky departament. Një nga prezantimet e përzgjedhura ishte mbi auditimin e ushtruar në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, Tiranë, me objekt *“Auditimin Financiar dhe Përputhshmëri”*, për periudhën 01.01.2017 deri në 31.12.2018, mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare, shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve;
- **Në datën 11 nëntor në sallën “Lech Kaczynski” në KLSH, u prezantuan dy botime të KLSH, të realizuara gjatë vitit 2019:**
  - o 3 vjet Auditim i Jashtëm Publik, 2016-2018, Dokumente të Kryetarit;
  - o Audituesit e KLSH në shtypin e përditshëm, Volumi XII.
- **Në datën 11 nëntor 2019**, në Hotel Tirana Internacional, u zhvillua promovimi i librit **“Historia e Mendimit Shqiptar”, i studiuesit Ndriçim Kulla**, botim i cili vjen si një vështrim historik, kulturor, sociologjik dhe psikologjik mbi kombin shqiptar. Në promovimin e librit morën pjesë Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj si dhe të ftuar e pjesëmarrës që përfshinin gjithë fushat, studiues, pedagogë, filozofë, mjekë, politikanë, juristë, auditues të KLSH-së, etj. Ky libër, përfshin të gjitha rrjedhat e mendimit shqiptar, që në gjurmët dhe filizat e tij kur u kristalizua, shkollat dhe rrymat e tij, tiparet dhe aktualitetin e tij të jashtëzakonshëm dhe do të plotësojë një boshllëk të madh për kulturën dhe shkencën shqiptare.
- Brenda aktiviteteve të Muajit të Hapur u organizua në datat 5-6 nëntor 2019 në mjediset e Akademisë së Shkencave, Konferenca e Audituesve të rinj të KLSH-së **“Young ALSAI”**<sup>10</sup>, me temë kryesore *“Sfidat e Auditimit Publik në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE”*.

---

<sup>10</sup> Ky aktivitet do të trajtohet më gjerësisht në kapitullin III.1.5

- Në datën 12 nëntor në sallën e KLSH-së, “Gene Dodaro”, **Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit** prezantoi dy auditimet më të mira të zhvilluara gjatë vitit 2019. Këto auditime ishin dy auditime përputhshmërie përkatësisht: auditimi në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë “Mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2018” si dhe auditimi i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve “Mbi përputhshmërinë e aktivitetit për periudhën 1.1.2018-31.12.2018”.
- Në datën 14 Nëntor 2019, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua një takim mes audituesve të KLSH, me temë diskutimi botimin e vitit 2019 **“Rregullorja e procedurave të Auditimit të KLSH-së & Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve”**.
- Në datën 10 janar 2020 (për shkak të shtyrjes së aktiviteteve të muajit të hapur) në ambientet e Akademisë së Shkencave u zhvillua **takimi mbi shkëmbimin e eksperiencave dhe përvojave të fituara nga audituesit e KLSH-së në aktivitetet jashtë vendit përgjatë vitit 2019**. Gjatë vitit 2019, 82 auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit morën pjesë në 44 aktivitete të zhvilluara jashtë vendit dhe kanë ndjekur një total prej 258 ditë trajnime. Në këto aktivitete kanë marrë pjesë si audituesit me eksperiencë, ashtu edhe ata të rekrutuar rishtazi në radhët e institucionit. Në takim morën pjesë të gjithë drejtuesit dhe audituesit e KLSH-së dhe u referua nga audituesit pjesëmarrës për të gjitha aktivitetet e vitit 2019, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe përfitimin e dijeve nga njëri-tjetri;
- Gjatë muajit të hapur u zhvilluan edhe shumë aktivitete të tjera si leksione me profesorë të universiteteve, nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit, pjesëmarrja në panairin e librit, takime të të gjitha departamenteve të Auditimit ku janë diskutuar dy auditimet më të mira të vitit 2019 dhe dy auditimet më problematike, etj.

### ***III.1.5 Konferenca YOUNG ALSAI dhe Revista Shkencore “Auditimi Publik”***

#### **Konferenca Shkencore e Audituesve të rinj, Young ALSAI**

K Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi në datat 5-6 nëntor 2019 në mjediset e Akademisë së Shkencave dhe në mjediset e tij në Tiranë, Konferencën e Audituesve të rinj të KLSH-së “Young ALSAI”, me temë kryesore “*Sfidat e Auditimit Publik në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE*”. Në Konferencë morën pjesë përfaqësues të Komisionit Europian, z. Raymond Hill, Përgjegjës Ekipi (Team Leader) në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit (DG-Budget) të Komisionit Evropian, z. Salvador Bertomeu Hernandez, DG-Budget dhe z. Joop Vrolijk, Ekspert i Financave Publike dhe Auditimit të Jashtëm në BE, ish-Këshilltar i Lartë i SIGMA, përfaqësues nga bota akademike, nga shoqëria civile, si dhe auditues të rinj dhe auditues me eksperiencë të KLSH.

Konferenca shkencore “Young ALSAI” organizohet për herë të dytë dhe synon të shndërrohet në një aktivitet traditë për institucionin, si dhe në një pikë referimi, platformë dhe tribunë shkëmbimi eksperiencash, për nxitjen e brezit të ri të audituesve për të vijuar në karrierën e tyre profesionale në KLSH, duke thelluar dijet në auditim dhe rritur bashkëpunimin mes tyre dhe audituesve më me përvojë, si dhe me rrjetin e audituesve të rinj në SAI-t partnere në Evropë dhe më gjerë. Kjo konferencë u zhvillua paralelisht me Konferencën e Katërt “Young EUROSAI”, në Londër, me temë “*Rëndësia: Të sigurojme që institucionet supreme të auditimit të*

*mbeten të rëndësishme në ndryshimet e shpejta në mjedisin qeverisës”, në të cilën morën pjesë edhe tre auditues nga KLSH. Kjo temë e konferencës ka shumë anë të ngjashme me temën e përzgjedhur nga Konferenca e dytë Young ALSAI “Çështjet kryesore të auditimit publik në kontekstin e ndryshimeve drejt integritit evropian të Shqipërisë”.*

Si anëtar i INTOSAI-t dhe EUROSAI-t dhe partner i SAI-ve të zhvilluara të BE-së, KLSH e konsideron ndërtimin e kapaciteteve audituese një proces të vazhdueshëm, të orientuar nga rezultati dhe objektivat.

Në leksionet e tyre përfaqësuesit e KE-së dhe SIGMAs falënderuan për ftesën dhe për iniciativën e veçantë të KLSH-së për promovimin e audituesve të rinj. Diskutimet e tyre u përqendruan në :

Kontrollin e Brendshëm, në kontekstin në të cilin ai operon, në përgjegjshmërinë e menaxherëve që drejtojnë kontrollin e brendshëm dhe në reformat që duhen ndërmarrë për rritjen e efektivitetit të Kontrollit të Brendshëm;

Auditimin e fondeve IPA, duke filluar me strukturat që menaxhojnë fondet IPA deri tek auditimi i tyre. Shqipëria ka marrë fonde IPA në tre fusha kryesore : ndërtimi i kapaciteteve, bujqësia dhe zhvillimi rural, bashkëpunimi rajonal dhe territorial;

Ndryshimet që duhen bërë në fushën e auditimit të jashtëm për t'u përgatitur për anëtarësimin në BE.

Panelistët dhe diskutuesit e shumtë në Konferencë theksuan se KLSH, gjatë periudhës 2012–2019, ka punuar që trupa audituese të zhvillohet, mbi të gjitha në drejtim të krijimit të një profili të lartë profesional, me auditues me eksperiencë, të kombinuar me auditues të rinj, që zotërojnë dije, aftësi dhe integritet në nivelet e audituesve të SAI-ve të zhvilluara evropiane. Institucioni është përpjekur të rekrutojmë sa më shumë auditues të rinj, i bindur në vlerën e shtuar që ata sjellin me mendësinë e re në qasjet inovative në auditim.

Me qëllim përmirësimit e performancës së tyre në auditim, si dhe për të fituar njohuri e teknika të reja, një pjesë e punonjësve të rinj kanë përfunduar studimet universitare në degë të dyta apo zotërojnë certifikata profesionale të njohura në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Politika e ndjekur nga KLSH për zhvillimin e kapaciteteve audituese, e mbështetur nga Strategjia e tij e Zhvillimit 2013–2017, e rishikuar, si dhe me pas nga Strategjia e Zhvillimit 2018-2022, ka synuar rekrutimin dhe mbajtjen e audituesve të rinj të aftë, të përkushtuar e të motivuar për të kontribuar në zhvillimin individual dhe më pas për të gjithë institucionin.

Në Konferencë referuan dhe paraqitën punimet e tyre 29 auditues të rinj dhe punimet e saj u ndoqën nga 100 pjesëmarrës. Në ditën e dytë të Konferencës, u trajtuan gjerësisht temat si auditimi jashtëm publik në vendet e BE-së, rregulloret dhe direktivat që lidhen me auditimin e fondeve të asistencës dhe përafrimi legjislativ me *Acquis Communautaire*, sistemet e menaxhimit të asistencës, marrëveshjet kuadër përfshirë : strukturat, rolet dhe rregullat e funksionimit, IPA si instrument i mbështetjes financiare të BE-së për vendet që aspirojnë integritimin, qasja e auditimit dhe llojet e auditimit për fondet e IPA-s, analiza e riskut në auditimin e fondeve të asistencës së BE-së, Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA) dhe auditimi i programeve të financimit, vlerësimi i riskut të projekteve, etj.

Konferenca “Young ALSAI ” përcolli mesazhet qendrore, të tilla si:

1. KLSH duhet të orientojë gjithnjë e më shumë audituesit e tij, sidomos ata të rinj në përdorimin e Sistemit të Informacionit për Menaxhimin dhe Mbështetjen e Proceseve të Auditimit, të quajtur RevZone, si dhe në auditimet e sistemeve të informacionit, të bazave masive të të dhënave Big Data.

2. Institucioni ka krijuar bazën e të dhënave për subjektet e auditimit IT (ICTS Database) dhe ka zhvilluar Manualin Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, i cili u testua në një auditim pilot, u përmirësua edhe me kontributin modest të audituesve të Teknologjisë së Informacionit të KLSH(në pjesën dërrmuese i përbërë nga auditues të rinj), u prezantua në disa evente të grupeve të punës së TI të EUROSAT-t dhe INTOSAT-t dhe po implementohet si një inovacion në fushën e auditimit nga komuniteti ndërkombëtar i Auditimit i TI.

3. KLSH ka themeluar dhe po konsolidon këtë vit Departamentin e Auditimeve Inovative dhe të Sistemeve, në reflektim të plotë të mesazheve të Kongresit të XXIII-të të INTOSAT-t, zhvilluar në Moskë në shtator 2019 dhe të ndryshimit të qeverisjes publike që po bëhet gjithnjë e më tepër dixhitale në ofrimin e shërbimeve publike ndaj qytetarit.



**Revista Kërkimore-Shkencore, “Auditimi Publik”** është pjesë e kolanës së botimeve të KLSH-së që nga viti 2012 dhe gjatë vitit 2019 janë botuar tre numra të saj, Nr. 21, Nr.22 dhe nr.23. Botimi i 23 revistave është tregues i përkushtimit dhe vlerave të institucionit që vijon të botojë çdo 4 muaj një numër të kësaj Reviste. Rritja në numër e kësaj reviste, kërkimore-shkencore, është një indikator i rritjes së kapaciteteve audituese të vetë KLSH-së dhe reflekton punimet shkencore të stafit të KLSH-së, botës akademike si dhe praktikave më të mira nga SAI-et homologe dhe organizatat ndërkombëtare.



Në numrin 21 të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre Dr.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së, Prof.Dr.Lindita Milo, Drejtore e Përgjithshme në KLSH, Prof.Dr.Skënder Osmani, Kryeaudituesja Valbona Gaxha, etj. Gjithashtu janë prezentë me intervistat dhe shkrimet e tyre personalitete të auditimit të jashtëm publik si z.Klaus-Heiner Lehne, President i ECA, drejtues të ECA dhe të INTOSAT-t, auditues të KLSH, etj.



Në numrin 22 të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të njohura të auditimit të jashtëm publik, si James-Christian Blockwood, Drejtor i Zyrës së Planifikimit Strategjik dhe Drejtor i Revistës Zyrtare të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA, përfaqësues të Gjykatës Evropiane të Audituesve, Presidenti i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë, Prof.Dr.Hysen Cela, Prof.Dr.Sazan Guri, pedagogë, etj.

Në numrin 23 të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të njohura të auditimit të jashtëm publik, si Zv/Presidenti i KE, z. Jyrki Katainen; Presidenti i SAI-t të Sllovakisë, z.Karol Mitrik; Drejtori i Qendrës Ekonomike të

Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA z.Olivier M. Richard, etj.


Kanë dhënë kontributin e tyre në këtë numër të Revistës Dr.Natasha Ahmetaj, Zv/Guvernatore e Bankës së Shqipërisë, Prof.Dr.Sazan Guri, si dhe profesorë të Universitetit të Tiranës dhe Durrësit.

### **III.1.6 Botimet në KLSH gjatë vitit 2019**

Gjatë vitit 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka vijuar botimin e librave të kolanës së KLSH-së, duke i shtuar 102 botimeve të viteve 2012-2018, 11 botimet e 2019, me titujt e mëposhtëm :

- Performanca e aktivitetit të KLSH-së për vitin 2018 ( në shqip dhe në anglisht);
- Revista Kërkimore-Shkencore, “Auditimi Publik” (Nr.21, Nr.22 dhe Nr.23);
- Manuali i Auditimit të Prokurimit Publik;
- ... 3 Vjet Auditim i Jashtëm Publik, 2016-2018-Dokumente të Kryetarit;
- Rregullorja e procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve;
- Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm (vëllimi XXII);
- Konferenca Young ALSAI 2019;
- GAO dhe NIK-Leksionet e Dodaros.

*Grafiku nr. 12 Numri i botimeve të KLSH*



*Burimi: KLSH*




**Raport vjetor i performancës së KLSH-së për vitin 2018** në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze vjen në vazhdim të kësaj kategorie botimesh që KLSH gjeneron që nga viti 2012. KLSH për gjithë periudhën 2012-2018 ka botuar çdo vit raportet vjetore të performancës institucionale. Në këto botime janë përfshirë në mënyrë të plotë raportet që KLSH në përmbushje të detyrimit

kushtetues dhe ligjor paraqet çdo vit në Parlament.



**Revista Kërkimore-Shkencore, “Auditimi Publik” (Nr.21, Nr.22 dhe Nr.23).** Tre numra të Revistës Kërkimore-Shkencore të KLSH-së i shtohen çdo vit kolanës së botimeve të Institucionit, duke filluar që nga viti 2012. Edhe për vitin 2019 janë përfunduar tre numra 21, 22 dhe 23.

**Manuali i Auditimit të Prokurimit Publik.** Si produkti më i rëndësishëm me vlera i projektit të BB në KLSH ishte hartimi i “Manualit të Auditimit të Prokurimit Publik”, i përgatitur nga z. Simeon A Sahaydachny, ekspert i Bankës Botërore në fushën e prokurimeve publike. Botimi i këtij Manuali vjen në një kohë kur sistemi i prokurimit publik në Shqipëri, ashtu si sistemet e tjera të prokurimit në të gjithë botën, vazhdon të zhvillohet dhe modernizohet, duke përfshirë edhe kuadrin ligjor, institucional dhe procedural, si dhe profesionalizmin e zyrtarëve publikë të përfshirë në operimin e sistemit.



**...3 Vjet Auditim i Jashtëm Publik, 2016-2018-Dokumente të Kryetarit, autor Bujar Leskaj.** Ky botim vjen në vijim të botimit “4 vjet Auditimi i Jashtëm Publik” (2012-2015) dhe i referohet aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën tre vjeçare 2016-2018. Në të njëjtën linjë me këto dy botime, KLSH ka botuar edhe librin “Dokumente të Këshillit Kontrollues 1925-1939”.

Libri ka shtatë kapituj, në të cilët përfshihen Raportimet e Kryetarit të KLSH-së në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendin e Shqipërisë; Artikuj të botuar në shtypin e përditshëm; Shkrime në Revistën Kërkimore-Shkencore “Auditimi Publik”; Diskutime në Analizat Vjetore të KLSH-së; Prezantime dhe kumtesa në Konferenca Shkencore; KLSH – shkollë për audituesit e rinj, shtëpi e dijes dhe partner i shoqatave profesionale të fushës si dhe Partneritetet me Institucionet Supreme të Auditimit.



**Rregullorja e procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve.** KLSH i udhëhequr nga praktikat më të mira profesionale ndërkombëtare, i angazhuar për t’u zhvilluar dhe ecur përpara, zhvillon dhe përditëson bazën metodologjike, rregullatore dhe udhëzuese dhe për këtë arsye ka si pjesë të kolanës së saj të vitit 2019 botimin :

- Rregullorja e Procedurave të Auditimit; dhe
- Rregullorja e Sistemit të Menaxhimit të Proceseve(RevZone).

Ligji i ri organik zgjeroi dimensionet audituese duke përvijuar horizonte të reja. Në funksion të këtij zhvillimi u kristalizua e plotë metodologjia audituese në të gjithë nivelet e saj. Përfshirja në këtë botim e Rregullores së Sistemit të Menaxhimit të Proceseve i referohet faktit që përdorimi i teknologjinë së informacionit është i domosdoshëm për rritjen e efektivitetit, efikasitetit dhe transparencës së procesit të auditimit.




**Audituesit e KLSH-së në shtypin e përditshëm (vëllimi XII)**, i cili i përket shkrimeve të bouara në periudhën janar-gusht 2019.

Dymbëdhjetë volumet e prezencës së audituesve të KLSH-së në media shpalosin përpara lexuesit ndryshimin dhe evoluimin e KLSH-së në kulturën e punës audituese dhe në rritjen e cilësisë së gjetjeve dhe rekomandimeve të saj për periudhën 7 vjeçare (2013-2019).



**Young ALSAI 2019, “Sfidat e Auditimit Publik në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE”**. Konferenca shkencore “Young ALSAI 2019” vjen në edicionin e saj të dytë dhe synon të shndërrohet në një aktivitet traditë për institucionin, si dhe në një pikë referimi, platformë dhe tribunë shkëmbimi eksperiencash, për nxitjen e brezit të ri të audituesve për të vijuar në karrierën e tyre profesionale në KLSH, duke thelluar dijet në auditim dhe rritur bashkëpunimin mes tyre dhe audituesve më me përvojë, si dhe me rrjetin e audituesve të rinj në SAI-t partnere në Evropë dhe më gjerë.



**GAO, NIK dhe Leksionet e Dodaros (autor B. Leskaj)<sup>11</sup>**.

Ky libër është një triptik i një lloji të veçantë, triptik auditiv. Botimi nuk është një studim i mirëfilltë akademik, por një narrativë horizontale për të sjellë, me modesti e nderim pranë lexuesit të interesuar shqiptar e veçanërisht pranë audituesve, përvojën dhe kontributin e tre prej institucioneve më të shquara, të tre liderëve të përmasave ndërkombëtare: GAO amerikane, NIK-u polak dhe, krahas tyre, portreti profesional dhe mendimi i zotit Gene Dodaro, Kontrollori i Përgjithshëm aktual i GAO-s, personalitet me kontributet dhe vlerat e një institucioni të mirëfilltë.

Përzgjedhja e këtyre tri subjekteve të shquara nuk është diçka rastësore dhe, doemos, është shumë më tepër se shprehje e simpatisë dhe konsideratës më të lartë

<sup>11</sup> Ky libër është botuar me kontributin financiar të autorit dhe do të shpërndahet falas për audituesit e KLSH-së, të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, si dhe për partnerët e KLSH-së.

personale të autorit për rolin, prestigjin dhe kontributet e tyre në sferën e auditimit të jashtëm publik.

Të gjitha botimet e KLSH-së janë promovuar çdo vit **në panairin e librit** dhe në datat 13-17 nëntor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë edhe në edicionin e XXII<sup>të</sup> të Panairit të Librit, në Tiranë, duke shënuar kështu për të shtatin vit radhazi një pjesëmarrje dinjitoze, duke u paraqitur me 109 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013, kur mori pjesë për herë të parë në këtë panair.

Kolana e botimeve të KLSH-së me 113 titujt e saj deri në fund të vitit 2019 është tregues i rëndësisë që i ka dhënë institucioni librit dhe forcimit të kapaciteteve të stafit të tij. Tradita e mirë do të vijojë edhe gjatë vitit 2020, gjatë të cilit do të botohen 14 tituj.

### **III.1.7 Faqja zyrtare e KLSH dhe gazeta online “Auditi për qytetarin”**

Faqja zyrtare e internetit ka përgjegjësinë që t’u ofrojë informacione dhe shërbime të gjitha shtresave shoqërore, si dhe të minimizojë efektet e “ndarjes dixhitale”, me qëllim që të gjithë qytetarët të kenë akses të njëjtë në shërbime dhe informacionet online. Në mënyrë të veçantë, faqja zyrtare e KLSH-së ofron informacion të mjaftueshëm, përmban informacion të saktë të përditësuar, është e dizajnuar mirë, duke marrë në konsideratë standarde dhe siguron akses për një numër të madh të përdoruesve.

Gjatë vitit 2019 ne kemi vendosur në WEB, në kuadër të rritjes së transparencës vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për auditimet e realizuara përgjatë vitit 2019, në masën 90% (janë vendosur 124 vendime auditimi nga 140 auditime të realizuara) dhe janë vendosur gjithashtu edhe raportet respektive të auditimit.

Gjithashtu në faqen zyrtare të KLSH gjenden të gjitha raportet që janë hartuar dhe përgatitur nga KLSH gjatë vitit 2019 si Raporti i Aktivitetit, Raporti i Buxhetit, Raporti i Monitorimit dhe Buletinët Statistikorë. Për të qenë sa më afër publikut, KLSH publikon në faqen e saj zyrtare të gjithë librat e kolanës së saj të botimeve.

### **Gazeta elektronike “Auditi për qytetarin”**

Gjatë vitit 2019 KLSH ka bashkëpunuar me Qendrën për Emancipimin Ekonomik të Medias (UNECEM) z. Fatos Çoçoli dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi janë publikuar **11 numra të Revistës elektronike “Auditi për qytetarin”** në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze.

Gazeta elektronike “Auditi për Qytetarin” ka sjellë në mënyrë periodike, me një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, në stilin e gazetarisë publicistike dhe asaj investigative, gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve më të rëndësishme të KLSH-së gjatë vitit 2019, të tilla si auditimet për problematikën e koncesioneve dhe PPP-ve, sidomos atyre në fushën e naftës dhe shëndetësisë publike, auditimet për transparencën e treguesve kryesorë të Buxhetit të Shtetit, për efektivitetin e tenderave publikë, politikat e zbutjes së varfërisë, përcaktimit të minimumit jetik, etj.

Në faqet e gazetës ka dalë zëri dhe eksperiencia e audituesit publik, kurajo e tij për të evidentuar abuzimet me pronën publike. Gazeta elektronike ka pasqyruar po ashtu aktivitetet e KLSH-së brenda dhe jashtë vendit, me botën akademike,

shoqerinë civile si dhe partneret në komunitetin evropian dhe më gjerë të institucioneve supreme të auditimit publik, organizatat EUROSAI dhe INTOSAI.

Qëllimi i botimit të kësaj gazete ka qenë rritja e pranisë së KLSH-së me mesazhe dhe informacione në publik, duke zgjeruar në këtë mënyrë kanalet e komunikimit.

### **III.1.8 Buletini statistikor**

Në kuadër të misionit që ka KLSH në drejtim të rritjes së kanaleve të komunikimit për të ofruar transparencë në marrëdhëniet me publikun, përgatit dhe nxjerr në mënyrë periodike programin mujor të auditimit dhe buletin informativ 3-mujor të auditimit. Gjithashtu monitoron dhe koordinon procesin e punës me departamentet e tjera, për konsolidimin e të dhënave të auditimeve të ushtruara dhe nxjerrjen në kohë të publikimeve zyrtare të KLSH-së, si dhe të evidencave statistikore në shkallë institucionale.

Qëllimi kryesor i publikimit të Buletinit është që të sjellim para publikut dhe medias informacion të saktë dhe të përmbledhur rreth auditimeve të kryera për gjatë vitit, në mënyrë që lexuesit, institucionet relevante dhe politikë-bërësit të orientohen drejt gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH-së.

Për vitin 2019 janë përgatitur tre buletine statistikore: nr.1 për periudhën janar-qershor; nr.2 për periudhën janar-shtator dhe nr.3 për janar-dhjetor. Buletini statistikor, përmbledh rezultatet e të gjitha auditimeve të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në periudhën janar-dhjetor 2019. Në këtë buletin është pasqyruar gjendja e dëmit ekonomik të konstatuar, të ardhurat e munguara dhe shpenzimet e kryera jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit (3E), përmirësimet ligjore, masat administrative, masat disiplinore dhe administrative të rekomanduara, si edhe kallëzimet penale të përcjella në Prokurori. Krahas përmbledhjeve narrative që përdoren në raport material shoqërohet me tabela, grafikë/imazhe. Gjithashtu DKBMJ gjatë vitit 2019 ka përgatitur dhe Raportin e Zbatimit të Rekomandimeve për subjektet e audituara nga KLSH për gjatë vitit

### **III.2 Bashkëpunimi i KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë**

Me synimin e përmbushjes së qëllimit të tretë të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, atë të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit, KLSH përveç përmbushjes së detyrimit kushtetues të raportimit për zbatimin e buxhetit faktik dhe raportimit mbi performancën e institucionit ka synuar informimin e Kuvendit edhe përmes raporteve të veçanta të cilat paraqesin rëndësi të veçantë për publikun.

Kështu gjatë vitit 2019 KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë 131 vendime dhe raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2018 dhe 135 vendime e raporte auditimi për auditimet e kryera gjatë vitit 2019.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 134/2018 “Për Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve” KLSH edhe gjatë vitit 2019 i ka përcjellë Kuvendit informacion lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të datës 19.07.2018. Një informacion më i detajuar për këtë çështje i është përcjellë Kuvendit në datën 18 janar 2019.

Me qëllim informimin e Kuvendit lidhur me statusin e implementimit të rekomandimeve të KLSH lënë institucioneve të audituara dhe me synimin e mbështetjes së këtij të fundit për të rritur llogaridhënien dhe transparencën e përdorimit të parasë publike, krahas raportit të performancës, KLSH me shkresën nr. 230/2, datë 08.04.2019 i ka përcjellë Kuvendit një raport të veçantë të detajuar për implementimin e rekomandimeve për periudhën tetor 2017- qershor 2018. Gjithashtu në dhjetor 2019, KLSH i ka përcjellë Kuvendit raportin e zbatimit të rekomandimeve për periudhën janar-dhjetor 2018 (me shkresën nr.230/7 prot., datë 31.12.2019). Theksojmë se raportet e sipërcituara i janë përcjellë edhe Ministrit për Marrëdhëniet me Kuvendin.

Përfaqësues të KLSH dhe përfaqësues të Komisionit për Ekonominë dhe Financat kanë marrë pjesë dhe kanë referuar lidhur me mënyrën si bashkëpunojnë institucionet tona edhe në aktivitete të ndryshme rajonale.

Kështu më datën 7 maj 2019 u zhvillua në Prishtinë Konferenca rajonale për Mbikëqyrjen Parlamentare, fokusuar në veçanti në fushën e Financave Publike. Kjo Konferencë u organizua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përkatësisht Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike me mbështetjen e GIZ, si partner kryesor i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të Komisioneve parlamentare dhe të Institucioneve Supreme të Auditimit të rajonit nga: Kosova si vendi organizator, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Serbia, Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi. Në këtë aktivitet morën pjesë edhe Kryetari i Komisionit për Kontrollin e Buxhetit në BE, Presidenti i ECA, z.Klaus-Heiner Lehne, Audituesi i Përgjithshëm i Britanisë së Madhe, përfaqësues të Bankës Botërore, Kryetare në detyrë dhe Drejtore e Përgjithshme në KLSH zj. Lindita Lati etj.

Gjithashtu në datën 12- 14 Nëntor 2019 përfaqësues të KLSH-së morën pjesë në seminarin e organizuar nga Banka Botërore dhe Parlamenti i Malit të zi me temë “Fuqizimi i Marrëdhënieve ndërmjet Parlamentit dhe Institucionit Suprem të Auditimit, për të përmirësuar performancën e auditimit të jashtëm në vendet e Ballkanit Perëndimor”.

Iniciativa e organizimit të Seminarit Rajonal për Institucionet Supreme të Auditimit dhe Komisionet Parlamentare për Financat dhe Llogaridhënien Publike, ishte një vazhdimësi e nismës së mbajtur në Tiranë në maj 2019, të organizuar nga Banka Botërore dhe Programi OECD për Mbështetjen e Reformave të Administratës Publike (SIGMA), ku përfaqësuesit e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor identifikuan planet e veprimit në nivel vendi, për të forcuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin e ndërsjellë midis këtyre dy institucioneve.

Në vijim të iniciativës së Kuvendit për ngritjen e një platforme elektronike për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe jo kushtetuese, përfaqësues të KLSH-së kanë bashkëpunuar ngushtë dhe kanë qenë pjesë e ngritjes së kësaj platforme. Dëshirojmë të theksojmë se metodologjia e aplikuar për evidentimin e zbatimit të rekomandimeve nga KLSH përpara periudhës së kërkesave të formalizuara nga Njësia e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura nuk mundëson gjenerimin e informacionit sipas të gjitha parametrave

të kërkuar nga ana e Kuvendit. Gjithashtu KLSH ka një numër të madh rekomandimesh (krahasuar me institucionet e tjera të pavarura) adresuar subjekteve të audituara. Vetëm për periudhën Janar-Dhjetor 2018, KLSH ka adresuar në institucionet publike të audituara 4232 masa për përmirësime ligjore, masa organizative, masa administrative dhe masa disiplinore, fakt që vështirëson punën tonë për përpunimin e të dhënave.

Megjithatë, KLSH në vlerësim të kërkesave të Kuvendit të Shqipërisë po përpunon Database-in e saj me qëllim përafrimin e raporteve tona në përputhje me kërkesat e Kuvendit dhe do të fillojë së shpejti hedhjen e të dhënave, lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së. KLSH ka përfunduar hedhjen e të dhënave në Platformën online për rekomandimet e dhëna nga KLSH gjatë vitit 2018 për Institucionet Qendrore dhe ato të varësisë dhe më pas do të operohet me rekomandimet e dhëna nga KLSH për Institucionet e Vetëqeverisjes Vendore dhe Shoqëritë Anonime.

Kontrulli i Lartë i Shtetit vlerëson maksimalisht bashkëpunimin dhe mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë për përmbushjen e misionit kushtetues të KLSH-së për mirë-menaxhimin e parasë publike dhe forcimin e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së ekzekutivit. Në këtë kuadër dhe në vijim të shkresë nr.737 prot., datë 02.10.2019, nëpërmjet së cilës kemi risjellë në vëmendje krijimin e Nën-komisionit të posaçëm, pranë Komisionit parlamentar për Ekonominë dhe Financat, për shqyrtimin e raporteve të KLSH-së dhe bazuar në praktikat më të mira të INTOSAI-t për bashkëpunimin mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve, KLSH ka përgatitur Udhëzuesin për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin.

Në Udhëzuesin për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin është parashikuar edhe nënshkrimi i një Memorandumi të gjerë kuadër mes KLSH-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, i cili do të përfshijë jo vetëm fuqizimin e ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, por edhe një axhendë konkrete për zbatimin e rekomandimeve kryesore të KLSH-së në këto vite, për draftimin dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik, për kufirin e borxhit publik, si dhe angazhimin juridik të Qeverisë për nxjerrjen e Urdhrit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga ana e institucioneve në varësi të saj, etj.

Mbështetur në sa më sipër, kemi kërkuar dhe kërkojmë mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë për konkretizimin e këtij Memorandumi dhe propozimin për ngritjen e një grupi të përbashkët pune për hartimin e Draft-Memorandumit dhe për hartimin e një plani pune për finalizimin e tij

### **Mbi adresimin e kërkesës për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes së Kryetarit të ri KLSH-së në zbatim të kërkesave të kuadrit Kushtetues dhe Ligjor.**

Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj që në krye të herës ka qenë i angazhuar fuqimisht për sigurimin e vazhdimësisë së drejtimit të institucionit sipas kuadrit kushtetues, duke bërë të ditur publikisht që në prill të vitit 2018 mosrikandidimin për herë të dytë në krye të KLSH-së. Përpjekjet për këtë çështje madhore nuk kanë reshtur, duke njoftuar drejtuesit e lartë të shtetit në shtator 2018 për përfundimin e mandatit dhe si dhe marrjen e masave për zgjedhjen e Kryetarit të ri të KLSH-së.

Situata e krijuar nga spektri politik dhe shtetëror për pamundësinë e zgjedhjes së drejtuesit të ri të KLSH-së, e ka detyruar z. Bujar Leskaj që t'i drejtohet përsëri në tetor të vitit 2019 Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit Kryetari i KLSH-së mbi domosdoshmërinë e përzgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH-së në zbatim të detyrimeve kushtetuese për këtë qëllim.

Në vijim gjenden masat e marra nga Kryetari i KLSH-së dhe praktika dokumentare e shkresore për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes së kryetarit në zbatim të kërkesave të kuadrit kushtetues dhe ligjor.

1. Kryetari i KLSH-së me **Vendimin nr.27, datë 02.04.2018** “Për miratimin e “Kodi Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ka miratuar “Kodin Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë” në nenin 4 të të cilit përcaktohet që:


*“Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të cenojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaron publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin, synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe, katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t’u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke jua bërë me dije edhe Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit”. (Bashkëlidhur Vendimi nr.27, datë 02.04.2018).*

2. Vendimi i Kryetarit të KLSH-së **nr. 28 datë 23.04.2018** “Për një shtesë në “Kodin Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 4 shtohet paragrafi:

*“Pas përfundimit të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për një periudhë prej 4 muajsh nga data e përfundimit të mandatit, Kryetari që dorëzon detyrën nuk merret me aktivitet aktiv politik”. (Bashkëlidhur Vendimi nr. 28 datë 23.04.2018).*

*Te dy vendimet e mësipërme janë publikuar në faqen zyrtare të KLSH-së [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al) si dhe në Fletoren zyrtare nr. 193, datë 8 Janar 2019.*

*Faksimile nr.1 Fletorja zyrtare nr. 193, datë 8 Janar 2019*

<b>FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË</b>	
 www.qbz.gov.al	Viti: 2018 – Numri: 193
Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare	
<b>Tiranë – E martë, 8 janar 2019</b>	
PËRMBAJTJA	
	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 119/1 /2018, datë 3.12.2018	Për miratimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e nivele të tarifës doganore”, të ndryshuar.....
Dekret i Presidentit nr. 11017, datë 21.12.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 38, datë 26.12.2018	Për datat dhe organizimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2019....
Vendim i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 27, datë 20.4.2018	Për miratimin e “Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.....
Vendim i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 28, datë 23.4.2018	Për një shtesë në “Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të Kontrollit të Lartë të Shtetit”.....
Vendim i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 244, datë 22.12.2018	Për delegim kompetence.....
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Lëvizjet e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 76, datë 6.11.2018	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Himarë.....
	15179
	15179
	15179
	15180
	15181
	15182
	15182

3. Kryetari i KLSH-së me **shkresën nr. 100/7 datë 02/09/2018** “Njoftim për përfundim të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe për respektim të Kodit Etik të Kryetarit të KLSH-së” ka njoftuar Presidentin e Republikës, Kryetarin e Kuvendit dhe Kryetarin e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave në Kuvend, mbi **“Përfundimin e mandatit të Kryetarit aktual të KLSH-së, vullnetin e tij për të mos rikandiduar për një mandat të dytë, në respekt të Kodit të Etikës së Kryetarit të KLSH të miratuar me vendimin nr.27, datë 20 Prill 2018 dhe marrjen e masave për përzgjedhjen e Kryetarit të ri të KLSH-së i cili referuar kuadrin kushtetues dhe ligjor duhej të fillonte ushtrimin e mandatit si Kryetar ne 23.12.2018”**.(Bashkëlidhur shkresa nr. 100/7 date 02/09/2018).

4. Në faqen zyrtare të KLSH-së ([www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)) publikohet Prononcimi i Kryetarit të KLSH-së mbi përfundimin e Mandatit të tij në Dhjetor të vitit 2018.(Bashkëlidhur Dokumenti i prononcimit).

5. Kryetari i KLSH-së me Vendimin nr. 244 datë 22.12.2018 “Për delegim kompetence” bazuar ne prerogativat Kushtetuese, përcaktimet e Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, Kodin e procedurave Administrative dhe Standardet Ndërkombëtar ISSAI, Kodin Etik të Kryetarit KLSH-së dhe Drejtuesve të Lartë etj., ka vendosur delegimin e kompetencave të Titullarit të Institucionit tek Zëvendës Kryetari i KLSH-së. (bashkëlidhur Vendimi nr. 244 datë 22.12.2018).


*Vendimi nr. 244 datë 22.12.2018 dhe Vendimet nr. 27 datë 02.04.2018 dhe Vendimi nr. 28 datë 23.04.2018 janë botuar në Fletoren Zyrtare nr.193 datë 08.01.2018.*

6. Kryetari i KLSH-së me shkresën nr. 1154 datë 31.12.2018 “Falënderime për mbështetjen institucionale dhe mbi përfundimin e mandatit të Kryetarit të KLSH-së” adresuar Presidentit të Republikës bën me dije se me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 244 datë 22.12.2018 delegimi i kompetencave tek zëvendës Kryetari. (Bashkëlidhur shkresa nr. 1154 datë 31.12.2018).

7. Kryetari i KLSH-së me Vendimin nr. 1 datë 21.05.2019 “Mbi shfuqizimin e kompetencave të deleguara me Vendimin nr. 244 datë 22.12.2018 “Për delegim kompetence” ka shfuqizuar kompetencat e deleguara me Vendimin nr. 244 datë 22.12.2018, Zëvendës Kryetarit të KLSH-së. (Bashkëlidhur Vendimi nr. 1 datë 21.05.2019).

*Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 73 datë 21.05.2019 si dhe në faqen zyrtare të KLSH-së [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)*

*Faksimile nr. 2 Fletorja Zyrtare nr. 73, datë 21.05.2019*

 www.qbz.gov.al	<b>FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË</b>	Vis. 2019 - Numri: 73
Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare		
Tiranë – E martë, 21 maj 2019		
PËRMBAJTJA		
Faqe		
Vendim i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 1, datë 21.5.2019	Mbi shfuqizimin e kompetencave të deleguara me vendimin nr. 244, datë 22.12.2018, “Për delegim kompetence të kryetarit të KLSH-së”.	5454

8. Kryetari i KLSH-së me shkresën nr. 871 datë 29.10.2019 “Mbi domosdoshmërinë e përzgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH-së” i është drejtuar Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit që në bashkëpunim dhe bashkëveprim të dy institucioneve të Presidencës së Republikës dhe të Kuvendit të Shqipërisë të merren masa për përzgjedhjen e Kryetarit të ri të KLSH-së në zbatim të prerogativave kushtetuese. (Bashkëlidhur shkresa nr. 871 datë 29.10.2019).

9. Në datat 28-29 shkurt 2020 Kryetari i KLSH-së në analizën e veprimtarisë së vjetore 2019 është prononcuar mbi dosdoshmërinë dhe përshpejtimin e proceseve të zgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH-së.

(Bashkëlidhur prononcimi i Kryetarit të KLSH z. Bujar Leskaj)

### ***III.2.1 Monitorimi i Plan-veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit për vitin 2017***

Kontrolli i Lartë i Shtetit nëpërmjet nxitjes së përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës në funksion të institucioneve qendrore e lokale efektive realizon misionin e tij për informimin e qytetareve dhe Kuvendit për përdorimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike .

Në zbatim të nenit 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 31 të Ligjit 154/2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH i ka paraqitur Kuvendit raportin vjetor të aktivitetit të tij për vitin 2017 i cili në datën 19 korrik 2018 ka miratuar Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017”. Me synim implementimin e plotë, të suksesshëm, me efikasitet dhe në kohë të Rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, KLSH ka hartuar planin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, i cili adreson në mënyrë të detajuar strukturat zbatuese, afatet, fondet e nevojshme dhe treguesit e rezultateve të këtij plani. KLSH në këtë dokument ka adresuar si faktor nxitës të ndryshimit menaxhimin modern institucional nën moton “**KLSH shërbëstar i qytetarit**” e cila është forca lëvizëse dhe motivuese për menaxhimin e ndryshimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Sjellim në vëmendje se për Raportin Vjetor të Performancës së KLSH-së për vitin 2018 Kuvendi nuk ka nxjerre dhe miratuar Rezolute. KLSH përgjatë vitit 2019 ka vijuar me implementimin e rekomandimeve të adresuara për Raportin e performancës së vitit 2017 të cilat kanë shërbyer si një platforme programatike për vazhdimësinë e reformave të progresit institucional.

Në këtë rezolutë Kuvendi i ka adresuar KLSH-së rekomandimet që lidhen me:

- ***Thellimin e përpjekjeve për forcimin e pavarësisë së institucionit për sigurimin e auditimeve të paanshme dhe objektive.***

Me synim përmirësimin e kuadrit ligjor institucional me praktikën më të mira të institucioneve supreme të auditimit të Bashkimit Evropian dhe në përmbushje të rekomandimit të mësipërm të Kuvendit të Shqipërisë, KLSH i ka përcjellë Kuvendit shkresën nr. 926, datë 02.08.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, me qëllim rritjen e pavarësisë, paanshmërisë dhe objektivitetit të veprimtarisë audituese. Ky propozim i KLSH-së ende nuk është vendosur në axhendën e Kuvendit dhe KLSH është në

*pritje të shqyrtimit (miratimit) të Projektligjit nga Kuvendi, i cili ndër të tjera do të rrisë dhe garantojë pavarësinë operacionale.*

**- Kryerjen e veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit**

Në përmbushje të objektivit të dytë të Strategjisë së Zhvillimit institucional, 2018-2022 “*Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse institucionale KLSH*” dhe konkretisht nën objektivit 2.2 “*Zbatimi i standardeve profesionale nëpërmjet zhvillimit të metodologjive dhe standardeve të aplikueshme në përputhje me praktikën më të mira*” KLSH gjatë vitit 2019 ka miratuar “*Udhëzuesin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit*”, përdorimi i të cilit synon rritjen e cilësisë së punës audituese. Në këtë udhëzues janë reflektuar të gjithë rekomandimet e lëna nga ekspertët e projektit IPA i implementuar në KLSH duke bërë pjesë integrale të tij edhe check listat specifike që japin garanci për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë së veprimtarisë audituese.

Me urdhër të Kryetarit të KLSH nr. 44, datë 31.03.2020 janë ngritur grupet e punës dhe janë në procesin e përditësimit dhe përmirësimit manualët e auditimit financiar, të përputhshmërisë dhe auditimit të performancës, duke reflektuar në to ndryshimet e vazhdueshme që kanë pësuar standardet ndërkombëtare të auditimit, propozimet e bëra nga ekspertët e huaj të projektit të binjakëzimit të implementuar në KLSH në vitet 2016-2018 dhe propozimet e ekspertëve të SIGMA-s dhe sfidat me të cilat ndeshen audituesit. Gjithashtu KLSH po punon për hartimin e Manualit të Auditimit të Buxhetit, që do t'u vijë në ndihmë audituesve për të dhënë një opinion më profesional për implementimin e buxhetit të shtetit. Me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve KLSH. me urdhrin e Kryetarit të KLSH-së, nr. 45, datë 31.03.2020 po punohet për hartimin e një manuali i cili do të shërbejë si një mjet ndihmës për audituesit për një ndjekje sa më efektive të zbatimit të rekomandimeve me qëllimin final, atë të informimit të Kuvendit dhe opinionit publik për veprimtaritë korrigjuese të institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale.

**- Përmirësimin e metodologjisë së auditimit bazuar në analizën e riskut**

Hartimi i një metodologjie në mbështetje të procesit të planifikimit të auditimit bazuar në analizën e riskut përbën një faktor të rëndësishëm për planifikimin për performancën dhe mirë qeverisjen e institucioneve supreme të auditimit. Miratimi nga Kryetari i KLSH në vitin 2018 i dokumentit “*Metodologjie e hartimit të planit strategjik dhe vjetor*” ka shërbyer si udhërrëfyes në hartimin e planit vjetor të auditimit për vitin 2019 dhe 2020 për të marrë në konsideratë dhe përmbushur pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe palëve të tjera të interesuara. Në analizat e veprimtarisë së departamenteve për vitin 2019 KLSH ka përdorur analizën SWOT për të identifikuar qartazi pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet sa i takojnë aktivitetit auditues dhe menaxhimit institucional.

**- Rritjen e peshës së auditimit të performancës**

KLSH më zbatim të rekomandimit të Kuvendit dhe në përmbushje të objektivit të parë të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018- 2022, pika 1.4 “*Fokusi në rritje drejt auditimit të performancës*” ka synuar rritjen e cilësisë së këtyre auditiveve. Gjatë

vitit 2019 KLSH ka kryer 16 auditime performance. Auditimet e performancës tashmë reflektojnë praktikat më të mira dhe qasjet e teknikat me bashkëkohore të aplikuara nga komuniteti i INTOSAI-t. Kjo është arritur përmes trajnimit të vazhdueshëm të stafit të Departamentit të Auditimit të Performancës brenda dhe jashtë vendit. Një rol të qenësishëm ka luajtur pjesëmarrja prej vitit 2015 e audituese të KLSH, por në numër më të madh e audituesve të Departamentit të Auditimit të Performancës në programin pesëmuor të internship-it të Gjykatës Evropiane të Auditimit dhe programin katër muor të fellowship-it të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

- ***Thellimin e auditimit të teknologjisë së informacionit***

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i gjerë i saj nga qeveritë për të përmirësuar shërbimet që ju ofrohen qytetarëve i ka vendosur institucionet supreme të auditimit para sfidave për ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafeve të tyre në mënyrë që të auditojnë përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë të kësaj teknologjie gjithnjë e më komplekse dhe më sfida për çështjet e sigurisë së informacionit dhe ruajtjen e të dhënave të qytetarëve.

Në përmbushje të pikës 1.5 të Strategjisë së Zhvillimit 2018-2022 “*Thellimi në auditimin e teknologjisë së informacionit*” KLSH falë një kuadri të plotësuar metodologjik dhe shtimit cilësor e të mirë trajnuar të stafit të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së informacionit ka kryer 7 auditime IT, të cilat janë shtrirë në institucione qendrore ku mund të përmendet auditimi i kryer në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, auditime në shoqëri aksionere si Korporata Elektroenergjitike Shqiptare, si dhe auditime horizontale ku mund të përmendet auditimi mbi performancën e përdorimit të internetit në administratën qendrore ushtruar në 11 subjekte.

Gjithashtu me synim përmirësimin e manaxhimit elektronik të të gjithë procedurave të auditimit dhe menaxhimit e dokumentacionit administrativ mbështetës të veprimtarisë institucionale, gjatë vitit 2019 është vazhduar puna për implementimin e programit “*Menaxhimi dhe mbështetjen e proceseve në KLSH*” i cili nisi të implementohej në KLSH në 2018, program i cili është në përputhje me eksperiencat më të mira të menaxhimit të dokumenteve nga SAI-et evropiane e më gjerë.

- ***Konsolidimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë, i cili përfshin kontrollin dhe sigurimin e cilësisë***

Cilësia e raporteve të auditimeve të KLSH është përmirësuar në mënyrë të ndjeshme gjatë viteve të fundit, duke tërhequr gjithnjë e më shumë vëmendjen e opinionit publik, pasi gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve orientohen pikërisht drejt identifikimit dhe rekomandimit të masave korrigjuese të problematikave të institucioneve të qeverisjes qendrore dhe lokale. Sfida për rritjen e kapaciteteve audituese, profesionalizmit dhe të cilësisë së punës audituese ka gjetur pasqyrim në strategjitë e zhvillimit të KLSH 2018-2022, e cila e ka vlerësuar si prioritet

përmirësimin e cilësisë dhe përfitimi nga auditimet e KLSH<sup>12</sup>. Udhëzuesi për Menaxhimin e Cilësisë së Auditimit ka përmbushur plotësisht kuadrin rregullativ në këtë fushë. Për vetë peshën specifike dhe thelbësore që luan sigurimi i cilësisë në procesin auditues për garantimin e produkteve të paanshme, objektive, profesionale dhe të bazuara në fakte, KLSH prej vitit 2019 ka një Drejtor të posaçme të ngarkuar me kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve, në përbërje të së cilës janë auditues me përvojë të gjatë në auditim dhe të mirë trajnuar.

- ***Forcimin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve***

Në Udhëzuesin për Institucionalizimin e Marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin, miratuar nga Kryetari i KLSH-së në qershor 2018 është parashikuar edhe nënshkrimi i një Memorandumi të gjerë kuadër mes KLSH-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, i cili do të përfshijë jo vetëm fuqizimin e ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, por edhe një axhendë konkrete për zbatimin e rekomandimeve kryesore të KLSH-së ndër vite, draftimin dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik, Ligjit për Kufirin e Borxhit Publik, si dhe angazhimin juridik të Qeverisë për nxjerrjen e Urdhrit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së nga ana e institucioneve në varësi të saj.

Me shkresën nr.737/1, datë 15 nëntor 2019, drejtuar Kryetarit të Kuvendit, KLSH ka adresuar kërkesën për mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë për konkretizimin e këtij Memorandumi, i cili do t'i japë “peshë” rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, kjo dhe në kuadër të zbatimit të rekomandimit të Progres Raportit të Komisionit Evropian 2019 sipas të cilit “*Shqipëria duhet të mundësojë zbatimin sistematik dhe në kohë të rekomandimeve të auditit të jashtëm*”.

KLSH ka bashkëpunuar ngushtësisht me Njësinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese për ngritjen e një platforme dixhitale për raportimin e rekomandimeve dhe statusin e implementimit të tyre. Deri në fund të muajit mars 2020 ka përfunduar përcjellja e të dhënave për statusin e implementimit të rekomandimeve për auditimet e kryera në institucionet qendrore gjatë vitit 2018. Në këtë mënyrë, në këtë platformë të gjitha palët e interesit mund të marrin informacion mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe subjektet e audituara në funksion të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës, si dhe fuqizimit të mbikëqyrjes parlamentare.

Me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve gjithashtu KLSH po punon për hartimin e një manuali, i cili do të shërbejë si një mjet ndihmës për audituesit për një ndjekje sa më efektive të zbatimit të rekomandimeve me qëllimin final, atë të informimit të Kuvendit dhe opinionit publik për veprimtaritë korrigjuese të ndërmarra nga qeveria dhe institucionet e pushtetit lokal.

- ***Rritjen e konsiderueshme të transparencës në publikimin e rezultateve të auditimit.***

Informimi i Kuvendit lidhur me auditime të kryera gjatë vitit 2019 dhe fuqizimi i ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është realizuar

---

<sup>12</sup> Qëllimi 1.7 i Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022

nëpërmjet përcjelljes së raporteve specifike, të cilat përbëjnë interes për publikun. Gjatë vitit 2019 janë përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë 131 vendime dhe raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2018 dhe 135 vendime e raporte auditimi për auditimet e kryera gjatë vitit 2019.

Në kuadër të rritjes së transparencës KLSH ka publikuar në WEB, vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për 124 vendime auditimi nga 140 auditime të kryera gjatë vitit 2019. Në faqen zyrtare të KLSH gjenden të gjitha raportet që janë hartuar dhe përgatitur nga KLSH gjatë vitit 2019 të tillë si Raporti i Aktivitetit, Raporti i Buxhetit, Raporti i Monitorimit dhe Buletinet Statistikorë.

Gjatë vitit 2019, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe aktivitetin e KLSH në një numër prej 336 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike.

Rekomandimi i rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e KLSH që synon rritjen e konsiderueshme e transparencës në publikimin e rezultateve të auditimit me fokusin në drejtim të përcjelljes profesionale dhe të kuptueshme të mesazhit të auditimit tek palët e interesuara dhe qytetarët është realizuar nëpërmjet:

- Prezencës së audituesve në median e shkruar gjatë vitit 2019 me 122 shkrime;
- Prezencës së stafit drejtues dhe auditues të KLSH-së në median vizive për trajtimin e problematikave dhe gjetjeve në auditimet;
- Bashkëpunimit me universitete publike dhe private, si dhe organizata të ndryshme jo qeveritare;
- Organizimit të muajit të hapur në datat 1 nëntor-6 dhjetor 2019;
- Realizimit të 11 botimeve, ku përfshihet revista kërkimore shkencore e KLSH të cilat janë të aksesueshme në faqen web.

***- Ndjekjen me përparësi të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe dëmshpërblimin e dëmit.***

Në zbatim të ligjit organik të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kodit të Procedurave Administrative, KLSH edhe gjatë vitit 2019 në çdo mision auditimi ka kryer verifikimin e ndjekjes se të gjitha rekomandimeve dhe në veçanti të evidentimit të shkallës së arkëtimit të dëmit të lënë për zhdëmtim nga subjektet shkaktuese të dëmit ekonomik. Krijimi i detyrimeve të prapambetura nga subjektet shtetërore ka qenë drejtim auditimi në çdo angazhim auditimi të ndërmarrë. Po kështu, edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve mbi dëmshpërblimin e dëmit, ndër të tjera ka qenë subjekt i misioneve të posaçme që KLSH kryen në fund të vitit në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Në fillimin e vitit 2020, KLSH ka kryer monitorimin e implementimit të planit të hartuar për zbatimin e rezolutës së rekomandimeve të Kuvendit nga ku rezulton se nga 56 masa në zbatim të 13 rekomandimeve të Kuvendit 40 masa ose 71 % e tyre janë realizuar tërësisht dhe janë objekt i punës në vijimësi dhe 16 masa të tjera ose 29 % e tyre janë realizuar pjesërisht apo janë në proces për t'u realizuar për periudhën në vijim.

### **III.3 Marrëdhëniet e KLSH me OJF, Organizatat e profesionistëve të fushës, institucionet homologe dhe organizata ndërkombëtare.**

Të udhëhequr nga motoja e INTOSAI-t “Experientia mutua omnibus prodest” dhe në zbatim të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022, Kontrolli i Lartë i Shtetit edhe gjatë vitit 2019 ka thelluar bashkëpunimin me të gjithë partnerët e saj brenda dhe jashtë vendit.

#### ***III.3.1 Bashkëpunimi me SAI-et partnere dhe Institucionet Ndërkombëtare***

Për një institucion si Kontrolli i Lartë i Shtetit, misioni i të cilit është rritja e rolit dhe kontributit për menaxhimin sa më të mirë të parasë publike, duke kryer auditime cilësore si dhe duke raportuar mbi rregullshmërinë dhe efektivitetin e përdorimit të të gjitha fondeve publike në dobi të qytetarëve, procesi i bashkëpunimit me institucionet homologe dhe përfitimi i eksperiencës prej tyre nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme dhe trajnime cilësore është një nga objektivat kryesore. Përmbushja e këtij objektivi ka për qëllim rritjen e cilësisë së auditimit si dhe zhvillimin profesional dhe individual të audituesve në KLSH.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të KLSH në aktivitetet jashtë vendit ka mbuluar gjithë spektrin e veprimtarisë së SAI-ve që lidhet jo vetëm me metodologjinë e auditimeve specifike, përfitimin e eksperiencave në kryerjen e auditimeve të performancës, auditimeve financiare dhe auditimeve IT, por edhe publikimin e rezultateve të auditimit dhe kanalet e komunikimit me palët e interesuara si dhe risitë në auditimin e çështjeve të luftës kundër korrupsionit e mashtrimit dhe auditimin e etikës.

KLSH gjatë vitit 2019 ka marrë pjesë në 44 aktivitete të zhvilluara jashtë vendit, në të cilat është përfaqësuar me 82 auditues, si në Kongrese, Konferenca shkencore dhe rajonale, seminare, trajnime dhe workshope:

Workshop- i me temë “*Kontributi social dhe transparenca e auditimeve në sektorin publik*” zhvilluar më Budapest në datat 7 dhe 8 shkurt 2019 në të cilin morën pjesë 2 auditues (Q.Cibaku, B. Kotorri).

Vizita studimore në kuadër të projektit “*Asistencë Teknike për krijimin e kapaciteteve për Strategjinë MFP*” zhvilluar në Dublin në datat 28 Shkurt – 2 Mars 2019 në të cilën morën pjesë 2 drejtues të KLSH-s (L.Nano, A.Gjinopulli).

Programi i Internshipit të organizuar nga Gjykata Evropiane e Audituesve në Luksemburg në datat 1 mars-31 korrik 2019 në të cilën morën pjesë 3 auditues (D.Balliu, M.Kurushi, E.Këllici)

Workshop-i me temë “*Rregullat Fiskale dhe Institucionet e Pavarura Fiskale-Mundësitë për të siguruar qëndrueshmëri fiskale*”, zhvilluar në Vjenë në datën 6 Mars 2019 në të cilin morën pjesë 2 auditues (A.Stringa, V.Gaxha).

Konferenca e tretë e përbashkët e EUROSAI-t dhe ASOSAI-t, zhvilluar në Jeruzalem në datat 10-14 Mars 2019 në të cilën morën pjesë 2 drejtues të KLSH (M.Naço, I.Islami).

Tryeza e rrumbullakët *“Praktikat e raportimit për të rritur impaktin e auditimeve në publik”* zhvilluar në Paris në datën 20-21 mars 2019, në të cilën morrën pjesë 3 përfaqësues të KLSH (Gj.Preçi, A.Hasanbelliu, A.Patozi).

Programi i Fellowshipit të organizuar nga Zyra e auditimit të Qeverisë e SHBA në datat 20 mars-12 korrik 2019, në të cilin mori pjesë një auditues (E.Vojka)

Aktiviteti për 20 vjetorin e Zyrës Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut zhvilluar në Shkup në datën 29 Mars 2019, në të cilin morën pjesë 2 drejtues të KLSH (Kryetare në detyrë L.Lati, I.Islami).

Takimi i XIII i Grupit të Punës të EUROSAT-t për Sistemet e Informacionit (ITWG) zhvilluar në Floriana, Maltë në datën 5 Prill 2019, në të cilin morën pjesë 2 auditues (K.Kondakçiu, A.Kita).

Takimi i Liaison Officer të SAI-ve të Bashkimit Evropian dhe vendeve kandidate të BE zhvilluar në Bukuresht në datat 8 – 10 prill 2019 në të cilin morën pjesë 3 auditues (E.Çaushaj, D.Prosi, R.Xhelili).

Konferenca me temë *“Qasjet më të fundit në matjen e vlerës së shtuar të auditimit dhe sfidat”*, zhvilluar në Stamboll datat 18-19 Prill 2019, në të cilën morën pjesë 2 auditues (V.Gaxha, M. Berdo).

Konferenca me titull *“Inovacionet e auditimit në vendet e BE-së dhe rritja e rolit këshillues të SAI-ve në dobi të shoqërisë”*, zhvilluar në Bukuresht në datat 6-7 maj 2019 në të cilën morën pjesë 2 drejtues të KLSH (L.Nano, M.Naço).

Sesioni pranveror i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Mjedisit, zhvilluar në Kalopanajotis, Qipro në datat 7-8 Maj 2019, në të cilin morën pjesë 3 auditues (K. Muça, R. Karapici, J.Goçaj).

Konferenca rajonale për Mbikëqyrjen Parlamentare zhvilluar në Prishtinë në datën 7 maj 2019, në të cilën morën pjesë 2 drejtues të KLSH (Kryetare në detyrë L. Lati, R.Muça).

Takim dypalësh me ftesë të Auditorit të Përgjithshëm të Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, zhvilluar në Zagreb datë 24 maj 2019 në të cilën morën pjesë 2 drejtues dhe auditues të KLSH (L.Lati, A.Patozi).

Workshop-i me të njëjtën temë *“Mbi Auditimin Financiar”*, zhvilluar në Stokholm në datat 11-14 qershor 2019, në të cilin morën pjesë 4 auditues (V.Gaxha, A.Polovina, E.Maçaj, J.Troqe)

Takimi i Komitetit të Kontaktit të SAI-ve të vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve kandidate të BE, zhvilluar në Varshavë në datat 27-28 qershor 2019 në të cilin mori pjesë Kryetari i KLSH-së, z.Leskaj dhe 2 përfaqësues të tjerë (Zv.Kryetare dhe Drejtore e Përgjithshme L.Lati, A.Shehu).

Trajnimi mbi implementimin e instrumentit të vetëvlerësimit të integritetit

IntoSAINT, zhvilluar në Beograd në datat 15- 19 Korrik 2019, në të cilin morën pjesë 2 përfaqësues të KLSH-së (A.Gjinopulli, S.Ramadani).

Takimi me temë *“Institucionet Supreme të auditimit bëjnë ndryshimin: Duke audituar implementimin e objektivave për një zhvillim të qëndrueshëm”*, zhvilluar në New York në datat 22-23 Korrik 2019, në të cilin morën pjesë 2 drejtues të KLSH-së (M.Naço, R.Muçaj).

Takimi i nëngrupit e-Qeverisje të grupit të punës së EUROSAT-t për auditimet IT zhvilluar në Lisbonë në 18 dhe 19 shtator 2019 në të cilin morën pjesë 3 përfaqësues të KLSH-së (K. Kondakçiu, E.Papadhima, D. Prosi).

Kongresi i XXIII-të i INTOSAT-t, zhvilluar në Moskë në datat 23-27 shtator 2019 në të cilin me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së z. Bujar Leskaj, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua me tre drejtuesit e lartë: Sekretari i Përgjithshëm L.Nano, Drejtore e Përgjithshme M.Naço, dhe Drejtore I.Islami).

Takimi i 3-të i një prej drejtimeve kryesore të Planit Strategjik të EUROSAT-t 2017-2023 zhvilluar në Liberec, Republika Çeke në datat 9-10 Tetor 2019, në të cilin morën pjesë 3 auditues (M.Kavaja, A.Begaj, R.Xhaja).

Konferenca e 11-të vjetore e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, zhvilluar në Shkup në datat 14-15 tetor 2019, në të cilën mori pjesë Kryetari i KLSH-së, z. Leskaj dhe 4 drejtues e auditues (B.Arizaj, B.Zenali, A.Kume, A.Tafilaj).

Takimi i 3-të i Task Forcës së EUROSAT-t(TFMA) mbi Auditimin e Bashkive zhvilluar në Lisbonë në datat 10-11 tetor 2019, në të cilin morën pjesë 4 auditues (A.Zaçe, A.Jonuzi, M.Llanaj, R.Ametllari).

Takimi i Nënkomitetit të 11-të për Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikave, BE – Shqipëri zhvilluar në Bruksel, në datat 3 Tetor 2019, në të cilin morën pjesë 3 drejtues të KLSH-së (L.Nano, A.Gjinopulli, Gj.Preçi).

Workshopi i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimet IT, ITWG, mbi Hapësirën e Kontrollit të e-Qeverisjes dhe Manualin Aktiv të Auditimit IT zhvilluar në Bratislavë në datat 14-16 Tetor 2019, në të cilin morën pjesë 3 auditues (B.Haka, E.Papadhima, R.Xhelilaj).

Konferenca për Biodiversitetin dhe takimi e 17-të i Grupit të Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit zhvilluar në Luksemburg në datat 22 - 24 tetor 2019, në të cilin morën pjesë 3 auditues (A.Cako, E.Kasmi, E. Seraj).

Workshopi me temë *“Administrimi i mjedisit në vendet anëtare të BE-së kundrejt sistemit tregues të vlerësimit”* të zhvilluar në Bruksel në datën 22 Tetor 2019, në të cilin morën pjesë 2 auditues (L.Kuka, O.Levani)

Vizita studimore në me ftesën e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kroacisë, zhvilluar në Dubrovnik në datën 30 tetor 2019, në të cilin morën pjesë 8 auditues (A.Kallesha, E. Kocani, R.Guzi, H.Solis, E. Hoxha, A. Polovina, R. Xhelilaj, Xh. Xhindole).

Seminari i Grupi i Punës i EUROSAT-t për Auditimin e Fondeve të Alokua për Fatkeqësitë dhe Katastrofat me temë *“Të kontribuosh në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në sferën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive dhe katastrofave”* zhvilluar në Beograd në datën 30 tetor 2019, në të cilin morën pjesë 3 auditues (E.Vojka, A.Bushi D.Balliu).

Konferenca Young EUROSAT zhvillua në Londër në datat 5-8 Nëntor, në të cilën morën pjesë 3 auditues (A.Stringa, E.Meçaj, E.Hoxha).

Workshop për auditimin dixhital nga institucionet supreme të auditimit zhvilluar në Shkup në datat 6 - 7 Nëntor 2019, në të cilën morën pjesë 4 auditues (A. Leskaj, A. Kosta, K.Saliu, A.Nesturi).

Takimi i parë për rakordimin e auditimit paralel me temë *“Ndotja e menjëhershme e deteve”* zhvilluar në Rijeka, Kroaci në datat 12-13 nëntor, në të cilin morën pjesë 4 drejtues dhe auditues (R.Muçaj, A.Zylfi, E.Agolli, M.Kurushi).

Seminari Rajonal *“Fuqizimi i Marrëdhënieve ndërmjet Parlamentit dhe Institucionit Suprem të Auditimit, për të përmirësuar performancën e auditimit të jashtëm në vendet e Ballkanit Perëndimor”* zhvilluar Podgoricë në datat 12- 14 Nëntor 2019 , në të cilin morën pjesë 4 përfaqësues të KLSH- së (A.Gjinopulli, E.Sako, M.Haxhija, J.Zhegu).

Workshopi mbi rregullimin e përgjithshëm të mbrojtjes së të dhënave dhe impaktin në proceset audituese zhvilluar në Larnaca, Qipro në datën 15 Nëntor 2019, në të cilin morën pjesë 2 përfaqësues të KLSH- së (L.Lati, A.Patozi).

Seminari i parë mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, pjesë e Agjendës së Kombeve të Bashkuara për vitin 2030 dhe 170-vjetori i Gjykatës së Llogarive të Portugalisë zhvilluar në Lisbonë në datat 21-22 nëntor 2019, në të cilën mori pjesë Kryetari i KLSH-së, z. Leskaj dhe 1 drejtues (R.Muçaj).

Konferenca vjetore e Shërbimit të Auditimit të Brendshëm zhvilluar në Bruksel, në datën 27 nëntor 2019 në të cilën mori pjesë 1 përfaqësues i KLSH-së (A.Hasanbelliu).

Seminari me temë *“Ndërtimi i Mirëbesimit – Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në sigurimin e besueshmërisë së të dhënave fiskale”* zhvilluar në Helsinki në datat 28-29 nëntor 2019, në të cilin morën pjesë 2 auditues (E.Metaj, H.Solis).

Vizita studimore me ftesë të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës zhvilluar në Prishtinë në datën 2 dhjetor 2019, në të cilën morën pjesë 10 auditues (E.Stafasani, E.Kabashi, S.Hajdari, V.Rizvani, M.Hajro, R.Lushaj, E.Kojku, F. Çika, I.Bidaj, R.Alimerkaj).

Trajnimi i 7-të ndërkombëtar mbi Auditimin Mjedisor zhvilluar në Jaipur, Indi në datat 25 nëntor - 7 dhjetor 2019, në të cilin mori pjesë 1 auditues (A.Guri).

Takimi mbi auditimin e përbashkët me temë “Mbetjet plastike” zhvilluar në Krakovë, në datat 10-11 Dhjetor 2019, në të cilin morën pjesë tre auditues (K.Kondakçiu, M.Lloji, K.Muçaj).

Takimi i X-të i Task Forces së EUROSAT- t për Auditimin e Etikës zhvilluar në Bon në datat 10-11 dhjetor 2019, në të cilin morën pjesë 3 drejtues dhe auditues të KLSH-së (L.Nano, I.Islami, A.Begaj).

Forumi me temë “30 Vjet Qeverisje dhe Reforma Antikorrupsion në Evropën Qendrore dhe Lindore”, zhvilluar në Shkup në datën 13 dhjetor 2019 në të cilin morën pjesë 3 drejtues dhe auditues (A.Hasanbelliu, B.Pajaj, M.Kurushi).

Konferenca “*Forcimi i marrëdhënieve bashkëpunuese mes SAI-ve dhe ACA-ve*”, zhvilluar në Abu Dabi në datat 14-15 dhjetor 2019, në të cilin morën pjesë dy auditues (M.Kavaja, D.Prosi).

### **III.3.1.1 Pjesëmarrja e KLSH në Task-Forcat e INTOSAI-t**

KLSH ka marrë pjesë gjatë vitit 2019 në 6 aktivitete që janë zhvilluar në kuadër të Grupeve të Punës në të cilat institucioni bën pjesë. Këto aktivitete e Grupe Pune (Working Groups) janë:

#### **- Grupi i Punës i EUROSAT-t për auditimet IT (takimi i XIII-të);**

Ky takim u fokusua në shkëmbimin e përvojave në sigurinë kibernetike, metodat e reja të analizës së të dhënave, projektin mbi versionin web të manualit aktiv për Auditimin e TI, portalin ndërkombëtar për shkëmbimin e njohurive rreth raporteve, konceptin e një platforme për bashkëpunim në kuadër të auditimeve paralele ndërmjet SAI-ve të veçanta si dhe pikat kryesore të ISSAI 5800 mbi zhvillimin e auditimeve të përbashkëta.

#### **- Grupi i Punës së EUROSAT-t për Auditimin e Fondeve të Alokua për Fatkeqësitë dhe Katastrofat;**

Në datën 30 tetor 2019, Grupi i Punës i EUROSAT-t për Auditimin e Fondeve të Alokua për Fatkeqësitë dhe Katastrofat dhe SAI i Serbisë organizuan në Beograd seminarin me temë: “*Të kontribuosh në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në sferën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive dhe katastrofave*”.

Seminari kishte në fokus të diskutimeve çështjet aktuale që lidhen me parandalimin dhe eliminimin e pasojave të fatkeqësive dhe katastrofave.

#### **- Grupi i Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit;**

Ky grup pune ka zhvilluar dy takime në Qipro dhe në Luksemburg. Temat e trajtuara kishin të bënin me impaktin e mbetjeve dhe ishin të fokusuar tek tipet e ndryshme të mbetjeve të gjeneruara dhe auditimi i tyre në bazë të qasjes së secilit SAI. Takimi i Luksemburgut mundësoi diskutimin rreth trendeve të fundit të politikave evropiane mbi biodiversitetin, si dhe mbi mundësitë dhe sfidat e auditimit për biodiversitetin.

### **- Task Forca e EUROSAT-t mbi Auditimin dhe Etikën;**

Takimi i X-të i grupit Task Force të EUROSAT-it për “Auditimin dhe Etikën” (TFA&E) u zhvillua në Bon dhe trajtoi çështje të rëndësishme që lidhen me Etikën dhe integritetin, si edhe diskutoi për të ardhmen e kësaj Task- Force dhe planin e saj të aktiviteteve. Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e 22 SAI-ve dhe u diskutuan çështjet e mëposhtme:

- Rekomandimet e OECD për auditimin e Integritetit në Sektorin Publik;
- Promovimi i Etikës në Organizatat e Sektorit Publik;
- Iniciativat që lidhen me etikën në SAI/ sistemet e kontrollit të Etikës;
- Politikat mbi bilbil-fryrësit;
- Vetëvlerësimi lidhur me implementimin e ISSAI 30 etj.

### **- Task Forca e EUROSAT-t për Auditimin e Bashkive.**

Në datat 10-11 tetor, në Lisbonë të Portugalisë u zhvillua takimi i 3-të i Task Forcës së EUROSAT-t(TFMA) mbi Auditimin e Bashkive. Task Forca e EUROSAT-t mbi Auditimin e Bashkive mbledh në gjirin e saj rreth 28 SAI evropiane dhe konsiderohet si një nga takimet më të rëndësishëm në morinë e aktiviteteve të zhvilluara nën ombrellën e EUROSAT-t. TFMA po bëhet gjithnjë e më shumë një forum protagonist dhe me jehonë në komunitetin e EUROSAT-t, ku përpos shkëmbimit të eksperiencave audituese, po luan një rol edhe në shkëmbimin kulturor mes pjesëmarrësve.

#### ***III.3.1.1 Takimi i V-të të Grupit të Punës së EUROSAT-t për “Auditimin e fondeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat” në Tiranë***

KLSH gjatë tetë viteve të fundit ka qenë pjesë aktive e grupeve të ndryshme të punës të EUROSAT-t dhe ka mirëpritur dhe ka organizuar disa veprimtari të tilla në Tiranë. Në këtë frymë bashkëpunimi, KLSH në datat 24-25 Prill 2019 ishte mikpritëse e takimit të V-të të Grupit të Punës së EUROSAT-t për “Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat”. Tema kryesore e aktivitetit ishte “Roli dhe kapacitetet e SAI-eve në rritjen e aftësisë së sigurisë së popullatës në rastet e fatkeqësive”. Ky takim i grupit të punës u drejtua nga zj. Valeriy Patskan dhe zj. Lindita Lati, Kyetare në detyrë.

Zyra e Llogarive të Ukrainës drejton sekretariatit e këtij grupi pune dhe Presidenti i kësaj zyre, z. Valeriy Patskan, në fjalën e tij theksoi se çështjet e e auditimit që mbulohen nga ky grup pune janë të një rëndësie të veçantë për shoqëritë e vendeve tona, pasi ato ndikojnë jo vetëm në jetën e qytetarëve por edhe në ekonomitë e vendeve. Popullatat dhe ekonomitë e vendeve tona gjithashtu gjithnjë e më tepër po përballen me fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu, të cilat janë gjithashtu në fokusin e këtij grupi pune. Ndaj synimi i përbashkët i SAI-ve duhet të jetë bashkëpunimi efektiv dhe i frytshëm në kryerjen e auditimeve që minimizojnë dhe parandalojnë pasojat për shoqëritë e vendeve tona.

Gjatë dy ditëve të takimit pjesëmarrësit u njohën dhe diskutuan rreth temave që lidhen me:

- Konventën e Bazelit- Problemet e zbatimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe mënyrat për t'i zgjidhur ato;

- Vlerësimin e eficiencës së zbatimit të sistemit të menaxhimit të mbetjeve shtëpiake dhe eficienca e përdorimit të fondeve të buxhetit të shtetit në këtë fushë;
- Luftën kundër marketingut të pesticideve të ndaluara;
- Karakteristikat e transportit ndërkufitar të mbeturinave të pajisjeve elektrike, elektronike dhe të baterive të përdorura;
- Rekomandimet nga praktikat e mira për auditimet e kryera për parandalimin dhe eliminimin e pasojave të përmbytjeve, etj.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Shqipërisë, Bjellorusisë, Bullgarisë, Gjeorgjisë, Kazakistanit, Moldavisë, Polonisë, Rumanisë, Serbisë, Sllovakisë, Turqisë dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve.

### ***III.3.1.2 Projekti me USAID-“Transparenca në sistemin shëndetësor”***

Që prej marsit 2017, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar USAID nëpërmjet projektit “Transparenca në sistemin shëndetësor” ka siguruar asistencë teknike për tre institucione të pavarura qeveritare qendrore dhe disa organizata të shoqërisë civile dhe medias për të identifikuar korrupsionin në sistemin shëndetësor. Duke punuar me Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), institucionin e Avokatit të Popullit dhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), projekti gjeneroi të dhëna nëpërmjet auditimeve të performancës, raportimit të aseteve dhe hetimit të ankesave me qëllim nxitjen e mekanizmave të transparencës dhe angazhimin e qytetarëve në mënyrë më efektive në luftën ndaj korrupsionit në shëndetësi.

Në datën 9 korrik 2019, në Tiranë u zhvillua Konferenca përmblylëse e këtij projekti. KLSH u përfaqësua në këtë konferencë nga Kryetari i KLSH-së z.Bujar Leskaj, Drejtori i Përgjithshëm zj.Lindita Milo dhe Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë, zj.Irena Islami. Gjatë konferencës e morën fjalën zj.Mikaela Meredith, Drejtore e USAID-t; zj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit; z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së, zj.Ornela Palushaj, Drejtore e Projektit; përfaqësues të ILDKPKI dhe të OJF-ve. Zoti Leskaj në referatin e tij vlerësoi një aspekt të rëndësishëm të projektit, atë të rritjes së transparencës, duke theksuar që rritja e aksesit të qytetarëve tek informacioni, futja e disa zgjidhjeve teknologjike për sistemin e ankesave nga qytetarët, si dhe përdorimi me efektivitet i të dhënave të hapura dhe treguesve të alarmit të kuq për fusha me risk të lartë për korrupsion kanë qenë instrumentet konkrete të zhvilluara nëpërmjet këtij projekti, të cilat kanë ndihmuar në rritjen e transparencës në të tre dimensionet e saj, duke qenë më të hapur e më komunikues me të gjithë palët e interesit dhe më të përgjegjshëm edhe ndaj qytetarit.

Ky projekt, i financuar nga USAID dhe i implementuar në periudhën mars 2017-korrik 2019, u propozua dhe u realizua në momentin kur KLSH po punonte për Strategjinë e Komunikimit të institucionit 2017-2019 dhe ishte në të njëjtën linjë me objektivat e kësaj strategjie, si dhe me proceset e modernizimit të KLSH-së. Për më tepër, sektori i shëndetësisë, i vendosur në fokus të projektit është një sektor me rëndësi dhe me efekte të drejtpërdrejta në cilësinë e jetës së qytetarit shqiptar. Projekti përfundoi, por është fakt që asistencë teknike e tij ka ndikuar jo vetëm në përmirësimin e auditimeve të performancës në sektorin e shëndetësisë, por

kryesisht në zgjerimin e rezonancës dhe të impaktit të punës audituese tek palët e interesit dhe kryesisht tek shoqëria civile.

Projekti që u implementua në periudhën mars 2017 - korrik 2019, ia arriti të krijonte një mjedis më të përgjegjshëm në shëndetësi, duke rritur rolin mbikëqyrës të institucioneve të pavarura dhe duke angazhuar përfituesit, shoqërinë civile dhe qytetarët.

### **III.3.1.3 Projekti “Forcimi i kapaciteteve në auditimin e prokurimeve publike, koncesioneve dhe PPP-ve”**

Projekti “Forcimi i kapaciteteve në auditimin e prokurimeve publike, koncesioneve dhe PPP-ve” është përgatitur nga KLSH qysh në vitin 2016, si pjesë e aplikimit për mbështetje nga INTOSAI - IDI *Donor Cooperation*.

Projekti u shpall fitues nga IDI, të cilët e referuan propozimin tek Banka Botërore nën Programin SAFE, por për shkak të numrit të lartë të aplikimeve KLSH-së iu sugjerua kontaktimi me zyrën e SECO (*Swiss State Secretariat for Economic Affairs*).

Pas takimeve dy palëshe të realizuara kryesisht gjatë fundvitit 2019, u dakordësua për financimin e projektit në shumën totale prej 264'000 USD, prej të cilave 239'100 USD janë financim i SECO dhe 24'900 USD (10% e vlerës) financim nga buxheti i shtetit për KLSH-në. Projekti do të ketë një kohëzgjatje 2 vjeçare dhe marrëveshja për fillimin e tij u nënshkrua në ambientet e KLSH-së, në datën 9 mars 2020 nga Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj dhe nga Ambasadori i Konfederatës Zvicerane në Republikën e Shqipërisë, SHTZ. Adrian Maitre.

Qëllimi kryesor i projektit është rritja e kontributit të KLSH-së për të forcuar llogaridhënien qeveritare në përdorimin e fondeve publike përmes auditimeve më profesionale dhe gjithëpërfshirëse të prokurimeve publike, koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, duke përdorur mjete IT në kryerjen e auditimeve financiare, përputhshmërisë dhe performancës në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikat e mira profesionale për sektorin publik.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP).

Ky projekt do të bëjë të mundur krijimin e eksperiencave të reja dhe do të përsosë njohuritë dhe aftësitë e audituesve të KLSH-së për të mbikëqyrur fushën e koncesioneve dhe kontratave të partneritetit publik-privat duke sjellë dhe plotësimin e një kornize të përshtatshme për të siguruar që këto lloj kontratash ofrojnë vlerë të shtuar dhe minimizojnë risqet në kushtet e financimit publik. I gjithë ky proces nuk mund të bëhet pa garantuar që audituesit kanë aftësitë e duhura teknike lidhur me përdorimin e mjeteve të teknologjisë së informacionit në auditim.

Projekti do të mundësojë auditime më cilësore dhe do të japë rekomandime me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmiresuar dhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publike përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare. Ky projekt dy vjeçar do të ndihmojë dukshëm në drejtim të auditimit më profesional të fondeve publike në fushën e koncesioneve dhe PPP-ve në Shqipëri.

Bashkëpunimi mes KLSH-së dhe Sekretariatit të Shtetit për Çështjet Ekonomike(SECO) i Konfederatës zvicerane do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së, por do të jetë njëkohësisht edhe promotori i mbështetjes së Konfederatës së Zvicrës për Republikën e Shqipërinë.

#### **III.3.1.4 Bashkëpunimi KLSH-SIGMA për vitin 2019**

Kontrolli i Lartë i Shtetit përgjatë 8 viteve të fundit ka bashkëpunuar ngushtësisht me SIGMA-n dhe partneriteti ka qenë i suksesshëm, veçanërisht në drejtim të konsolidimit dhe përmirësimit të veprimtarisë audituese në dobi të mirëqeverisjes publike, si dhe suportin në modelimin e reformave administrative e metodologjike në KLSH.

Vlen të ritheksojmë që ndihma e SIGMA dhe e DG Budget ka qenë vendimtare në miratimin e Ligjit të ri organik të KLSH-së në nëntor të vitit 2014, i cili është në përputhje të plotë me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

Raporti i fortë i bashkëpunimit mes KLSH-së dhe SIGMA është mbështetur në vullnetin e treguar nga Kryetari i KLSH-së z.Bujar Leskaj dhe nga Drejtuesit e SIGMA z. Bagrat Tunyan, Drejtues i SIGMA për Shqipërinë, z.Alastair Swarbrick, Këshilltar i Lartë i SIGMA-s për Financat publike dhe Auditimin, si dhe z.Joop Vrojlik, Këshilltar i Jashtëm.

Ky bashkëpunim i suksesshëm ka vijuar dhe është thelluar përgjatë vitit 2019, me synim forcimin e kapaciteteve audituese. Bashkëpunimi është fokusuar në tre drejtime kryesore :

1. Përgatitjen e Manualit për Auditimin e Buxhetit të Shtetit, i cili është ende në proces dhe janë duke u bërë rakordimet e fundit mes KLSH-së dhe SIGMA-s;
2. Organizimin e Konferencës Shkencore së KLSH-së, në 12 maj 2020 me temë kryesore “Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe Shqipëria”, e cila do të fokusohet në sfidat dhe veprimtarinë e institucioneve shqiptare në arritjen e këtyre shtatëmbëdhjetë objektiveve për rritje ekonomike. Përfaqësues të SIGMA do të jetë bashkë-drejtuës të konferencës dhe ekspertët e saj do të jenë prezentë në Konferencë me kontribute konkrete dhe profesionale.
3. Mbështetja e SIGMA do të jetë e qenësishme në projektin e ri që ka ndërmarrë KLSH për ngritjen e Departamentit të Auditimit të Sistemeve dhe Inovacionit, për të cilin bëhet nevojë dhe domosdoshmëri përgatitja e një stafi të aftë dhe profesional. Në këtë kuadër, asistenca e ekspertëve të SIGMA do të kontribuojë në formimin më të shpejtë të stafit të kësaj strukture.

#### **III.3.1.5 Vetëvlerësimi i integritetit- “IntoSAINT”**

Në datat 17-21 Shkurt 2020, në Kontrollin e Lartë të Shtetit u zhvillua workshop-i mbi vetëvlerësimin e integritetit IntoSAINT. Ky workshop u organizua në vijimësi të aktiviteteve të zhvilluara nga Task Forca e EUROSAT-t për Auditimin dhe Etikën.

Objektivi kryesor për krijimin e kësaj Task Force ishte promovimi i rëndësisë së sjelljes etike si në Institucionet Supreme të Auditimit ashtu edhe në organizatat e sektorit publik. Me qëllim përmbushjen e këtij objekti, në periudhën 2017-2020 aktivitetet e kësaj Task Force u fokusuan në rishikimin e ISSAI 30, mbështetjen e

implementimit të ISSAI 130 dhe inkurajimi i SAI-ve për të promovuar integritetin në sektorin publik.

Kontrolli i Lartë i Shtetit është prej vitesh anëtar aktiv i kësaj Task Force dhe ka qenë tepër aktiv në takimet e kësaj task force që kanë pasur në fokus çështjet e etikës, integritetit dhe luftës kundër korrupsionit e mashtrimit. KLSH iu përgjigj menjëherë ftesës se EUROSAT-t për t'ju nënshtruar procesit të vetëvlerësimit të integritetit të institucionit duke e vlerësuar këtë aktivitet si një mundësi për identifikimin e sfidave dhe hapave që duhen ndërmarrë për forcimin e strukturës etike. Aktiviteti u drejtua nga përfaqësuese të SAI-ve të Maqedonisë së Veriut, të Finlandës dhe të Norvegjisë dhe një audituese e KLSH-së, koordinatorë për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti. Në këtë workshop morën pjesë 15 auditues të KLSH-së të përzgjedhur nga departamente auditimi dhe stafi administrativ.

IntoSAINT- (Self Assessment INTEgrity), është instrument i zhvilluar nga Gjykata Hollandeze e Auditimit. Ky “mjet” vetëvlerësimi i organizuar në formën e një seminari u mundëson SAI-ve të vlerësojnë cënueshmërinë dhe elasticitetin e tyre ndaj shkeljeve të integritetit, duke hartuar më pas rekomandime për të përmirësuar në rang menaxherial performancën institucionale.

Institucioni duhet të sigurojë pavarësinë e tij, cilësinë e pa diskutueshme të punës dhe standarde të larta të sjelljes së stafit (ISSAI 30), duhet të promovojë dhe manifestojë vlerat si aset i shtuar në kryerjen e funksioneve institucionale (ISSAI 12) dhe të udhëheqë nëpërmjet shembullit të mirë (ISSAI 20).

ISSAI 30 promovon vlera si: Integriteti; Pavarësia dhe objektiviteti; Kompetenca Profesionale; Sjellja profesionale dhe Konfidencialiteti dhe transparencja. Risia që sjell ky Standard Ndërkombëtar Auditimi është në sanksionimin e parimit se: “Sjellja etike e stafit ndikohet gjithashtu edhe nga mjedisi i punës”. Në përputhje me rrethanat, Kodi adreson përgjegjësitë e SAI-ve në promovimin dhe ruajtjen e etikës dhe vlerave etike në çdo aspekt të organizatës dhe aktivitetëve të saj.

Metodologjia e përdorur për vetëvlerësimin e integritetit në këtë seminar, konsistoi në dy faza:

- Vlerësimin e Dobësive dhe risqeve të integritetit; si edhe
- Përcaktimin e nivelit të maturimit të sistemit të kontrollit të integritetit.

Objekt i këtij procesi ishte e gjithë veprimtaria Institucionale e KLSH-së. Grupi i 15 pjesëmarrësve të KLSH-së në këtë seminar evidentoi disa nga risqet që mund të ndikojnë në cënueshmërinë e integritetit. Bazuar në përgjigjet e dhëna nga audituesit e KLSH-së në fund të procesit të vetëvlerësimit të integritetit u propozuan disa rekomandime të cilat kanë si qëllim përmirësimin e mëtejshëm e të vazhdueshëm, si dhe konsolidimin e strukturave dhe politikave për integritetin në KLSH.

Në përfundim të këtij seminari, grup i moderatorëve vlerësoi pozitivisht punën dhe rezultatet e arritura për mirëmenaxhimin dhe funksionimin institucional duke çmuar dhe vlerësuar në mënyrë të veçantë drejtimin menaxherial të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Bujar Leskaj, i cili ka iniciuar ndryshime thelbësore që lidhen me miratimin e Kodit të ri Etik të KLSH-së, dokument tërësisht në përputhje me ISSAI 30 dhe praktikën më të mira të fushës, përkthimin në gjuhën shqipe të ISSAI 30, botimin “ Forcimi i Infrastrukturës Etike në SAI-e dhe Auditimi i

Etikës në Sektorin Publik” si dhe botimin “INTOSaint- Manuali i Vetëvlerësimit të Integritetit për institucionet Supreme të Auditimit” .

Impakt pozitiv pati gjithashtu edhe konsolidimi i kolanës së botimeve të KLSH-së me 113 tituj, duke evidentuar edhe njëherë rëndësinë e veçantë që KLSH i ka dhënë librit dhe botimeve profesionale të fushës, si edhe pjesëmarrja në shtypin e shkruar dhe media e audituesve, me qëllim promovimin e aktivitetit auditues dhe informimin e qytetarëve duke rritur kështu impaktin e auditimeve të kryera nga KLSH.

Për herë të parë, KLSH u bë pjesë e implementimit të këtij instrumenti në vetëvlerësimin e aktivitetit institucional të vitit 2014. E gjithë veprimtaria audituese dhe menaxhuese institucionale u vendos të analizohej nën këndvështrimin e vlerës themelore për një SAI që është “Integriteti”.

Ky vetëvlerësim shërbeu si bazë për hartimin dhe zhvillimin e politikave, akteve rregullatore dhe praktikave etike që prej vitesh janë bërë pjesë jetësore e misionit, vizionit dhe vlerave të Kontrollit të Lartë të Shtetit. KLSH është e angazhuar që integriteti dhe politika e integritetit të jenë të gdhendura në sjelljen dhe qëndrimin e çdo hallke institucionale, si dhe të jenë një pjesë e paluajtshme si në sistemin e menaxhimit institucional ashtu dhe të cilësisë së punës audituese.

Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse dhe efektive të integritetit, të cilat fokusohen tek parimi i udhëheqjes nëpërmjet shembullit, e kanë vendosur institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në rolin e institucionit që promovon integritetin dhe etikën profesionale në administratën publike.

Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022 konsolidoi integritetin si një komponent standard në drejtimin dhe në ciklin e politikave të KLSH-së edhe për vitet e ardhshme.

Seminari u përmyll me prezantimin e raportit nga moderatorët për stafin menaxherial.

### ***III.3.1.6 Kongresi i XXIII-të i INTOSAI-t dhe aktivitete të tjera***

Një nga aktivitetet më të rëndësishme të vitit 2019 ka qenë pa dyshim **Kongresi i XXIII-të i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, INTOSAI-t.** Në kongres morën pjesë 600 delegatë nga 168 SAI nga 194 anëtarë, përfaqësues të të gjitha organizatave rajonale të INTOSAI-t.

Një ngjarje për t’u shënuar gjatë zhvillimit të punimeve të këtij Kongresi ishte pranimi i Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës (ZKA) anëtare me të drejta të plota në Organizatën Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, nga data 1 janar 2020.

Kongresi trajtoi dy tema kryesore :I. Teknologjia e Informacionit dhe roli i saj në zhvillimin e administratës publike;II. Roli i SAI-ve në Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

I. Teknologjia e Informacionit dhe roli i saj në zhvillimin e administratës publike

Në temën e I-rë u diskutuan shumë çështje të rëndësishme që lidhem me zhvillimet IT sepse në vitet e fundit këto zhvillime kanë ndikuar në mënyrë sinjifikative në jetën e qytetarëve në mbarë botën. Revolucioni teknologjik, në veçanti telefonia celulare, big data dhe inteligjenca artificiale janë në zhvillim të vazhdueshëm. Në

këtë proces, zhvillet e reja teknologjike kanë sjellë rritje eksponenciale të të dhënave në forma të ndryshme, duke krijuar mundësinë që marrja e vendimeve publike të jetë më racionale dhe më eficiente. Nga diskutantët e ndryshëm gjatë zhvillimit të seancave plenare lidhur me këtë temë u trajtuan tematikat si më poshtë :

- Roli i IT në Administratën Publike;
- Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e administratës publike;
- Karakteristikat e Big Data;
- Roli i Big Data në përmbushjen e detyrave nga SAI-t;
- Sfidat që duhet të përballen nga Auditimi i Big Data.

Në përfundim të diskutimeve, problemet më të shpeshta me të cilat ndeshen SAI-t në drejtim të zhvillimeve teknologjike janë “Sfidat teknologjike”, “Mungesa e profesionistëve”, Mungesa e dizejnimit nga drejtuesit e nivelit të lartë për Auditimet IT” dhe “ Buxhet i pamjaftueshëm dhe investimet në IT”.

## II. Roli i SAI-ve në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Për këtë temë, diskutimi më i rëndësishëm ishte ai i z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA. Zoti Dodaro nënvizoi lidhjen mes 17 Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Planit të Zhvillimit Strategjik të GAO-s, të cilat i referohen gjithashtu çështjeve vitale dhe relevante në SHBA.

Nëse i referohemi Programit të Riskut të Lartë, duke filluar që nga viti 1990, ky program është fokusuar në operacionet e qeverisë me risk më të lartë për mashtrime, vjedhje, abuzime, keq-menaxhim dhe kjo me qëllim që të përballojmë sfidat me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Në drejtim të realizimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm duhet të kemi një qasje të re, mënyra të reja të menduari dhe kapacitete të reja qeverisëse, të cilat janë esenciale për qeveritë kombëtare për të arritur objektivat kombëtarë, përfshirë ato të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në përfundim të punimeve, Kongresi miratoi Deklaratën e Moskës.

KLSH, me vendim të Kryetarit të KLSH z. Bujar Leskaj, u përfaqësua në këtë aktivitet nga Sekretari i Përgjithshëm, zj.Luljeta Nano; Drejtori i Përgjithshëm, zj.Manjola Naço dhe Drejtori i Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, zj.Irena Islami.

Ndër takimet më të rëndësishme, në të cilat ka qenë pjesëmarrës Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Leskaj mund të përmendim **takimin e drejtuesve të SAI-eve të Komitetit të Kontaktit të EUROSAT** të zhvilluar në Varshavë në datat 27-28 qershor 2019.

Sfidat dhe mundësitë e institucioneve supreme të auditimit në Evropën dixhitale kanë qenë tema kryesore e diskutimit në takimin e Komitetit të Kontaktit të SAI-ve të vendeve të Bashkimit Evropian, në të cilin ekspertë të fushës dhe drejtues të SAI-eve paraqitën eksperiencat për rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm të SAI-eve në këtë proces.

Zhvillimet e teknologjisë së informacionit gjithnjë e më tepër kanë parashtruar sfida të vazhdueshme për SAI-et për zhvillimin e kapaciteteve dhe metodologjive të domosdoshme për të realizuar auditime cilësore të këtij aspekti me impakt në shërbimet që qeveritë ju ofrojnë qytetarëve.

Gjatë zhvillimit të këtij aktivitetit drejtuesit e SAI-eve pjesëmarrëse u pritën nga Presidenti i Republikës së Polonisë, Z Andrzej Duda, i cili shprehu vlerësimin për rolin dhe kontributin e institucione supreme të auditimit në konsolidimin e eficiencës dhe efektivitetit në një fushë kaq të rëndësishme siç është dixhitalizimi i qeverisjes, e cila duhet të synojë jo vetëm përfaqësimin por edhe përfshirjen e qytetarëve në procese të ndryshme të qeverisjes dixhitale.

Në dy ditët e takimit të Komitetit të Kontaktit të Institucioneve Supreme të Auditimit të vendeve të BE-së, Kryetari i KLSH-së zhvilloi takime pune me Presidentin e SAI-t Polak, z.Kwiatkowski, Presidentin e SAI-t të Portugalisë, z. Caldeira, Audituesin e Përgjithshëm të Finlandës, znj. Tytti Yli-Viikari, Presidentin e SAI-t të Çekisë, z. Kala, Presidentin e SAI-t të Rumanisë, z. Busuioc, Audituesin e Përgjithshëm të Qipros, z. Michaelides, Presidentin e SAI-t të Malit të Zi, z.Dabović, Anëtarin e Gjykatës Evropiane të Audituesve, z. Wojciechowski, Zv. Presidentin e NIK-ut polak, z. Kutyla dhe Zv. Auditorin e Përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Ademi.

**Me qëllim thellimin dhe rritjen cilësore të bashkëpunimit të KLSH me Zyrën kombëtare të Auditimit të Kosovës, Kryetari i KLSH-së ka marrë pjesë në Konferencën e 11-të vjetore të kësaj zyre** të zhvilluar në Strugë në datën 15 tetor 2019. Tema kryesor e kësaj konference ishte *“Rritja e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes në sektorin publik”*. Në këtë konferencë morën pjesë edhe përfaqësues të Maqedonisë së Veriut, Suedisë, Malit të Zi dhe Gjykata Turke e Llogarive. Në kumtesën e tij, z.Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH-së u përqendrua në punën e KLSH-së në rritjen e ndikimit të auditimit në përmirësimin e qeverisjes publike. Kjo rritje ka përberë një nga tre objektivat kryesore të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022, Qëllimi Strategjik 1 *“Rritja e Impaktit të punës audituese me fokus në 6E-të”*. KLSH e ka parë realizimin e këtij qëllimi nëpërmjet ofrimit të produkteve cilësore të auditimit, duke gërshetuar gjetjet dhe rekomandimet nga auditimet financiare, të rregullshmërisë dhe përputhshmërisë, me këshillat dhe sugjerimet e përmbajtura në auditimet e performancës.

Në prezantimin e tij, Kryetari i KLSH u fokusua edhe tek *Udhëheqja nëpërmjet shembullit*, duke vënë theksin në përpjekjet për të qenë një organizatë model me qëllim që SAI të ndikojë në përmirësimin e qeverisjes, duke udhëhequr nëpërmjet shembullit institucional.

**Përfaqësues të KLSH-së kanë marrë pjesë në takimin “Institucionet Supreme të Auditimit bëjnë ndryshimin: Auditimi i implementimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm”** të zhvilluar në New York në datat 22-23 Korrik 2019, të organizuar nga Departamenti i Çështjeve Sociale dhe Ekonomike të Kombeve të Bashkuara dhe Iniciativës për zhvillim të INTOSAI-t (IDI) sepse objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të Axhendës 2030 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara kanë qenë edhe gjatë vitit 2019 në fokusin auditues të shumë SAI-eve.

Sfidat me të cilat ndeshen SAI-et e vendeve evropiane dhe atyre afrikane në auditimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm kanë qenë edhe në qendër të seminarit të parë të EUROSAT-t dhe AFROSAT-t të zhvilluar në Lisbonë në datat 21-22 nëntor 2019. Në këtë aktivitet SAI e ndryshme sollën eksperiencat e tyre kombëtare në auditimin e implementimit të 17 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

KLSH ka marrë pjesë gjithashtu në **seminarin e parë mbi Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të zhvilluar në data 21-22 nëntor 2019, në Lisbonë**. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga mbi 50 SAI të ndryshme, kryesisht evropiane dhe afrikane. Qëllimi i takimit ishte sensibilizimi i pjesëmarrësve për emergjencën në arritjen e 17 objektivave dhe adresimin e duhur të tyre tek qeveritë përkatëse. Në seminar u vu theksi tek sfidat e përbashkëta me të cilat ndeshet sot komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht tek varfëria, pabarazia sociale, ndryshimet klimatike dhe degradimi mjedisor, paqja, drejtësia, arsimimi dhe kontributin që mund të japin SAI-et përballë këtyre sfidave.

Në këtë aktivitet Kryetari i KLSH, z. Bujar Leskaj pati takime frytdhënëse me drejtues të SAI-t portugez, polak, turk, bullgar, malazez, etj. Në këto takim u vendosën ura bashkëpunimi për auditime të përbashkëta performance me vendet anëtare të EUROSAT-t, sikurse ai që është aktualisht në proces me SAI-n kroat, të Malit të Zi dhe të Sllovenisë mbi “Ndotjen e Menjëhershme të Deteve”.

### ***III.3.1.7 Internshipi i ECA-s dhe Fellowship i GAO-s***

Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022 e ka vënë theksin tek kapitali njerëzor, audituesit, të cilët mbeten aset më i rëndësishëm dhe më i vlefshëm, duke konsideruar që suksesi në përmbushjen e misionit dhe arritjen e objektivave varet në mënyrë të ndjeshme nga krijimi i një trupe auditimi kompetente dhe të mirë trajnuar.

Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), nëpërmjet programit të internship-it dhe Zyra e Auditimit të Qeverisë të SHBA-së (GAO), nëpërmjet programit të fellowship-it kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e kapacitetit profesional të audituesve pjesëmarrës në këto aktivitete.

Në vitin 2019, tre auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit, zj.Megi Kurushi, zj.Erieta Këllici dhe z.Dorel Balliu, kanë qenë pjesë e strukturave të ECA-s për një periudhë 5 mujore duke ndjekur nga afër dhe në mënyrë të detajuar të gjitha fazat e kryerjes së auditimit nga kjo gjykatë. Dy auditues të tjerë kanë ndjekur programin e internshipit, i cili ka startuar në tetor 2019 dhe ka përfunduar në 29 shkurt 2020.

Internshipi i konceptuar si një proces i përvetësimit të dijeve nëpërmjet trajnimit dhe përfshirjes në grupet e auditimit të ECA i ka dhënë mundësinë audituesve të KLSH të njihen me metodologjinë e përdorur në kryerjen e auditimeve të performancës dhe atyre financiare, hartimin e raporteve specifike si dhe paraqitjen e opinionëve për ligje specifike që lidhen me menaxhimin financiar.

Për periudhën 2014-2020, 22 auditues të KLSH-së kanë marrë pjesë në programet e internship-it të ofruar nga ECA.

Bashkëpunimi i suksesshëm i iniciuar prej vitit 2012 me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së Shteteve të bashkuara të Amerikës ka vazhduar edhe gjatë vitit 2019. Audituesja Ermira Vojka, pjesë e departamentit të Auditimit të Performancës ka ndjekur për një periudhë 4 mujore programin e fellowshipit të ofruar nga ky institucion. Numri i audituesve që kanë përfunduar fellowshipin e plotë të GAOs ka shkuar në gjashtë dhe bashkëpunimi me GAO-n do të vijojë në këtë drejtim.

Për këtë bashkëpunim një falenderim dhe një vlerësim maksimal shkon për z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Llogaridhënies Qeveritare të SHBA dhe për Drejtorin e Planifikimit Strategjik në GAO, z. James Blockwood, të cilët kanë pasur dëshirën e mirë dhe vullnetin për të mbështetur audituesit e rinj shqiptarë në drejtim të rritjes së kapaciteteve të tyre audituese.

### ***III.3.2. Marrëdhëniet e KLSH-së me OJF-të, Organizatat profesionale të fushës, institucionet akademike etj.***

Gjatë tetë viteve të fundit KLSH ka nënshkruar 60 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 33 me OJF dhe Universitete Publike e Private, 17 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore.

Bashkëpunimi me profesoratin e Universiteteve është vlerësuar maksimalisht nga KLSH, duke bashkëpunuar ngushtësisht me personalitete të fushave të ndryshme, duke përfshirë një pjesë të tyre edhe në auditime specifike, që kërkojnë mendim më të specializuar. Kjo qasje bashkëpunimi me Universitetet konfirmohet edhe për vitin **2019, gjatë të cilit Kryetari i KLSH ka nënshkruar tre marrëveshje të reja bashkëpunimi me Universitete, përkatësisht me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universitetin “LOGOS” dhe “Albanian University”.**

#### *Sfidat e institucionit në fushën e komunikimit dhe transparencës për vitin 2020*

- Përfundimi i strategjisë së re të komunikimit të KLSH-së, 2020-2022, brenda gjashtë-mujorit të parë të vitit 2020;
- Rritja e prezencës së audituesve të KLSH-së në media;
- Përfshirja e përfaqësuesve të OJF-ve dhe të botës akademike në auditime konkrete, për fusha në të cilat ata kanë ekspertizë të kualifikuar;
- Realizimi i Konferencës së VII-të Vjetore Shkencore të KLSH-së, në bashkëpunim me SIGMA, me temë : “Objektivat e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 dhe Shqipëria”.
- Realizimi i 14 botime të reja të KLSH-së për vitin 2020, duke punuar fort në drejtim të përmirësimit të cilësisë së botimeve, veçanërisht në drejtim të Revistës kërkimore shkencore të KLSH-së, “Auditimi Publik”, etj.

## **IV. Menaxhimi institucional dhe zhvillimi strategjik**

### **IV.1 Performanca bazuar në kornizën e Indikatorëve të Matjes së Performancës**

Sikurse është raportuar edhe në Raportet e Performancës së institucionit në mënyrë konsistente që nga viti 2016, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka konsoliduar metodologjikisht dhe ka implementuar Kornizën e Matjes së Performancës<sup>13</sup> (KMP). Tashmë vlerësimi i performancës institucionale nëpërmjet Kornizës së Matjes së performancës përbën një filozofi të konsoliduar të funksionimit të institucionit në rrugëtimin e tij drejtë modernizimit dhe përmbushjes së objektivave strategjik të zhvillimit.

Analiza dhe vlerësimi i performancës institucionale nëpërmjet Kornizës (KMP) është konceptuar dhe ka shërbyer si instrument që mundëson identifikimin situatës aktuale të zbatimit të Standardet Ndërkombëtare të SAI-ve dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës nga auditimi i jashtëm publik në Shqipëri. Për më tepër, është instrumenti që siguron jo vetëm transparencën por pasqyron shkallën e përgjegjshmërisë mbi identifikimin e aspekteve të funksionimit institucional dhe të aktivitetit auditues që duhen përmirësuar. Në këtë kontekst, kjo qasje metodologjike nuk përbën qëllim në vetvete por është në përmbushje të misionit kushtetues dhe për të sjellë vlerë për qytetarët.

Metodologjia e aplikuar edhe përgjatë vitit 2019 për vlerësimin e KMP është qasje hibride, pra kombinimi i vetëvlerësimit mbi baza vullnetare të performancës institucionale, sipas kritereve të përcaktuara për çdo element përbërës të treguesve duke përdorur Standardet Ndërkombëtare të SAI-ve dhe praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës, me vlerësimin e dimensioneve të veçanta nga ekspertë ndërkombëtar të fushës. Konkretisht, dimensionin e integritetit dhe i etikës të KLSH-së është vlerësuar nëpërmjet një procesi vetëvlerësimi duke aplikuar instrumentin INTOSAINIT nën moderimin e kolegëve homologë të SAI-t të Norvegjisë, Finlandës dhe Maqedonisë së Veriut.

Matrica e treguesve merr në konsideratë faktin që institucionet supreme të auditimit janë institucione komplekse, për rrjedhojë treguesit e performancës të fushave apo të dimensioneve të ndryshme janë të ndërlydhura. Kjo matricë treguesish gjeneron një informacion sa të sintetizuar aq edhe analitik. Nëpërmjet treguesve të sintetizuar mundësohet krahasimi i performancës së KLSH-së me atë të Institucioneve të tjera Supreme të Auditimit, si dhe mundësohet analiza e dinamikës së zhvillimit të vetë institucionit ndër vite. Ndërsa, përmes dimensioneve analitike mundësohet të identifikohen aspektet konkrete të cilat duhet të përmirësohen krahasuar me standardet dhe praktikat më të mira të INTOSAI-t.

#### **IV.1.1 Analiza e Performancës sipas Treguesve**

Monitorimi i treguesve të performancës i mundëson KLSH-së të ndjekë progresin në aspektet kryesore dhe të sigurojë informacion të rëndësishëm mbi të cilin mund të bazohen vendimet menaxheriale dhe organizative, të cilat sigurojnë përmirësimin e

---

<sup>13</sup> “Korniza e Matjes së Performancës së SAI-ve”, metodologji e miratuar në Kongresin INCOSAI XXII të INTOSAI-t në Abu d’Habi, Dhjetor 2016. Botime KLSH – 07/2017/74


vazhdueshëm dhe konsolidimin e rritjes institucionale. Kjo qasje metodologjike nuk përbën qëllim në vetvete por është në funksion të realizimit të misionit kushtetues dhe të objektivit të brendshëm për të krijuar vlerë për qytetarët.

Korniza e Matjes së Performancës paraqitet në formën e një matrice treguesish të detajuar, sipas 6 fushave kryesore, Pavarësia dhe Korniza ligjore; Qeverisja e Brendshme dhe Etika; Cilësia e Auditimit dhe Raportimi; Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Strukturat Mbështetëse; Burimet Njerëzore dhe Trajnimi; si dhe, Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesit.

Secila prej fushave përbëhet nga shumë dimensione, duke formësuar një matricë të përbërë nga 25 tregues, të cilat janë matur sipas kriterëve të mirë përcaktuar si nga pikëpamja e matjes ashtu edhe nga pikëpamja e pikëzimit.

Rezultatet e vlerësimit të treguesve të performancës sipas fushave, e realizuar sipas metodologjisë së pikëzimit të Kornizës së Matjes së Performancës (KLSH, 2017), ku për secilin dimension dhe fushë niveli i pikëzimit varion nga 0 në 4, reflektohet në diagramën e mëposhtme.

Diagrama nr.1 Vlerësimi i treguesve të performancës sipas fushave



Burimi: KLSH

Sikurse paraqitet në diagramë, treguesit e agreguar sipas fushave identifikojnë faktin se KLSH ka një **performancë mbi nivelin mesatar dhe konkretisht për tre nga 6 fusha vlerësimi është 3 (nga 4) dhe për tre fusha vlerësimin 4.**

Nëse i referohemi një analize analitike dhe më të thelluar të secilit dimension dhe të kriterëve sipas të cilave vlerësohen, konstatojmë aspekte që reflektojnë përmirësimin kundrejt vitit 2018 dhe të aspekteve dhe drejtimeve që duhet të përmirësohen e duke strukturuar aktivitetin e menaxhimit institucional për vitin e ardhshëm. Nga krahasimi i të dhënave të agreguara të viti 2019 kundrejt vitit 2018, konstatohet se fusha F “Komunikimi dhe Menaxhimi i palëve të interesit” ka shënuar përmirësim duke arritur vlerësimin maksimal 4 nga 3 që ishte vlerësuar në vitin 2018. Ndërsa aspektet e tjera kryesisht ato të cilësisë së auditimit dhe raportimit nuk paraqesin përmirësimin e dukshë, megjithëse disa nga dimensionet

kanë patur përmirësim por nuk arrijnë të ndryshojnë nivelin e agreguar të vlerësimit në nivelin e fushës.

#### IV.1.2 Përmbledhje e Treguesve të Performancës për vitin 2019

Vlerësimi i treguesve specifikë të çdo dimensionit që përbëjnë fushat është bazuar në qasjen e vetëvlerësimit nga grupet e punës së KLSH-së dhe nga vlerësimi i ekspertëve homologë të komunitetit të INTOSAIT. Rezultatet e procesit të pikëzimit sipas kriterëve specifikë janë paraqitur të agreguara në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.6 Përmbledhje e treguesve të performancës së KLSH-së për vitin 2019

Tregues	Fusha	Dimensionet	Pikëzimet
	<b>A. Pavarësia dhe Korniza Ligjore</b>		<b>4</b>
SAI-1	<b>Pavarësia e SAI-t</b>	(i). Korniza kushtetuese e përshtatshme dhe efektive (ii). Pavarësi në autonomi financiare (iii). Pavarësi në autonomi organizative (iv). Pavarësia e Kryetarit të SAI-t dhe Zyrtarëve të tij	4 3 4 4
SAI-2	<b>Mandati i SAI-t</b>	(i). Mandat mjaftueshëm (ii). Akses në informacion (iii). E drejta dhe detyrimi për raportim	4 4 4
	<b>B. Qeverisja e Brendshme dhe Etika</b>		<b>3</b>
SAI-3	<b>Cikli i Planifikimit Strategjik</b>	(i). Përmbajtja e Planit Strategjik. (ii). Përmbajtja e Planit Vjetorë Planit Operacional (iii). Procesi i Planifikimit Organizativ (iv). Monitorimi dhe Raportimi i Performancës	4 3 3 3
SAI-4	<b>Mjedisi i Kontrollit Organizativ</b>	(i). Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm – Etika, Integriteti dhe Struktura Organizative (ii). Sistemi i Kontrollit të Brendshëm (iii). Sistemi i Kontrollit të Cilësisë (iv). Sistemi i Sigurimit të Cilësisë	4 4 3 4
SAI-5	<b>Auditimet me Burimet e Jashtme</b>	(i). Procesi i Përzgjedhjes së Audituesve me Kontratë (ii). Kontrolli i Cilësisë së Auditimeve me Burimet të Jashtme (iii). Sigurimi i Cilësisë së Auditimeve me Burimet të Jashtme	na na
SAI-6	<b>Udhëheqja dhe Komunikimi i Brendshëm</b>	(i). Udhëheqja (ii). Komunikimi i Brendshëm	4 4
SAI-7	<b>Planifikimi i Përgjithshëm i Auditimit</b>	(i). Procesi i Përgjithshëm i Planifikimit të Auditimit (ii). Përmbajtja e Planit të Përgjithshëm të Auditimit	4 3
	<b>C. Cilësia e Auditimit dhe Raportimi</b>		<b>3</b>
SAI-8	<b>Mbulimi i Auditimit -3-</b>	(i). Mbulimi i Auditimit Financiar (ii). Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivat e Auditimit të Performancës (iii). Mbulimi, Përzgjedhja dhe Objektivat e Auditimit të Përputhshmërisë	na 2 4

SAI-9	<b>Standardet Financiare të Auditimit dhe Menaxhimi i Cilësisë -3-</b>	(i). Politikat dhe Standardet e Auditimit Financiar (ii). Menaxhimi i Grupit të Auditimit Financiar dhe Aftësitë (iii). Kontrolli i Cilësisë në Auditimin Financiar	3 3 3
SAI-10	<b>Procesi i Auditimit Financiar -3-</b>	(i). Planifikimi i Auditimit Financiar (ii). Zbatimit i Auditimit Financiar (iii). Vlerësimi i Evidencës së Auditimit, Konkluzionet dhe Raportimi i Auditimit Financiar	3 3 3
SAI-11	<b>Rezultatet e Auditimit Financiar -4-</b>	(i). Dorëzimi në kohë i Rezultateve të Auditimit Financiar (ii). Publikimi në kohë i Rezultateve të Auditimit Financiar (iii). Ndjekja e zbatimit të komenteve dhe Rekomandimeve të Auditimit Financiar nga SAI	4 3 3
SAI-12	<b>Standardet e Auditimit të Performancës dhe Menaxhimi i Cilësisë -3-</b>	(i). Politikat dhe Standardet e Auditimit të Performancës (ii). Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Performancës dhe Aftësitë (iii). Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Performancës	2 3 3
SAI-13	<b>Procesi i Auditimit të Performancës -3-</b>	(i). Planifikimi i Auditimit të Performancës (ii). Zbatimi i Auditimeve të Performancës (iii). Raportimi në Auditimet e Performancës	3 2 3
SAI-14	<b>Rezultatet e Auditimit të Performancës -3-</b>	(i). Dorëzimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës (ii). Publikimi në kohë i Raporteve të Auditimit të Performancës (iii) Ndjekja e zbatimit të komenteve dhe Rekomandimeve të Auditimit të Performancës nga SAI	4 4 2
SAI-15	<b>Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë dhe Menaxhimit i Cilësisë -3-</b>	(i). Politikat dhe Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë (ii). Menaxhimi i Grupit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe Aftësitë (iii). Kontrolli i Cilësisë në Auditimin e Përputhshmërisë	2 3 4
SAI-16	<b>Procesi i Auditimit të Përputhshmërisë -3-</b>	(i). Planifikimi i Auditimit të Përputhshmërisë (ii). Zbatimi i Auditimit të Përputhshmërisë (iii) Vlerësimi i Evidencës së Auditimit, Konkluzionet dhe Raportimi në Auditimet e Përputhshmërisë	2 3 3
SAI-17	<b>Rezultatet e Auditimit të Përputhshmërisë -3-</b>	(i). Dorëzimi në kohë i Rezultateve të Auditimit të Përputhshmërisë (ii). Publikimi në kohë i Rezultateve të Auditimit të Përputhshmërisë (iii) Ndjekja e zbatimit të komenteve dhe Rekomandimeve të Auditimit të Përputhshmërisë nga SAI	4 3 3

SAI-18	<b>Standardet e Kontrollit Gjyqësor dhe Menaxhimi i Cilësisë (për SAI-t Gjyqësore)</b>	(i). Politikat dhe Standardet e Kontrollit Gjyqësor (ii).. Menaxhimi i Grupit të Kontrollit Gjyqësor dhe Aftësitë (iii) Kontrolli i Cilësisë në Kontrollat Gjyqësore	na
SAI-19	<b>Procesi i Kontrollit Gjyqësor (për SAI-t me Funksione Gjyqësore)</b>	(i). Planifikimi i Kontrolleve Gjyqësore (ii). Zbatimi i Kontrolleve Gjyqësore (iii) Procesi vendimmarrës gjatë Kontrolleve Gjyqësore (iv) Vendimi Përfundimtar i Kontrolleve Gjyqësore	na
SAI-20	<b>Rezultatet e Kontrolleve Gjyqësore (për SAI-t me Funksione Gjyqësore)</b>	(i). Njoftimi i Vendimeve lidhur me Kontrollin Gjyqësor (ii). Publikimi i Vendimeve lidhur me Kontrollin Gjyqësor (iii). Ndjekja e Zbatimit të Vendimeve lidhur me Kontrollin Gjyqësor	na
<b>D. Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse</b>			<b>4</b>
SAI-21	<b>Menaxhimi Financiar, Asetet dhe Shërbimet Mbështetëse</b>	(i). Menaxhimi Financiar (ii). Planifikimi dhe Përdorimi Efektiv i Aseteve dhe Infrastrukturës (iii) Shërbimet Administrative Mbështetëse	4 3 4
<b>E. Burimet Njerëzore dhe Trajnimi</b>			<b>3</b>
SAI-22	<b>Menaxhimi i Burimeve Njerëzore -3-</b>	(i).Funksioni i Burimeve Njerëzore (ii). Strategjia e Burimeve Njerëzore (iii) Rekrutimi i Burimeve Njerëzore (iv) Shpërblimi, Promovimi dhe Mirëqenia e Stafit	3 3 4 4
SAI-23	<b>Zhvillimi dhe Trajnimi Profesional-3-</b>	(i).Planet dhe Proceset për Zhvillimin dhe Trajnimin Profesional (ii). Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin Financiar (iii) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Performancës (iv) Zhvillimi Profesional dhe Trajnimi për Auditimin e Përputhshmërisë	3 3 3 3
<b>F. Komunikimi dhe Menaxhimi i Palëve të Interesuara</b>			<b>4</b>
SAI-24	<b>Komunikimi me Legjislativin, Ekzekutivin dhe Gjyqësorin- 3-</b>	(i).Strategjia e Komunikimeve (ii). Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Legjislativin (iii) Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Ekzekutivin (iv) Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Gjyqësorin, Prokurorinë dhe Agjencitë Investigative	4 4 3 4
SAI-25	<b>Komunikimi me Median, Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile -4-</b>	(i).Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Media në Shtypin (ii). Praktika e mirë në lidhje me Komunikimin me Qytetarët dhe Organizatat e Shoqërisë Civile	4 4

Burimi: KLSH

Sikurse është prezantuar edhe në raportimin e vitit të kaluar, **Fusha A, “Pavarësia dhe korniza ligjore”**, është vlerësuar nga Gjykata Austriake e Auditimit duke konkluduar se aktiviteti i KLSH-së ishte në përputhje me: Deklaratën e Limës, Deklaratën e Meksikës si dhe Standardin Ndërkombëtar të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) nr.11. Ekspertët ndërkombëtar kanë rekomanduar, gjithashtu, përmirësime të kuadrit ligjor për forcimin e pavarësisë reale, kryesisht të asaj financiare. Eksperienca e KLSH-së për arritjen e pavarësisë reale është konsideruar si *“best practice”* dhe ka qenë pjesë e prezantimeve dhe diskutimit në disa aktivitete ndërkombëtare si në Aktivitetin e 40-vjetorit të Deklaratës së Limës mbajtur në Peru, apo në konferencën e nivelit të lartë “Roli i Institucioneve të Auditimit në rritjen e Përgjegjshmërisë, Transparencës dhe Integritetit në Sektorin Publik” në Sofje, etj.

Pavarësisht se nga pikëpamja ligjore, KLSH ka mandat të mjaftueshëm dhe akses në informacion, gjatë aktivitetit auditues të viti 2019 ka patur raste të përgjigjeve kundërshtuese dhe mosdhënies së të gjithë informacionit të kërkuar duke ndikuar në këtë mënyrë në objektivitetin e opinionit të shprehur nga grupet audituese. ***Këto raste, janë tregues të papërgjegjshmërisë së drejtuesve të lartë të këtyre institucioneve, si AKU apo Njësia e auditimit të projekteve të BE-së.*** Për të rritur pavarësinë reale financiare si dhe adresimin e problematikave të hasura gjatë zbatimit të ligjit bazë, KLSH ka adresuar disa përmirësime ligjore Kuvendit të Shqipërisë duke synuar realizimin e plotë të misionit kushtetues.

Tërësia e treguesve që vlerësojnë aspekte të **Fushës B, “Qeverisja e brendshme dhe etika”**, identifikon se KLSH është drejtuar duke dhënë shembullin e mirë dhe për të qenë organizatë model, si dhe ka promovuar transparencën dhe llogaridhënien përmes mirëqeverisjes dhe sjelljes etike, në mënyrë që të përmbushet mandati i tij. Një nga aspektet kësaj fushe është edhe Dimensionit “Mjedisi i Kontrollit Organizativ”, SAI-4, i cili ka qenë objekt i vlerësimit nga një ekip vlerësuesish të institucioneve homologe i drejtuar nga Gjykata e Auditimit Hollandeze. Misioni i vlerësimit u realizua në muajin Shkurt 2020 dhe kishte si objekt sistemin e kontrollit të integritetit dhe të etikës. Procesi i vlerësimit u realizua në zbatim të metodologjisë së SAINT, i cili është zbatuar për të gjithë anëtarët e INTOSAI-t.

Vlerësimi i nivelit të maturimit të sistemit të kontrollit të integritetit ka përfshirë ekzistencën, zbatimin e funksionimin dhe performancën e kontroleve. Si konkluzion i përgjithshëm i vlerësimit ishte se niveli i maturimit të sistemeve të kontrollit të integritetit ishte i lartë, pra me vlerësimin maksimal, megjithatë mbeten disa aspekte për t’u përmirësuar, të cilat janë adresuar rekomandime. Nëpërmjet vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtar u mundësua të identifikohen aspekte të cilat kryesisht lidhen me komunikimin e objektivave të lidhur me integritetin, aktivitetin e sektorit të etikës dhe të integritetit dhe trajnimin e vazhdueshëm për aspekte të integritetit si pjesë përbërëse e edukimit të vazhdueshëm.

Duke adresuar aspektin e vulnerabilitetit/ mundësisë për të vepruar në shkelje të parimeve të integritetit dhe etikës, ekspertët rekomanduan mundësinë e rritjes së pagës, apo të dietave ditore, nëpërmjet rritjes së pavarësisë financiare, apo përfshirjen në treguesit e performancës së treguesit të vjetërsisë në një pozicion

konkret, trajnimet, apo publikimet në mediat, eksperiencë e cila është identifikuar nga departamenti i auditimit të performancës. Gjithashtu, menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të ndërtoj një plan konkret për zëvendësimin gradual të personelit në moshë pensioni me personelin e ri në mënyrë që të ketë një kalim gradual të detyrave dhe proceseve midis brezave.

Në vlerësimin e përgjithshëm të Fushës B, konkludohet se janë ndërmarrë hapa për të siguruar një qeverisje të mirë duke adoptuar dhe vepruar në përputhje me parimet e mirëqeverisjes, në të gjitha aspektet e punës së tij. Është e rëndësishme që kjo përgjegjësi është pranuar në mënyrë të qartë në nivel të lartë të menaxhimit dhe është reflektuar në qeverisjen e KLSH dhe që është ndjekur në të gjithë institucionin.

KLSH ka përmirësuar dimensionin e përmbajtjes së planit strategjik duke hartuar dhe zbatuar “Metodologjinë e planifikimit strategjik dhe vjetor të aktivitetit auditues bazuar në risk”<sup>14</sup>. Por mbetet për tu përmirësuar në disa aspekte të tilla si:

- përfshirja në planin vjetor të treguesve të matshëm në nivel produkti dhe rezultati;
- konsultimi me palët e interesit të planit vjetor të parashikuar;
- ndjekja e shikueshmërisë publike dhe matja e ndikimit përmes reagimeve të jashtme në përputhje me ISSAI 20:6; apo
- aspekte të ndërtimit të sistemeve që marrin në konsideratë risqet të lidhura me cilësinë, të cilat lindin gjatë funksionimit (sipas ISSAI 40, fq 8).

**Fusha C, “Cilësia e auditimit dhe raportimi”,** mbulon tre llojet e auditimit që realizon nëpërmjet aktivitetit auditues KLSH, përkatësisht: auditimin financiarë, performancës dhe përputhshmërisë. Gjithashtu, vlerëson cilësinë dhe rezultatet e punës së auditimit, nëpërmjet dimensioneve që përfshijnë tre aspektet: *Parimet*, *Proceset* dhe, *Rezultatet*. Sistemi analitik i treguesve sipas dimensioneve mundëson të realizohet analiza e shkaqeve të “rrënjës” duke identifikuar qartësisht se çfarë masash duhet të ndërmerren për një përmirësim real të aspekteve audituese. Kështu, sistemi i vlerësimit tregon se mbetet shumë për të bërë në lidhje:

- me dimensionet e mbulimit me auditim financiar,
- mbulimi dhe përzgjedhja e objektivave të auditimit të performancës,
- përcaktimi i qartë i materialitetit dhe të riskut në tërësi për çdo auditim si dhe për elemente të veçanta të tij,
- përzgjedhja e kampionit,
- hartimi i raportit në një formë më shkurtër dhe lehtësisht i kuptueshëm.

Të gjitha këto aspekte përbëjnë sfidat e vitit që ka filluar.

**Fusha D, “Menaxhimi financiar, asetet dhe strukturat mbështetëse”,** tregoi se KLSH ka një menaxhim organizativ të përshtatshëm dhe struktura mbështetëse që sigurojnë një qeverisje të mirë, dhe që mbështetin kontrollin e brendshëm dhe praktikën e menaxhimit (në përputhje me kërkesat e ISSAI 12, Parimi 9). Kjo gjetje

---

<sup>14</sup> [http://www.klsh.org.al/web/metodologjia\\_e\\_planifikimit\\_4430.pdf](http://www.klsh.org.al/web/metodologjia_e_planifikimit_4430.pdf)

është gjithëpërfshirëse si për menxhimin e aseteve dhe të shërbimeve mbështetëse të institucionit.

**Fusha E, “Burimet Njerëzore dhe Trajnimi”**, tregon performancën e KLSH-së në menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, duke siguruar që trupa audituese të ketë kualifikim të mjaftueshëm, zhvillim profesional dhe përditësim të njohurive mbi standardet dhe metodat e auditimit, si dhe ka qasje strategjike të zhvillimit profesional. Aspektet të cilat duhet ti përgjigjen më mirë standardeve lidhet me zhvillimin e një portofoli trajnimesh bazuar në specifikat dhe kompetencën individuale të audituesit. KLSH, synon kryesisht rritjen e kapaciteteve të lidhura me auditimet financiare dhe me përdorimin e teknologjisë së informacionit në mbështetje të aktivitetit auditues.

**Fusha F, “Komunikimi dhe menaxhimi i palëve të interesit”**, është vlerësuar në përputhje me kërkesat e ISSAI 12, dhe identifikon një nga objektivat kryesore të KLSH-së, demonstrimi i rëndësisë së tij të palët e interesit. KLSH ka përdorur të gjitha instrumentet e rekomanduara nga praktikantët më të mira me qëllim që të rriten njohuritë e palëve të interesit për të kuptuar rolin dhe përgjegjësinë e audituesit të pavarur të sektorit publik. KLSH, ka identifikuar palët e interesit dhe ka zhvilluar strategjinë e komunikimit duke përsosur kanalet e komunikimit dhe menaxhimit për të përfshirë të gjithë palët e interesit.

Në vlerësimin e përgjithshëm të kësaj fushe KLSH ka patur një performancë në rritje në vitin 2019 kundrejt vitit 2018. Aspektet që kanë ndikuar në këtë nivel të ri të vlerësimit nga 3 në 4 të fushës F lidhet me rritjen e prezencës së audituesve në mediat vizive duke bërë transparente problematikat e identifikuara në auditimet e realizuar prej tyre, kryesisht të Departamentit të Auditimit të Performancës, si dhe është përmirësuar ndjeshëm bashkëpunimi konkret me Kuvendin e Shqipërisë si në aspektin e rritjes së numrit të vendimeve të Kryetarit të KLSH-së dhe të raporteve të auditimit të përcjella, por kryesisht në bashkëpunimin e ngushtë midis KLSH, Departamentit të Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhëniet me Jashtë, dhe Departamentit të Monitorimit të Institucioneve të Pavaruara, në Kuvendin e Shqipërisë, në lidhje me vënien në eficiencë të sistemit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e ekzekutivit. Gjatë vitit 2019 janë përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë 131 vendime dhe raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2018 dhe 135 vendime e raporte auditimi për auditimet e kryera gjatë vitit 2019.

Në kuadër të rritjes së transparencës, KLSH ka publikuar në WEB, vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për 124 vendime auditimi nga 140 auditime të kryera gjatë vitit 2019. Në faqen zyrtare të KLSH gjenden të gjitha raportet që janë hartuar dhe përgatitur nga KLSH gjatë vitit 2019 të tillë si: Raporti i Aktivitetit, Raporti i Buxhetit, Raporti i Monitorimit dhe Buletinet Statistikore.

Gjatë vitit 2019, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe aktivitetin e KLSH në një numër prej 405 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike.

Aspektet që vazhdojnë të përbëjnë sfidë edhe për vitin që ka filluar do të jetë vlerësimi i impaktit që ka KLSH tek palët e interesit, ku rëndësi të veçante merr forcimi i bashkëpunimit me Ekzekutivin dhe Legjislativin për të rritur shkallën e

zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së nëpërmjet përdorimit të instrumentave të ndërtuara në bashkëpunim me këto institucione.

Analiza bazuar në treguesit e mësipërm tregon jo vetëm pikat e forta të performancës së KLSH-së, të cilat kryesisht konsistojnë në dimensionet e pavarësisë institucionale dhe financiare, në menaxhimin e proceseve të brendshme, në ngritjen dhe efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm; udhëheqjen dhe komunikimin; publikimin e rezultateve të auditimeve financiare, performancës e përputhshmërisë; menaxhimin financiar; shërbimet administrative mbështetëse etj, por identifikojnë edhe pikat më të dobëta të performancës së institucionit, të cilat sikurse paraqiten edhe në tabelën e mësipërme janë vlerësuar me 2 pikë (ku vlerat e pikëzimit janë nga 0-4). Aspektet që kërkojnë përmirësime të mëtejshme konsistojnë kryesisht në dimensionet që lidhen me kuptimin dhe implementimin e plotë të standardeve të auditimit të përputhshmërisë dhe financiarë, apo me zbatimin e auditimeve të performancës, të vlerësuara këto në mënyrë të detajuar kundrejt të gjithë standardeve specifike të nivelit të tretë dhe të katërt të ISSAI 200, 300 dhe 400. Aspektet e vlerësimit të riskut si bazë për përcaktimin e materialitetit jo në tërësi por për elemente të veçanta të planifikimit dhe të programimit të auditimeve, përbëjnë një sfidë me të cilën kemi filluar të përballemi që në fillimet e vitit 2019, dhe që do të jetë një proces i gërshetuar me përmirësimet metodologjike në tërësi.

Niveli i detajuar i treguesve si dhe referencat në dokumente, manuale apo standardet e praktikave më të mira, përbëjnë një rrugë të qartë për KLSH, në përballimin e sfidave për një zhvillim të konsoliduar jo vetëm afatshkurtër por edhe afatmesëm në përmbushje e objektivave që rrjedhin nga Kushtetuta dhe Ligji.

## **IV.2 Implementimi i Strategjive**

### ***IV.2.1 Monitorimi i Strategjisë së Zhvillimit 2018-2022***

Viti 2019 shënoi vitin e dytë të zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën 2018-2022.

Objektivat strategjikë të institucionit kanë avancuar dhe ecur paralel me objektivat e Planeve Strategjike 2017-2023 të EUROSAT-t dhe 2017-2022 të INTOSAT-t, dy organizatat e komunitetit të institucioneve supreme publike të auditimit në Evropë dhe botë. Monitorimi i zbatimit të kësaj Strategjie ka sjellë konsolidimin e reformës institucionale në KLSH dhe e ka rankuar dhe vendosur KLSH në panelin e institucioneve bashkëkohore e të përparuara të komunitetit të auditimit të jashtëm në Evropë. Bazuar në nivelin e treguesve të Kornizës së Matjes së Performancës së një Institucioni Suprem Auditimi, (dokument i miratuar si standard ISSAI në Kongresin e XXII të INTOSAT-t), rezulton se, objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit 2018-2022, për dyvjeçarin 2018-2019 janë realizuar në nivelin relativ prej 89 %.

Për qëllim implementimi dhe monitorimi, plani strategjik i KLSH 2018-2022 është i ndarë në 3 prioritete strategjike (qëllime makro), që detajohen më tej në një rrjet prej 21 objektivash themelore specifike, të integruara dhe shtjelluara analitikisht më tej në 73 aktivitete, nënobjektiva dhe procese kapilare. Këto 73 aktivitete dhe nënobjektiva formësojnë bazamentin e kësaj strategji dhe nga këto, vetëm 69

aktivitete dhe veprimtari i përkasin mbulimit të spektrit kohor 2018-2019, kurse 4 aktivitete obligohemi ti zbatojmë pas vitit 2020. Nga analiza e kryer për monitorimin e Plan Veprimit të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH (miratuar me datë 24.4.2018), rezulton se në fund të vitit 2019, 95 % e aktiviteteve janë realizuar në masë të plotë ose vijon procesi i realizimit të grafikuar sipas afateve të parashikuara.

Kjo matricë tregon rrugëtimin e detajuar të veprimtarisë së institucionit tonë, për të implementuar strategjinë, aspekte këto që ndiqen çdo ditë, monitorohen dhe raportohen intensivisht sipas afateve të përcaktuara nga departamentet dhe strukturat përgjegjëse. Më lejoni të theksoj se, mosarritja prej 2 % e disa indikatorëve të Strategjisë Sektoriale, është kushtëzuar nga faktorë objektivë jashtë institucionit tonë, që ndërlidhen dhe kushtëzojnë ritmin e këtyre avancimeve në reformë. KLSH ka programuar disa indikatorë dhe aktivitete të ndërvarur nga veprimi i legjislativit, meqenëse në kohën e hartimit të Strategjisë së KLSH-së, besimi ynë ka qenë për veprime më energjike nga ana e Kuvendit të Shqipërisë për këto ndryshime e përmirësime ligjore të domosdoshme të rekomanduara prej nesh. Në një analizë të fundit, aprovimi i këtyre ndryshimeve sjell përafrimin më të plotë të legjislacionit e fushës së auditimit shtetëror me kërkesat e kuadrit "Acquis Communautaire", arsye kjo që na ka detyruar tu drejtohem sërish strukturave shtetërore kompetente duke ridizajnuar dhe përcaktuar afate të reja për implementimin e këtyre nënobjektivave dhe aktiviteteve.

Strategjia e Zhvillimit Institucional të KLSH për pesëvjeçarin 2018-2022 është ngritur mbi tri kolona që shënojnë dhe tre qëllimet prioritare mbi këndvështrimet e mëposhtme:

1. Rritja e impaktit të punës audituese me fokus 6-E.
2. Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.
3. Forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.

Më hollësisht zhvillimi dhe implementimi i komponentëve të këtij dokumenti është si më poshtë:

☞ Në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022, Objektivi i Parë Strategjik lidhet me rritjen e impaktit të punës audituese me fokus 6-E.

Në epiqendër të këtij qëllimi është forcimi i pavarësisë institucionale të KLSH. Aktualisht, KLSH ka një ligj organik bashkëkohor dhe tërësisht në përputhje me standardet e INTOSAI-t, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në fund të vitit 2014, me ndihmën e ekspertizës së Bashkimit Evropian. KLSH fokusoi përpjekjet për zhvillim institucional duke vendosur si qëllim të parë strategjik forcimin e pavarësisë në akord me parimet themelore të "*magna carta-s*" së auditimit, Deklaratës së Limës dhe Deklaratës së Meksiko-s, nëpërmjet përmirësimit të bazës rregullatore të tij, fakt i pranuar edhe nga autoritetet e ndryshme evropiane.

Kështu, referuar raport progresit të KE për Shqipërinë, datë 26.5.2019, kapitulli 32 "Kontrolli Financiar", (faqe 99) në lidhje me këtë aspekt theksohet se:

“Kwadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (SAI), në linjë me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI).<sup>15</sup>

Në linjë me këto prosperime, janë miratuar dhe janë në funksionim një kuadër i brendshëm rregullator administrativ e organizativ, së bashku me Manualet dhe udhëzuesit specifikë në funksion të zbatimit në praktikë të Standardeve ISSAI. Në dorë të audituesve të KLSH numërohen sot mbi 15 guida kryesore dhe manuale metodike sipas tipologjive të auditimit publik, që i shërbejnë zberthimi të panelit INTOSAI GOV në përditshmërinë dhe praktikën e punës audituese.

Zhvillimet profesionale dhe rritja e kapaciteteve audituese mbështetën fuqimisht angazhimet të ndërmarra për përmirësimin e cilësisë dhe shtimin e numrit të auditimeve të performancës.

Kwadri i ri ligjor dhe kushtetues ka zgjeruar gamën e auditimeve me lloje e tipologji të reja të përfshira me ligj, të pa njohura dhe të pa aplikuar gjer atëherë, (*si ato të performancës, të përdorimit të fondeve të BE-së, të teknologjisë së informacionit, të auditimit të mjedisit, auditimet e përbashkëta me partnerët etj*). Kështu, para pak vitesh u themeluan Departamentit e Auditimit te Performancës dhe ai i auditimit IT dhe për herë të parë iniciohen auditimet e IT (nga 2 angazhime të realizuara gjatë viteve 2015 dhe 2016, duke mbërritur në 7 auditime në vitin 2018).

Kështu startuan dhe morën kuptim në një terren të pashkelur, programimet e auditimeve të performances, meqenëse me miratimin e Ligjit 154/2014, KLSH u mandatua për të realizuar auditime performance në mënyrë eksplicite dhe specifike, me akses të pakufizuar, si në subjekte, ashtu edhe në informacion, sikurse dhe me të drejtën për të raportuar në Kuvend me auditime individuale performance. Për vitin 2019, numri i auditimeve të performancës u rrit me 6% në krahasim me vitin 2016, si dhe u dyfishua ndaj vitit 2014 duke arritur në 16 auditime të kësaj tipologjie

Me Objektivin e pare, KLSH provoi të kalonte me sukses sprovën drejt një zhvillimi ambicioz, atë të auditimeve në sistemet e teknologjisë së informacionit. si një lloj i veçantë i auditimi nëpërmjet të cilit, KLSH mbledh dhe vlerëson provat, për të përcaktuar nëse një sistem kompjuterik mbron asetet, ruan integritetin e të dhënave, lejon që synimet e subjektit që auditohet të arrihen në mënyrë efektive, duke përdorur burimet në mënyrë eficiente. Nën këtë objektiv, është krijuar Drejtoria e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe janë realizuar auditimet e para të këtij lloji, ndërkohë që është punuar për të miratuar kuadrin e plotë rregullativ dhe hartuar udhëzuesit metodologjik të nevojshëm, mbi të cilin realizohen auditime të tilla mjaft komplekse. Auditimet e IT në vitin 2014 nuk aplikoheshin ende, ndërsa sot numri i tyre ka arritur në 7 auditime të dedikuara këtij lloji të veçantë auditimi , ose me një rritje prej 3 herësh ndaj numrit të auditimeve IT të kryera në vitin 2015, kur ata startuan për herë të parë.

---

<sup>15</sup> [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al), Njoftime: Vlerësimet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian në Progres Raportin 2019

Qasja e institucionit në përmbushje të Objektivit të Dytë Strategjik, Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse , u udhëhoq nga parimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

✓ Në përmbushje të këtij Objektivit, institucioni ka rritur kontributin për qeverisjen e mirë për administrimin e burimeve publike, duke synuar rritjen e transparencës dhe të llogaridhënies, nëpërmjet thellimit të luftës kundër korrupsionit.

Në këtë plan, përgatitja e kallëzimeve dhe indicieve penale është konsideruar një gur themeli dhe një qëndrim konstant gjatë gjithë kësaj periudhe tetëvjeçare. KLSH nga auditimet e realizuara në vitin 2019 ka përcjellë **28 kallëzime** dhe indicie penale, dhe **2** janë në proces shqyrtimi dhe vlerësimi nga Departamenti Juridik në KLSH, për 40 drejtues të nivelit të lartë dhe të mesëm.

Veprat kryesore penale për të cilat akuzohen këta persona janë “Shpërdorimi i detyrës”, “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, por nuk mungojnë edhe akuza për “Falsifikim dokumentesh”, përveç sa janë rekomanduar masa disiplinore prej “Largim nga puna” dhe deri në “Vërejtje”, si për drejtues ashtu edhe për zyrtarë ekzekutiv.

Në epiqendër të këtyre kallëzimeve penale kanë qenë abuzimet me tenderat nga zyrtarët dhe entet publike e shtetërore, shpenzimet e pa-argumentuara dhe të ardhurat e munguara, abuzime me pronat publike e zyrtarë të korrumpuar, keqmenaxhimi i financave publike, abuzimet dhe shkeljet e ligjshmërisë me prokurimet dhe parregullsitë gjatë procedurave të shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore i kanë kushtuar buxhetit të shtetit një dëm prej 645 miliardë lekësh në dy vite, 2018-2019. Përkatesisht, në sektorin publik në përgjithësi dhe në mënyrë të veçantë në menaxhimin e financave publike, dëmi total për dy vitet e fundit arrin në shumën 363 miliardë lekë. Problematikat e shumta në procedurat e prokurimit në periudhën 2018-2019 kanë regjistruar dëm ekonomik në vlerën 2.8 miliardë lekë. Ndërsa në fushën e shitjes, blerjes dhe dhënies me qira të pasurisë shtetërore dëmi i shkaktuar buxhetit të shtetit i kalon 280 miliardë lekë. Të tjera fenomene që ushqejnë kategoritë e korrupsionit janë: krijimi i barrierave oligopolistike në ekonomi; ngathtësia dhe paafëzia burokratike; niveli i lartë i papunësisë dhe përpjekje fiktive për ta zvogëluar atë nëpërmjet hapjes së vendeve të reja të përkohshme të punës; niveli i përgjithshëm i çmimeve i krahasueshëm me vendet e zhvilluara evropiane, ndërsa niveli i pagave i krahasueshëm me vendet e pazhvilluara; potenciali ende i pa përmbushur i shoqërisë civile etj.

Të gjitha këtyre shkaqeve u duhet shtuar edhe fakti i krijimit të klimës së pandëshkueshmërisë së zyrtarëve të inkriminuar në praktika mashtruese dhe korruptive. Dënimet penale të parashikuara në legjislacionin tonë për korrupsionin nga zyrtarët publikë janë të përgjithshme dhe krijojnë hapësira për shmangie. Pikërisht për të eliminuar këto hapësira, ne si KLSH prej më se 7 vitesh i kemi propozuar qeverisë dhe Kuvendit të kalojnë ligjin “Mbi përgjegjësinë materiale të zyrtarëve të lartë dhe të mesëm publikë”, i cili do të intensifikonte më tej luftën ndaj korrupsionit. Thënë ndryshe “do të vendoste pikat mbi ‘i’”. Duhet theksuar se sfidat për realizimin e proceseve integruese dhe angazhimeve të Agjendës së vitit 2030 për

Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së (në këtë proces ne si Shqipëri jemi shumë mbrapa), kërkojnë bashkëpunim efektiv të të gjithë aktorëve dhe faktorëve kryesore në vend, me objektiv zhvillimin e qëndrueshëm të vendit përmes mirëqeverisjes, llogaridhënies dhe sinergjizimit të politikave dhe aksioneve kombëtare.

Në frymën e kultivimit të kulturës së të mësuarit gjithë jetës, janë mbështetur veprimtaritë tona të kualifikimit, edukimit dhe trajnimit profesional. Në fund të vitit 2019, audituesit e KLSH realizuar një mesatare prej 25 dite trajnimi / auditues. Treguesi kryesor i progresit reflektohet në rritjen e numrit të trajnimeve që çdo auditues ka kryer gjatë vitit, duke arritur një nivel të kënaqshëm prej 3611 ditë njerëz trajnime, ose referuar 145 audituesve efektive vjetore, rezultojnë 25 ditë trajnimi mesatare vjetore për auditues në vit, (kundrejt 2.1 të arritura në 2011 dhe 3.1 ditë trajnimi/person të kryer në vitin 2010), që shënon një rritje me 12 herë kundrejt vitit 2011, kur ky tregues raportohej, ndonëse ishte minimal.

Vetëm gjatë 5 viteve të fundit kanë marrë pjesë në trajnime, seminare e workshope, grupe pune e konferenca, etj., 654 auditues dhe drejtues gjithsej, të inkuadruar në 264 aktivitete. Internship-et janë konsideruar një mjet eficient për të ofruar njohuri mbi auditimin e fondeve të BE-së. Në total janë 23 auditues të KLSH-së që kanë fituar internship-et tek ECA. Bashkëpunimi i suksesshëm i iniciuar prej vitit 2012 me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA ka vazhduar me pjesëmarrjen të audituesve tanë në një fellowship 4 mujor pranë kësaj zyre dhe aktualisht e kanë përfunduar këtë program 6 auditues

¶ Nën Objektivin e Tretë Strategjik, KLSH ka integruar elementë modernë të komunikimit dhe ka miratuar Strategjinë e Komunikimit 2017-2019, duke synuar të përçojë zërin e qytetarit dhe të publikut nëpërmjet auditimeve dhe raportimeve për gjetjet dhe rekomandimet e tyre. Strategjia e komunikimit thekson marrëdhëniet e KLSH me publikun dhe Kuvendin, duke përfshirë edhe partnerë të tjerë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Sipas monitorimit të planit të veprimit të strategjisë së komunikimit rezultojnë që ajo është implementuar në masën 90%.

Objekti i tretë strategjik është orientuar dhe mbështetur në frymën e Parimit 8, të Standardit Ndërkombëtar të Auditimit ISSAI 20, që nxit dhe inkurajon transparencën dhe përgjegjshmërinë, ku nënvizohet se “SAI-et komunikojnë në kohë dhe gjerësisht mbi aktivitetet e tyre dhe rezultatet e auditimit përmes mediave, faqeve të internetit dhe me mjete të tjera”. Këtu mund të ndalemi në disa dimensione të prekshme :

✓ 1.Për periudhën shtatë-vjeçare 2013-2019 të gjithë audituesit e KLSH-së kanë botuar në total 764 artikuj në pothuajse në të gjitha gazetatat e vendit. Për të kuptuar dinamikën, mund të përmendim se për vitin 2019, 90 auditues, prej të cilëve rreth 30% janë auditues të rinj, kanë qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetatat me 122 shkrime. Shkrimet e audituesve janë botuar në 12 volume dhe përfaqësojnë fytyrën e punës sonë audituese për gjetje dhe problematika të dala gjatë auditimit duke i shërbyer drejtpërsëdrejti qytetarit.

✓ 2.Gjatë vitit 2019, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp të KLSH-së në një numër prej **405 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike**. Komunikimi dhe bashkëpunimi me median vijon me të njëjtën frymë dhe intensitet dhe të gjitha mediat janë ftuar të marrin pjesë edhe në analizat

vjetore të Departamenteve të auditimit, duke rritur në këtë mënyrë transparencën e veprimtarisë së KLSH-së.

✓ Gjatë tetë viteve të fundit KLSH ka nënshkruar 60 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 33 me OJF dhe Universitete Publike e Private, 17 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore. Bashkëpunime me profesoratin e Universiteteve është vlerësuar maksimalisht nga KLSH, duke bashkëpunuar ngushtësisht me personalitete të fushave të ndryshme, duke përfshirë një pjesë të tyre edhe në auditime specifike, që kërkojnë mendim më të specializuar. Kjo qasje bashkëpunimi me Universitetet konfirmohet edhe për vitin 2019, gjatë të cilit Kryetari i KLSH ka nënshkruar tre marrëveshje të reja bashkëpunimi me Universitete, përkatësisht me Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Universitetin “LOGOS” dhe “Albanian University”.

✓ Edhe në vitin 2019, në zbatim të një prej objektivave të Strategjisë së Komunikimit të institucionit, KLSH organizoi për të tretin vit radhazi Muajin e Hapur për qytetarët në datat 1 nëntor-6 dhjetor 2019. Gjatë muajit të hapur audituesit e KLSH-së morën pjesë në shumë aktivitete brenda dhe jashtë institucionit,

✓ Gjatë vitit 2019 ne kemi vendosur në WEB, në kuadër të rritjes së transparencës vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për auditimet e realizuara përgjatë vitit 2019, në masën 90% (janë vendosur 124 vendime auditimi nga 140 auditime të realizuara, (nuk janë vendosur sepse janë konfidencialë) dhe janë vendosur gjithashtu edhe raportet respektive të auditimit. Gjithashtu në faqen zyrtare të KLSH gjenden të gjitha raportet që janë hartuar dhe përgatitur nga KLSH gjatë vitit 2019 si Raporti i Aktivitetit, Raporti i Buxhetit, Raporti i Monitorimit dhe Buletinet Statistikorë. Për të qenë sa më afër publikut, KLSH publikon në faqen e saj zyrtare të gjithë librat e kolanës së saj të botimeve.

#### ***IV.2.2 Monitorimi Strategjisë së Komunikimit 2017-2019***

Strategjia e Komunikimit të KLSH-së, 2017-2019 dhe rezultatet e implementimit të kësaj strategjie kanë qenë shumë pozitive dhe kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e profilit publik të institucionit.

Implementimi me sukses i strategjisë së komunikimit ka ardhur si rezultat i veprimeve të bashkërenduara të të gjitha strukturave të KLSH-së sepse pavarësisht nga madhësia e një institucioni, ai formon një tërësi dhe vepron si i tillë. Është veprimi i bashkërenduar i departamenteve të ndryshme që kontribuon në arritjen e objektivave.

Monitorimi i zbatimit të kësaj strategjie është shumë i rëndësishëm dhe i dobishëm për KLSH-në sepse evidenton mënyrën se si janë përcjellë në media nga institucioni mesazhet kryesore të auditimeve dhe të propozimeve të KLSH-së për përmirësimin e qeverisjes.

KLSH ka realizuar monitorim e zbatimit të “Strategjisë së komunikimit të KLSH-së, 2017-2019” për të gjashtë objektivat e saj kryesore dhe ka konkluduar në rezultatet e mëposhtme :

**Objektivi Nr. 1: Rritja e profilit publik të KLSH-së dhe e të kuptuarit të misionit, vizionit dhe rolit të tij në shoqëri, për të forcuar besimin e qytetarëve tek institucioni.**

*Statusi i implementimit (Realizuar)*

Është rritur perceptimi i qytetarit dhe i opinionit publik për KLSH, duke krijuar për këtë institucion kushtetues përshtypjen e një institucioni të pavarur nga politika dhe strukturat qeveritare, si edhe të një institucioni që lufton korrupsionin dhe mashtrimin financiar.

Aktivitetet e realizuara nga KLSH në kuadër të zbatimit të planit të veprimit të strategjisë së komunikimit kanë ndikuar ndjeshëm në përmbushjen e misionit të KLSH-së për informimin e qytetarit, publikut dhe Kuvendit në lidhje me përdorimin e burimeve me ekonomicitet, efektivitet dhe efikasitet nga pushteti qendror dhe vendor dhe nga njësi të tjera publike. Vetëm gjatë vitit 2019, KLSH ka organizuar dhe realizuar aktivitetet e mëposhtme që kanë ndikuar në arritjen e objektivit nr.1:

**Rritja e Kolanës së botimeve të KLSH-së me 11 tituj të rinj;**

Çdo botim është i shoqëruar me fletëpalosje, të cilat përmbledhin në një gjuhë të thjeshtë përmbajtjen e librit, në mënyrë që mesazhi të jetë më i kuptueshëm për qytetarin;

Kolana e botimeve të çdo viti shoqërohet me botimin e katalogut, në të cilin jepet një përmbledhje e të gjithë titujve të botuar;

Analiza vjetore e institucionit dhe Analizat e Departamenteve, ashtu sikurse edhe në vitet e shkuara, u zhvilluan në prani të medias;

U organizua për të tretin vit radhazi “Muaji i Hapur” për qytetarët, gjatë të cilit qytetarët kishin mundësinë të vizitonin çdo dite institucionin, të njiheshin më nga afër me historikun e tij dhe të mund të merrnin përgjigje për çdo auditim, qoftë ai edhe në proces, nga audituesit e KLSH-së;

Të gjitha njoftimet për aktivitetet e zhvilluara gjatë 2019 brenda dhe jashtë vendit janë të vendosura në WEB-in e KLSH-së;

Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi në datat 5-6 nëntor 2019 në mjediset e Akademisë së Shkencave, Konferencën e Audituesve të rinj të KLSH-së “Young ALSAI”, me temë kryesore “Sfidat e Auditimit Publik në kontekstin e anëtarësimit të vendit në BE”;

Pothuajse të gjitha vendimet/raportet e auditimeve janë të vendosura në WEB-in e KLSH-së.

Audituesit e KLSH-së kanë qenë prezentë me 122 shkrime gjatë vitit 2019 në shtypin e përditshëm, etj.

**Objektivi Nr. 2: Shtimi i mjeteve të komunikimit të jashtëm të KLSH-së me qytetarët dhe grupet e ndryshme të interesit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të publikut.**

*Statusi i implementimit (Realizuar)*

Me zhvillimin e teknologjisë së informacionit, mundësitë e një institucioni publik për të aksesuar qytetarin, për ta informuar atë dhe për ta bërë pjesëmarrës në dhënien e opinioneve për aktivitetin publik të institucionit bëhen gati të pafundme. Kjo ka qenë një sfidë dhe për qeverisjen tonë publike, në të cilën KLSH ka synuar të luajë rolin e vet promovues dhe nxitës, për rritjen e transparencës, besimit të qytetarit në qeverisje dhe reduktimin e korrupsionit.

Iniciativat e ndërmarra nga KLSH në përmbushjen e këtij objekti përgjatë vitit 2019 :

Janë caktuar koordinatorët për marrëdhëniet me publikun dhe qytetarin pranë çdo departamenti auditimi, në mënyrë që mesazhi i auditimeve të jetë i qartë, i thjeshtë, dhe i kuptueshëm.

Në mënyrë të veçantë faqja zyrtare e KLSH-së ka zhvilluar objektiva të qarta, ofron informacion të mjaftueshëm, përmban informacion të saktë dhe të përditësuar, e mirë dizajnuar dhe siguron akses për një numër të madh të përdoruesve. Nëpërmjet faqes zyrtare qytetarët mund të përcjellin shqetësimet dhe ankesat e tyre në çdo kohë;

Çdo tre muaj përgatitet Buletini statistikor i auditimeve dhe publikohet menjëherë në faqen zyrtare (tre të tillë janë realizuar për vitin 2019);

KLSH publikon në faqen e saj zyrtare të gjithë librat e kolanës së saj të botimeve.

Raporti i Performancës së aktivitetit të KLSH-së është i vendosur në WEB-in e institucionit në gjuhën shqipe dhe angleze. Gjatë vitit 2019 janë realizuar dy botime : “Raporti i Performancës së KLSH-së për vitin 2018” dhe “ALSAI Performance Report 2018”.

Në datat 13-17 nëntor 2019, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në edicionin e XXII<sup>të</sup> të Panairit të Librit, në Tiranë, duke shënuar kështu për të shtatin vit radhazi një pjesëmarrje dinjitoze, duke u paraqitur me 109 botime përkundrejt 17 botimeve të vitit 2013, kur mori pjesë për herë të parë në këtë panair.

Organizim i leksioneve të hapura me studentë të Universiteteve të ndryshme të vendit me qëllim njohjen e tyre me misionin dhe rolin e institucionit. Realizuar gjatë gjithë vitit, veçanërisht gjatë analizave vjetore të realizuar në shkurt 2019 dhe muajit të hapur, zhvilluar gjatë muajve nëntor – dhjetor 2019. Ky bashkëpunim është pjese edhe e marrëveshjeve të bashkëpunimit që Kryetari i KLSH-së ka nënshkruar me Universitete të ndryshme. Vetëm gjatë vitit 2019 janë nënshkruar tre të tilla me : Universitetin “Logos”, “Albanian University” dhe Universitetin “Luigi Gurakuqi” në Shkodër.

Gjatë vitit 2019 KLSH ka bashkëpunuar me Qendrën për Emancipimin Ekonomik të Medias (UNECM) dhe si rezultat i këtij bashkëpunimi janë publikuar 11 numra të Revistës elektronike “Auditimi për qytetarin” në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. Gazeta elektronike “Auditimi për Qytetarin” ka sjellë në mënyrë periodike, me një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve më të rëndësishme të KLSH-së gjatë vitit 2019.

**Objektivi Nr. 3: Promovimi i rezultateve të auditimit të KLSH për të transmetuar tek opinioni publik rezultatet dhe dobitë e institucionit në përmirësimin e qeverisjes, përmes luftës kundër korrupsionit.**

*Statusi i implementimit (Realizuar)*

**KLSH është përpjekur të garantojë cilësinë e mesazhit të përcjellë në publik, në mënyrë që ai të jetë i qartë, i thjeshtë, tërheqës dhe i goditur. Për këtë, institucioni është mbështetur në :**

**Përgatitjen e njoftimeve për shtyp nga drejtuesit dhe audituesit më të mirë, për auditimet sensitive dhe me rëndësi për qytetarin, të cilët i janë bërë të njohur publikut përmes medias së shkruar dhe vizive, si edhe WEB-it të KLSH-së. Gjatë vitit 2019, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp të KLSH-së në një numër prej 405 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike;**

Gjatë vitit 2019, KLSH ka vendosur në WEB, në kuadër të rritjes së transparencës vendimet e plota të Kryetarit të KLSH-së për auditimet e realizuara përgjatë vitit, në masën 90% (janë vendosur 124 vendime auditimi nga 140 auditime të realizuara) dhe janë vendosur gjithashtu edhe raportet respektive të auditimit.

Në faqen zyrtare të KLSH gjenden të gjitha raportet që janë hartuar dhe përgatitur nga KLSH gjatë vitit 2019 si Raporti i Performancës së institucionit, Raporti i Auditimit të Zbatimit të Buxhetit, Buletinët Statistikorë, etj.

Prezencë e audituesve të KLSH-së veçanërisht nga Departamenti i Auditimit të Performancës në disa media vizive, me qëllim informimin e publikut në mënyrë të drejtpërdrejtë me rezultatet e auditimeve të përfunduara.

**Objektivi Nr. 4: Shtimi i komunikimit dhe ndërveprimit të KLSH-së me qytetarin, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në aktivitetet dhe tryezat e rrumbullakëta.**

*Statusi i implementimit (Realizuar)*

Me qeverisjen elektronike, qeveritë mund të bëhen më transparente në sytë e qytetarit, pasi mund ta vendosin informacionin menjëherë në dispozicion të tij në kohë reale dhe ta bëjnë lehtësisht të arritshëm për të. Në të njëjtën kohë, qytetarët gjithnjë e më shumë po përfshihen në çështjet e auditimit. Ata mund të bëhen “pjesëmarrës” në auditimet e KLSH-së, duke ofruar indicie apo opinione për një sërë çështjesh apo fushash problematike.

Për këtë objektivi, KLSH si rezultat i bashkëpunimit me USAID në projektin “Transparenca në sistemin Shëndetësor (implementuar në periudhën mars 2017-korrik 2019), ka zhvilluar dhe ka hapur dritare të reja komunikimi.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij projekti, ishte ai në drejtim të rritjes së transparencës, nëpërmjet rritjes së aksesit të qytetarëve tek informacioni, futjes së disa zgjidhjeve teknologjike për sistemin e ankesave nga qytetarët, si dhe përdorimin me efektivitet të të dhënave të hapura dhe treguesve të alarmit të kuq. Këto instrumente, për fusha me risk të lartë për korrupsion kanë qenë instrumentet konkretë të zhvilluara nëpërmjet këtij projekti, të cilat vijojnë të ndihmojnë në

rritjen e transparencës së institucionit, duke qenë më të hapur dhe më të përgjegjshëm ndaj qytetarit.

Konkretisht në faqen zyrtare të KLSH gjenden 4 nyje të reja komunikuese mes publikut dhe stafit të KLSH-së. Vendosja dhe zhvillimi i instrumentave ICT si në vijim: *Mekanizimi i Ankesave, Red Flags, Data Mining dhe Open Data*

Indicet e qytetarëve për problematika të ndryshme janë marrë në konsideratë nga KLSH ose në auditimet në proces (kur ka qenë e mundur) ose në auditimet që do të zhvillohen në këto subjekte në periudhat në vijim (në funksion të planit të auditimeve të institucionit).

***Objektivi Nr. 5: Konsolidimi i pjesëmarrjes së audituesve në opinion-dhënien në median e shkruar dhe kalimi gradual drejt dhënies së opinionit në emisionet televizive.***

*Statusi i implementimit (Pjesërisht)*

Kontributi i audituesve dhe drejtuesve të KLSH në median e shkruar është kthyer tashmë në pjesë të punës së tyre të përditshme. Për periudhën shtatë-vjeçare 2013-2019 të gjithë audituesit e KLSH-së kanë botuar në **total 833 artikuj në pothuajse të gjitha gazetat e vendit. Për të kuptuar dinamikën**, mund të përmendim se për vitin 2019, 90 auditues, prej të cilëve rreth 30% janë auditues të rinj, kanë qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 122 shkrime. Shkrimet e audituesve janë botuar në XII volume (volumi i XII u botua gjatë vitit 2019) dhe përfaqësojnë fytyrën e punës sonë audituese për gjetje dhe problematika të dala gjatë auditimit duke i shërbyer drejtpërsëdrejti qytetarit.

Drejtuesit dhe Audituesit e KLSH-së kanë qenë prezent në media, veçanërisht audituesit e Departamentit të performancës, lidhur me problematikat e dala nga auditimet e zhvilluara, por nuk është arritur ende të realizohet një emision mujor televiziv, dedikuar auditimit publik.

***Objektivi Nr. 6: Rritja e komunikimit të brendshëm në institucion dhe e shkëmbimit të informacionit mes drejtorive dhe departamenteve të auditimit.***

*Statusi i implementimit (Pjesërisht)*

KLSH ka zhvilluar dhe implementuar sisteme të avancuara të teknologjisë së informacionit në kuadër të modernizimit institucional:

Përdorimi i **modulit Intranet** të platformës informatike të KLSH-së. Ky modul është një platformë që funksionon si një rrjet kompjuterik i brendshëm, i cili shërben për të shkëmbyer informacione, dokumente dhe materiale të tjera që lidhen me detyrat funksionale, midis stafit auditues dhe administrativ të institucionit dhe ky modul funksionon duke zbatuar të gjithë kuadrin rregullator të institucionit. Aktualisht, me qëllim ofrimin e mbështetjes në kushte optimale të komunikimit të brendshëm institucional dhe ndjekjen e zbatimit të standardeve më të larta ndërkombëtare, KLSH po punon në drejtim të ri-dizajnit dhe ri-organizimit të këtij moduli, duke shfrytëzuar burimet njerëzore dhe logjistike të brendshme.

Që në fillim të vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019, KLSH përveç Intranetit ka implementuar me sukses **Sistemin e Informacionit për Mbështetjen dhe**

**Menaxhimi e Proceseve të Auditimit, të mbështetur në teknologji moderne Microsoft Hyper-V**, duke ofruar facilitete në përdorim dhe siguri të lartë në drejtim të konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit. Ky sistem ka shërbyer dhe vazhdon të shërbejë si një mjet shumë i dobishëm për mbështetjen e procesit kryesor të institucionit, procesin e auditimit.

Ky sistem funksionon si një bazë të dhënash modulare, dhe është tepër i adaptueshëm në varësi të nevojave të institucionit. Vlera e shtuar e këtij sistemi në kuadër të komunikimit të brendshëm qëndron në faktin se ai u jep mundësinë audituesve të KLSH-së ta aksesojnë atë nga çdo pajisje elektronike që ka akses në internet, duke i garantuar siguri maksimale, çka tejkalon çdo pengesë të mundshme në komunikim.

**Sistemi i Informacionit për Mbështetjen dhe Menaxhimi e Proceseve të Auditimit, i integruar me postën elektronike si dhe me modulën Intranet**, kanë ofruar mundësi të mëdha, të cilat janë shfrytëzuar maksimalisht nga institucioni, në kuadër të komunikimeve të brendshme, duke i dhënë mundësi audituesve të KLSH-së të shkëmbejnë dhe menaxhojnë një aset tepër të rëndësishëm të institucionit, informacionin.

KLSH është duke punuar për hapjen e profilit të institucionit në Facebook, duke ndjekur shembullin e suksesshëm të Departamentit të Auditimit të Performances, në mënyrë që të bëjë të njohur në një masë më të madhe të qytetarëve, kryesisht tek të rinjtë, misionin, vizionin dhe gjetjet e KLSH-së.

#### ***IV.2.3 Monitorimi Strategjisë së Menaxhimit të Riskut të KLSH-së***

Strategjia e Menaxhimit të Riskut të KLSH-së, e rishikuar, (SMR) është një prej dokumenteve bazikë të veprimtarisë menaxheriale të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 250 date 31.12.2018 .

Nëpërmjet implementimit të kësaj strategjie është mundësuar që komponenti i menaxhimit të riskut të jetë në themel të menaxhimit organizativ duke synuar identifikimin, vlerësimin, zbutjen, zvogëlimin e riskut për çdo veprimtari që kryen institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Monitorimi i Strategjisë synon nxitjen e zhvillimit duke u bazuar në rishikime të rregullta dhe procese të përditësimit të vlerësimeve të risqeve në varësi të ndryshimeve që paraqet ambienti strategjik ku vepron Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Menaxhimi i riskut në veprimtarinë menaxheriale institucionale dhe atë audituese është konsideruar si detyrë dhe përgjegjësi e çdo punonjësi në KLSH, të çdo niveli deri në hierarkinë më të lartë drejtuese.

KLSH përgjatë vitit 2019, vijoi me implementimin e strategjisë së menaxhimit të riskut, konsideruar boshti i sistemit të menaxhimit të riskut në institucion.

Menaxhimit të Riskut në KLSH kryhet bazuar në implementimin e kërkesave të ISSAI 9100 “Udhëzues për Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik- Informacion i zgjeruar për Menaxhimi e Riskut Institucional” dhe në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ”Për Menaxhimi Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.

Politika e Menaxhimit të Riskut, ka siguruar instalimin e përgjegjësive dhe linjave të raportimit brenda KLSH për menaxhimin e riskut, një komunikim efektiv dhe me përfshirjen aktive ekipit të menaxhimit të riskut, të udhëhequr nga drejtimi si dhe monitorim të progresit të SMR dhe rishikimin e procesit të menaxhimit të rrezikut në vazhdimësi.

Përgjatë vitit 2019 menaxhimi i riskut, ka siguruar një proces efektiv për të mbështetur vendimmarrje eficiente, bazuar në vlerësime të vazhdueshme të rezultateve, ka planifikuar dhe menaxhuar me efektivisht burimet në dispozicion, si dhe ka mundësuar vendosjen e prioriteteve dhe ndërmarrjen e veprimeve me të domosdoshme.

Si një mjet për planifikimin strategjik, KLSH ka përdorur Analizën SWOT për të vlerësuar fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që janë pjesë e veprimtarisë së saj, pra çka ekziston në kushtet aktuale dhe që kanë apo mund të kenë impakt të konsiderueshëm në aspiratat dhe qëllimet strategjike të institucionit. Në Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të rishikuar, KLSH ka identifikuar risqet kryesore, të jashtme dhe të brendshme, risqet e menaxhimit institucional dhe risqe të punës audituese, kriteret për përcaktimin e risqeve madhore; mekanizmat e riskut si dhe kriteret për matjen e riskut, në përputhje me politikën e KLSH-së.

Një rol kryesor për funksionimin e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut është ekipi i menaxhimit të riskut i cili është ngritur dhe funksionon në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator.

Anëtarët e Ekipit të Menaxhimit të Riskut, bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me titullarët e njësive strukturore, Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive respektive në funksion të përmbushjes së përgjegjësive menaxheriale në të gjithë procesin e identifikimit, vlerësimit, monitorimit të riskut me qëllim kryesor përmbushjen e objektivave të Departamentit/Drejtorisë si dhe të objektivave institucionale.

Bazuar në objektivat strategjike të KLSH-së dhe risqet që pengojnë përmbushjen e këtyre objektivave, është hartuar i Regjistrit të Riskut të KLSH-së, të paraqitura sipas shkallës së mundësisë së ndodhjes dhe pasojave të riskut.

Ky dokument përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit, metodën sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore.

Ekipi i Menaxhimit të Riskut ka kryer analizën e regjistrit të riskut duke observuar dhe rivlerësuar risqet për periudhat në vijim. Rivlerësimi i risqeve i shërben ndërgjegjësimit të menaxhimit të lartë, duke adresuar veprimet që duhet të ndërmerren për shmangien e ngjarjeve të rastit të padëshiruara. Në nivel Drejtorie ai i shërben stafit auditues për të rritur cilësinë e punës, duke përmirësuar procedurat e planifikimit.

Regjistri i Riskut, përfaqëson një dokument të projektuar në formën e matricës monitoruese, në të cilin evidentohet informacion mbi riskun e identifikuar, riskun e qenësishëm (para kontrolleve) dhe riskun pas kontrolleve duke evidentuar gjithashtu nevojën për kontrolle të mëtejshme.

Sa më sipër KLSH, konsideron se Strategjia e menaxhimit të Riskut, implementimi dhe monitorimi i kësaj Strategjie përbën boshtin kryesor të menaxhimit të veprimtarisë institucionale në funksion të përmbushjes së objektivave të Strategjisë së Zhvillimit institucional 2018-2022.

### **IV.3 Progresi i menaxhimit institucional**

#### **IV.3.1 Analiza SWOT e KLSH-së**

Analiza SWOT<sup>16</sup> është një nga instrumentet menaxheriale që stafi drejtues i KLSH-së përdor në identifikimin e faktorëve potencialisht ndikues mbi objektivat e synuara dhe në asistimin e vendim-marrjes për përmbushjen e tyre. Në raste të caktuara implementohen teknika të tjera menaxheriale si: **PESTLE** (faktorët politikë, ekonomikë, socialë, teknologjikë, ligjorë dhe mjedisorë) apo **Balance Scorecard**.<sup>17</sup>

Analiza kryhet çdo vit, në rang institucional dhe departamental, për të qartësuar dhe unifikuar perceptimin e mjedisit brenda dhe jashtë sferës ndikuese të KLSH-së.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2019, analiza SWOT, në trajtë të zgjeruar, konstatoi dhe rikonstatoi:

#### **FUQITË**

1. **Mandat i qartë kushtetues** – Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në pjesën e XIV-të të saj, nenet 162-165, përcakton në mënyrë të qartë, eksplicite dhe pa ekuivoke pavarësinë institucionale, fokusin e punës dhe detyrat funksionale, si edhe pozicionin e Kryetarit të KLSH-së në marrëdhëniet me organet më të larta

---

<sup>16</sup> “**Analiza SWOT**” është instrument strategjik në duart e menaxhimit të institucionit që analizon fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet e ndërmarrjes në raport me konkurrentët ose tregun në përgjithësi. Realizimi i analizës SWOT qoftë edhe për institucionet e vogla ndikon në të kuptuarit e gjendjes së ndërmarrjes dhe veprimi drejt gjetjes së mundësive për përmirësimin e kësaj gjendje nënkupton rritjen e performancës së aktiviteteve.

#### **Si realizohet analiza SWOT ?**

Për të realizuar një SWOT analizë të suksesshme duhet që të identifikohet qartë fusha e realizimit të analizës me qëllim që ajo të jetë sa më reale dhe sa më e dobishme. Nëse qëllimi është që të shihet raporti mes kompanisë dhe disa konkurrentëve të caktuar, atëherë hapi më i mirë është fillimisht identifikimi i konkurrentëve dhe pastaj realizimi i matjeve në raport me secilin konkurrent. Në mënyrë analoge kryhet analiza edhe sa i përket segmenteve të caktuara të tregut. Realizimi i një analize të përgjithshme duke i marrë për bazë analizat specifike do të jepte një pasqyrë të biznesit në përgjithësi, kurse realizimi i kësaj analize pa analiza specifike si bazë do ishte më e komplikuar dhe më pak preciz.

Pas caktimit të fushës së analizës, duhen identifikuar të gjithë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në performancën e ndërmarrjes. Faktorët e jashtë klasifikohen si mundësi dhe kërcënime (*opportunities and threats*) dhe janë jashtë kontrollit menaxherial të institucionit. Faktorët e brendshëm klasifikohen si fuqi dhe dobësi (*strengths and weaknesses*) dhe mund ndikohen direkt ose indirekt nga institucioni. Qëllimi final është balancimi i faktorëve të jashtëm me ata të brendshëm për të maksimizuar suksesin. Ky balancim realizohet përmes strategjisë e më tej përmes planeve taktike e atyre operacionale. Një drejtues vizionar është i aftë të shndërrojë kërcënimet në mundësi dhe dobësitë në fuqi.

<sup>17</sup> **Balanced scorecard** është një sistem menaxhimi dhe planifikimi strategjik, që përdoret në mjediset e biznesit dhe industriale, institucionet qeveritare dhe OJF për të sinkronizuar aktivitetet operacionale me vizionin dhe strategjinë organizative, përmirësuar komunikimin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe kontrolluar e monitoruar realizimin e planeve dhe politikave.

shtetërore të RSH-së. Një mandat i tillë është baza e punës audituese, që për kryefjalë të saj ka pavarësinë, objektivitetin, paanësinë dhe profesionalizmin e opinionëve që jep në tipe të ndryshme auditimesh.

**2. Pavarësia e sanksionuar përmes një mandati të qartë dhe të fuqishëm, në bazë të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”** – Ligji i ri Institucional, miratuar pas debatesh të shumta në Komisionet Parlamentare në Nëntor të vitit të kaluar, zgjeron duke përpunuar, detajuar e plotësuar pavarësinë institucionale të shprehur në Kushtetutë. Ligji zgjeron më së pari sferën audituese të KLSH-së, duke prezantuar dy tipe bashkëkohore auditimi, atë të performancës dhe teknologjisë së informacionit. Përdor në mënyrë të përkëmbyer termin “kontroll” me termin “auditim”, në përjasje me standardet ndërkombëtare audituese dhe praktikën më të mira të SAI-eve homologe. Specifikon aksesin në grumbullimin, analizimin dhe publikimin e informacionit, përfshirë edhe atë konfidencial. Adreson transparencën në marrëdhënien me të tretët dhe thekson etikën e integritetit profesional të punonjësve dhe ekspertëve të KLSH-së.

**3. Vizion dhe Plan Strategjik të miratuar dhe implementuar në kohë** – vizioni strategjik institucional, formuluar në planin strategjik, synon që KLSH të përmbushë maksimalisht rolin e vet kushtetues, atë të rritjes së përgjegjshmërisë për të gjithë komunitetin të cilit i shërben. Për përmbushjen e këtij vizioni, KLSH ka formuluar planin strategjik 2018-2022, do ta përditësojë atë në 2020-n dhe e ka detajuar me Planin e Veprimit 2018-2022. Plani strategjik ka formuluar objektiva të cilat adresojnë kuadrin ligjor dhe rregullativ, rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike në funksion të përmirësimit të auditimit, luftën ndaj korrupsionit, impaktin në Kuvend, Qeveri, palë interesi dhe publik, etj. Po kështu, strategjia e zhvillimit institucional të KLSH-së 2018-2022 konvergjon me strategjinë e INTOSAI-t 2017-2022 dhe atë EUROSAI 2018-2023.

**4. Kornizë rregullative dhe udhëzuese nën frymën INTO SAINT, për të promovuar integritetin, si karakteristikë kyçe e besimit të perceptuar nga Kuvendi dhe palët e interesit** – KLSH ka miratuar dhe po përditëson Rregulloren Institucionale, e cila vjen në frymën e Into SAINT. Into SAINT është një instrument vetë-vlerësimi që SAI duhet ta përdorë për vlerësimin e risqeve ndaj integritetit dhe maturitetit të sistemeve për të menaxhuar këto risqe. Rregullorja institucionale, sëbashku me Kodin e Etikës, përdorin këtë taktikë menaxheriale për të dizajnuar një politikë adekuate integriteti, duke rritur ndërkohë ndërgjegjësimin e stafit auditues në këtë drejtim.

**5. Lidërsip nëpërmjet shembullit, transformues dhe me inteligjencë emocionale në rang institucional dhe departamental** – Stafi drejtues i KLSH-së është pjesë integrale e rutinës së përditshme audituese, duke vënë në jetë moton e INTOSAI-t: “Nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë”. Udhëheqja përmes shembullit forcon frymën e grupit, shërben si faktor motivues dhe rrit besimin e transparencën e ndërsjellë epror-vartës dhe midis kolegësh. Ineteligjenca emocionale mundëson komunikimin e sinqertë, diversitetin e vlerave dhe qëndrimeve, optimizmin dhe empatinë.

**6. Strukturë e qartë formale dhe e shtresëzuar optimalisht në 2 linja autoriteti dhe 3 nivele vendim-marrëse** – Organizimi hierarkik i autoritetit në një organizatë është kritik në ndarjen e roleve dhe përgjegjësi, menaxhimin e integritetit profesional e personal, si dhe suksesin e organizatës si të tërë. Në

përputhje me frymën IntoSAINT, në KLSH ekzistojnë dy linja vertikale hierarkike: një për funksionet primare audituese dhe një për funksionet mbështetëse. Secila linjë është e ndarë në 3 nivele vendim-marrëse: 1. Kryetari, 2. Zëvendës Kryetari (u shtua në strukturë), Sekretari/Drejtori i Përgjithshëm dhe 3. Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive. Një shtresëzim i tillë është fleksibël, optimalisht burokratik dhe mundëson rrjedhjen e shpejtë dhe formale të informacionit.

**7. Menaxherë me grada shkencore, përvojë të gjatë institucionale dhe njohuri të thelluara në fushën e auditimit** – Niveli i lartë dhe i mesëm drejtues në KLSH ka të punësuar profesorë të asociuar në lëmin e jurisprudencës dhe ekonomisë, doktorë shkencash dhe një sërë zyrtarësh të tjerë me master shkencor apo profesional në fushën e shkencave sociale, ekonomike, juridike, komunikimit, etj. Drejtuesit e departamenteve apo drejtorive kanë minimalisht mbi 5 vjet që okupojnë këto pozicione dhe një pjesë e tyre vijnë nga bota akademike, ndërsa pjesa tjetër kanë avancuar gradualisht në këto poste brenda KLSH-së, duke investuar punë dhe përkushtim për një periudhë kohore mbi 15-vjeçare.

**8. Standarde Ndërkombëtare Auditimi që aplikohen drejtpërsëdrejti në punën audituese** – KLSH mbështetet në ISSAI-et për përmbushjen e funksionit të vetë primar auditues. Një qasje e tillë parametrizon punën audituese, e bën atë të krahasueshme dhe lexueshme nga partnerët e huaj, rrit besimin në palë interesi dhe profilin në mjedisin e jashtëm. Standardet Ndërkombëtare janë përkthyer, përshtatur, publikuar dhe përditësuar nga vetë KLSH, si pjesë e transparencës dhe përgjegjshmërisë në punën e saj audituese.

**9. Auditues me përvojë dhe formim të larmishëm akademik** – Stafi auditues i KLSH-së dominohet nga ekonomistë, juristë, inxhinierë të fushave të ndryshme dhe plotësohet vazhdimisht edhe me sociologë, informaticienë, gazetarë, etj. Spektri i gjerë i formimit të audituesve shton perspektivat në trajtimin e problematikave audituese, sidomos në auditimet e performancës, apo të auditimeve që përmbajnë elementë të performancës. Eksperiencia në auditim është kritike në gjenerimin e një gjykimi të shëndoshë dhe ruajtjen e skepticizmit profesional, sikurse kërkohet nga standardet audituese.

**10. Kryerja e auditimeve të përbashkëta dhe paralele me SAI me përvojë në fushën e auditimeve të performancës dhe të tjera** – KLSH ka shtuar së tepërmi bashkëpunimet me SAI-et e tjera rajonale dhe europiane në funksionin auditues. Departamenti i Auditimit të Performancës ka kryer auditime paralele me SNAO-n, ECA-n, ZAP-in, SAI-n kroat, slloven, maqedonas, malazet dhe boshnjak. Bashkëpunimi në nivel profesional me kolegët e huaj është vital në implementimin e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave bashkëkohore audituese.

**11. Përfshirja në agjendën audituese të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara** – Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, problemet me të cilat ndeshet Shqipëria janë pjesë e problematikave më të gjera, të cilat kërkojnë qasje dhe zgjidhje globale, jo vetëm kombëtare apo të fragmentuara. Për t'iu përgjigjur me efektivitet sfidave të kohës, KLSH ka përfshirë në agjendën e saj të çdo niveli 17 objektivat dhe nënobjektivat pasuese të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm.

**12. Trajnim dhe edukim i vazhdueshëm me theks praktik i stafit** – Stafi i KLSH-së (auditues dhe mbështetës) duhet të përmbushë objektivin institucional prej 25 ditë trajnimi në vit, ku të paktën 5 ditë janë trajnim i pandërprerë për

çështje të caktuara. Trajnimit i nënshtrohen të gjitha nivelet e punonjësve në KLSH, pa dallim posti, senioriteti, etj. Trajnimi kryhet në bashkëpunim me ekspertë të huaj dhe vendas, të certifikuar në sferën e auditimit dhe/ose grumbullimit, analizimit dhe raportimit të informacionit.

**13. Shkëmbim i përvojave të auditimit dhe praktikave më të mira, nëpërmjet promovimit dhe analizës së vazhdueshme** – Departamentet audituese në KLSH, përmes mbledhjeve, workshopeve dhe punës në grupe raportojnë periodikisht për informacionet, subjektet dhe metodologjitë audituese. Shkëmbimi i informacionit përmes diskutimeve apo prezantimeve interaktive ndihmon procesin planifikues, auditues dhe raportues, duke gjeneruar njëkohësisht ide të reja.

**14. Mentorim i strukturuar i audituesve të rinj nga kolegë me përvojë** – Çdo auditues i lartë, kryeauditues dhe drejtor në KLSH ka nën mentorim një auditues të ri, për një periudhë 4-mujore. Një organizim i tillë pune ndihmon audituesit e rinj të integrohen më shpejt, ulin riskun e gabimeve, nxisin frymën e bashkëpunimit dhe krijimin e një klime profesionale dhe dashamirëse pune.

**15. Testime periodike të strukturuar për rifreskimin dhe shtimin e njohurive audituese me synim mbajtjen e postit aktual të punës dhe avancimin në karrierë** – Vendi i punës në KLSH është funksion linear i dijeve dhe aplikimit të suksesshëm të njohurive audituese. Përveç raporteve objektive, të balancuara dhe me impakt të gjerë në palë interesi, një mënyrë tjetër e promovimit të vlerave profesionale është testimi periodik i njohurive të nxëna përmes trajnimeve, studimit autodidakt dhe mentorimit nga auditues me përvojë. Testime të tilla kryhen minimalisht dy herë në vit dhe bëhen pjesë e dosjes personale të çdo audituesi, duke i shërbyer angazhimit të mëtjetshëm në funksionet audituese dhe të tjera.

**16. Implementim dhe aksesim online i të dhënave, përmes platformave të dedikuara të teknologjisë së informacionit** – KLSH, krahas përdorimit të platformave gjenerike virtuale për aksesim, shpërndarje dhe publikim të informacionit, ka implementuar me sukses sistemin **RevZone**, të përshtatur për punë audituese. Ky sistem ofron gjurmim në kohë reale të shkresave dhe evidencave audituese, sikurse na shpie një hap më pranë objektivit mjedisor për mjedis “*paperless*” brenda dhe jashtë KLSH-së.

**17. Shtim i botimeve profesionale dhe shkencore në lëmin e auditimit, si edhe prani e rritur në median e shkruar** – KLSH është përgjegjëse jo vetëm për evidentimin e vlerës së shtuar nga aktiviteti publik, por edhe për nxitjen e përgjegjshmërisë në menaxhimin e fondeve publike. Këtë aspekt edukues, institucioni e realizon ndër të tjera edhe përmes botimit të Revistës Shkencore “Auditimi Publik”, botimeve të artikujve në gazeta e revista brenda e jashtë vendit, si edhe organizimit apo pjesëmarrjes në konferenca shkencore dhe workshop-e me kolegë studiues, profesionistë dhe specialistë vendas dhe të huaj.

## **DOBËSITË**

**1. Vështirësi në implementimin e ISSAI-eve** – Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm të kuadrit ligjor e rregullativ, implementimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit mbetet ende një sfidë insitucionale. Vështirësitë qëndrojnë në studimin e kujdesshëm dhe integral të ISSAI-eve nga të gjitha strukturat brenda KLSH-së, interpretimin e tyre brenda kontekstit shqiptar të

auditimit të aktivitetit ekonomik publik, si edhe aksesit të kufizuar në informacion që shpeshherë ofrojnë subjektet nën auditim.

2. **Vështirësi në dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të subjekteve të audituara** – KLSH ende nuk jep opinion për pasqyrat financiare të subjekteve që auditohen financiarisht. Kjo për shkak të profesionalizmit ende të kufizuar të audituesve financiarë.

3. **Delegimi i dy apo më shumë detyrave paralele tek vartësit, duke sjellë shfokusim nga puna audituese** – Angazhimi në një sërë frontesh pune, për të rritur profilin dhe impaktin institucional ka bërë që punonjësit të angazhohen njëkohësisht në disa punë paralele. Ky shfokusim sjell vonesa, cilësi të dobët pune, demotivim, inefektivitet dhe rrit shanset për gabime.

4. **Perceptim jo i plotë dhe nga të gjithë i vizionit dhe strategjisë institucionale, nën frymën e kuadrit të përditësuar rregullator** – Punonjësit e KLSH-së kanë ende mangësi në kuptimin dhe ndarjen e të njëjtit vizion me eprorët, kolegët dhe veten e tyre përgjatë kohës. Dinamika e aktiviteteve institucionale, qarkullimi ndër-departmental, studimi i dobët i publikimeve profesionale dhe diferencat në formim, janë disa nga shkaqet e devijimeve nga vizioni i përbashkët.

5. **Studim i pamjaftueshëm i dokumenteve audituese dhe qasje jo e plotë ndaj problemeve të konstatuara** – Vërehet ende një studim sipërfaqësor dhe mekanik i evidencës audituese, mangësi në teknikat e mbledhjes dhe analizimit të informacionit, të cilat çojnë për rrjedhojë në një gjurmim jo të plotë të së vërtetës. Përgjithësisht ka një qasje reaktive dhe gjuhë pasive ndaj problemeve të konstatuara.

6. **Mungesë e aplikimit të auditimit me bazë risku dhe mangësi në metodologjinë audituese** – Auditimi është disiplinë e konsoliduar teorike dhe praktike, është një fushë dinamike dhe në ekspansion. Për rrjedhojë, metodologjitë e reja, tashmë lehtësisht të përdorshme edhe për shkak të teknologjisë së informacionit, duhen mësuar e aplikuar me përparësi. KLSH ka mangësi në këtë drejtim, një pjesë të trashëguara dhe një pjesë për shkak se stafi është rezistent ndaj ndryshimit të shpejtë dhe kërkon kohë të riorientojë aftësitë e veta, veçanërisht në auditimet e performancës ku kërkohet një qasje ndryshe për çdo auditim.

7. **Siguri e pamjaftueshme e kontrollit të cilësisë** – ISSAI 40 adreson ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të cilësisë. Në KLSH sistemi është ngritur, por për shkak të fluksit të madh të informacionit auditues, kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe mjedisit dinamik, kontrolli i cilësisë vazhdon të mbetet kritik në dhënien e sigurisë për raportet e auditimit, kjo veçanërisht në fushat e reja audituese.

8. **Mangësi në formulimin logjik të gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve** – Një raport auditimi duhet të jetë i balancuar, i argumentuar, objektiv dhe i shkruajtur me gjuhë të thjeshtë dhe nga perspektiva e lexuesit. Në KLSH mungon një njësi e specializuar për redaktimin kuptimor dhe letrar të raporteve të auditimit. Kjo dobësi është edhe rrjedhojë e problemeve në kontrollin e cilësisë.

9. **Kapacitete të pamjaftueshme në përpunimin elektronik të të dhënave** – Në KLSH është ngritur dhe përmirësuar vazhdimisht sistemi IT, përfshirë së fundmi edhe RevZone, por aksesimi, përpunimi, analizimi, ndarja, publikimi, protokollimi dhe inventarizimi elektronik i të dhënave lë ende për të dëshiruar. Faktorë

problematikë në këtë drejtim mbeten pjesërisht mosha e stafit dhe pjesërisht avancimi i shpejtë i teknologjisë së informacionit.

**10. Mospërputhja e konstatuar e trajnimeve me nivelin dhe perspektivën e audituesve** - Trajnimet jo gjithnjë i përgjigjen kërkesave dhe nevojave të audituesve. Pavarësisht se është ngritur dhe funksionon departamenti i trajnimeve dhe metodologjisë, numri i kufizuar i punonjësve të angazhuar në këtë departament nuk krijon mundësinë e përgatitjes dhe ndjekjes të një kalendari vjetor trajnimesh në përputhje me kategoritë e nevojave të audituesve. Po kështu, trajnimet e ofruar nga partnerët e huaj, jo gjithnjë i përshtaten nivelit dhe profilit të audituesve.

**11. Bazë të dhënash jo tërësisht e besueshme dhe e përditësuar e trajnimeve të stafit** – Kjo mangësi është rrjedhojë e kufizimit në kapacitete të departamentit të trajnimeve, aplikimit jo të duhur të teknologjisë së informacionit nga audituesit dhe mosevidentimit në kohë të ditëve, temave dhe lektorëve të trajnimit.

**12. Komunikim i izoluar i drejtorive mbështetëse me stafet audituese** – Drejtoritë mbështetëse, veçanërisht ato të Burimeve Njerëzore, Metodologjisë, Publikimeve, Kontrollit të Cilësisë, etj., duhet të rrisin komunikimin me stafet audituese të të gjitha niveleve. Përgjithësisht, komunikime të tilla inicijohen vetëm nga Kryetari.

## **MUNDËSITË**

**1. Mbështetje e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë** – KLSH gjithnjë është mbështetur nga partnerët ndërkombëtarë. Një tregues i rëndësishëm në këtë drejtim janë referencat dhe sugjerimet në Progres Raportet e BE-së për punën tonë institucionale. Kërkohet një rol gjithnjë e më i rritur i auditimit të jashtëm publik në luftën ndaj abuzimit ekonomiko-financiar, rritjes së kapaciteteve institucionale dhe përgjigjes së administratës ndaj rekomandimeve tona.

**2. Promovim i faktorëve motivues në vendin e punës** – Stafi drejtues i KLSH-së mund të përdorë më mirë dhe më me efektivitet faktorët e jashtëm motivues si: vlerësimi i aftësive, delegimi i përgjegjësisë, avancimin në karrierë, shpërblimin moral dhe material.

**3. Rritja e frymës së grupit në vendim-marrje** – Në vijim të faktorëve motivues, vendim-marrja konsensuale i shërben ndarjes së të njëjtit vizion, përkushtimit më të madh në punë dhe rritjes së shanseve për sukses.

**4. Perceptim unik i zinxhirit të vlerës në administratën publike** – Për shkak të mandatit ligjor dhe aksesit në informacion, KLSH ka një mundësi unike në përfitim të një panorame të plotë të aktivitetit ekonomik publik. Kjo panoramë i krijon mundësi KLSH-së të ngrejë një bazë të dhënash në nivel kombëtar, bëjë analiza makro-ekonomike dhe faktorizohet në dhënien e konsulencës gjatë vendim-marrjes publike.

**5. Rritje e impaktit në publik, për shkak të kufizimit të ndikimit nga ndërhyrjet e jashtme** – KLSH është një institucion i depolitizuar dhe departizuar. Si e tillë ajo mund të shtojë edhe më influencën e raportimeve të veta, duke u ngritur profesionalisht mbi këtë premisë. Kjo pavarësi ligjore duhet kombinuar me rritjen e aftësive të stafit auditues, për ta transformuar nga një mundësi potenciale në një realitet të prekshëm.

**6. Inkurajim i institucioneve homologe, organizatave, shoqatave të ndryshme dhe njësisive akademike për aktivitete të përbashkëta trajnimi dhe shkëmbimi**

**eksperience** – KLSH ka organizuar vazhdimisht konferenca, workshop-e të hapura dhe tryeza të rrumbullakëta me pjesëmarrje të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile. Një traditë e tillë duhet konsoliduar më tej dhe kthyer në kulturë institucionale për krijimin e një profili transparent, vlerë-shtues dhe bashkëkohor.

**7. Inkurajim i pjesëmarrjes së ekspertëve të fushës dhe OJF-ve në probleme specifike auditimi** – KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me mjaft OJF dhe ka kontraktuar ekspertë të jashtëm, specialistë në fusha të caktuara. Një bashkëpunim i tillë duhet forcuar edhe më tej në të ardhmen për rritur profesionalizimin në auditim, trajnuar kapacitetet dhe shtuar impaktin e raporteve audituese në palë interesi.

**8. Monitorimi i instrumenteve financiarë të njohura në sektorin privat, por ende të pazhvilluara dhe parregulluara në sektorin publik** - Sfida kryesore lidhet me buxhetin e shtetit, pasi e konsiderojmë një aspekt të rëndësishëm në ciklin e reformimit të strukturave financiare dhe ligjore që qeverisin zbatimin e tij. Jemi investuar dhe do ta intensifikojmë rolin tonë në reformën buxhetore, rregullimin financiar dhe fiskal dhe çdo fushë tjetër të lidhur me shpenzimet publike sidomos në referencë të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike për periudhën 2014-2020. Prioriteti i këtyre reformave është “fokusi në rezultate” duke thjeshtuar rregullat e financimit, duke rritur kushtëzimin dhe maturimin e buxhetit të BE-së. Ato sjellin një numër të konsiderueshëm të çështjeve për përgjegjshmërinë dhe auditimin publik.

## **KËRCËNIMET**

**1. Pasivitet i institucioneve më të larta për emërimin e Kryetarit të Ri të KLSH-së** - Viti 2019, është karakterizuar nga një dukuri, veçori juridike dhe kushtetuese që është jashtë atributëve, jurisprudencës, kontrollit dhe influencës menaxheriale të këtij institucioni, (e pa ndeshur më parë në gjithë historikun e këtij institucioni të pavarur), e kushtëzuar nga mosveprimet e hallkave dhe autoriteteve shtetërore për dekretimin dhe miratimin e Kryetarit të Ri të KLSH, përgjatë vitit 2019. Duhet të sjellim në vëmendje se Kryetari i KLSH-së z. Bujar Leskaj, që në dhjetor 2018 i kishte deleguar kompetencat e Titullarit të Institucionit tek Zëvendës Kryetari i KLSH-së. Kjo situatë ka influencuar në mënyrë indirekte e në një farë mase, impaktin dhe rezultatet e institucionit në vitin e kaluar dhe në vijimësi.

**2. Perceptim i dobët nga publiku dhe palët e interesit** – Pavarësisht investimit në komunikim që KLSH ka bërë gjatë viteve të fundit, ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Mosperceptimi apo perceptimi i dobët i punës së KLSH-së kërcënon arritjen e një sërë objektivash ët planit strategjik.

**3. Konsolidimi i mëtejshëm i kulturës së mosndëshkueshmërisë midis zyrtarëve të nivelit të lartë** – Mbetet ende problem zbatimi dhe ndjekja e rekomandimeve që KLSH iu ngarkon institucioneve qeveritare. Edhe pse organizmat ndërkombëtare e kanë ngritur shpeshherë këtë problem, kërcënimi vazhdon ende të sabotojë punën audituese të KLSH-së.

**4. Risk në rritje për shkak të numrit të lartë të auditimeve dhe zgjerimit të spektrit të tyre bazuar në Ligjin e Ri Institucional** – Zgjerimi dhe thellimi i funksioneve audituese, tashmë të mandatuara edhe në Ligj, duhet menaxhuar me kujdes, për të minimizuar riskun e gabimeve.

**5. Pamjaftueshmëri kapacitetesh njerëzore dhe logjistike për të mbuluar me auditim shumicën e institucioneve publike** – Është e pamundur që KLSH të mbulojë me auditime të të gjitha llojeve, aktivitetin ekonomik publik në Shqipëri. Për këtë arsye, përgjedhja e subjekteve dhe temave audituese duhet bërë në përputhje me burimet e kufizuara në dispozicion.

#### **IV.3.2 Zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve njerëzore**

Burimet njerëzore janë një faktor i rëndësishëm në realizimin e objektivave kryesorë institucional. Në këtë këndvështrim menaxhimi i burimeve njerëzore në KLSH është konsideruar si parakusht dhe jetik për funksionimin e institucionit në mënyrë efikase dhe të efektshme.

KLSH në kuadrin e reformimit dhe modernizimit institucional ka implementuar në vijimësi një politikë të menaxhimit të burimeve njerëzore e cila është në një linjë me standardet ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe parimeve e praktikave më të mira të administratës publike të rekomanduara nga Bashkimi Evropian.

Përgjatë vitit 2019, KLSH e ka orientuar Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në një linjë me objektivat e përcaktuara në Dokumentin e Politikave të Burimeve Njerëzore miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 228 date 31.12.2017, në drejtimet si më poshtë vijon:

- *Sigurimi i transparencës, përgjegjshmërisë dhe qeverisjes së mirë në procesin të menaxhimit të burimeve njerëzore.*
- *Zbatimi me rigorozitet i kuadrit rregullator ligjor të fushës;*
- *Dokumentimi dhe zbatimi i praktikave më të mira, të përshtatshme për KLSH-në mbështetur në Standardet e INTOSAI-t në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;*
- *Rekrutimi i të rinjve/individëve ekselentë të tregut të punës me rezultate maksimale të arsimimit në një ose dy degë diplomimi, që njohin disa gjuhë të huaja, apo dhe të disponimit njëherazi të titujve akademikë, ekspertë dhe specialistë me kontribute të shquara në fusha të ndryshme si të teknologjisë së informacionit etj.*
- *Sigurimi i zhvillimit të vazhdueshëm profesional, nëpërmjet ruajtjes së njohurive dhe ekspertizës “know-how”, zhvillimit të kapaciteteve, promovimit të të mësuarit, shpërndarjes së njohurive si dhe kryerjes së trajnimeve në mënyrë të vijueshme.*
- *Përbushja e misionit të KLSH duke përdorur me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet burimet në dispozicion për maksimizimin e produktivitetit të burimeve njerëzore.*
- *Zhvillimi dhe zbatimi një sistemi objektiv të vlerësimit të stafit bazuar në performancë, në përbushjen e objektivave individuale dhe kërkesave të kompetencave profesionale*

**1. Mbi ndryshimet dhe zhvillimet e Strukturës Organizative.** Disajnimi i Strukturës Organizative të KLSH-së, në respektim të parimit të pavarësisë organizative, është projektuar në funksion të arritjes së objektivave si nga njësitë strukturore ashtu edhe në nivel institucional.


Struktura aktuale siguron planifikimin efektiv, zbatimin, kontrollin dhe raportimin e performancës së aktiviteteve dhe produkteve të çdo njësie strukturore në KLSH

Departament/Drejtori/Sektor. Përgjatë vitit 2019 u kryen modifikime te strukturës organizative te KLSH-së ne funksion te përmbushjes dhe rritjes se pritshmërive për arritjen e objektivave institucionale.

Ndryshimet e Strukturës reflektojnë kërkesat e “COSO model” kundrejt pesë komponentëve për të siguruar fleksibilitet dhe sisteme efektive të kontrollit të brendshëm duke formuar në këtë mënyrë një sistem të integruar që reagon në mënyrë dinamike ndaj ndryshimit të kushteve eventuale. Kjo strukture mundëson linja efektive ndërveprimi dhe raportimi ne funksion te përmbushjes se përgjegjësiive ne nivel njësie strukturore . Brenda çdo njësie janë instaluar linja efektive raportimi çka mundëson komunikimin e një informacioni cilësor qe synon realizimin e objektivave te njësisë.

Në fund te vitit 2019 organigrama e KLSH-së paraqitet më poshtë.

Diagrama nr.2 Organigrama e KLSH në vitin 2019



Burimi: KLSH

Në funksion të arritjes së pritshmërive për modernizimin institucional si dhe implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, në një linjë me rekomandimin e Komisionit Evropian adresuar ne Raportet e Progresit për rritjen e numrit te auditimeve te Performancës përgjatë vitit 2019 vijoi konsolidimi i Departamentit të Auditimit të Performancës me shtimin e numrit të audituesve si dhe të Departamentit të Auditimit IT. Për më tepër përgjatë vitit 2019, KLSH ka progresuar më tej në hedhjen e idesë për krijimin e një strukture/departamenti Departamenti i Auditimit të Inovacionit dhe të Sistemeve, të dedikuar për kryerjen e auditimeve të inovacionit si një lloj modern auditimi dhe që i paraprin instalimit të politikave të inovacionit në entitetet e sektorit publik në kuadrin e digjitalizimit të qeverisjes. Nëpërmjet ushtrimit të këtij lloj auditimi, KLSH synon të kontribuojë në diagnostifikimin e situatës ekzistuese dhe adresimin e rekomandimeve për përmirësimin e kapaciteteve aftësiive inovative, identifikimin e oportuniteteve,

mundësive për implementimin e proceseve inovative në sektorin publik.

Krahas sa më sipër, duhet theksuar Vendimi i Kryetari të KLSH Bujar Leskaj nr. 244, datë 22.12.2018 për delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit të zëvendëskryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, botuar në Fletoren Zyrtare nr.193, datë 08.01.2019. Në zbatim të këtij Vendimi, i është deleguar ushtrimi i detyrës dhe përgjegjësi shtetërore të titullarit të institucionit përgjatë fazës kalimtare e tranzitore nga përfundimi i mandatit kushtetues të Kryetarit të KLSH (datë 23 dhjetor 2018) deri në emërimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të Kryetarit të ri të KLSH-së, tek Zv/Kryetari i KLSH, znj. Lindita Milo (Lati).


Në funksion të fokusimit të veprimtarisë menaxheriale të rritjes se rolit mbikqyrës dhe kontrollues u krijua strukture e posaçme e *Drejtorit të Përgjithshëm* me linja hierarkike dhe vartësie të tre Departamenteve: Departamentit të Auditimit të Performancës, Departamentit të Auditimit IT dhe të Departamentit të Auditimit të Inovacionit dhe Sistemeve.

Përgjatë vitit 2019 është rritur numri i audituesve të Departamentit të Auditimit IT duke synuar zhvillimin e burimeve njerëzore për Auditimin IT duke kryer rekrutimin e 5 audituesve të rinj. Në adresim të sfidave dhe objektivave të KLSH-së, përgjatë vitit 2019 u krye zhvendosja e këtij Departamentit nën vartësinë e Drejtorit të Përgjithshëm i cili mbulon njëherazi veprimtarinë e Departamentit të Auditimit të Performancës, Departamentit të Auditimit IT dhe të Departamentit të Auditimit të Inovacionit dhe Sistemeve duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e kualitetit të auditimit dhe përmbushjen e objektivave institucionale në drejtim diversifikimit të portofolit të llojeve të auditimit.

**2. Mbi zhvillimet e strukturës organike.** Për vitin 2019, me anë të Vendimit nr. 4, datë 27.01.2017 të Kryetarit të KLSH, “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në KLSH”, i ndryshuar është miratuar struktura organike me një total prej 196 punonjësish. Nga viti 2011 dhe struktura ka pasur një numër total prej 156 punonjësish e cila ka ardhur duke u rritur nga vitit në vit duke arritur për vitin 2019, një numër total prej 196 punonjësish.

Në total numri i stafit Kryeauditues dhe Auditues në vitin 2019 është 149 punonjës që zë rreth 76% të numrit total të punonjësve. Me poshtë pasqyrohet struktura e punonjësve e cila ka vijuar të ndryshojë në favor të stafit auditues.

Grafiku nr.12 Trupa audituese 2011-2019




Burimi: KLSH

**3.Struktura organike sipas profilit te diplomimit .** Klasifikuar sipas arsimimit, në strukturën organike për vitin 2019, punonjësit me arsim të lartë zënë 186 punonjës ose rreth 94.8 % kundrejt numrit total të punonjësve në vitin 2019 (pa arsimin e lartë janë vetëm shoferët dhe punonjëset e pastrimit).

Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë për vitet 2011-2019 paraqitet:

Grafiku nr.13 Profili i punonjësve me arsim të lartë



Burimi: KLSH

Me qëllim aftësimin profesional metodologjik ne funksion te përmirësimit e performancës një pjesë e punonjësve kanë përfunduar studimet në degë të dyta apo kane ndjekur studimet dhe janë diplomuar apo certifikuar brenda dhe jashtë vendit të cilat bëjnë të mundur që ato ti përdorin aftësitë e tyre, në mënyrë efektive dhe ne përgjigje te zhvillimeve te reja ne fushën e auditimit publik. Në fund të vitit 2019 rezultojnë përkatësisht:

- ✓ 2 Drejtues që kanë titullin Profesor Doktor dhe Profesor i Asocuar, 5 Drejtues dhe auditues kanë titullin Doktor Shkencash, ndërkohë që përgjatë vitit 2011 nuk kishte asnjë drejtues me grade shkencore.
- ✓ 31 Drejtues dhe auditues kanë një diplomë të dytë universitare nga të cilët 23 në Drejtësi, 6 në Financë dhe 1 të tjera.
- ✓ 4 Drejtues me diploma profesionale në kontabilitet dhe auditim të njohura ndërkombëtarisht, nga të cilët 2 Drejtues me Diplomë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA) dhe Certifikatë Ndërkombëtare në Kontabilitet dhe Auditim (CIPFA) dhe 2 Drejtues Diplomë Ndërkombëtare CPA
- ✓ 7 punonjës që zotërojnë Certifikatën Kontabël i Miratuar dhe 2 punonjës Ekspert Kontabël.
- ✓ 19 punonjës kanë certifikatën e Audituesit të Brendshëm.
- ✓ 12 punonjës kanë certifikatën e Vlerësimit të Pasurive të Paluajtshme.
- ✓ 9 punonjës kanë certifikata të trajnimeve të zhvilluara on-line nga IDI (Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t).
- ✓ 20 Auditues të KLSH-së kanë përfutur trajnime, nëpërmjet internshipeve me afat

5 mujor nga Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA) dhe 6 drejtues e auditues, përmes fellowship-eve me afat 4 mujor nga Zyra e Auditimit Qeveritar të SHBA-së, GAO.

#### 4- Përbërja strukturore e stafit sipas funksioneve

-Për vitin 2019 përbërja e punonjësve sipas funksioneve dhe detyrave që rezulton:

-19 Personel drejtues (ku përfshihen Kryetari, Drejtorët e Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm. Drejtorët e Departamenteve e të Drejtorive) që përbën 9.6 % të numrit total të punonjësve,

- 16 Kryeauditues që përbën 8.1 % të numrit total të punonjësve,


- 134 Auditues (67.8 %) te numrit total të punonjësve,

- 25 Punonjës mbështetës (përgjegjës sektori, specialistë, juristë, punonjës shërbimi) që përbën 13.7 % të numrit total të punonjësve për vitin 2019, nga këto

10 Punonjës shërbimi (shoferë dhe punonjëse e pastrimit) që përbëjnë 5.1% të numrit total të punonjësve te vitit 2019.

Më poshtë paraqitet përbërja strukturore e stafit për periudhën 2011-2019.

Grafiku nr.14 Përbërja strukturore e stafit



Burimi: KLSH

**5.Mbi proceset e rekrutimit, përzgjedhjes dhe pranimit të stafit.** Rekrutimi dhe përzgjedhja është pika e nisjes për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nga KLSH janë konsideruar si procese të lidhura ngushtë me strategjinë, strukturën dhe funksionimin efektiv të institucionit. Objektivi gjatë procesit të rekrutimit ka qenë sigurimi i stafit të duhur me kualifikimet e duhura, aftësitë dhe përvojën për të plotësuar si nevojat korente ashtu edhe të periudhave në vijim.

Politikat e rekrutimit të punonjësve janë aplikuar në një linjë me strategjinë e zhvillimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore me qëllim që KLSH të sigurojë stafin e duhur me kualifikimet, aftësitë dhe përvojën e duhur për të plotësuar nevojat e korente dhe të perspektivës. KLSH ka zbatuar politika efektive të menaxhimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore bazuar në tre parimet bazë që janë: i) Vlerësimi i profesionalizmit, ii) transparencës dhe iii) konkurimi i hapur dhe

mundësia e pjesëmarrjes për të gjithë të interesuarit.

Si një proces shumë i rëndësishëm për performancën e institucionit, gjatë vitit 2019 janë rekrutuar 16 punonjës sipas të gjitha procedurave, rregullave dhe dispozitave ligjore në fuqi mbi nëpunësin civil. Në asnjë rast gjatë vitit 2019 nuk janë rekrutuar punonjës nëpërmjet akteve të emërimit apo kontratave të përkohshme.

**6. Politikat e ngritjes në detyrë dhe nxitjes së karrierës.** Nisur nga standardet ndërkombëtare ku një institucion suprem auditimi duhet të ruajë dhe të zhvillojë trupën profesionale në funksion të qëllimit të krijimit të mundësive për promovimin dhe për integrimin e stafit të ri gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 5 testime dhe është miratuar ngritja në kategori për 12 auditues dhe drejtues, ndërkohë që gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 8 testime dhe është miratuar ngritje në kategori për 49 auditues, duke u dhënë në këtë mënyrë mundësinë zhvillimit të karrierave profesionale brenda institucionit, nëpërmjet konkurimit.

Çdo punonjës i KLSH-së ka të drejtën e ngritjes në detyrë dhe dëshmi për këtë është çdo anëtar i stafit të KLSH-së. Qëllimi i politikës së ngritjes në detyrë në KLSH është të sigurojë përdorimin e potencialit të punonjësve në një linjë me kuadrin rregullator institucional dhe Standardet Ndërkombëtare ISSAI. Politika e ngritjes në detyrë dhe nxitjes së karrierës, është gërshtuar me politikat për motivimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve.


**7. Moshë dhe vjetërsia në punë.** Tregues të tjerë po aq të rëndësishëm për burimet njerëzore janë moshë e punonjësve për të garantuar një vijimësi të punës dhe gërshtim të përvojës së audituesve të vjetër me procedurat e auditimit, sipas metodologjive të INTOSAI-t të zotëruara nga stafet e reja.

Ecuria në këto vite e treguesve moshor ka njohur trendin e uljes së moshës mesatare të punonjësve kjo për shkak të rekrutimit të punonjësve me aftësi profesionale që i përgjigjen zhvillimit dinamik të teknologjive të reja, fushave të reja me të cilat përballet sektori publik.

-Moshë mesatare në KLSH në fund të vitit 2019 është 42.5 vjeç, nga 50 vjeç në vitin 2011, pra moshë mesatare në periudhën 8 vjeçare 2011-2019 është ulur me rreth 7.5 vjet.

Grafikisht treguesit e moshës mesatare për periudhën 2011-2019 paraqiten më poshtë.

*Grafiku nr.15 Moshë mesatare 2011-2019*



*Burimi: KLSH*

**8. Vjetërsia në institucion.** Për vitin 2019 vjetërsia në punë e punonjësve në Institucionin e KLSH-se, rezulton 7.7 vjet, nga 9.1 vjet që shënonte në vitin 2011.


Diagrama nr.3 *Vjetërsia në institucion*



Burimi: KLSH

- Rezultojnë 43 punonjës nën moshën 30 vjeç, nga mosha 31-50 vjeç janë 77 punonjës, ndërsa mbi moshën 51 vjeç janë 62 punonjës.

Grafiku nr.15 *Shtresëzimi i trupës audituese*



Burimi: KLSH

### 9. Politikat e sigurimit të Barazisë Gjinore

KLSH në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore ka synuar promovimin dhe përfshirjen e integritit gjinor në të gjitha politikat aspektet veprimtaritë institucionale duke respektuar parimin e barazisë gjinore në funksion të eliminimit të fenomeneve të diskriminimit për shkak të gjinisë.

Bazuar në parimin e barazisë gjinore janë zhvilluar proceset e rekrutimit dhe ngritjes në detyrë konform Legjislacionit të Shërbimit Civil duke zhvilluar procedurat e përzgjedhjes, punësimit dhe emërimit, duke përfshirë edhe pozicione drejtuese, në përputhje me kërkesën për përfaqësim të barabartë të femrave dhe meshkujve.

**Rezultati:** Në vitin 2019 raporti i barazisë gjinore arriti 45 % me 55 % nga 33% me 67 % që ishte në 2011.

**Objektivi:** KLSH synon që raporti i barazisë gjinore të jetë 50% femra me 50 % meshkuj nga 33% me 67 % që ishte në vitin 2011.


KLSH ka implementuar parimin e buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjinore të respektohet në, shpërndarjen e burimeve;

Politikat e barazisë gjinore janë implementuar dhe në sigurimin e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha konferencat, mbledhjet, seminarët dhe trajnimet jashtë dhe brenda vendit;

Ndryshimi i raportit femra-meshkuj, sipas të cilit auditueset femra përbëjnë aktualisht 45% nga 33 % të numrit të audituesve që ishin në vitin 2011, pra me një rritje prej 12 % konfirmon qasjen strategjike të KLSH-së ndaj barazisë gjinore në institucion.

Raporti femra/meshkuj i stafit të KLSH-së për vitin 2019 rezultoi 45 % me 55%, kundrejt 33.5% me 66.5% në vitin 2011 me një trend rritës në peshe specifike nga viti në vit në favor të punonjëseve femra sikurse paraqitet më poshtë:

Grafiku nr. 16 Raporti i punonjëseve meshkuj-femra në periudhën 2011-2019



Burimi: KLSH

Politika e KLSH-së në mbështetje të zhvillimit në karrierë të gruas, reflektohet në numrin e konsiderueshëm që drejtueset femra zënë në nivele drejtuese menaxheriale, duke përfaqësuar 11 pozicione drejtuese kundrejt 23 drejtues në total për gjithë institucionin si: Sekretare e Përgjithshme 1, Drejtore të Përgjithshme 2, Drejtore Departamenti 1, Drejtore Drejtorie 2 dhe Kryeaudituese 5.

Po kështu përfaqësimi gjinor për Nivelin e Lartë Drejtues për kategorinë (Sekretar/Drejtor i Përgjithshëm) i cili është niveli më i lartë i Shërbimit Civil në institucion për vitin 2019 rezultoi në pozicion drejtues femra në nivelin 75 % kundrejt 25% .

Politikat e barazisë gjinore janë implementuar dhe në sigurimin e përfaqësimit në predominance të femrave dhe meshkujve në të gjitha konferencat, mbledhjet, seminarët dhe trajnimet jashtë dhe brenda vendit.

Për vitin 2019 rezulton që 57 % të ditëve të trajnimit jashtë vendit për pjesëmarrje në aktivitete të organizuara nga Komuniteti INTOSAI-t janë përfshirë nga auditueset/specialistët femra.

Tabela nr.7 Raporti gjinor i pjesëmarrjes në trajnime të INTOSAI-t

Nr. pjesëmarrësve, 78	Femra	Meshkuj
Totale 248 ditë njerëz	147	111
Raporti Gjinor	57%	43%

Burimi: KLSH

### **IV.3.3 Trajnimet profesionale**

Zhvillimit profesional dhe trajnimi i integruar i audituesve të KLSH-së përgjatë vitit 2019 është bazuar dhe orientuar nga korpusi i akteve dhe kërkesat e Pasaportës së Indikatorëve të Kornizës së Matjes së Performancës (PFM) së SAI-t, dhe nga këto dokumente e norma profesionale e ligjore:

1. Korniza e Matjes së Performancës së KLSH-së, *Grupi i treguesve të Performancës*.
2. Plani Strategjik i INTOSAI-t 2017–2022, *Prioriteti ndërsektorial 3 dhe 5*.
3. Plani Strategjik i EUROSAT, 2017 – 2023. *Qëllimi strategjik 3.2: ndihmesa ndaj SAI-ve në përballjen me mundësitë dhe sfidat të reja nëpërmjet mbështetjes në zhvillimin e kapaciteteve të tyre institucionale*.
4. Ligji nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, Neni 39, “*Trajnimet profesionale*”
5. Strategjia e Zhvillimit të KLSH 2018-2022
6. Plan veprimi për Zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022
7. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, e datës 19 korrik 2018 mbi vlerësimin e aktivitetit të KLSH-së dhe plan veprimin respektiv.

Një analizë SWOT është një mjet i planifikimit strategjik, për të vlerësuar Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet për një projekt apo angazhim.

Në thelb të analizës SWOT është përcaktimi objektivit dhe identifikimi i faktorëve të brendshëm e të jashtëm, të favorshëm e të pafavorshëm për të arritur këtë objektiv, që është formuluar nga Kryetari i KLSH-së z.Bujar Leskaj, në trajtën: “*KLSH do të vijojë ta konsiderojë trajnimin dhe zhvillimin profesional të audituesve si një standard auditimi të njohur, vendosur dhe të pranuar*”.

### **Implementimi i Programit të Zhvillimit Profesional të stafit të KLSH për vitin 2019.**

Sipas synimeve të projektuara në kërkesat e Vendimit të Kryetarit të KLSH nr. 258, datë 31.12.2018, mundësoi që çdo auditues në KLSH përgjatë v.2019 të arrijë objektivat dhe realizojë indikatorët themelorë që nxisin forcimin e kapaciteteve profesionale përmes trajnimit.

Gjatë vitit 2019, karakteristikë është se janë alternuar në mënyrë të harmonishme të dy opsionet e mundshme, sipas vendit të kryerjes së seancave të konsolidimit të njohurive:

- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në institucionin e KLSH-së me lektorë vendas dhe të huaj;
- Seminare dhe trajnime të zhvilluara në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë pranë SAI-ve dhe Gjykatave të Auditimit.

Trajnimet e organizuara brenda institucionit janë fokusuar kryesisht në tre blloqe kryesore:

1. *Trajnime për stafin e ri*, (4-25 nëntor 2019) me bosht kryesor prezantimet dhe njohuritë mbi rolin dhe përgjegjësitë e institucionit suprem të auditimit, dhënien e njohurive dhe koncepteve themelore mbi përgjegjshmërinë, llogaridhënien publike dhe misionin e profesionistëve të auditimit publik; aftësitë dhe mjeshtritë që ata duhet të zotërojnë; teknikat dhe mjetet që duhet të përdorin gjatë punës së tyre etj,
2. *Trajnime të përditësimit të njohurive*, të cilat janë drejtuar për stafin ekzistues dhe me eksperiencë, kryesisht në formën e analizës së rasteve studimore (case study); shkëmbimit të eksperiencës brenda departamenteve nëpërmjet komunikimit të gjetjeve dhe rekomandimeve për auditimet më të vlerësuara; si dhe ofrimin e trajnimeve nga partnerët ndërkombëtarë dhe lokalë, të organizuara gjatë gjithë vitit 2019. Ky grup trajnimesh intensive ka përfshirë dy fasha mujore: trajnime të realizuara gjatë muajit gusht 2019 dhe ato të kryera gjatë periudhës shtator-nëntor 2019.

Në fund të vitit 2019, audituesit e KLSH kishin siguruar një mesatare prej 25 ditë trajnimi /auditues, duke shënjestruar një nivel të lartë të këtij treguesi përgjatë gjithë zhvillimit të këtij institucioni ndër vite, që nga krijimi i tij. Në referencë të procedurave analitike krahasimore, indikator i numrit të ditë trajnimeve për çdo auditues mesatar vjetor rezulton të jetë 14,5 herë më shumë se viti 2009 ku regjistroheshin vetëm 2 ditë mesatare trajnimi/auditues.

Trajnimet dhe kualifikimet jashtë vendit. Këto aktivitete kanë shtuar mundësitë e kontakteve dhe përfitimeve direkte nga shkëmbimi i përvojave gjatë vitit 2019 dhe ku ndoqën aktivitete kualifikimi 79 auditues dhe janë realizuar 258 ditë trajnimi jashtë vendit në 2019.

Vetëm në intervalin kohor 2015-2019, nga ana e KLSH-së janë ndjekur 264 aktivitete jashtë vendit, me 2993 ditë trajnimi gjithsej për këto pesë vite si vizita zyrtare, workshop-e, marrëveshje bashkëpunimi me institucionet analoge evropiane dhe më gjerë, komitete të kontaktit, tryeza të grupeve të punës, konferenca shkencore dhe seminare trajnuese, vizita studimore në SAI-t homologe etj.

Në zbatim të politikave të zhvillimit profesional, bazuar në marrëveshje dhe marrëdhënie me institucionet ndërkombëtare të auditimit, gjatë periudhës 2013-2019, është përfituar përvojë nga programe internship-i prej 6 audituesve për periudha afatgjatë në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), Luksemburg. Meriton të thuhet se, numri i audituesve dhe nga 1 auditues i KLSH është ndjekur cikli i trajnimeve (fellowship) pranë GAO-s.

1. *Indikatorët sintetike (metrikset e performancës) së trajnimeve të periudhës 1 Janar 2019-31 dhjetor 2019.*

☰ Mesatarja e trajnimeve të realizuar për auditues gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019: 25 ditë trajnimi për auditues.

☰ Në total janë realizuar gjatë vitit 2019, 3611ditë njerëz trajnime brenda dhe jashtë vendit.

☰ Nga ana e Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit janë organizuar së paku 5 plane dhe programe me aktivitete trajnimi si më poshtë:

*Tabela nr.8 Planet dhe programet e aktivitetit trajnues*

CESHTJA/PLANI & APROVIMI	PERIUDHA	RAPORTIMI MBI ECURINE
1.Takimet dhe tavolinat e diskutimit për rishikimin e Rregullores së procedurave të auditimit, së bashku me kryerjen e analizave departamentale të v.2019	Shkurt-mars 2019	Informacion për strukturat me të larta drejtuese të KLSH (DP)
2.Plan trajnimesh për muajin Maj 2019	2-10 maj 2019	Info dërguar Kryetarit të KLSH me date 9.6.2019
3.Plan trajnimesh për muajin Gusht 2019. Miratimi me nr. 246, date 26.7.2019	Gjithë Muaji gusht 2019	Info dërguar Kryetarit të KLSH me date 04.09.2019, së bashku me Regjistrin e Trajnimeve të KLSH
4.Plan trajnimesh për periudhën Shtator-Tetor 2019. Miratimi me nr. 629, date 29.8.2019	Shtator-Tetor 2019	Info dërguar Kryetarit të KLSH me date 9.6.2019
5.Plan trajnimesh për target grupin e të rinjve të rekrutuar në KLSH gjatë këtij viti	4 nëntor Deri me 25 nëntor 2019	Info dërguar Kryetarit të KLSH
Raporti përfundimtar mbi zhvillimin profesional + regjistri vjetor i trajnimeve 2019	xxx	Memo dërguar Kryetarit të KLSH-së me datën 14.1.2020

*Burimi: KLSH*

☰ Në lidhje me trajnimet, seminarët dhe workshop-et e ndjekura jashtë vendit nga stafi auditues dhe drejtues i KLSH paraqitet kjo dinamikë për 5-vjeçarën 2015-2019:


*Tabela nr.9 Dinamika e numrit të pjesëmarrësve dhe aktiviteteve trajnuese 2015-2019*

Viti	Numri i punonjësve	Nr. aktiviteteve	Dite/njerëz
2019	82	44	258 ditë
2018	138	51	520 ditë

2017	146	57	675 dite
2016	153	53	765 dite
2015	135	59	775 ditë

Burimi: KLSH

Grafiku nr. 16 Analiza grafike dinamike e procesit të trajnimeve




Burimi: KLSH

☐ Ecuria e procesit të trajnimeve profesionale si dhe zhvillimi i tyre gjatë vitit 2019, është udhëhequr nga Standardi Ndërkombëtar i Auditimit ISSAI 12/ (Parimi nr.12/1, i cili përcakton se, “SAI duhet të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm profesional që kontribuon në përsosjen: Organizative; Individuale dhe Ekipore”

Treguesi kryesor i progresit reflektohet në rritjen e numrit të trajnimeve që çdo auditues ka kryer gjatë vitit, duke arritur një nivel të kënaqshëm prej 3611 dite njerëz trajnime, ose referuar 145 audituesve efektive vjetorë, rezultojnë 25 ditë trajnimi mesatare vjetore për auditues në vit, (kundrejt 2.1 të arritura në 2011 dhe 3.1 ditë trajnimi/person të kryer në vitin 2010).

✓ Arritja e një numri mestar prej 25 ditë trajnimi për çdo auditues shënon një rritje me 12 herë kundrejt vitit 2011, kur ky tregues ishte minimal.

Grafiku nr. 17 Dinamika e trajnimeve të KLSH për periudhën 2009-2019



Burimi: KLSH

## Analiza krahasuese:

**I.** Në fund të vitit 2019, audituesit e KLSH kishin siguruar një mesatare prej 25 ditë trajnimi /auditues, duke shënjestruar një nivel të lartë të këtij treguesi edhe në krahasim me periudhat e shkuara të zhvillimit të këtij institucioni, që nga krijimi i tij.

Në referencë të procedurave analitike krahasimore, indikatori i numrit të ditë trajnimeve për çdo auditues mesatar vjetor rezulton të jetë 12 herë më shumë se viti 2009 ku regjistroheshin vetëm 2 ditë mesatare trajnimi / auditues

**II.** Indikator i vjetor prej 25 ditë trajnimi / auditues, është realizuar në masë të plotë (100%) në përputhje me rekomandimet e pikës nr. 3.4.1 të Rezolutës të datës 19.7.2019 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë”(dhe plan veprimit respektiv, dërguar Kuvendit nga ana e KLSH me shkresën nr. 113/4, datë 26.9.2018) ”zhvillimi i mëtejshëm i sistemit tashme të strukturuar të zhvillimit profesional

**III.** Në fund të vitit 2019, indikator i vjetor prej 25 ditë trajnimi / auditues, është shumëfish më i lartë se detyrimi (referenca ligjore) e audituesve të brendshëm, që sipas përcaktimeve të nenit 20, të ligjit nr. 114/2015 “Për AB e SP”, ”të gjithë audituesit e certifikuar në detyrë, të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 2, të nenit 11, të këtij ligji, i nënshtrohen trajnimit të vijueshëm profesional, të paktën 80 orë në dy vjet”, (ose 40 orë , apo 5 ditë në vit).

**IV.** Indikator i realizuar në vitin 2019 nga KLSH përafrohet me numrin e ditëve të Programeve të trajnimit të organizmave të specializuara në fushën e zhvillimit të kapaciteteve, si Instituti i Audituesve të Brendshëm, ku gjatë vitit 2017, janë organizuar 22 sesione trajnimi mbi menaxhimin e rrezikut dhe kontrollit të brendshëm (COSO) për arritjen e nivelit të dëshiruar të ekspertizës dhe zbatimin e programit të auditimit të Standardeve të Auditimit SNA për të siguruar zhvillimin e tyre të vazhdueshëm.

#### **IV.3.4 Teknologjia e informacionit në shërbim të KLSH dhe auditimet IT**

Edhe për vitin 2019 KLSH ka vazhduar në përdorimin e teknikave CAAT në auditim.

Jo rastësisht Big Data dhe përdorimi i tyre në auditim ishte edhe një nga tema e Kongresit të XXIII-të të INCOSAI mbajtur në Moskë në datat 25 – 27 shtator 2019. Ndër të tjera u theksua se Institucionet Supreme të Auditimit mund të synojnë përdorimin e një analize më mirë të të dhënave në auditime, përfshirë strategjitë e adaptimit, siç është planifikimi për auditime të tilla, zhvillimi i ekipeve me përvojë për analitikë të të dhënave dhe futja e teknikave të reja në praktikën e auditimit publik.

Specifikisht SAI-t inkurajohen të ushqejnë auditorët e së ardhmes, të cilët mund të përdorin analiza të të dhënave, mjete të IA artificiale dhe metoda të përparuara cilësore, të forcojnë inovacionin; dhe të veprojnë si aktorë strategjikë, shkëmbyes të njohurive dhe prodhues të para shikueshmërisë.

Prej disa vitesh KLSH dhe Departamenti TI ka investuar në përdorimin e teknikave CAATT në auditim, përdorimi i programeve për analizimin, ekstraktimin dhe vizualizimin e të dhënave kanë qenë pjesë jo vetëm për modelimin e auditimeve nëpërmjet vlerësimit të riskut por dhe si mjet e teknika në auditim.

Zhvillimet e sistemeve të teknologjisë së Informacionit në Shqipëri si dhe implementimi i programit (SIMPA) për menaxhimin e proceseve në KLSH po krijojnë kushte të përshtatshme për rritjen e përdorimit të teknikave CAATT dhe kalimit në një fazë më të avancuar të përdorimit të Inteligjencës Artificiale në auditim.

Si rezultat i përdorimit të analizës së riskut gjatë vitit 2019 përpara hartimit të programit të auditimit me mjetin "Manuali Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit" të miratuar me vendimin 171 datë 27.11.2018 kemi një rritje të efektivitetit të auditimit me indikator gjetjet në fusha jashtë planifikimit në intervalin 0-19% (mesatarisht 7%).


Më hollësisht paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim.

*Tabela Nr.10 Gjetjet jashtë programit sipas subjekteve*

<b>Subjekti</b>	<b>Gjetje jashtë programit në %</b>
UKL	5.4
UKBK	19
FSDKSH	8.1
MFE	0
KESH	4.1
Performanca e përdorimit të Internetit	6

Burimi: KLSH

*Grafiku nr.18 Fushat me gjetje jashtë planifikimit*



Burimi: KLSH

Nga të cilat rezultojnë:

- Qeverisja TI me .....35%
- Backup dhe disaster recovery..... 38%
- Operacionet TI me..... 27%

Shfrytëzimi i logeve, bazave të dhënave e çdo burimi tjetër të dhënash elektronike është pjesë e çdo auditimi TI dhe jo vetëm.

Gjatë vitit 2019 analizat e bazave me teknika CAAT dhe vizualizimin e tyre është përdorur në çdo disa auditime dhe veçanërisht në:

- Auditimet e përputhshmërisë e financiare në:

Auditimin e Buxhetit ne Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Auditimin në Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA, Spitalin Rajonal Durrës dhe Albpetrol Sh.A duke kontribuar në këto auditime me njohuritë e tyre në fushën e teknologjisë së informacionit me 18 masa organizative, 11 Masa për shpërblim dëmi me vlerë 2.7 milionë lekë dhe 7 Masa për Eliminimin e Efekteve Negative me rreth 34 milion lekë.

- Si dhe auditimet TI në:


UKL dhe UKB për sistemet e faturimit dhe kontabilitetit që përdorin këto sh.a.

Në sistemet e Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor ku sasia e informacionit dhe kompleksiteti i tyre përbënte rastin tipik të auditimit të Big Data.

Nga analizat vizualizuese të miliona rekordeve po veçojmë:

1. Konstatimin e anomalive në varësinë ndërmjet vlerës së rimbursimit dhe numrit të recetave për dy raste.

*Grafiku nr. 19 Anomalitë në varësinë ndërmjet vlerës së rimbursimit dhe numrit të recetave për dy raste*



Burimi: KLSH

2. Analizimi me programin IDEA (data analitik) të miliona rekordeve të recetave të lëshuara e rimbursuara për vitin 2018 dhe arritur në konstatimin se 1.15% e mjekëve (apo vetëm 20 mjekë) duke lëshuar vetëm 1% të recetave (nga rreth 6.3 milion receta në total) mundësojnë 21% të vlerës totale të rimbursimit apo 253 milion lekë (nga rreth 1.2 miliardë lekë totali).

Grafiku nr. 20 Analiza me programin IDEA të recetave të lëshuara e rimbursuara



Burimi: KLSH

**IV.3.5 Sigurimi i cilësisë në procesin auditues**

Departamenti i Strategjisë dhe Metodologjisë, Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë ka kryer kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve të auditimit gjatë dhe në fund të vitit të bazuar në kuadrin rregullator përkatës si: Rregullorja e brendshme administrative e KLSH-së, Rregullorja e procedurave të auditimit, Udhëzuesi për menaxhimin e cilësisë, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI 40 dhe ISSAI 5600) etj. Një veprimtari e tillë është finalizuar në fund të vitit 2019 me Urdhrin nr.130 të Kryetarit të KLSH z. Bujar Leskaj, datë 26.11.2019 “Për kontrollin e sigurimit të cilësisë në procesin auditues për vitin 2019”

Cilësia dhe besueshmëria e raporteve të auditimeve të KLSH është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme, duke tërhequr gjithnjë e më shumë vëmendjen e opinionit publik, pasi gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve orientohen pikërisht drejt identifikimit dhe zgjidhjes së problematikave të qeverisjes publike, pra në dobi të mirëqeverisjes.

Në vijim, një sfidë e tillë për rritjen e kapaciteteve audituese, profesionalizmit dhe të cilësisë në auditim ka gjetur pasqyrim në strategjitë e zhvillimit, dhe konkretisht në Qëllimet dhe Objektivat për periudhën 2018-2022, për cilësinë si prioritet i KLSH-së - Përmirësimi i cilësisë dhe përfitimi nga auditimet e KLSH (qëllimi 1.7 i Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022).

Veç e këtyre janë në proces konsolidimi, si në koncept ashtu edhe në përfshirjen e zbatimit në praktikë të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (detyrimi për të reflektuar shkallën më të lartë të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t dhe IFAC-it, si dhe rezolutat e Kongreseve të INTOSAI-t dhe EUROSAI-t), në funksion të cilësisë së auditimit, të nisura për herë të parë në fund-vitin 2014, në historinë e re të zhvillimit të KLSH-së.

“*Cilësia e auditimit*” përfaqëson shkallën në të cilën përmbushen një grup karakteristikash të qenësishme të auditimit si: rëndësia, siguria, objektiviteti, qëllimi, qartësia, afatet, efica dha efektiviteti; ndërsa “*Kontrolli i cilësisë*” është një term që përfshin politikat dhe procedurat që janë zbatuar nga KLSH për t’u siguruar që puna e saj e auditimit është e një cilësie të lartë në mënyrë të vazhdueshme. “*Sigurimi i cilësisë*” është procesi i vendosur nga KLSH për t’u siguruar që: ekzistojnë kontrollet e nevojshme; kontrollet janë duke u zbatuar siç duhet; si dhe të identifikohen mënyrat e mundshme të forcimit dhe/ose përmirësimit të kontrolleve të kësaj fushe.

KLSH, tashmë është e kompletuar me botimin në shqip të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit; të të gjitha llojeve të Manualeve të auditimit: financiar, të përputhshmërisë, të performancës, të teknologjisë së informacionit, të prokurimeve etj.; udhëzuesve të ndryshëm si për auditimin e mjedisit, mbi praktikat më të mira të auditimit të financimit privat/publik dhe koncesioneve & Kodi i Transparencës Fiskale, FMN etj., dokumente të cilat jo vetëm janë tema të trajnimeve të vazhdueshme, por në të njëjtën kohë janë pjesë e bibliotekës personale të audituesve që shërbejnë për t’u konsultuar gjatë procesit auditues. **Njohja, përvetësimi dhe zbatimi në praktikë i tyre nga audituesit është jo vetëm domosdoshmëri, por dhe një bazë e mirë për cilësinë e auditimit.**

Veç sa më sipër, përmirësimit të cilësisë së auditimit dhe zbatimit të standardeve i ka shërbyer Rregullorja e Procedurave të Auditimit me ndryshime, e shoqëruar me dokumentet përkatëse, si dhe Sistemi i Menaxhimit të Proceseve (RevZone).

Në funksion të zbatimit të standardeve dhe sigurimit të cilësisë, dokumentacioni i mësipërm vitin e kaluar është plotësuar me **Udhëzuesin e Menaxhimit të Cilësisë së Auditimit**, duke përmbushur plotësisht kuadrin rregullativ në këtë fushë, ashtu siç ka theksuar Kryetari i KLSH z. Bujar Leskaj se: “*KLSH angazhohet në përpilimin e dokumenteve duke iu referuar standardeve të punës së INTOSAI dhe EUROSAI, si dhe institucioneve lider në auditim si GAO, ECA, NIK, SIGMA dhe IDI.*”

**Por, evoluimi i veprimtarisë së subjekteve të auditimit e kuadrin rregullator të tyre, përbën sot një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet KLSH. Një gjë e tillë kërkon që audituesit të kenë zhvillim të vazhdueshëm profesional, duke u mbështetur në standardet e auditimit dhe praktikat më të mira botërore. Pikërisht, nga ana e KLSH insistohet në mënyrë të vazhdueshme që cilësia e**

**auditimit të jetë një element i qenësishëm i secilit auditues, si baza e progresit në veprimtarinë audituese.**

Tashmë në KLSH ka një strukturë (Drejtori) të posaçme të ngarkuar me kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve, në përbërje të së cilës janë kualitetet më të mira audituese, krahas veprimtarisë së hallkave të tjera në këtë linjë si: Kryeauditues, Drejtor Departamenti etj., që ka rritur ndjeshëm impaktin në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së auditimit.

**KLSH e ka konsideruar cilësinë e auditimit, jo vetëm faktorin më të rëndësishëm në prezantimin auditimit (raportit) dhe rezultateve të tij: opinionit, konkluzioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve; por edhe në rritjen e përgjegjshmërisë së audituesve gjatë auditimit dhe subjekteve të audituara për zbatimin e rekomandimeve.**

Kontrolli i cilësisë së auditimit dhe zbatimit të standardeve është një veprimtari e cili kryhet për secilin auditim gjatë këtij procesi, duke kaluar në disa filtra dhe duke u përqendruar në një format 3D: në se auditimi është në formë dhe/ose strukturë, është në përmbajtje dhe është në afate në përputhje me dokumentet standarde të auditimit, duke referuar vërejtjet dhe sugjerimet përkatëse për shmangiet e evidentuara. Në vijim, reflektimi i këtyre mendimeve është objekt i grupit të auditimit në funksion të përmirësimit të cilësisë së auditimeve. Gjatë vitit 2019, Drejtorja e Standardeve dhe Sigurimit të cilësisë ka kryer kontrollin e cilësisë dhe ka dhënë mendimet përkatëse për 138 auditime. Pavarësisht arritjeve në këtë fushë, gjatë shqyrtimit të dosjeve të auditimit deri në fazën e hartimit të Raportit Përfundimtar dhe Projektvendimit ka rezultuar:

*a. Vazhdon të shfaq mangësi përdorimi në kohë reale nga ana e audituesve i Sistemit elektronik të Menaxhimit të Proceseve (REVZONE), që për hir të së vërtetës, duhet theksuar se në disa raste është për pamundësi përdorimi në terren apo dhe nga hallka të tjera jashtë kontrollit menaxherial të audituesve. Një gjë e tillë është konstatuar për arsye se, Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë nuk ka arritur që të njihet nga sistemi me dokumentacionin e auditimit.*

Veç kësaj, në këtë kuadër vihet re se akoma nuk është kuptuar nga Drejtorët e Departamenteve të auditimit zbatimi i nenit 31, pika 6 e Rregullores së Procedurave të Auditimit, për të përcjellë një kopje të Projekt Raportit të Auditimit tek Drejtoria jonë, me qëllim zbatimin e procedurave për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë.

*b. Dokumentet e raportimit të auditimit (Projekt Raport dhe Raport përfundimtar), pavarësisht ndonjë mangësie që shfaqin nga ana strukturore, ka raste kur nuk dokumentohen kriteret e vlerësimit, standardet e aplikuara të auditimit etj.; janë trajtuar në mënyrë të cunguar dhe/ose konfuze objektivat dhe qëllimi, identifikimi i çështjes, përgjegjësitë e zyrtarëve të identifikuar me probleme etj., duke sjellë për pasojë humbjen e tipareve të plotësisë, saktësisë, qartësisë, objektivitetit etj.*

Gjithashtu, Projekt Raportet dhe Raportet e auditimit vazhdojnë të vuajnë çështjen e vëllimit (numrit të faqeve), të cilat jo vetëm nuk janë në përpjesëtim me madhësinë e aktivitetit të subjektit; periudhës së auditimit; numrit, klasifikimit dhe cilësisë së gjetjeve etj., por shfaqin edhe mangësi në formatim (jo në përputhje me standardet) dhe në drejtshkrimin e gjuhës zyrtare, duke i bërë të lodhshme dhe me efekt të

tkurrur për të audituarit, parlamentin dhe opinionin publik. Gradualisht, gjykojmë se duhet të hyjmë në hullinë e eksperiencës së disa prej SAI-eve të tjera, në atë të përcaktimit një kufiri maksimal të numrit të faqeve të Raporteve të auditimit.

*c. Projektvendimi, si një nga dokumentet më të rëndësishme në procesin auditues, në disa raste shkon deri në 25 % të vëllimit të Raportit përfundimtar, duke mos mbajtur në konsideratë, një trajtim të përmbledhur, të qartë dhe shumë konciz. Kjo pasi, trajtimi i plotë dhe më i detajuar përmban referencat përkatëse në faqet e Raportit Përfundimtar.*

Përgjithësisht, nuk kemi një renditje sipas rëndësisë të gjetjeve dhe rekomandimeve në kapitujt përkatës të llojit të tyre (klasifikimi); në disa raste përzihen elementë të njëra tjetrës ose përsëriten midis tyre; nuk adresohet saktë struktura përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit etj.

Veç kësaj, janë evidentuar dhe raste të mos arsyetimit dhe mos vlerësimit siç duhet të afatit të zbatimit të rekomandimeve, e lidhur kjo me kohën dhe shkallën e pranimit dhe zbatimit tyre nga ana e subjekteve të audituara, si një nga treguesit e rëndësishëm të performancës së veprimtarisë së KLSH-së.

*d. Pjesë e kontrollit të cilësisë së dosjeve të auditimit, ka qenë dhe është i gjithë dokumentacioni që nga njoftimi i fillimit të auditimit deri në hartimin e Projektvendimit. Në këtë kuadër, duhet theksuar se, Audituesit e Drejtorisë së Standardeve dhe të Sigurimit të Cilësisë janë të shqetësuar për formalizmin që shfaqet nga ana e Kryeaudituesve dhe Drejtorëve të Departamenteve të Auditimit në dhënien e mendimeve për zbatimin e standardeve dhe cilësisë, të cilat pothuajse në të gjitha rastet janë në të njëjtin format dhe nuk evidentojnë asnjë konsultim për çështje të ndryshme të auditimit me grupin e auditimit të dala gjatë këtij shqyrtimi. Një gjë e tillë e nxjerr Drejtorinë tonë jo si një nga hallkat që vendos një tullë në murin e cilësisë, por si një mur ku vijnë dhe përplasen audituesit dhe auditimet.*

Në mënyrë të detajuar për këto dhe çështje të tjera të lidhura me standardet dhe cilësinë e auditimit, atje ku janë evidentuar, ju janë bërë të njohura drejtorëve të Departamenteve dhe përgjegjësve të grupeve të auditimit përgjatë vitit 2019 në procesin e evadimit.

Në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI 40 dhe ISSAI 5600); Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH-së (pika 10.5.8.2/2); Rregullores së procedurave të auditimit në KLSH, neni 40, pika 4, si dhe Udhëzuesit të menaxhimit të cilësisë (Lista kontrolluese 5), kryetari i KLSH ka nxjerrë Urdhrin nr.130, datë 26.11.2019 “Për kontrollin e sigurimit të cilësisë në procesin auditues për vitin 2019”, në të cilin janë përcaktuar afatet, grupi i punës, drejtimet kryesore ku duhet të përqendrohet kjo veprimtari, lista verifikuese etj.

Zbatimi i këtij Urdhri për sigurimin e cilësisë nëpërmjet kontrollit vjetor në “të ftohtë” është realizuar në mbi 30% të dosjeve të auditimit të periudhës janar-nëntor 2019 ose për 36 dosje auditimi të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme. Në këtë proces, krahas Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, janë angazhuar gjithsej 11 auditues me përvojë dhe që kanë shfaqur ekspertizë të veçantë në lloje të ndryshme të auditimeve. Duhet theksuar se gjatë kësaj veprimtarie është mbajtur në konsideratë që audituesit e përfshirë në grupin e cilësisë të një Departamenti, të

shqyrtojnë dosjet e një Departamenti tjetër, si dhe një risi nga vitet e mëparshme është përfshirja e Udhëzuesit për Menaxhimin e cilësisë gjatë kryerjes së këtij procesi. *Vlerësimi i detajuar për çdo dosje është bërë sipas formularit të miratuar më këtë Urdhër, dhe të listës verifikuese, e cila përfshin 20 tregues për tre fazat e ciklit të plotë të procesit auditues: planifikim, kryerje e auditimit dhe raportimi e evadimi; rezultatet përfundimtare të të cilëve janë evidentuar pas takimit përmbyllës me grupin e auditimit.* Më pas, secila prej dosjeve të auditimit të shqyrtuara ka qenë objekt diskutimi në analizat vjetore të veprimtarisë së Departamenteve auditimit, në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të KLSH-nr.6, datë 23.01.2020 (pika 1), në funksion të përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë audituese të KLSH.

Në mënyrë të përmbledhur konstatohet se:

a. Me gjithë arritjet në përmirësimin e cilësisë, *vazhdon të mbetet problem në pjesën më të madhe të auditimeve dhe të Departamenteve të auditimit çështja e mbledhjes dhe dokumentimit të informacionit paraparak për subjektin që auditohet.* Fatkeqësisht audituesit tanë nuk kanë arritur akoma të kuptojnë se mbledhja dhe dokumentimi i këtij informacioni, theksoj “mbledhja dhe dokumentimi”, jo vetëm është baza e suksesit të pritshmërive të një auditimi, por dhe e garantimit të cilësisë së tij.

b. Gjatë fazës së në terren, auditimet tona vazhdojnë të vuajnë pasqyrimin dhe përdorimin e procedurave dhe teknikave të përshtatshme të auditimit, duke zbehur deri diku forcën argumentuese dhe objektivitetin në vlerësimin e mangësive të rezultuara gjatë auditimeve.

Po kështu, audituesit e cilësisë kanë vërejtur se jo në të gjitha rastet janë ballafaquar dhe ndjekur deri në fund çështjet e dala gjatë auditimit, kryesisht në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Gjatë kësaj faze janë shfaqur dhe raste që Akt-verifikimet dhe Akt konstatimet nuk respektojnë plotësisht strukturën e përcaktuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit.

Gjithashtu, përgjithësisht zhvillimi dhe dokumentimi i takimit përmbyllës me subjektin e auditimit, vazhdon të mbetet një proces formal, pasi jo vetëm që nuk dokumentohet siç duhet, por nuk gjen reflektim në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

c. Lidhur me raportimin dhe evadimin e auditimeve, rezulton se vështirësisht për disa Departamente auditimi si ai i Institucioneve Qendrore dhe Vetëqeverisjes vendore, forma e përmbajtja e Projekt Raportit dhe Raportit janë në përputhje të plotë me dokumentet standarde të auditimit.

Pavarësisht veçorive të vitit 2019 që kemi lënë pas, duhet theksuar se ka pasur vonesa dhe mangësi në dhënien e mendimeve, kryesisht në Departamentin e auditimeve të Buxhetit të shtetit, apo dhe formalizmave të cilësuar më sipër në përgjithësi nga strukturat e tjera.

**Në përfundim të veprimtarisë së kontrollit të zbatimit të cilësisë rezulton se performanca e KLSH ka progres në këtë drejtim, pasi 80 % e dosjeve të shqyrtuara janë vlerësuar “mirë”, 17 % që plotësojnë të gjitha kriteret (vlerësimi “shumë mirë”) dhe vetëm 3 % kanë marrë notën “mjaftueshëm”.**

**Një konkluzion i tillë arrihet, pasi krahasuar me vitin e kaluar është ulur ndjeshëm numri i dosjeve me mangësi dhe është rritur përkujdesja në mbi 20 % të dosjeve të auditimit (nga 60 % me vlerësimin “mirë” një vit më parë në 80 % në 2019).**

*Theksojmë se ky përmirësim në drejtim të cilësisë së auditimit është rezultat i angazhimit të vazhdueshëm të Drejtorisë së Standardeve dhe Kontrollit të Cilësisë, funksionimit të sistemit REVZONE, përpjekjeve të të gjithë stafit auditues të KLSH për zbatimin e Rregullores së procedurave të auditimit, manualeve dhe udhëzuesve të auditimit etj.*

Megjithatë, janë evidentuar dhe disa mangësi e të meta në faza të ndryshme të auditimit, në dosje dhe departamente të ndryshme të auditimit dhe në çështje specifike brenda tyre. Në bazë të kriterëve paraprake të caktuara për vlerësimin e dosjeve të përzgjedhura, në mënyrë të përmbledhur sipas opinionit të shqyrtuesve të cilësisë konstatohet se:

#### **I. Për fazë e planifikimit të auditimit/hartimit të programit të auditimit**

Për këtë fazë të procesit auditues janë shqyrtuar dhe vlerësuar 6 kriterë, duke u nisur që nga përzgjedhja e subjekteve, grumbullimi i informacionit paraprak etj., dhe deri tek ndarja e detyrave për çdo auditues, në referencë dhe të Dokumenteve standarde të auditimit, sipas Rregullores së Procedurave të auditimit.

**1.** *KLSH, tashmë ka të konsoliduar hartimin e planit vjetor të auditimeve mbi bazën e kriterëve të qarta dhe që, deri diku garantojnë siguri në gjetje dhe nisje të mbarë në sigurimin e cilësisë në vijim të auditimit, pasi kryhet sipas Udhëzimit nr.4 të Kryetarit të KLSH, datë 31.12.2015 “Për hartimin e planit vjetor të auditimeve të KLSH-së bazuar në vlerësimin e riskut”. Kështu, 36 dosjet e auditimit të shqyrtuara janë plotësisht sipas planit vjetor të miratuar në fillim të vitit.*

**2.** *Me gjithë përmirësimet e arritura në drejtim të mbledhjes dhe dokumentimit të informacionit paraprak për subjektin që auditohet, vërehen mangësi akoma tek disa Departamente auditimi. Më e theksuar kjo është tek Departamenti i Auditimit të Njësive të vetëqeverisjes vendore (bashkia Pukë, Bulqizë, Patos etj.) në të cilat informacioni nuk finalizohet me plotësimin e dokumentit Standard 2 “Memo mbi planifikimin e Projektit të Auditimit”, dokument mjaft i rëndësishëm i cili është baza për hartimin e programit të auditimit, si dhe jep një kornizë të qartë mbi vlerësimin e riskut dhe llogaritjen e materialitetit. E njëjta gjë ndodh dhe tek Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike, ndonëse jo në përmasat e departamentit të cilësuar më sipër, për auditimet Ujësjellës Kanalizimeve Pogradec, Qendrës Spitalore Universitare etj., në të cilat është vërejtur se përcaktimi i materialitetit nuk është i bazuar në vlerësime paraprake dhe përdorimi i tij nuk evidentohet, pasi, sipas dokumenti standard të Rregullores së Porcedurave të Auditimit, përllogaritja e riskut dhe materialitetit përfshihen në dokumentet e punës, pasi ato janë bazë e rëndësishme për përcaktimin e shtrirjes së auditimit, metodës së auditimit apo dhe afateve kohore.*

**3.** *Për këtë fazë, konstatohet se kryesisht në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit përgjithësisht dokumentet që kanë të bëjnë me procedurat e shmangies së konfliktit të interesit, si dhe ndarja e detyrave për çdo auditues nuk janë të miratuara nga Drejtori i Departamentit. Në Departamentin e Auditimit të Institucioneve*

Qendrore, në auditimin e AKBN nuk është kryer ndarja e detyrave midis dy audituesve.

## **II. Për fazën e kryerjes së auditimit**

Janë shqyrtuar 5 kritere në lidhje me respektimin e programit të auditimit, përdorimin e procedurave dhe teknikave të auditimit, ballafaqimin e çështjeve të auditimit dhe dokumentimin e tij, sipas përcaktimeve dhe në dokumentet standarde.

**1.** *Megjithëse respektohet dhe zbatohet programi i auditimit, KLSH ka mangësi në përdorimin e përshtatshëm dhe dokumentimin e procedurave dhe teknikave të auditimit për mbledhjen e provave, dokumenti 7 Letrat e punës, të cilat kanë të bëjnë paraqitjen dhe përshkrimin e punës së kryer nga audituesi. Një fenomen i tillë gjendet i shtrirë plotësisht në Departamentin e Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, në auditimin e OST SHA, Qendrën Spitalore Universitare, bashkinë Pukë, bashkinë Bulqizë etj., si dhe në APP, Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Harmonizimit etj. Përgjithësisht ose mungon fare dokumenti i cilësuar më sipër ose ka një kuptim të deformuar nga ana e audituesve në plotësimin e dosjes së auditimit.*

**2.** *Veç kësaj, në Departamentin e Auditimit të Insititucioneve Qendrore (auditimi AZHBR, AKBN dhe Ministria e Drejtësisë) janë vërejtur Akt verifikime dhe Akt konstatime të paplota. Theksojmë se, sipas kërkesave të Rregullores së procedurave të auditimit të ndryshuar, neni 26 “Dokumente të auditimit”, pika 1, germa “b”: “...Ekzistenca e konkluzioneve negative kërkon plotësimin nga audituesi të bazës ligjore të shkelur, evidentimin e dëmit dhe evidentimin e personave përgjegjës”. Edhe në raste të tjera janë konstatuar evidentim të shkeljeve në mungesë të bazës ligjore analitike të cenuar (kriteri) dhe të adresimit përgjegjësive nominale, dhe jo strukturore.*

**3.** *Takimi Përmbyllës i Punës në Terren konstatohet se ose nuk dokumentohet fare (si në auditimin e AKU, të CFCU, në Drejtorinë e buxhetit (MFE) etj., ose është i paplotë (rasti i bashkisë Pukë, ku për një dokument të tillë është vendosur takimi me një anëtar të KVO-s), ose përgjithësisht nuk gjen pasqyrim në raportet e auditimit, duke kthyer në një procedurë formale pa ndikim përmirësimi në procesin auditues.*

**4.** *Nga shqyrtimi, nëse janë ballafaquar dhe ndjekur deri në fund çështjet e dala gjatë auditimit, kryesisht dhe përgjithësisht në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit (auditimet e CFCU, FSDKSH, ISSH, Drejtoria e Buxhetit etj.) nga grupi i auditimit nuk është kërkuar ballafaqimi përpara përfshirjes së gjetjeve në evidencën e auditimit, për sqarime sipas rastit nga personi/personat përgjegjës për të pasur dijeni për çfarë është vërejtur, si dhe faktorë të tjerë që kanë ndikuar në shfaqjen e mangësive në aktivitetin e subjektit. Theksojmë se duhet dokumentuar ballafaqimi me personat që kanë lidhje me objektin e konstatimit jo thjeshtë dhe vetëm për vënien në dijeni, por dhe për faktin e qartësisimit, saktësisimit, objektivitetit dhe paanshmërisë në dhënien e opinionit për një çështje të caktuar.*

Një fenomen i tillë ka rezultuar dhe në auditimin e AKBN, Ministria e Drejtësisë, QSUT etj.

### **III. Faza e raportimit dhe evadimit të materialeve të auditimit**

Kjo fazë përmbyllëse e procesit auditues ka përfshirë 9 tregues që nisin me takimin përmbyllës me subjektin në KLSH, vazhdojnë me formën dhe përmbajtjen e Raporteve të auditimit dhe mbyllen me evidencat e auditimit.

**1.** Referuar Rregullores së Procedurave të auditimit (neni 33, pika 2), takimi ballafaques midis niveleve drejtuese të KLSH, grupit të auditimit dhe subjektit të audituar, organizohet nëse kjo kërkohet nga subjekti i audituar dhe/ose nga KLSH, si dhe (pika 3) në këtë takim paraqiten argumentet pro dhe kundër të shoqëruara me fakte për opinionet e audituesve që janë parashtruar në Projekt Raport. Përgjithësisht, në të gjitha rastet dhe nga të gjithë departamentet e auditimit, kjo minifazë e procesit auditues është shndërruar në një formalitet sa që në të ardhmen mund të sjellë humbjen e interesit të subjekteve audituese për të marrë pjesë në këto ballafaqime (kur bëhen me kërkesën e KLSH). Kjo vjen si rezultat i asaj që as subjektet, por as grupi i auditimit, nuk kanë se çfarë të demonstrojnë më shumë se kur ishin në subjekt; edhe për shkak të një lloj qëndrimi të pandryshuar të audituesve, si dhe të mungesës së dokumentimit dhe reflektimit të tyre në Raportin përfundimtar të auditimit.

**2.** Për departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore (në AZHBR, AKBN, AKU etj.); por edhe për atë të Vetëqeverisjes Vendore (bashkia Pukë, Tirana parking etj.); të Aseteve dhe Mjedisit në DSHMPU-Fier; të Shoqërive Publike për Ujësjiellës Kanalizime Pogradec dhe të Performancës për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, forma dhe përmbajtja e Projektraportit dhe Raportit përfundimtar të auditimit nuk kanë rezultuar sipas kërkesave të dokumenteve standarde të Rregullores së auditimit. Kështu, konstatohet se: përmbledhja ekzekutive nuk është përmbledhje; përshkrimi i gjetjeve nuk është kryer sipas standardit ku të jenë përcaktuar gjithë elementët e saj; trajtimi i drejtimeve të auditimit humbet në përshkrime të panevojshme; testet e përdorura në arritjen e konkluzioneve në disa raste nuk janë të mjaftueshme; kanë probleme formatimi, kanë një vëllim jo optimal që nuk është në raport me gjetjet etj.

Për disa auditime si Dega doganore Elbasan, ISSH (Departamenti i Auditimit të Buxhetit); AKBN, AKU, Ministria e Drejtësisë (Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore) dhe Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec (Departamenti i Auditimit të Shoqërive publike) raportet e auditimit janë përgatitur jashtë afateve të përcaktuara në Rregulloren e procedurave të auditimit.

**3.** Megjithëse dhënia mendimeve në kohë dhe sipas hierarkisë përkatëse për Raportin përfundimtar dhe Projektvendimin është një nga elementët e rëndësishëm për sigurimin e cilësisë, në Departamentin e Auditimit të Buxhetit për 5 nga 9 auditimet e marra në shqyrtim për cilësinë rezulton se: mungon mendimi i Drejtorit të Departamentit dhe/ose Drejtorit të Përgjithshëm për auditimin e FSDKSH, Degës Doganore Elbasan, ISSH, Drejtoria e Thesarit (për këtë mungon dhe mendimi i Kryeaudituesit) dhe Drejtoria e Harmonizimit. Dhe në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike janë vërejtur raste të tilla për auditimet e Ujësjiellës-Kanalizime Pogradec dhe Projekti në AKU.

4. Në evidencat e rezultateve të auditimit mungon formulari si p.sh për Verifikimin e Cilësisë së Auditimit, sipas përcaktimeve në Rregulloren e procedurave të auditimit për 7 nga 9 dosjet e Departamentit të Auditimit të Buxhetit, si dhe për Ujësjellës kanalizime Pogradec SHA e Hekurudha Shqiptare SHA të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike.

Në mënyrë të detajuar, çështjet e veçanta të kontrollit të cilësisë dhe të zbatimit të standardeve për vitin 2019 për secilën dosje, ju janë bërë të ditura secilit Departament auditimi në analizën vjetore të zhvilluara gjatë ditëve të fundit.

Përmirësimi i cilësisë së auditimit është një sfidë e madhe me të cilën përballen të gjitha Institucionet Supreme të Auditimit, e cila ndikon në reputacionin dhe besueshmërinë e tyre tek subjektet e audituara, parlamentarët dhe opinioni publik, dhe në fund të fundit shpreh aftësinë për të përmbushur mandatin e saj KLSH.

#### **IV.4 Zbatimi i rekomandimeve të adresuara në Raport Progresin e KE-së publikuar në Prill 2019**

Progres Raportet e Komisionit Evropian, janë konsideruar në vijimësi si dokumente të rëndësishëm për përcaktimin e prioriteteve zhvillimore institucionale INTOSAI-t dhe EUROSAT-t, si dhe për të kontribuar për një qeverisje të mirë, në kuadrin e forcimit të përgjegjshmërisë menaxheriale në administrimin e fondeve publike. KLSH, ka konsideruar si një nga partnerët më të rëndësishëm në procesin e reformimit dhe modernizimit të KLSH-së drejt përafrimit me praktikën e “*Acquis Communautaire*”, të BE-së vlerësuar si tejet të rëndësishëm dhe strategjik ndihmesën dhe këshillimin ndër vite të dhëna në vijimësi nga Komisioni Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Delegacioni i BE-së në Shqipëri nën konsiderimin si një nga partnerët më të rëndësishëm në procesin e reformimit dhe modernizimit të KLSH-së.

Raporti Progresi i Komisionit Evropian për Shqipërinë i publikuar në Maj të vitit 2019 për kapitullin 32- Auditimi i jashtëm adresoi rekomandimet si më poshtë:

- Sigurimi implementimit të plotë të Kuadrit Ligjor të SAI;
- Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së punës audituese;
- Shqipëria duhet të sigurojë implementim më sistematik dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

KLSH zbatimin e rekomandimeve të adresuar nga Progres Raporti i KE i publikuar në Maj të vitit 2019 e konsideron ndër objektivat parësore në politikat menaxheriale të veprimtarisë institucionale duke e konkretizuar në Planin e Veprimit mbi rekomandimet e KE-së për KLSH-në, miratuar nga Kryetari me shkresën nr. 516, datë 15.07.2019. Ky plan veprimi iu adresua Delegacionit të EU në Tiranë dhe Kryetarit të Kuvendit me shkresën nr. 526 prot., datë 18.07.2019.

Këto rekomandime janë kthyer tashmë në objektiva të veprimtarisë së KLSH duke u harmonizuar me Objektivat Strategjike Institucionale të Strategjisë Për Zhvillim 2018 -2022.

**Rekomandim. Sigurimi implementimit të plotë të Kuadrit Ligjor të SAI.**

KLSH ne funksion te sigurimit të kuadrit ligjor në përputhje me “Acquis Communautaire” me shkresën nr. 926 prot., datë 02.08.2018 “Dërgohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së” ka dërguar në Kuvend propozimet për ndryshime në Ligjin nr. 154/2014. Po kështu është ridërguar ne Kuvend përsëri me shkresën nr. 164 prot., datë 30.01.2020 “Ri dërgohet projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, duke synuar arritjen e nivelit më të lartë të institucionit si një nga parakushte themelore për të siguruar paanshmërinë dhe objektivitetin e auditimeve. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.154/2014, Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", sjell një sërë risish të cilat do të ndikojnë pozitivisht në ushtrimin me efikasitet nga KLSH të kompetencave të tij kushtetuese, si dhe do të sigurojë një shkallë përafrimi më të madhe me “Acquis Communautaire”.

Projektligji synon kryerjen e një sërë ndryshimeve, shtesave dhe riformulimeve në përcaktimet aktuale të bëra në nenet e Ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe që lidhen me çështjet e mëposhtme:

1. Certifikimi si "auditues të jashtëm në sektorin publik" dhe krijimi në KLSH i një qendre të hapur trajnimi dhe certifikimi multidisiplinore.
2. Moskufizimi i KLSH-së në auditimin e fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Evropian.
3. Saktësimi në ligj i kompetencës së plotë juridiksionale audituese të KLSH-së në auditimin e të gjitha subjekteve (1) publike apo (2) private, të angazhuara, pjesëmarrëse dhe palë në fushat dhe kontratat: (1) koncensionare; (2) prokurimit publik; dhe (3) partneritetit publik-privat.
4. Saktësimi në ligj i kompetencës së plotë juridiksionale audituese të KLSH-së në auditimin e (1) personave juridikë publikë ku përfshihen edhe entet rregullatorë si p.sh. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) si dhe auditimin e (2) Bankës Qendrore të shtetit.
5. Legjitimimi i KLSH-së si palë në proceset gjyqësore të iniciuara në bazë të kallëzimeve penale të bëra nga KLSH.
6. Plotësimi i kompetencave dhe detyrave ligjore të Kryetarit të KLSH-së.
7. Saktësimi i emërimit të raportit vjetor që Këshilli i Ministrave paraqet çdo vit në Kuvend në lidhje me zbatimin e buxhetit.

***Rekomandim: -Përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së punës audituese.***

KLSH është fokusuar në fuqizimin e kapaciteteve të auditimit, si në kompletimin e një kuadri rregullator metodologjik cilësor ashtu dhe në rritjen e aftësive dhe njohurive të audituesve në funksion të kryerjes së veprimtarisë audituese në përputhje me kërkesat e Standardeve të INTOSAI-t, ISSAI.

Miratimi dhe vënia në zbatim e Rregullores së Procedurave të Auditimit si dhe Manualeve dhe Udhëzuesve lidhur me auditimin e fushave specifike kanë ndihmuar KLSH që ISSAI-t të gjejnë zbatim në punën audituese.

- *Mbi menaxhimin e cilësisë së auditimit.* Në këtë aspekt është synuar në vendosjen dhe aplikimi i një sistemi efektiv për menaxhimin e cilësisë së auditimit, i cili siguron përdorimin e suksesshëm të dy elementëve për Kontrollin dhe Sigurimin e Cilësisë në planifikimin, kryerjen, raportimin dhe mbikëqyrjen e punës audituese. Me Vendimin nr. 9, date 22.07.2019 “Për miratimin e udhëzuesit për menaxhimin e cilësisë së Auditimit” është miratuar Udhëzuesi “Për Menaxhimin e Cilësisë, udhëzues ky i hartuar në kuadrin e implementimit të Projektit të binjakëzimit IPA nën suportin dhe ekspertizën e SAI-t Kroat.

Në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI 40 dhe ISSAI 5600); Rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH-së Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, si dhe Udhëzuesit “Për menaxhimin e cilësisë” KLSH ka realizuar sigurimin e cilësisë nëpërmjet kontrollit vjetor në “të ftohtë” të mbi 30% të dosjeve të auditimit të vitit 2019 ose të 36 dosjeve. Në këtë proces u angazhuan 11 auditues me përvojë dhe mbi këtë bazë është përgatitur *Raporti i Sigurimit të Cilësisë dhe adresimi i rekomandimeve* për përmirësimin e cilësisë audituese për vitin 2019, e cila është pjesë e Raportit Vjetor të Performancës së KLSH për vitin 2019.

-*Kryerja e Trajnimeve të Stafit mbi Sistemin e Kontrollit dhe Sigurimit të Cilësisë.* Janë kryer trajnime gjatë vitit 2019, duke filluar me trajnim “nëpërmjet punës” dhe është vazhduar me tema individuale dhe të përbashkëta mbi cilësinë e auditimeve. Periodikisht janë zhvilluar tryeza mbi analizën e dosjeve të auditimit, bazuar në ISSAI 40 dhe zbatimin e kërkesave të Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH.

- *Manuali “Për zbulimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar në auditim” i*

Manuali udhëzues “Për zbulimin e korrupsionit dhe mashtrimit financiar në auditim” i miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 80 datë 30.06.2018 u hartua nën suportin dhe ekspertizën e NIK-ut të Polonisë rezultat i implementimit të projektit të binjakëzimit IPA 2013.

Manuali udhëzues është pjesë e kuadrit rregullator dhe procedural dhe KLSH do të vijojë me implementimin e tij gjatë veprimtarisë audituese. Trajnime mbi auditimin e mashtrimit dhe korrupsionit kanë qenë pjesë e programit vjetor të trajnimit për audituesit e KLSH-së, ku paketa e trajnimit prezantues për audituesit e rinj të zhvilluar në nëntor-dhjetor 2019 përfshiu tema për këtë fushë.

- Në drejtim të Auditimit të IT, veprimtaria audituese kryhet bazuar miratuar me Vendim të Kryetarit nr 171 datë 27.11.2018 “Për miratimin e Manualit Aktiv të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit”.

-*Manuali i Auditimit të Prokurimeve.* Duke u fokusuar në rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm që auditimi i jashtëm publik ka në mbrojtjen e interesave të Shtetit në fushën e prokurimeve, KLSH u mbështet nga Banka Botërore nëpërmjet Projektit “Rritja e Performancës së Prokurimit” i cili kishte si Objektiv: forcimin dhe zhvillimin e monitorimit të pajtueshmërisë dhe rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit publik si dhe rritjen e kapaciteteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të audituar prokurimin e kontratave publike dhe kontratat e financuara nga donatorët në Shqipëri.

Produkt i këtij projekti ishte *Manuali i Auditimit të Prokurimeve* miratuar me Vendim të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.249, datë 28.12.2018.

-Krahas sa më sipër, me mbështetjen e SIGMA, KLSH *po harton Udhëzuesin Standard për zbatimin e Buxhetit të Shtetit*, i cili do të ndihmojë audituesit në formësimin dhe formatimin e procesit të auditimit të ekzekutimit të buxhetit të shtetit duke synuar standarde të larta dhe punë cilësore të auditimit.

-Projekti *“Forcimi i kapaciteteve në auditimin e prokurimeve publike, koncensioneve dhe PPP-ve”*. Kontratat e partneritetit publik-privat konsiderohen si një zonë me rrezik të lartë dhe me qëllim të rritjes së numrit dhe cilësisë së auditimeve të KLSH-së në vlerësimin e PPP-ve duke forcuar kapacitetin e auditimit të ALSAI në fushën e auditimit të kontratave të PPP-ve, KLSH me *mbështetjen e SECO* do të përqendrohet në trajnimin e audituesv për kornizën ligjore të PPP, kërkesat e legjislacionit Evropian dhe zhvillimin e udhëzimeve specifike për të ndihmuar audituesit në auditimin e PPP-ve. Projekti do të ketë një kohëzgjatje 2 vjeçare dhe marrëveshja për fillimin e tij u nënshkrua në ambientet e KLSH-së, në datën 9 mars 2020 nga Kryetari i KLSH-së, dhe nga Ambasadori i Konfederatës Zvicerane në Republikën e Shqipërisë. Objektivi i përgjithshëm i projektit është të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe frenimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP).

- ***Rekomandim “Shqipëria duhet të sigurojë implementim më sistematik dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm”***

Në funksion të implementimit të këtij rekomandimi KLSH është fokusuar në intensifikimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me Parlamentin.

Dokumenti “Udhëzues për institucionalizimin e marrëdhënieve KLSH –Parlament” miratuar nga Kryetari i KLSH në Qershor 2018 reflekton drejtimet se si Institucioni do të adresojë veprimet e tij për një bashkëpunim më efektiv, në mënyrë të veçantë në mbështetjen e KLSH për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

*i) Mbi adresimin e kërkesës për krijimin e nënkomisionit*

KLSH në vijimësi ka insistuar në adresimin e kërkesës Kuvendit për krijimin e Komisionit parlamentar i dedikuar për shqyrtimin e Raporteve të KLSH-së. Së fundmi Kryetari i KLSH-së me shkresën nr 737 datë 02.10.2019 drejtuar Kryetarit të Kuvendit ka kërkuar krijimin e Nënkomisionit të posaçëm për shqyrtimin e raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ne kete shkrese Kryetari thekson qe : *Krijimi i këtij nënkomisioni parlamentar do të mundësonte institucionalizimin e praktikave më të mira në Komunitetin e INTOSAI-t si dhe do të ndikonte në rritjen e efektivitetit të auditimit të jashtëm publik për mirëqeverisjen dhe përmirësimin e efektivitetit, ekonomikitetit dhe eficiencës në përdorimin e fondeve publike. Në këtë kontekst, do të vlerësonim ndërhyrjen tuaj për realizimin e këtij projekti si një nga mekanizmat e vlerësuar edhe nga partnerët tanë ndërkombëtare BE dhe SIGMA”.*

*ii) Mbi nënshkrimin e një Memorandumi/Protokolli Bashkëpunimi KLSH/Kuvend*

Bazuar në praktikat më të mira të INTOSAI-t për bashkëpunimin mes Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Parlamenteve, KLSH ka përgatitur Udhëzuesin për institucionalizimin e marrëdhënieve të KLSH-së me Parlamentin.

Në këtë Udhëzues është parashikuar edhe nënshkrimi i një Memorandumi të gjerë kuadër mes KLSH-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, i cili do të përfshijë jo vetëm fuqizimin e ndjekjes parlamentare për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, por edhe një *axhendë konkrete për zbatimin e rekomandimeve kryesore të KLSH-së në këto vite*, për draftimin dhe miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Materiale të Nëpunësit Publik, për kufirin e borxhit publik, si dhe angazhimin juridik të Qeverisë për nxjerrjen e Urdhrit për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga ana e institucioneve në varësi të saj, etj. Me shkresën nr.737/1, datë 15/11/2019, drejtuar Kryetarit të Kuvendit KLSH ka adresuar kërkesën për mbështetjen e Kuvendit të Shqipërisë për konkretizimin e këtij Memorandumi dhe ngritjen e një grupi të përbashkët pune për hartimin e Draft-Memorandumit dhe për hartimin e një plani pune për finalizimin e tij.

*iii) Caktimi i strukturës koordinuese të marrëdhënieve me Parlamentin.*

KLSH ka caktuar Drejtorinë e Komunikimit Publikimeve dhe Marrëdhënieve me jashtë si struktura përgjegjëse për sigurimin e marrëdhënieve të vazhdueshme me Komisionin e Ekonomisë dhe Financave e komisioneve të tjera parlamentare.

*iv) Informimi i Komisioneve Parlamentare me Raportet/Vendimet e Auditimeve*

Me synimin e përmbushjes së qëllimit të tretë të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018-2022, atë të forcimit të komunikimit dhe bashkëpunimit, KLSH përveç përmbushjes së detyrimit kushtetues të raportimit për zbatimin e buxhetit faktik dhe raportimit mbi performancën e institucionit ka synuar informimin e Kuvendit edhe përmes raporteve të veçanta të cilat paraqesin rëndësi të veçantë për publikun. KLSH i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë 131 vendime dhe raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2018 dhe 135 vendime dhe raporte për auditimet e kryera gjatë vitit 2019.

*v) Informimi i Kuvendit rreth statusit të zbatimit të rekomandimeve.*

Për një monitorim sa më efektiv të veprimtarisë së institucioneve kushtetuese Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Vendimin nr. 134/2018, „Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik“ të këtyre institucioneve.

Bazuar në këtë dokument institucionet e pavarura kushtetuese duhet te raportojnë mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve adresuar ne entitetet publike.

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 134/2018 “Për Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik të këtyre institucioneve” KLSH edhe gjatë vitit 2019 i ka përcjellë Kuvendit informacion lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit të datës 19.07.2018. Një informacion më i detajuar për këtë çështje i është përcjellë Kuvendit në datën 18 janar 2019.Me qëllim informimin e Kuvendit lidhur me statusin e implementimit të rekomandimeve të KLSH lënë institucioneve të audituara dhe me synimin e mbështetjes së këtij të fundit për të rritur llogaridhënien dhe transparencën e përdorimit të parasë publike, krahas raportit të performancës, KLSH me shkresën nr. 230/2, datë 08.04.2019 i ka përcjellë Kuvendit një raport të veçantë të detajuar për implementimin e rekomandimeve për periudhën tetor 2017- qershor 2018. Gjithashtu në dhjetor 2019, KLSH i ka përcjellë Kuvendit raportin e zbatimit të rekomandimeve për periudhën janar-dhjetor 2018 (me shkresën nr.230/7 prot.,

datë 31/12/2019). Theksojmë se raportet e sipërcituara i janë përcjellë edhe Ministrit për Marrëdhëniet me Kuvendin.

*v. Mbi ngritjen dhe funksionimin e Platformës Ndërinstitucionale Online për statusin e zbatimit të rekomandimeve.*

Aktualisht KLSH po bashkëpunon intensivisht me Njesinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese të Kuvendit dhe po vijon me përmbushjen e detyrimeve në rolin e kontribuesit me të dhënat për statusin e zbatimit të rekomandimeve nga çdo entitet. Deri në fund të muajit Mars 2020 ka përfunduar përcjellja e të dhënave për statusin e implementimit të rekomandimeve për auditimet e kryera në institucionet qendrore gjatë vitit 2018. Kjo platformë konsiderohet si një instrument efektiv për rritjen e kontrollit parlamentar nga ana e Kuvendit të Shqipërisë mbi ekzekutivin për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-se.

**- Mbi adresimin Kuvendit të ndryshimeve të ligjit organik të KLSH-së “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”**

Projektligji për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” është dërguar pranë Kuvendit të Republikës me shkresë nr. 926 prot., datë 02.08.2018 si dhe ridërguar me shkresë nr. 164 prot., datë 30.01.2020.

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.154/2014, Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", sjell një sërë risish të cilat vlerësojmë se do të ndikojnë pozitivisht në ushtrimin me efikasitet nga KLSH të kompetencave të tij kushtetuese.

Për herë të parë në projektligj parashikohet domosdoshmëria e certifikimit si "auditues i jashtëm në sektorin publik" e punonjësve aktual të KLSH-së dhe gjithë punonjësve të rinj që do të rekrutohen nga KLSH-ja, përmes një procesi sistematik dhe të planifikuar trajnimi, zhvillimi profesional, i cili përfshin shtimin dhe përditësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme në kryerjen me efektivitet të detyrave të auditimit. Sipas parashikimeve të projektligjit, certifikimi si "auditues i jashtëm në sektorin publik", si dhe dhënia e certifikatave të tjera kualifikuese, mund t'iu ofrohet edhe personave të tjerë të cilët nuk janë në marrëdhënie pune me KLSH-në. Projektligji parashikon edhe pozicionin e "asistent audituesit". Punonjësit e rinj që do të rekrutojë KLSH pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të propozuara në këtë projektligj, të cilët nuk do të zotërojnë certifikatën "auditues i jashtëm në sektorin publik" ose një certifikatë tjetër ndërkombëtare të barasvlershme me të, pavarësisht faktit nëse kanë apo jo statusin e nëpunësit civil, nuk do të kryejnë veprimtari audituese, por veprimtari ndihmëse në funksion të procesit të auditimit, kjo me qëllim rritjen e profesionalizmit dhe aftësive të tyre përmes proceseve trajnuese, certifikuese.

Nëpërmjet procesit të certifikimit KLSH do të mund të gjenerojë të ardhura, të cilat do të mbulojnë kostot e këtij procesi, duke u mundësuar ngritja e një qendre trajnimi multidisiplinore dhe mos rëndimi i buxhetit të shtetit me fonde shtesë për nevojat e këtij procesi. Nëpërmjet qendrës së trajnimit KLSH maksimizon 3E-të (ekonomiciteti, eficaenca, efektiviteti) e investimeve që vazhdimisht bën për trajnimin e stafit të saj jashtë shtetit. Në rast se KLSH do të mund të krijojë një qendër të

tillë, do të ketë mundësi të transmetojë gjithë njohuritë dhe eksperiencën e akumuluar në vite dhe të certifikojë pjesëmarrësit në lidhje me këto njohuri. Ofrimi nga KLSH i një procesi të vazhdueshëm trajnimit dhe certifikimit mundëson sigurimin dhe ruajtjen e një cilësie të vazhdueshme në kryerjen e misionit të tij kushtetues të auditimit, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në vend, duke kontribuar në mirëqeverisje dhe mirëmenaxhim të ekonomisë, financiar dhe pronës publike.

Gjithashtu, parashikimet e këtij projektligji krijojnë edhe bazat juridike për gradimin e punonjësve të KLSH-së, proces ky i lidhur ngushtë me procesin e certifikimit.

Projektligji, me qëllim: mbrojtjen e fondeve dhe asetëve publike, kryerjen e auditimeve sa më të plota, të sakta dhe gjithëpërfshirëse; garantimin e të drejtave të subjekteve private palë në procedura prokurimi, koncensionit, partneritetit publik-privat, interesat e të cilave, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, realisht janë prekur nga auditimet dhe rezultatet e tyre; harmonizimin e parashikimeve ligjore me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit parashikon saktësimin e kompetencës së plotë juridiksionale të KLSH-së në auditimin e të gjithë subjekteve (publike apo private) të angazhuar, pjesëmarrës ose palë në fushat dhe kontratat koncensionare, të prokurimit publik, të partneritetit publik-privat.

Të tre këto fusha kanë lidhje me kompetenca sensitive, në të cilat dukshëm në praktikë janë evidentuar një sërë problematikash të mëdha lidhur me administrimin që institucionet shtetërore ju kanë bërë fondeve apo pronës publike/shtetërore. Në këto marrëdhënie, subjektet private hyjnë në marrëdhënie kontraktore me karakter publik, për shkak të subjektit publik me të cilin kontrakttojnë ose hyjnë në marrëdhënie, si dhe për shkak të karakterit publik të shërbimeve apo punëve të cilat angazhohen të kryejnë.

#### Projektligji

- në përgjigje të pengesave praktike të hasura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit lidhur me ushtrimin e kompetencave të tij audituese;
- në funksion të përdorimit me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet të fondeve, pronës publike dhe asaj shtetërore; zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm menaxhimi financiar;
- duke marrë në konsideratë praktikën e institucioneve homologe supreme të auditimit saktëson kompetencat e KLSH për auditimin e personave juridik publik ku përfshihen në mënyrë taksative entet rregullatore, Banka Qendrore e Shtetit.

Në projektligj, në respektim të detyrimit për harmonizim të legjislacionit tonë me të drejtën e Bashkimit Evropian, është propozuar moskufizimi i kompetencës audituese të KLSH-së për auditimin e fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Evropian, ndërsa në respektim të parimit kushtetues të hierarkisë së akteve, projektligji parashikon ndryshimin e aktit përmes së cilit mund të kufizohet kompetenca e KLSH-së për auditimin e përdoruesve të fondeve publike të ofruara nga organizata ndërkombëtare të ndryshme nga Bashkimi Evropian. Harmonizimi i legjislacionit me të drejtën e BE-së dhe respektimi i parimit të hierarkisë së akteve

janë detyrime, zbatimi i të cilave duhet domosdoshmërisht të pasqyrohet në sistemin juridik shqiptar.

Projektligji parashikon gjithashtu të drejtën e Kryetarit të KLSH për të bërë, në përputhje me ligjin "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror", klasifikim të dokumenteve të auditimit, raporteve. Kjo me qëllim që KLSH, në rastin e gjetjeve audituese publikimi i të cilave mund të çojë në cenim të sigurisë kombëtare, të bëjë klasifikim të këtyre dokumenteve. Kontrolli i Lartë i Shtetit, për shkak të karakterit të funksioneve të tij (audituese) bën dhe mund të bëjë gjetje, mosklasifikimi i të cilave mund të cenojë sigurinë kombëtare dhe vetë stabilitetin e vendit, si rrjedhojë vlerësojmë se nuk është efektiv e në përputhje me pavarësinë e KLSH-së diskrecioni i vetëm i Kryeministrit për të vlerësuar, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 8457/1999 "Për informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror", të ndryshuar, përfshirjen ose jo të drejtuesit të KLSH në Regjistrin Shtetëror të Informacionit të Klasifikuar.

## **IV.5 Financat e KLSH dhe auditimi i tyre**

### ***IV.5.1 Treguesit buxhetor dhe Financiar të vitit 2019***

Politika buxhetore dhe ajo menaxheriale e KLSH-së është fokusuar në përmbushjen me cilësi të lartë dhe në kohë të detyrimeve ligjore, të objektivave si dhe prioriteteve të institucionit të parashikuar në Planin e Zhvillimit Strategjik, 2018-2022, duke konsideruar kërkesat e organizmave ndërkombëtarë të auditimit dhe të BE-së të përcaktuara në MSA-në e Shqipëri-BE në kuadrin e Integritimit Evropian.

Gjatë vitit 2019, menaxhimi u fokusua në angazhimin për zbatimin rigoroz të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së 2018 - 2022 në lidhje me qëllimet dhe objektivat vjetore që nga rritja e impaktit të punës audituese me fokus në 6 E-të, optimizimin e kapaciteteve profesionale, aftësive audituese, procedurave të punës, administrative, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse deri tek forcimi i komunikimit dhe bashkëpunimit.

Menaxhimi institucional është fokusuar në sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm duke konsideruar implementimin e objektivave strategjike si një proces dinamik të rivlerësimit, përditësimit, të dimensioneve të objektivave strategjike. Njëherazi është proceduar me sigurimin e monitorimit të planit strategjik si një proces, i cili mundëson përditësimin e objektivave duke i shtuar vlerë strategjisë për zhvillim institucional. Raportet e monitorimit kanë shërbyer edhe si një instrument informimi dhe transparence për palët e interesit si publiku, Kuvendi e Komisioni Evropian, dhe të gjitha organizmat ndërkombëtarë të cilëve u mundësohet në këtë mënyrë vlerësimi i progresit të zhvillimit Institucional.

Në zbatim të Ligjit 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 22760/92 Prot., datë.17.01.2019, si dhe shkresës nr. 22760/68 datë 14.01.2019 është bërë miratimi i çeljes së fondeve buxhetore për vitin 2019, për institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Bazuar sa më sipër është kryer detajimi i fondeve të planifikuara konform kërkesave dhe afateve të përcaktuara në kuadrin rregullator të zbatimit të buxhetit.

Buxheti i akorduar për programin "Veprimtari audituese e KLSH-së" viti 2019, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2019-2021 dhe është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikën e

Programit. Në zbatim të procedurave KLSH ka dizajnuar Pemën e Programit Buxhetor referuar arkitekturës së elementeve hierarkike i) *struktura e objektivave* ii) *treguesit e performances* iii) *treguesit e projekteve dhe produkteve*.

Në vijimësi përgjatë vitit 2019, konform procedurave është kryer monitorimi, konsideruar ky si një instrument efektiv dinamik për ndjekjen e performancës së fondeve buxhetore në funksion të arritjes së objektivave të politikës së institucionit të KLSH-se.

Monitorimi i treguesve buxhetore ka synuar në ndjekjen në vijimësi të objektivave të përcaktuar në Deklaratën e politikës së programit të KLSH-së të përfshirë në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022.

Nëpërmjet monitorimit KLSH ka evidentuar statusin e realizimit të produkteve kryesore, nivelin e realizimit të fondeve buxhetore të KLSH-së të detajuar në kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar duke mundësuar në këtë mënyrë riorientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar procesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas zërave për 2019 paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 10 Fondet e alokuara sipas artikullit 2019

Mijë lekë

EMERTIMI ARTIKULLIT	BUXHETI PLAN FAKT			Diferenca	Në % Realizim Vjetor
	Plani fillestar 2019	Plani Perfundimtar 2019	Fakti Janar-Dhjetor 2019		
Paga	260.600,00	260.600	256.179,8	4.420,2	98%
Sigurime Shoqërore	46.300,00	46.300	39.925,7	6.374,3	86%
Mallra dhe Shërbime të Tjera	90.850,00	90.850	79.462,8	11.387	87 %
Transferta Korente të Huaja	150,00	150	117,2	32.8	78%
Transf. për Buxh. Familjare & Individ	1.200,00	1.200	1.133,2	67	94%
Shpenzime Korrente	399.100,00	399.100	376.818,8	22.281	94%
Investime me Financim të Brendshëm	20.000,00	20.000	190	19.810	10%
Shpenzime Kapitale	20.000,00	20.000	190	19.810	10%
Korrente dhe Kapitale	419.100,00	419.100	377.008,9	42.091	90%

Burimi: KLSH

Në total shpenzimet buxhetore për vitin 2019 me financim të brendshëm, janë programuar në vlerën 419.100 mijë leke, realizuar në vlerën 377.009,9mijë lekë ose 90%, ku shpenzimet korente janë programuar në vlerën 399.100 mijë leke dhe janë realizuar në vlerën 376.818 mijë lekë, ose 94%. Shpenzimet kapitale janë programuar në vlerën 20.000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 190 mijë leke.

1. *Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore.* Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2019 për zërin Paga dhe Sigurime është 306,900 mijë lekë dhe shpenzuar në shumën 296,104 mijë lekë ose 97. % e planit vjetor .

Shuma e shpenzuar në zërin Shpenzime Personeli, përfshin pagat e punonjësve të KLSH-së dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar komform shkresave dhe kontratave të nënshkruara me ta.

2. *Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera Operative.* Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për vitin 2019 është 90.850 mijë lekë, ku fond i planifikuar për shpenzime për mallra dhe shërbime, për periudhën Janar-Dhjetor 2019 është shpenzuar në masën 79.462 mijë lekë. Me këtë zë shpenzimesh janë përballuar nevojat administrative të shpenzimeve si: për energji, ujë, telefon etj. Në këtë artikull janë kryer shpenzimet për trajnime jashtë dhe brenda vendit dhe për dieta në funksion të veprimtarisë audituese. Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete janë shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në menaxhim sa më të kujdesshëm dhe përdorim sa më me efektivitet të fondeve.

Në këtë zë shpenzimesh përballohet dhe shpenzimi për mirëmbajtjen e sistemit informatik të veprimtarisë audituese e administrative mbështetëse dhe shpenzimet e transportit, etj. Një pjesë të konsiderueshme në shpenzimet operative zënë shpenzimet për udhëtim e dieta brenda vendit, të nevojshme për realizimin e veprimtarisë audituese në të gjithë territorin e vendit.

3. *Transferta korrente dhe të huaja.* Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2019, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 117 mijë lekë nga 150, mijë lekë të planifikuara.

4. *Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606.* Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, është dhënë Fond i Veçantë me kërkesat e bëra nga ana jonë dhe të konfirmuara nga Ministria e Financave në vlerën 1200 mijë lekë, për daljen e punonjësve në pension, rast sëmundjeje dhe është realizuar në masën 1.133 mijë lekë. Referuar përcaktimeve të kuadrit rregullator ligjor dhe Vendimit nr. 244 date 22.12.2018 si dhe praktikave shkresore me Ministrinë e Financave është alokuar vlera 629,136 leke në shtesë të fondit të veçantë, me destinacion pagesë kalimtare. Në vijim është proceduar me kryerjen e veprimeve për pakësimin këtij fondi nga llogaria 606 konfirmuar nga Ministria e Financave me shkresën nr. 5868/6, datë 16.12.2019.

5-*Shpenzime për investime kapitale.* Bazuar në Ligjin nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale me Financim të Brendshëm ishte në shumën 20.000 mijë lekë. Bazuar në kriteret e kuadrit rregullator janë kryer procedurat e detajimit të fondeve konform përcaktimit në Planin Buxhetor Afatmesëm. Për dy zërat kryesorë të investimeve “blerje automjete” dhe “pajisje kompjuterike” KLSH adresoi për kryerje të procedurave të prokurimeve në Agjensinë e Blerjeve të Përqendruara dhe AKSHI.

-Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për blerjen e 3-automjeteve, për plotësimin e nevojave në vlerën 9,700 mijë lekë, nuk është realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, si institucioni i autorizuar për kryerjen e këtyre procedurave për këtë kategori aktivi me pasojë mosshpenzimin e fondeve.

- Blerje pajisje kompjuterike. Fondi vjetor i detajuar është 10,000 mijë lekë. Ky fond nuk u prokurua brenda vitit 2019, nga AKSHI si institucion i autorizuar për kryerjen e prokurimeve për këtë kategori aktivi duke sjellë për pasojë mosrealizimin e fondeve të investimeve në këtë zë.

Te dy institucionet e ngarkuara për kryerjen e prokurimeve të përqendruara të institucioneve me veprimet e mosveprimet e tyre sollën për pasojë mosperfundimin e procedurave të prokurimeve brenda vitit 2019 dhe djegien e fondeve të KLSH-së aq të domosdoshme për krijimin e kushteve logjistike, administrative, mbështetëse në funksion të ushtrimit të veprimtarisë institucionale në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore.

- Blerje paisje zyrash, fondi i planifikuar në këtë zë është 300 mijë lekë. Per 12-mujorin në këtë zë janë kryer shpenzime në vlerën 190 mijë lekë. Në këtë kategori investimi është proceduar me blerjen e orendive dhe pajisjeve të zyrave të nevojshme për funksionimin normal veprimtarisë administrative mbështetëse.

#### ***IV.5.2 Konkluzion i auditit të brendshëm mbi Pasqyrat Financiare 2019***

Objekti i këtij auditimi është që të japë një gjykim të përgjithshëm mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në Kontrollin e Lartë të Shtetit, dhënien e një opinioni mbi zbatimin e buxhetit të vitit 2019, si dhe rregullshmërinë e transaksioneve të pasqyruara në pasqyrat financiare të institucionit.

Qëllimi i këtij auditimi është vlerësimi i aktivitetit të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Fushëveprimi i këtij auditimi është aktiviteti ekonomik financiar për periudhën nga 01.01.2019 deri më 31.12.2019.

Kriteret e vlerësimit: Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të institucionit, normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit dhe manualeve përkatëse si dhe standardet e pranuar dhe të sanksionuara me ligj.

#### **Rezultatet e auditimit**

##### ***Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm***

Gjatë auditimit u vlerësua implementimi i komponentëve të menaxhimit si Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit dhe Informimi e Komunikimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Nga auditimi është arritur në konkluzionin se, KLSH përgjatë vitit 2019 ka vijuar me veprimtarinë menaxheriale institucionale suportuar nga një qeverisje e brendshme efektive dhe mirë funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm me qëllim sigurimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe përmbushjen e objektivave Strategjike në nivelin e pritshmërive të synuara drejt konsolidimit të reformave të ndërmarra, në përputhje me detyrimet kushtetuese, standardet ndërkombëtare të auditimit, ISSAI, me rekomandimet e Progres Raporteve të BE dhe me pritshmëritë e Kuvendit, publikut dhe të gjitha palëve të interesit. Menaxhimi i ndryshimit dhe zhvillimit institucional është realizuar duke konsideruar implementimin e

objektivave strategjike si një proces dinamik duke proceduar me rivlerësimin, përditësimin, përshtatur dhe zgjeruar dimensionet objektivave strategjike. Njëherazi është proceduar me sigurimin e monitorimit të planit strategjik si një proces, i cili mundëson përditësimin e objektivave duke i shtuar vlerë strategjisë për zhvillim institucional.

### **Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2019 në Kontrollin e Lartë të Shtetit**

Programimi dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2019, është në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe në vijim të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9 datë 06.02.2018, “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, si dhe të UMF nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në NJQQ”, për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2019.

Buxheti i akorduar për programin “Veprimtari audituese e KLSH-së”, ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2019-2021 në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës dhe Programit.

Në zbatim të Ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, është bërë miratimi i çeljes së fondeve buxhetore për vitin 2019 për Institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Fondet e alokuara për funksionimin e aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe realizimi sipas zërave për 2019 paraqiten si më poshtë:

*Tabela nr.11* Fondet e alokuara të planifikuara dhe të realizuara

*Në mijë lekë*

Grupi	24	Kodi 1024001			
Programi	Veprimtari Audituese e KLSH	Titulli 1120			
Artikulli / Kodi	Emërtimi i artikullit	Buxheti Plan - Fakt		Diferenca	Realizimi në %
		Plani Buxhetor 2019	Fakti 2019		
1	2	3	4	03-Apr	04-Mar
600	Paga	260,600	256,180	4,420	98%
601	Sigurime Shoqërore	46,300	39,926	6,374	86%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	90,850	79,463	11,387	87%
605	Transferta Korente të Huaja	150	117	33	78%
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	1,200	1,133	67	94%
<b>Shuma</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>399,729</b>	<b>376,819</b>	<b>22,910</b>	<b>94%</b>
230+231	Invest. me Financ. te brendsh.	20,000	190	19,810	10%

<b>Shuma</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>20,000</b>	<b>190</b>	<b>19,810</b>	<b>10%</b>
<b>Totali</b>	<b>Korrente dhe Kapitale</b>	<b>419,100</b>	<b>377,009</b>	<b>42,091</b>	<b>90%</b>

Burimi: KLSH

Analiza e shpenzimeve:

1. Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore.

Fondet buxhetore me destinacion shpenzime personeli “Për zërin Paga dhe Sigurime shoqërore dhe shëndetësore” për vitin 2019 është në vlerën 306,900 mijë lekë, nga të cilat:

- Shpenzimet faktike përbëjnë 98 % të planit vjetor i cili rezultoi në vlerën 260 600, mijë lekë.
- Fondi i Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është shpenzuar në vlerën 39.925 mijë lekë që përbën rreth 86 % e planit vjetor 2019.

Shuma e shpenzuar në zërin Pagat, Sigurimet Shoqërore dhe Shëndetësore, përfshin si pagat e punonjësve të KLSH si dhe të ekspertëve të jashtëm të përkohshëm të kontaktuar dhe paguar komform kontratave të nënshkuara me ta .

2. Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera Operative .

Fond i alokuar nga buxheti i shtetit për Shpenzimet Mallra dhe Shërbime për vitin 2019 është në vlerën 90.850 mijë lekë, dhe për periudhën Janar-Dhjetor 2019 është realizuar në masën 79.462 mijë lekë.

Me fondet e alokuara në këtë kategori shpenzimesh janë mbuluar shpenzimet për trajnime jashtë dhe brenda vendit si dhe shpenzimet për udhëtime e dieta në funksion të veprimtarisë audituese.

Organizimi dhe pjesëmarrja në këto aktivitete është shoqëruar me kostot përkatëse duke u fokusuar në një menaxhim sa më të kujdesshëm dhe përdorim sa më me efektivitet. Në këtë zë shpenzimesh, është kryer mbulimi i nevojave administrative të shpenzimeve për drita, ujë, telefon si edhe shpenzimet për mirëmbajtjen e sistemit të auditimit, shpenzime transporti etj.

3. Transferta korentë dhe të huaja.

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2019, janë shlyer detyrimet për kuota anëtarësimi për organizatat INTOSAI dhe EUROSAI, në shumën 117 mijë lekë nga 150 mijë lekë të programuara.

4. Transferta për buxhetet familjare. Llogaria 606

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2019, është alokuar Fond i Veçantë sipas kërkesave të bëra nga KLSH-ja dhe të konfirmuara nga Ministria e Financave në vlerën 1200 mijë lekë, për dhënien e shpërblimeve në rastet e mbushjes së moshës së pensionit për punonjësit e KLSH si dhe të rasteve të sëmundjeve në vlerën 1.133 mijë lekë, kryer kjo konform kuadrit ligjor rregullator specifik.

5. Realizimi i shpenzimeve për investime kapitale.

Plani i buxhetit me destinacion Investimet Kapitale është programuar në shumën 20.000 mijë lekë të gjitha këto si Investime me Financim të Brendshëm.

Tabela nr. 12 Analiza e financimit të brendshëm të investimeve

Emërtimi i Projektit/ Financim i Brendshëm	Plani sipas ligjit	Plani i ndryshua r	Fakti	Diferen ca
Blerje pajisje kompjuterike	10.000			10.000
Pajisje te ndryshme zyre	300		190	110
Blerje automjete	9.700			9.700
<b>Totali</b>	<b>20.000</b>		<b>190</b>	<b>19.810</b>

Burimi: KLSH

- Blerje pajisje kompjuterike. Fondi vjetor i detajuar është në shumën 10,000 mijë lekë. Ky fond nuk u prokurua brenda vitit 2019, nga AKSHI si institucion i autorizuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për këtë kategori aktivi.
- Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për blerje “Automjete” për plotësimin e nevojave për automjete, të 3-automjeteve, në vlerën 9,700 mijë lekë. Ky investim nuk është realizuar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara si institucioni i autorizuar për kryerjen e procedurave të prokurimit.

Te dy objektet e investimeve si me sipër nuk u realizuan për shkak të moszbatimit në kohë të procedurave, çka tregon për papërgjegjshmërinë e menaxhimit nga institucionet e autorizuar për kryerjen e prokurimeve, me pasoje të drejtpërdrejta djegien e fondeve të KLSH-se.

- Blerje pajisje zyrash, fondi i planifikuar në këtë zë është 300 mijë lekë. Për vitin 2019, në këtë zë, janë kryer shpenzime në vlerën 190 mijë lekë.

Detajimi i zërave të shpenzimeve të pasqyrave financiare të vitit 2019.

Struktura e shpenzimeve paraqitet si më poshtë dhe konstatohet se pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore zënë 78% të totalit të shpenzimeve.

Tabela nr.13 Struktura e shpenzimeve

Llogaria e shpenzimeve	Emërtimi i Shpenzimeve	Lekë	% ndaj totalit
<b>600</b>	<b>Pagat dhe përfitimet e punonjësve</b>	<b>256,610,484</b>	<b>68</b>
6001	Paga personel i përhershëm	256,610,484	
<b>601</b>	<b>Kontribute të sigurimeve</b>	<b>40,105,464</b>	<b>10</b>
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	35,722,602	
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	4,382,862	
<b>602</b>	<b>Blerje mallra e shërbime</b>	<b>81,522,681</b>	<b>21,6</b>
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	6,774,184	
6021	Materiale dhe shërbime speciale	555,560	
6022	Shërbime nga të tretë	5,540,848	
6023	Shpenzime transporti	4,042,487	
6024	Shpenzime udhëtimi	59,813,975	
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	2,538,294	
6026	Shpenzime për qiramarrje	364,410	
6027	Shpenzime për detyrime e kompensime legale	1,165,200	
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua		

6029	Shpenzime të tjera operative	727,723	
<b>603</b>	<b>Subvencione</b>	<b>0</b>	
	<b>Transferime korente</b>	<b>1,250,466</b>	<b>0,4</b>
<b>604</b>	<b>1.Transferime korente të brendshme</b>	<b>0</b>	
<b>605</b>	<b>2.Transferime korente me jashtë</b>	<b>117,266</b>	
6051	Transferime për Organizatat Ndërkombëtare	117,266	
<b>606</b>	<b>3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë</b>	<b>1,133,200</b>	
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta të paguara nga Institucione të tjera e Organet e Pushtetit Vendor	1,133,200	
<b>63</b>	<b>Ndryshim i gjendjes se inventarit</b>	<b>-2,781,623</b>	
	<b>Shuma</b>	<b>376,707,472</b>	

Burimi: KLSH

#### Përdorimi i fondit të veçantë.

Gjatë vitit ushtrimor 2019, është përdorur fondi i veçantë për shumën totale **1,133,200 lekë**. Ai është përdorur në çdo rast me urdhër të Kryetarit të KLSH-së dhe çeljet e këtyre fondeve janë bërë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vlerën **1,200,000** lekë me shkresën nr. 5761/1 datë 08.04.2019. Më hollësisht, të dhënat mbi përdorimin e fondit të veçantë, jepen në pasqyrën që vijon:

Tabela nr.14 Përdorimi i fondit të veçantë

Nr	Urdhri i Kryetarit. Nr. datë	Përfituesi	Shpërblim i Lekë	Paguar me Urdhër Shpenzimi Nr. datë	Arsyeja e shpërblimit
1	Nr. 34 dt. 06/05/2019	Qemal Shehu	160,800	USH -146 date 15.05.2019	Dalje në Pension
2	Nr. 34 dt 06/05/2019	Bashkim Shehu	108,800	USH -146 date 15.05.2019	Dalje në Pension
3	Nr. 136 dt 04/12/2019	Xhovan Domi	121,800	USH-457 date 23.12.2019	Dalje në Pension
4	Nr. 137 dt 04/12/2019	Bardhul Lilaj	50,000	USH-457 date 23.12.2019	Sëmundje
5	Nr. 29 dt 11/04/2019	Pjeter Beleshi	121,800	USH-118 date 16.04.2019	Dalje në Pension
6	Nr. 29 dt 11/04/2019	Qemal Meta	121,800	USH-118 date 16.04.2019	Dalje në Pension
7	Nr. 29 dt 11/04/2019	Halil Isufi	108,800	USH-118 date 16.04.2019	Dalje në Pension
8	Nr. 29 dt 11/04/2019	Andrea Kristo	121,800	USH-118 date 16.04.2019	Dalje në Pension
9	Nr. 29 dt 11/04/2019	Pal Daci	108,800	USH-118 date 16.04.2019	Dalje në Pension
10	Nr. 29 dt 11/04/2019	Raimond Koci	108,800	USH-118 date 16.04.2019	Dalje në Pension
	<b>Shuma</b>		<b>1,043,200</b>		

Burimi: KLSH

Nga auditimi konstatohet se në përdorimin e fondit të veçantë, janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” i ndryshuar me VKM 493, datë 6.07.2011, UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit” dhe UMF nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, pikat 54, 55. Në përdorimin e fondit të veçantë, u konstatua se është respektuar limiti i përdorimit me kursim për diferencën  $1,133,200 - 1,043,200 = 90,000$  lekë.

Refruar përcaktimeve të kuadrit rregullator të ligjit nr.8097, datë 21.03.1996 “Për miratimin e kritereve, rregullave dhe procedurave për përfitimin pensioneve suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” i ndryshuar dhe Vendimit të Kryetarit KLSH-së me nr. 244, datë 22.12.2018, si dhe praktikave shkresore me Ministrinë e Financave, është alokuar në fondin e veçantë, artikulli 606, vlera prej 629,136 lekë për përballimin e pagesave kalimtare. KLSH adresoi kërkesën Ministrisë së Financave, (referuar ndalesave si dhe arkëtimeve) nga paga për pakësimin e fondeve të alokuara në vlerën e mësipërme, Ministria e Financave ka konfirmuar pakësimin e fondit të veçantë me shkresën nr.5868/6 prot., datë 16.12.2019 në vlerën prej 629,136 lekë.

Faksimile nr.3 Shkresa nr.5868/6 prot., datë 16.12.2019

KONTROLLI I LARTË TË SHETIT  
NR 45/10 DATE 16/12/19


REPUBLICA E SHqipërisë  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BUXHETIT

Nr. 5868 / 6 Prot. Tiranë, më 16.12.2019

Lënda: Pakësimi i akorduar me shkresën nr. 5868/3 Prot., datë 16.05.2019.

**DEGËS SË THESARIT TIRANË**  
**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË THESARIT**  
**KONTROLLIT TË LARTË TË SHETIT**  
**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË**

Në përgjigje të shkresës nr. 45/38 Prot., datë 05.12.2019, të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me subjekt “Kërkesë për pakësimi i fondit” si dhe në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave nr. 5868/3 Prot., datë 16.05.2019 nëpërmjet së cilës është bërë akordimi i fondit, për kryerjen e pagesës pas ndërprerjes së funksionit të fundit, mbështetur në argumentat e paraqitur, miratohet pakësimi dhe shtesa e fondeve sipas strukturave buxhetore në tabelën bashkëlidhur, në lekë.



Ent Qev	Min. Linj	Kod Institucioni	Emër Institucioni	Kap.	Programi	Llog ekon	Kodi Degës thesarit	Kod produkti	Emertimi i produktit	Shuma
<i>në lekë</i>										
<b>Shtesa</b>										<b>629,136</b>
001	10	1010001	Aparati i MFE	01	01130	6040000	3535	91003AA	Shpërblime sipas funksionit	629,136
<b>Pakësime</b>										<b>629,136</b>
001	24	1024001	Kontrolli i Lartë i Shtetit	01	01120	6060000	3535	92401AA	Auditime të kryera	629,136

## ***Auditimi i rregullshmërisë së Raportimit Financiar për vitin 2019.***

---

Opinion mbi pasqyrat Financiare të vitit 2019.

Nga Zyra e Financës janë përgatitur Pasqyrat Financiare për vitin ushtrimor 2019 në zbatim dhe në përputhje me afateve ligjore.

Gjatë auditimit u analizuan disa llogari dhe u konstatua si vijon:

- **Llogaria 468** “Debitorë të ndryshëm”, gjendja e debitorëve, është për vlerën 2,845,167 lekë, e pa ndryshuar nga viti paraardhës 2018. Nga kjo shumë:
  - vlera 2.536.652 lekë, përfaqëson vlerën e dëmit që i është shkaktuar Institucionit të KLSH-së në ngjarjet e 14 Shtatorit 1998;
  - vlera për 338.757 lekë e cila pasqyron vlerën debitorë sipas Urdhër Ekzekutimit për shpërblim dëmi me nr.1002 prot, datë 31.08.2018 për një person fizik, Vendim i cili është në proces gjyqësor;
- **Llogaritë 401-408** “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, në shumën 2,140,246 lekë, kjo vlerë përfaqëson detyrimet e muajit dhjetor 2019, të pa kaluara në bankë në vitin 2019;
- **Llogaria 466** “Fonde të ngurtësuar” në fund të vitit 2019 paraqitet në vlerën 1.996.859 lekë dhe përfaqëson vlerën e mjeteve në ruajtje në masën 5% si garanci të punimeve, për Rikonstruksionin e godinës së KLSH-së, për subjektin sipërmarrës ALB-STAR shpk;

Llogaritë kreditore që përfaqësojnë detyrimet ndaj personelit për paga, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, u përkasin detyrimet e pa paguara të muajit dhjetor 2019 për vlerat si vijon:

- **Llogaria 42** “Detyrime ndaj personelit” për pagat e pa paguara në shumën 16,604,285 lekë;
- **Llogaria 435** “Sigurimet shoqërore” për vlerën 5,739,819 lekë dhe
- **Llogaria 436** “Sigurimet shëndetësore” për vlerën 738,554 lekë.

### ***Saktësia dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera në magazinë.***

---

Nga auditimi është vërejtur se në daljet nga banka dhe veprimet në magazinë janë zbatuar kërkesat ligjore dhe kërkesat e UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

Ndjekja e konsumit të karburantit, është bërë bazuar në normativat teknike të konsumit si dhe dokumentacionin e nevojshëm si autorizimet, fleta udhëtimi etj.

Për administrimin e vlerave materiale ka funksionuar magazina e institucionit. Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni i magazinës është mbajtur në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve të njësisve publike”. Për çdo lëvizje malli është prerë fletë-hyrje apo fletë dalje sipas rastit, me të gjitha kërkesat e formateve dhe pa korrigjime. Për veprimet e kryera për çdo artikull janë mbajtur kartela të cilat rezultuan të jenë rakorduar me sektorin e financës. Sektori i Financës për hyrjet dhe daljet e magazinës ka mbajtur ditar në të cilin janë regjistruar në mënyrë kronologjike veprim për veprim të gjitha ngjarjet ekonomike të cilat më pas janë hedhur sipas programit alfa të instaluar gjatë vitit 2015. Të gjitha fletë-daljet e magazinës janë bazuar në planin e shpërndarjes të nënshkruar nga Sektori i Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike dhe Nëpunësi

Autorizues. Punonjësja e Financës e ngarkuar me mbajtjen e magazinës ka çelur dhe mban kartela personale për çdo punonjës të KLSH për të gjithë inventarin e imët dhe për inventarin ekonomik të tërhequr nga magazina, të cilat janë rakorduar me Zyrën e Financës.

Auditimi ka konkluduar se:

*Të gjitha veprimet ekonomike janë evidentuar në kartelat e magazinës dhe në ditarët e kontabiliteti, në përputhje me rregullat e përcaktuara për menaxhimin e aktiveve dhe për mbajtjen e kontabilitetit.*

### ***Inventarizimi i pronës shtetërore.***

Në Institucionin e KLSH-së, është kryer inventarizimi fizik i aseteve në fund të vitit ushtrimor, 2019.

Bazuar në Relacionin e Komisionit të Inventarizimit, konstatohet se:

Në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr. 148, datë 30.12.2019 dhe Urdhrit nr. 4, datë 13.01.2020, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, komisioni i inventarizimit të Aktiveve të KLSH, në zbatim të UMF nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, ka kryer inventarizimin fizik të aseteve gjendje më 31.12.2019 si në tabelë që vijon:

<b>Nr.</b>	<b>Inventari Fizik i Aktiveve</b>	<b>31/12/2019</b>
1	Aktive në përdorim personal	94,377,822
2	Aktive dhe vlera materiale në zyra	92,607,592
3	Aktive gjendje në magazinë	91,829,454
4	Fondi i Bibliotekës	2,602,910
5	Ndërtesa	616,467,743
6	Magazina e botimeve	4,843,272
<b>Shuma</b>		<b>902,728,791</b>

Nga inventarizimi rezulton se gjendja fizike e aseteve është barabartë me gjendjen kontabël të aseteve, sipas llogarive të pasqyrave financiare të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

*në lekë*

<b>Llogaria</b>	<b>Inventari Fizik i Aktiveve</b>	<b>Bilanci 31/12/2019</b>
212	Ndërtime e konstruksione	616,467,743
214	Instalime teknike, makineri paisje	65,139,448
215	Mjete transporti	37,152,000
218	Inventar ekonomik	162,605,035
Klasa 3	Llogaritë e kl. III	21,190,071
<b>Shuma</b>		<b>902,728,791</b>

### ***Respektimi i strukturës organike të miratuar dhe krahasimi me faktin.***

Është respektuar struktura organike dhe numri i punonjësve të miratuar për vitin 2019.

Sipas treguesve të buxhetit të miratuar, numri i punonjësve për vitin 2019, ka qenë parashikuar për 196 punonjës mesatarisht në muaj.

Gjatë viti 2019, numri mesatar i punonjësve në muaj, është 195 punonjës, pra është respektuar numri i punonjësve sipas programimit buxhetor.

Po kështu, në programin buxhetor të vitit 2019 është programuar kontraktimi i ekspertëve të jashtëm, gjithsej për numrin 10 ekspertë në muaj me kohë të plotë. Në fakt gjatë viti 2019, numri mesatar i ekspertëve të jashtëm të kontraktuar është mesatarisht për 5,7 ekspertë në muaj.

Fondi i përdorur për pagat e ekspertëve është për shumën totale bruto 5,317,596 lekë.

### ***Mbi shërbimin e transportit dhe administrimin e karburantit***

---

Nga auditimi u konstatua se shërbimi i transportit është i organizuar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për Rregullimin e Shërbimit të Transportit për Funkionarët Publik dhe Nëpunësit Civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe shoferëve në dispozicion të ministrive dhe institucioneve qendrore”.

Për sa më sipër institucioni i KLSH-së ka në inventar 12 automjete, nga të cilat, në gjendje pune janë vetëm 6 mjete. Gjatë vitit 2019, është bërë çregjistrimi provizor i 3 mjeteve të transportit, pasi është konstatuar konsum mbi normativat maksimale teknike i karburantit për shkak të amortizimit teknik të tyre, automjetet janë të prodhuara gjatë viteve 1996 deri 2005, ndërsa 2 automjete janë çregjistruar para vitit 2019. Një automjet rezulton i vjedhur në vitin 2005, denoncimi nr. 311, dt. 01.03.2005.

Nga auditimi u konstatua se, për mjetet në shërbim në dispozicion të grupeve të auditimit janë mbajtur fletë udhëtimit për çdo automjet, ku janë shënuar, data e udhëtimit, destinacioni i udhëtimit, kilometrazhi në nisje, kilometrazhi në mbërritje dhe nënshkrimi i punonjësit udhëtues. Të gjitha fletë-udhëtimit janë të nënshkruara nga përdoruesi i mjetit, nëpunësi udhëtues dhe nga Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve.

Gjatë auditimit u kryen disa sondazhe për plotësimin e fletë-udhëtimit dhe rezultoi se ato ishin plotësuar sipas kërkesave të formatit.

*Normativa e harxhimit të karburantit është llogaritur sipas tipit të automjetit dhe kilometrave të përshkuara të cilat janë të barabarta me ato të evidentuara në fletudhëtimit e çdo automjeti. Sektori i Shërbimeve ka rakorduar çdo muaj me magazinën për sasinë e karburantit të tërhequr nga përdoruesit e automjeteve dhe ka bërë përlllogaritjet për harxhimin e tij sipas kilometrave të përshkuar.*

### ***Mbi procedurat e prokurimeve***

---

A. Gjatë vitit 2019, sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve, konstatohet se në KLSH janë zhvilluar dy procedura prokurimi me tender dhe konkretisht:

1. Tenderi me objekt: **“Riparim shërbim të automjeteve”**, me procedurë elektronike, me fond limit 1,387,920 lekë pa t.v.sh.;
2. Tenderi me objekt: **“Shërbim i ruajtjes të ambienteve të zyrave me polici private”**, me procedurë elektronike, me fond limit 3,529,442 lekë pa t.v.sh.

Nga auditimi, u konstatua se në të dy tenderët e mësipërm janë zbatuar procedurat e prokurimit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për

prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

B. Gjatë vitit 2019 në KLSH janë parashikuar për tu zhvilluar 28 procedura prokurimi me vlera të vogla, me vlerë totale 13.300.147 lekë me tvsh nga të cilat janë realizuar 13 procedura me fondin limit të planifikuar për 10.872.147 lekë me tvsh, përfshirë këtu edhe fondin për blerje bileta udhëtimi me avion me vlerë 6.461.700 lekë me tvsh.

Gjatë auditimit të prokurimeve për blerjet me vlera të vogla për zërin “Blerje bileta udhëtimi me avion” rezultoi të jenë kryer 39 procedura prokurimi ku u konstatuan raste në të cilat Operatori Ekonomik i cili në mënyrë elektronike ka dhënë ofertën me vlerë më të ulët dhe ka rezultuar fitues nuk është paraqitur për të lidhur kontratën e shërbimit duke u tërhequr ose nuk ka plotësuar kërkesat e prokurimit.

Grupi i auditimit përzgjodhi dhe auditoi praktikat e prokurimeve të këtyre rasteve për të vlerësuar nëse është dokumentuar nga KVO, arsyeja e mos kontraktimit të ofertës me vlerën më të vogël. Nga auditimi rezultoi se gjatë procedurave të prokurimit të blerjes së biletave të avionit janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Në përfundim sa i përket auditimit të procedurave të prokurimit me vlera të vogla u konstatua se procedurat e prokurimit janë kryer në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

## **KONKLUZIONI I AUDITIMIT**

Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, ka audituar veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) për vitin ushtrimor 2019, në mbështetje të kërkesave të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm të Sektorit Publik”, Standardeve Ndërkombëtare të auditimit dhe manualit të auditimit të brendshëm të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 ku citohet: *“Gjatë kryerjes së auditimit financiar duhet t’i kushtohet rëndësi faktit, nëse pasqyrat financiare janë hartuar në mbështetje të dokumenteve të sipërcituar dhe në përputhje me kërkesat specifike për raportimin financiar. Nëse arrihet në përfundimin se pasqyrat financiare kanë gabime materiale, audituesit duhet të kenë evidencë të mjaftueshme për ta provuar këtë gjetje. Nxjerrja e bilancit kontabël në afat dhe plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse”.*

Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë, janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Niveli menaxherial i KLSH-së është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale.

Përgjegjësia e auditimit është të japë siguri të arsyeshme se aktiviteti është kryer në përputhje me kuadrin rregullativ dhe se pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

### **Mbi auditimin e pasqyrave financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare, për vitin ushtrimor deri më 31 Dhjetor 2019. Pasqyrat financiare, janë shoqëruar me anekset përkatëse; Pasqyrën e pozicionit Financiar, Pasqyrën e Performancës Financiare, Pasqyrën e Cash Flow, Pasqyrën e Fondeve Neto, Shënimet Shpjeguese, Pasqyrën e Investimeve, Pasqyrën e AAGJ dhe Pasqyrën e numrit të punonjësve dhe fondin i pagave.

Pasqyrat financiare, janë përgatitur sipas standardeve të kontabilitetit dhe kuadrit rregullativ ligjor në fuqi dhe japin një pamje të besueshme të gjendjeve të aktiveve dhe pasive të Institucionit Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Ato paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin e llogarive financiare më datën 31 Dhjetor 2019, sipas kuadrit ligjor e rregullator.

Gjendja e llogaritë inventariale të aktiveve dhe ato të pasivit, janë sipas akteve të rakordimit me degën e Thesarit dhe sipas rezultateve të inventarizimit fizik.

#### **Mbi shpenzimet dhe prokurimet:**

Shpenzimet, janë kryer në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi. Bashkëngjitur dokumenteve të bankës, janë dokumentet e nevojshme justifikuese kontabël.

Procedurat për prokurimet për blerje dhe shërbime me vlera të vogla, përgjithësisht janë kryer në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor rregullativ; ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij.

Nga KLSH-ja, janë kryer procedura të prokurimeve me tender në dy raste ku rezulton të jetë zbatuar kuadri ligjor rregullues i fushës së prokurimeve.

Dy procedura prokurimesh janë deleguar për tu kryer respektivisht nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dhe nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit si institucione të autorizuar për kryerjen e procedurës së prokurimit për këtë kategoritë përkatëse të aktiveve.

**Në përfundim,** *Sistemet e kontrollit të brendshëm përgjithësisht janë funksionalë, duke garantuar një menaxhim dhe administrim të kujdesshëm të aktivitetit. Hartimi dhe zbatimi i buxhetit përgjithësisht reflekton zbatimin e kërkesave ligjore. Raportet financiare japin një pasqyrë të drejtë e të besueshme të transaksioneve dhe aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2019.*

*Gjithsesi, konstatohen fusha ku ka nevojë për përmirësime të vogla dhe ku Menaxhimi duhet të fokusohet gjatë vitit në vijim si ndjekja e detyrimeve debitore dhe rritja e mjeteve të transportit në dispozicion të institucionit pasi konstatohet se 50% e mjeteve të KLSH nuk janë në gjendje pune.*

**V. KLSH në shifra dhe grafikë: 10 vite (2002-2011) kundrejt 8 vite (2012-2019)**



**V. KLSH NË SHIFRA DHE GRAFIKË**



**PERFORMANCA E KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT**

**KRAHASIMI I INDIKATORËVE**

**10 vite Vs 8 vite**  
**(2002-2011) (2012-2019)**






## INDIKATORI I DOBISË SË AUDITIMIT

(Raporti i dënimeve të zbuluara dhe të kërkuara për zhdukjen nga KLSH me shpenzimet buxhetare (aktive të KLSH-së)



INTOSAI

Indikator i dobisë së auditimit, si një nga treguesit më domethënës të performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit është shprehur në grafikun e mëposhtëm për periudhën 2002-2019.



## INDIKATORI I DOBISË SË AUDITIMIT



INTOSAI

Për 8 vitet 2012-2019 rezultojnë se për çdo një lek të shpenzuar për institucionin e KLSH-së është kërkuar për t'u zhdukur 82,2 lekë, ose 4 herë më shumë, se sa është kërkuar në periudhën 10 vjeçare 2002-2011 (21.1 lekë).





## DËMI EKONOMIK I ZBULUAR DHE HUMBJET NË FINANCAT PUBLIKE NGA SHKELJET FINANCIARE PËR VITET 2012 - 2019



### Dëmi ekonomik

Nga auditimet e ushtruara përgjatë 8 viteve 2012 - 2019, KLSH ka konstatuar:

A.Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm ekonomik në shumën totale prej 254 miliardë lekë ose 2 miliardë euro.

B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve, si dhe shkelje të disiplinës buxhetore lidhur me likuidimin e shpenzimeve, keqmenaxhimin e fondeve të programuara, në shumën totale prej 521 miliardë lekë, afërsisht 4.2 miliardë euro.


Në total KLSH ka konstatuar shkelje në shumën 774 miliardë lekë ose afërsisht 6.2 miliardë euro.



## DËMI EKONOMIK I ZBULUAR DHE HUMBJET NË FINANCAT PUBLIKE NGA SHKELJET FINANCIARE PËR VITET 2012 - 2019




*Dëmi ekonomik / Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve jo me eficiencë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike*






## DËMI EKONOMIK

*Dëmi ekonomik në harkun kohor 2002-2019 në miliardë lekë*



## DËMI EKONOMIK

*Dëmi ekonomik i zbuluar për periudhat 2002-2011 dhe 2012-2019, në miliardë lekë.*




*Në 8 vitet (2012-2019) nga KLSH është zbuluar 5,4 herë më shumë dëm ekonomik krahasuar me 10 vitet e periudhës 2002-2011.*



## DËMI EKONOMIK I ZBULUAR DHE HUMBJET NË FINANCAT PUBLIKE NGA SHKELIET FINANCIARE

Struktura e dëmit ekonomik sipas fushave për vitet 2012 - 2019 në milionë lekë

Dëmi ekonomik sipas fushave për vitet 2012-2019 (milionë lekë)		
1	Tatim Taksa	27,938
2	Dogana	13,997
3	Shitje, qera, koncensione, PPP	165,505
4	Të tjera	31,741
5	Paga Shpërblime	935
6	Shpenzime Operative	1,576
7	Prokurime Publike	11,927
8	Në Urbanistikë	364
	<b>Total</b>	<b>253,983</b>



■ Tatim Taksa      ■ Dogana      ■ Shitje, qera, koncensione, PPP  
 ■ Të tjera      ■ Paga Shpërblime      ■ Shpenzime Operative  
 ■ Prokurime Publike      ■ Në Urbanistikë



## AUDITIME TË KRYERA 2002-2019

Treguesi i realizimit të auditimeve në harkun kohor të shtatëmbëdhjetë viteve (2002-2019) rezulton:






### AUDITIME TË KRYERA 2002-2019



Mesatarisht auditime në vite  
10 vite (2002-2011) Vs 8 vite (2012-2019)




Auditimet	2002-2011 (10 Vite)	2012-2019 (8 Vite)
Planifikuar	1484	1246
Realizuar	1513	1241



### STRUKTURA E AUDITIMEVE TË KRYERA



Treguesi i realizimit të auditimeve në harkun kohor të viteve 2012-2019 rezulton:






## SUBJEKTET E AUDITUARA PËRGJATË VITEVE 2012-2019



### Auditimet sipas subjekteve

Ministri dhe institucionet qendrore	336
Institucionet e qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	470
Drejtori dhe degët e tatim-taksave e të doganave	113
Institucione financiare dhe shoqëri me kapital të përbashkët shtetëror	140
Njësi dhe projekte me financime të huaja	72
Subjekte të mbrojtjes së mjedisit	49
Institucionet ku janë zhvilluar auditimet e performancës (qendrore dhe vendore)	360
<b>TOTALI</b>	<b>1540</b> Subjekte:




## AUDITIME PERFORMANCE



*Auditimi i Performancës është konceptuar si prioritet në strategjinë e zhvillimit të institucionit, si një nga shtyllat moderne të zhvillimit të KLSH-së, sipas eksperiencave të INTOSAI-1.*

### Auditime Performance 2008-2019





*Numri i Auditimeve të Performancës është rritur ndjeshëm gjatë këtij 8-vjeçari, bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe Ligjin e ri të KLSH-së, 154/2014, mbështetur në punën e audituesve, bashkëpunëtorëve vendas dhe të huaj, duke mbukur të gjithë sektorët që ushtrojnë aktivitet ekonomiko-social publik.*

*Gjatë këtij 8-vjeçari, auditimi i performancës arriti të realizojë me sukses të gjithë objektivat strategjike të parashtruar, por sfida për të ardhmen mbeten ende prezente, veçanërisht sfida për ta shndërruar këtë auditim në motor të zhvillimit dhe përmirësimit institucional.*



## AUDITIME PERFORMANCE

*Për vitet 2012-2019, KLSH ka përfunduar dhe evaduar 92 Auditime Performance, duke ushtruar auditime në 360 institucione në nivel qendror dhe vendor.*



\* Gjatë viteve 2008-2009, 10 auditimet e performancës KLSH i ka kryer me ndihmën e SAI-ve të Britanisë dhe Holandës, në kuadër të një projekti binjakëzimi. Në vitet 2010-2011, numri i auditimeve të performancës u ul ndjeshëm, në 3 në vitin 2010 dhe 1 në vitin 2011.



## AUDITIMI I PERFORMANCËS

Në nenin 3 të ligjit të KLSH-së Nr.154/2014 dhe ISSAI 300 «Parimet themelore të Auditimit të Performancës» termat dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:

**“Auditimi i performancës”** ka të bëjë me auditimin e ekonomicitetit, efijencës dhe efektivitetit dhe përfshin:

- auditimin e ekonomicitetit**, që nënkupton minimizimin e kostos së burimeve që përdoren në një veprimtari publike, duke mos cenuar cilësinë e tij.
- auditimin e efijencës**, që nënkupton optimizimin e raportit burime-rezultate të veprimtarisë publike, duke modifikuar proceset, strukturat dhe gjithë zinxhirin ekonomik të vlerës, në përputhje me standardet kombëtare e ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.
- auditimin e efektivitetit**, që nënkupton vlerësimin e rezultateve përfundimtare dhe objektivave të vendosura, në përputhje me politikat e subjektit të audituar.




## FILLIMET E AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT



- Objektivi për zhvillimin e Auditimit TI u konsolidua në planin strategjik të zhvillimit të viteve 2013-2017, ku KLSH synonte të bënte ndryshime themelore në përdorimin e Teknologjisë së Informacionit në punën e saj audituese.
- ..... 9 vite më vonë struktura e Auditimit TI paraqitet si një Departament me fizionomi të konsoliduar që zbaton metodologjinë më të fundit të rekomanduar nga organizmat ndërkombëtare të Auditimit dhe gjetjet e rekomandimet e auditimit pranohen në një shkallë të lartë nga subjektet e audituara.


BUKIMET NJERËZËZAKE NË AUDITIMIN TI



## AUDITIME TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË VITET 2015-2019



### Auditimet IT në afatin kohor 2015-2019



Nga analizat grafike të Gjetjeve në subjektet e mbuluara me Auditimin TI në vitet 2015-2019 vërehet se trendi rritës ndjek atë të numrit të auditimeve.


Për vitin 2019 kemi një rritje rreth 2.8 herë në krahasim me një vit më parë për:

- Numrin gjetjeve
- Mbulimin e Subjekte me Auditim TI

### Numri i gjetjeve në auditimet IT vite




### Mbulimi me auditim i subjekteve





## REKOMANDIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIM TË LEGJISLACIONIT DHE ZBATIMI I TYRE


Rekomandimet dhe zbatimi i propozimeve për ndryshim legjislativ, për vitet 2002-2011 grafikisht paraqitet:



## REKOMANDIMET

Masa organizative të rekomanduara dhe të zbatuara, për vitet 2002-2019

Rekomandimi dhe zbatimi i masave organizative për grup vitet 2002-2011 dhe 2012-2019 grafikisht paraqitet:






## REKOMANDIMET

### Masa disiplinore e administrative të rekomanduara dhe të zbatuara, për vitet 2002-2019

Rekomandimi dhe zbatimi i masave disiplinore dhe administrative për grup vitet 2002-2011 dhe 2012-2019 grafikisht paraqitet:



## REKOMANDIMET

### Rekomandimet sipas natyrës së tyre për vitet 2012-2019






## KALLËZIMET PENALE 2002-2019



### Numri i kallëzimeve penale dhe personave të kallëzuar penalisht 2002-2019

KLSH ka luftuar pa kompromis ndaj abuzimeve dhe mashtrimeve financiare me pronën publike, duke synuar përmirësimin e qeverisjes publike nëpërmjet thellimit të luftës pa kompromis ndaj zyrtarëve të korruptuar, kryesisht adresimin e kallëzimeve penale me akuzat "Shpërdorim detyre", "Shkelje e barazisë në tendera", etj.

*KLSH në 8 vitet e fundit, 2012-2019, ka përcjellë 336 Kallëzime Penale për 999 persona, ose thënë ndryshe ka adresuar çdo javë një Kallëzim Penal, për zyrtarët e nivelit të mesëm dhe të korrupsionit, të konstatuar me shkelje të rënda nga auditimet e KLSH.*




## KALLËZIMET PENALE 2002-2019





### Numri i kallëzimeve penale dhe persona të kallëzuar penalisht 2002-2019

➤ Nga të dhënat e grafikut del qartë se numri i kallëzimeve penale në 8 vitet e fundit 2012-2019 (336) është 2 herë me shumë krahasuar me periudhën 10 vjeçare 2002–2011 (168), ndërsa numri i personave të kallëzuar penalisht është 2 herë më i lartë .

Grafiku 1: Numri i kallëzimeve penale dhe persona të kallëzuar penalisht për vitet 2002-2011 (10 vjet) VS 2012–2019 (8 vjet)







## MENAXHIMI INSTITUCIONAL



Trupa audituese e KLSH-së për vitet 2011-2019

Të ndarë sipas profilit të diplomimit, klasifikimi i punonjësve me arsim të lartë



## MENAXHIMI INSTITUCIONAL




Trupa audituese e KLSH-së për vitet 2011-2019



➤ Vjetërsia në institucion është 7.7 vjet, nga 6.7 vjet në vitin 2018, nga 7.4 vjet në vitin 2017, nga 9 vjet në vitin 2016, nga 7.2 vjet në vitin 2015, nga 8 vjet në vitin 2014, 8.2 vjet për person që ka qenë në vitin 2013, 8.7 në vitin 2012, 9.1 në vitin 2011.

➤ Rezultojnë 43 punonjës nën moshën 30 vjeç, nga mosha 31-50 vjeç janë 77 punonjës, ndërsa mbi moshën 51 vjeç janë 62 punonjës.







## Barazia Gjimore për vitet 2011-2019

## Grafikisht trendi paraqitet

## Pasqyrimi i stafit të KLSH-së sipas ndarjes gjimore



- Raporti femra/meshkuj 45 % me 55.9% në vitin 2019, nga 42.9 % me 57.9% në vitin 2018, nga 39.7 % me 60.2% në vitin 2017, nga 39.1 % me 60.9% në vitin 2016, nga 39.7 % me 60.2% në vitin 2015, nga 39% me 61% që ishte në vitin 2014, 37% me 63 në vitin 2013, 32% me 68 % në vitin 2012, 33.5% me 66.5% në vitin 2011.



## DINAMIKA E TRAJNIMEVE TE KLSH PËR PERIUDHEN 2009-2019

Treguesi kryesor i progresit reflektohet në rritjen e numrit të trajnimeve që çdo auditues ka kryer gjatë vitit, duke arritur një nivel të kënaqshëm prej 3611 ditë njerëz trajnime, ose referuar 145 audituesve efektive vjetorë, rezultojnë 25 ditë trajnimi mesatare vjetore per auditues në vit, (kundrejt 2.1 të arritura në 2011 dhe 3.1 ditë trajnimi/person të kryer në vitin 2010).



Arritja e një numri mester prej 25 ditë trajnimi për çdo auditues shënon një rritje me 12 herë kundrejt vitit 2011, kur ky tregues ishte minimal.

Indikator i vjetor prej 25 ditë trajnimi / auditues, është realizuar në masë të plotë (100%) në përputhje me rekomandimet e pikës nr. 3.4.1 të Rezolutës të datës 19.7.2019 të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë" (dhe plan veprimtari respektiv, dërguar Kuvendit nga ana e KLSH me shkresën nr. 113/4, datë 26.9.2018)

"Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të bashkëpunimit të strukturuar të zhrv. profesional duke siguruar përmbushjen e objektivave nëpërmjet implementimit të programit të trajnimit të vazhdimshëm profesional të audituesve dhe rritjen e nivelin e pjesëmarrjes në trajnimin mesatarisht prej 25 ditë trajnime në vit për auditues"




## PREZENCA E KLSH-së NË MEDIA

Komunikimi me qytetarët në vitet 2002-2019



Gjatë vitit 2019, shtypi i shkruar ka pasqyruar raportet dhe deklaratat për shtyp të KLSH-së në një numër prej 405 artikuj, njoftime, editoriale dhe komente analitike. Komunikimi dhe bashkëpunimi me median vijon me të njëjtën frymë dhe intensitet dhe të gjitha mediat janë ftuar të marrin pjesë edhe në analizat vjetore të Departamenteve të auditimit, duke rritur në këtë mënyrë transparencën e veprimtarisë së KLSH-së.



30

KLSH

INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT (SAI-4) NË SHËRBIM TË QYTETARËVE




## MENAXHIMI INSTITUCIONAL



PREZENCA E AUDITUESVE TË KLSH-SË NË MEDIAN E SHKRUAR 2013-2019

Për të kuptuar dinamikën, mund të përmendim se për vitin 2019, 90 auditues, prej të cilëve rreth 30% janë auditues të rinj, kanë qenë prezentë pothuajse në të gjitha gazetat me 122 shkrime. Shkrimet e audituesve janë botuar në 12 volume dhe përfaqësojnë fytyrën e punës sonë audituese për gjetje dhe problematika të dalta gjatë auditimit duke i shërbyer drejtpërsëdrejti qytetarit.



Për periudhën shtatë-vjeçare 2013-2019 të gjithë audituesit e KLSH-së kanë botuar 764 artikuj në pothuajse në të gjitha gazetat e vendit.

31

KLSH




## MENAXHIMI INSTITUCIONAL



### Komunikimi me qytetarët në vitet 2002-2019

Gjatë viteve 2012-2019, KLSH ka trajtuar 3565 letra dhe ankesa nga të cilat 1508 kanë qenë jashtë kompetencës dhe juridiksionit të institucionit dhe 2507 në kompetencë të KLSH-së. Të gjitha këto kërkesa janë adresuar për kompetencë në institucionet përkatëse. Në pritje të marrjes së përgjigjes nga institucionet e adresuara, qytetari vihet në djeni nga KLSH dhe informohet pas ardhjes së përgjigjeve zyrtare.

KLSH ka verifikuar dhe u është dhënë përgjigje 2507 ankesave dhe letrave në kompetencë të KLSH.



Kontrolli i Lartë i Shtetit përgjatë katër viteve, ka vijuar të trajtojë me korrektesë dhe profesionalizëm letrat dhe ankesat e qytetarëve, të cilët në çdo rast kanë marrë përgjigje, edhe kur çështja e ngritur prej tyre ka qenë jashtë kompetencave të institucionit. Në këto raste, KLSH i ka orientuar qytetarët, nëpërmjet përgjigjeve zyrtare se cili institucion duhet ti drejtohen për të marrë përgjigje për shqetësimet e tyre.



## MENAXHIMI INSTITUCIONAL



### Viti 2019 ishte viti i katërt radhaz që Kontrolli i Lartë i Shtetit organizoi "Muajin e Hapur" dhe kjo traditë mund të konsiderohet si një traditë institucionale.

Gjatë muajit të hapur, 1 nëntor – 6 dhjetor audituesit e KLSH-së morën pjesë në shumë aktivitete brenda dhe jashtë institucionit, si takime mes Departamenteve të ndryshme të auditimit me qëllim shkëmbimin e eksperiencave; takime me gazetarë; prezantime të botimeve të KLSH-së nga Auditues të rinj; pjesëmarrje në Panairin e librit 2019; takime dhe leksione me akademikë, profesorë, filozofë të fushave të ndryshme; promovime librash që kanë interes për KLSH; aktivitete kulturore, promovimi i pjesëmarrjes së KLSH-së në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, si dhe Konferenca e Audituesve të rinj në KLSH «Young ALSAI», ku auditues të rinj ndanë eksperiencën dhe vizionin e tyre për të ardhmen e institucionit, etj.






### Botimet të realizuara nga KLSH Vitet 2012-2019

KLSH vjen në shtatë vitet e fundit 2012-2019 me një kolanë botimesh prej 113 libra.

*Kolana e botimeve të KLSH-së ka arritur në 113 tituj, ndër të cilët:*


- 23 numra të Revistës Shkencore "Auditimi Publik" në gjuhën shqipe dhe angleze;
- 7 analiza vjetore të punës së KLSH-së;
- 10 botime që i dedikohen Performances së institucionit në shqip dhe në anglisht;
- 12 volume të shkrimeve të përmbledhura të audituesve në shtypin e përditshëm;
- 7 volume që lidhen me Konferencat Shkencore vjetore të KLSH-së;
- 23 Botime që lidhen me standardet e Auditimit (ISSAI-t);
- 20 tituj te tjerë që pasqyrojnë auditimet e KLSH-së në vitet 2012-2015, strategjitë e KLSH-së, historikun e INTOSAI-t;
- 1 Botim kushtuar Historikut të NIK;
- 3 Botime të GAO-s.



### Botime të realizuara nga KLSH

Botimet e KLSH-së janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit për t'u mundësuar qytetarëve, veçanërisht studiuesve dhe studentëve të degës së financës e menaxhimit publik, një akses më të gjerë. KLSH vjen në tetë vitet e fundit 2012-2019 me një kolanë botimesh prej 113 titujsh nga 12 botime në 20 vjet, 1991-2011.

#### Numri i botimeve në vite 1991-2011 dhe 2012-2019





## KONFERENCAT SHKENCORE VJETORE 2012 - 2019

KLSH gjatë viteve 2012 - 2019 ka vijuar traditën e mirë të organizimit të Konferencave shkencore.

Gjatë 8 viteve janë zhvilluar gjashtë konferenca të tilla:

- Konferenca e I Shkencore e KLSH-së (Dhjetor 2012) me temë "87 vjet KLSH në 100 vjet shtet shqiptar";
- Konferenca e II-të Shkencore e KLSH-së (Dhjetor 2013) me temë "Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për një menaxhim publik të përgjegjshëm në sfidat e sotem"
- Konferenca e III-të Shkencore (Tetor 2014) e KLSH-së me temë "Auditimi Kombëtar në shërbim të Qeverisjes Kombëtare";
- Konferenca e IV-të Shkencore e KLSH-së (Qershor 2016) me temë "Analiza e Riskut";
- Konferenca e V-të Shkencore e KLSH-së (Tetor 2017) në bashkëpunim me Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës me temë "Të auditosh për qëndrueshmëri dhe zhvillim";
- Konferenca e VI-të Shkencore e KLSH-së (Prill 2018) në bashkëpunim me SAI-n e Kuvajtit me temë "Auditim me bazë risku";
- Konferenca e VII-të (Nëntor 2019) "Young ALSAI 2019".



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Gjatë viteve 2012 - 2019, janë nënshkruar dhe 19 marrëveshje bashkëpunimi me SAI-t partnere

Nr.	Institucione Homologe
1.	Zyra e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës (Shkurt 2012)
2.	Gjykata e Llogarive e Sllovenisë
3.	Institucioni Suprem i Auditimit të Polonisë (Maj 2012)
4.	Zyra Shtetërore e Auditimit të Kroacisë
5.	Gjykata e Llogarive të Turqisë
6.	Gjykata e Audituesve e Austrisë
7.	Institucioni Shtetëror i Auditimit të Malit të Zi
8.	Zyra e Auditimit të Institucioneve të Bosnje Hercegovinës
9.	Zyra Shtetërore e Auditimit të Republikës së Maqedonisë
10.	Marrëveshje me TIKA
11.	Zyrën Supreme të Auditimit të Republikës Çeke
12.	Zyrën kombëtare të Auditimit të Bullgarisë
13.	Zyra shtetërore e Auditimit të Kuvajtit
14.	Zyra e Kombëtare e Auditimit të Kosovës (Nëntor 2016)
15.	SAI-n e Ojpros
16.	Zyra Shtetërore e Auditimit të Hungarisë
17.	Dhoma Kombëtare e Llogarive të Ukrainës
18.	Institucioni Suprem i Auditimit të Polonisë (Mars 2016)
19.	Gjykata Rumune e Llogarive

Gjatë viteve 2012 - 2019, janë nënshkruar dhe 10 marrëveshje bashkëpunimi me Institucionet Shtetërore

Nr.	Institucione Shtetërore
1.	ILDKP
2.	Ministria e Financave
3.	Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm
4.	Departamenti i Administratës Publike
5.	Agjencia e Prokurimit Publik
6.	Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil
7.	Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet KLSH dhe Ministrisë së Financave, me objektivin e përbashkët për krijimin dhe zhvillimin e një sistemi modern, funksional dhe efektiv të kontrollit të brendshëm financiar publik.
8.	Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, Akredituar nga Bashkimi Evropian
9.	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
10.	ILDKPKI



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Gjatë viteve 2012 - 2019, janë nënshkruar dhe 33 marrëveshje bashkëpunimi me Organizatat Jo Fitimprurëse të fushës dhe Universitetet.




Nr.	OIF
1	Lëvizja Evropiane Shqiptare
2	Instituti i Studimeve Bashkohore
3	Qendra për Transp. dhe Informim të Lirë
4	Instituti për Demokraci dhe Mësimjetësia
5	Transparency International Shqipëri
6	Alternativa Civile
7	Instituti "GëG"
8	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit
9	BEKA
10	Fakulteti Gjeologj-Miniera
11	SHIÇAK, Kosove
12	Instituti për Studime Publike dhe Ligjore
13	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë
14	Gazeta "Ekonomia"
15	Instituti Shqiptar i Shkencës
16	Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë
17	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
18	Qendra shqiptare për rehabilitimin e traumës dhe torturës
19	Organizata "Integrimi Urban"
20	Revista "MONITOR"
21	KONFINDUSTRIA
22	"Albanian Platform for Policy Advocacy"
23	Marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin Ekonomik.
24	Marrëveshje bashkëpunimi me Institutin për Kontabilitet, Auditim dhe Financa, Kosove (IKAF).
25	USAID-i
26	Universiteti "Luarasi"
27	Universiteti "Mesihota" i Shqipërisë
28	Universiteti "Aleksander Moisiu", Durrës
29	Organizata "Qendresa Qytetare"
30	Agjencia e Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm, SEDA (senkontraktor i PMUJ)
31	Universiteti Logos
32	Albanian University
33	Universiteti i Shkodrës Luigj Gurakuq

Marrëveshje bashkëpunimi në vite  
10 vite (2002-2011) vs 8 vite (2012-2019)



Marrëveshje bashkëpunimi 2012-2019



## VI. ANEKSE

### A.1 Për zbatimin e rekomandimeve të adresuara në auditimet e mëparshme;

Në evidenca nuk është vendosur statusi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së sepse subjektet e audituara sipas ligjit kanë në dispozicion një afat kohor prej 6 muajsh për të trajtuar dhe raportuar lidhur me ecurinë e rekomandimeve të KLSH-së.

*Bashkëlidhur evidencave të masave të rekomanduara nga KLSH për periudhën janar - dhjetor 2019 do të paraqesim dhe një përmbledhje të rezultateve lidhur me nivelin e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2018.*

Nga auditimet në 113 subjekte janë rekomanduar gjithsej Masa për përmirësime ligjore, organizative, administrative dhe disiplinore **3,004**, nga të cilat janë pranuar **2,855 ose 95%** e masave të rekomanduara dhe nuk janë pranuar **149 masa ose 5%** e masave të rekomanduar.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga **2,855** masa të pranuar janë zbatuar plotësisht **1492 ose 52.2%**.

Përmbledhja e rezultateve

	Përmirësime/ Ndryshime ligjore	Organizative	Disiplinore	Administrative
Rekomanduar	23	2005	696	280
Pranuar	19	1902	656	278
Zbatuar	7	851	497	137

Më konkretisht:

A. Rekomanduar "**Masa për shpërblim dëmi**" në vlerën **392,188,088 mijë lekë**, nga të cilat është pranuar vlera **390,850,766 mijë lekë** ose **99%** dhe nuk është pranuar vlera **1,337,322 mijë lekë**. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezultoi se nga vlera e shpërblimit të dëmit të pranuar është zbatuar shpërblimi i dëmit në vlerën **1,543,405 mijë lekë** dhe është në proces zbatimi vlera **388,643,492 mijë lekë** ose **98%** e vlerës së pranuar për shpërblim dëmi. KLSH ka rikërkuar nga të gjitha subjektet përsheptimin e zbatimit të masave të shpërblimit të dëmit të pranuar por të pazbatuar.

Rekomanduar 23 "**Masa për përmirësime ligjore**"<sup>1</sup>, nga të cilat janë pranuar 19 masa. Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve rezulton se nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 7 masa ose 37% e tyre.

**Evidenca e Masave Disiplinore dhe Administrative të rekomanduara nga KLSH për periudhën Janar – Dhjetor 2019**

Nr	Emërtimi i subjekteve	Gjithsej masat		
		ME STATUSIN E NEPUNESIT CIVIL	ME KODIN E PUNES	MASAT ADMINISTRATIVE
		Rek	Rek	Rek
1	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	34		
2	Ministria e Drejtësisë	6		6
3	Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve		17	0
4	Universiteti i Shkodrës		10	1
5	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	4		
6	Drejtoria Arsimore Rajonale Fier	1		
7	Universiteti i Vlorës		1	
8	Ministria e Drejtësisë (tematik)	1		
9	Instituti i Mjekësisë Ligjore (tematik)	1		
10	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjes	1		
11	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë CFCU	5		
12	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm dhe Kujdesit Shëndetësor		7	
13	Instituti i Sigurimeve Shoqërore		1	
14	Dega Doganore Elbasan		1	
15	Drejtoria e Përgjithshme e Doganeve	1		1
16	MFE: Drejtoria e Zbatimit të Buxhetit	1		1
17	Drejtoria Përgjithshme e Tatimeve	1		1
18	MFE: Drejtoria e Thesarit	1		1
19	MFE: Drejtoria e Përgjithshme e harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik	2		
20	Shoqëria e parë e investimeve FAF SHA, sot Agrocredit SHA	1	1	
21	MFE: Drejtoria e Konkencioneve	1		
22	Bashkia Kurbin	6	15	4
23	Bashkia Tropojë	12	23	5
24	Bashkia Librazhd	10		7
25	Bashkia Pukë	8		6
26	Bashkia Mat			15
27	Bashkia Fushë Arëz			9
28	Bashkia Bulqizë			7
29	Bashkia Gramsh	5	7	12
30	Bashkia Shkodër	10		1
31	Bashkia Sarandë	8	1	14
32	Bashkia Patos			2
33	Bashkia Libohovë	3	1	15
34	Bashkia Dropull			1
35	Bashkia Himarë	15		10
36	Bashkia Berat	0		3
37	Bashkia Delvinë	15		1
38	Bashkia Klos	1	1	
39	Bashkia Krujë	2		
40	Bashkia Mat Auditim Tematik (Pasq Fina.2018)	1		
41	Bashkia Korçë (Auditim Tematik 1 proc prokurimi)	1		1
42	Operatori i Sistemit të Transmetimit OST		10	
43	Ujësjetës Kanalizime Pogradec SHA		14	
44	Ujësjetës Kanalizime Durrës SHA		19	
45	Ujësjetës Kanalizime Gjirokastër SHA		14	
46	Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë		13	
47	Ujësjetës Kanalizime Lushnje SHA		9	

48	Spitali Rajonal Korçë		12	
49	Albpetrol SHA		16	
50	Ujësjetllës Kanalizime Shkodër SHA		4	
51	Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA		15	2
52	Posta Shqiptare SHA		10	
53	Hekurudha Shqiptare SHA		2	
54	Autoriteti I Aviacionit Civil	2		
55	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Projekti IPA 2013 "Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri"		2	
56	ARRSH Projekti "Ndërtimi i Rrugës Qukës-Qafë Ploçe"		1	
57	ADISA Projekti "Ofrimi i Shërbimeve Publike dhe në Qendër Qytetarin"		1	
58	ZVRPP Bulqizë		3	
59	ZVRPP Tropojë		2	
60	ZVRPP Gramsh		1	
61	ZVRPP Lezhë		3	
62	ZVRPP Lushnje		11	
63	ZVRPP Gjirokastër		7	
64	ZVRPP Berat		6	
65	ALUIZNI Lezhë		20	
66	ALUIZNI Tirana Jug		4	
67	ALUIZNI Elbasan		21	
68	DR ISHMPU Fier	7	9	
69	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Durrës	6		
70	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë	20	4	
71	DR ISHMPU Tiranë	11	4	
72	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Elbasan	6		
73	ZVRPP Devoll		3	
74	ALUIZNI Vlorë		10	
75	ALUIZNI Kavajë		11	
76	ALUIZNI Zona Rurale Nr.1 Tiranë		22	
77	Shërbim Gjeologjik Shqiptar	8		
	<b>TOTALI</b>	<b>218</b>	<b>369</b>	<b>126</b>

## A.2 Statusi i ankimimeve gjyqësore, Kallëzimet penale të kryera përgjatë vitit 2019

Evidenca nr. 6

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr.prot. data e kallezimit	Nr. Pers	Detyra funksionale	Referenca ligjore për kallëzim penal	Gjendja e kallëzimit	Dëmi ekonomik në lekë	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
1	MFE: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit	Nr 240/7 Date 11/11/2019		Dërgim materiale për Vlerësim	Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar.	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
2	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Nr 1444/18 Date 14/11/2019		Indicie Penale	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
3	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU)	Nr 1443/28 Date 22/02/2020		Indicie Penale		Në hetim		Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
4	Agjencia Kombëtare e Ushqimit	Nr.Prot 1439/7 Në datë 06.09.2019		Indicie Penale	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore

<b>5</b>	Agjencia Kombëtare Burimeve Natyrore	<i>Nr.1442/23</i> <i>Në datë</i> <i>18.11.2019</i>		Indice Penale	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
<b>6</b>	Autoriteti Rrugor Shqiptar	<i>Nr.363/15</i> <i>Datë</i> <i>28/10/2019</i>	4	Indice për ndjekje penale 1) Drejtor i Përgjithshëm i ARRSH 2) Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Vlerësimit të Ofertave 3) Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Vlerësimit të Ofertave 4) Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Vlerësimit të Ofertave	Neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
<b>7</b>	Muzeu Historik Kombëtar	<i>Nr.1441/12</i> <i>Datë</i> <i>25/02/2020</i>		Indice Penale		Në hetim		Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
<b>8</b>	Bashkia Pukë	<i>Nr.Prot</i> <i>1432/12 Në</i> <i>datë</i> <i>19.09.2019</i>	1	1) Administrator Firme	Neni nr.281 Ligji nr.7905 dt.21.03.1995 Kodi i Procedures Penale, i ndryshuar, neni nr.186 "Falsifikimi i dokumenteve"	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore

9	Bashkia Mat	Nr.Prot 1434/11 Në datë 23.09.2019	1	1) Administrator Firme	Neni nr.281 Ligji nr.7905 dt.21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar, neni nr.186 "Falsifikimi i dokumenteve	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
10	Bashkia Mat	Nr.Prot 1434/12 Në datë 23.09.2019		Indicie penale	Neni nr.281 Ligji nr.7905 dt.21.03.1995 Kodi i Procedures Penale, i ndryshuar, neni nr.186 "Falsifikimi i dokumenteve"	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
11	Bashkia Gramsh	Nr.Prot 200/8 Në datë 22.08.2019		Indicie penale	Neni nr.281 Ligji nr.7905 dt.21.03.1995 Kodi i Procedures Penale, i ndryshuar	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
12	Bashkia Dropull	Nr.Prot 368/8 Në datë 02.10.2019		Dërgim materiale për Vlerësim	Neni nr.281 Ligji nr.7905 dt.21.03.1995 Kodi i Procedures Penale, i ndryshuar.	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
13	Bashkia Fushë Arrëz	Nr.Prot 1434/11 Në datë 23.09.2019		Indicie Penale	Neni 186 "Falsifikimi i dokumenteve", nenin 186/a "Falsifikimi kompjuterik", neni 190 "Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve" Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
14	Bashkia Himare	Nr.Prot 366/8 Në datë 30.01.2020		Indicie për ndjekje penale	Indicie për ndjekje penale	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Vetqeverisjes Vendore
15	ALUIZNI Tirana Jug	Nr.Prot 1279/9 Në datë 24.09.2019	3	1) Përgjegjës Sektori i Legalizimit 2) Ish Drejtor	Dërgim Materiali për indicie Neni 281, Ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

				3) Ish Përgjegjës Sektori Legalizim	Shqipërisë”, të ndryshuar; Ligji nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.			
<b>16</b>	ZVRPP Bulqizë	<i>Nr.Prot 207/11 Në datë 24.09.2019</i>	5	1) Ish Regjistruese 2) Ish specialist 3) Specialiste 4) Hartograf 5) Ish koordinator projekti	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal Ligji nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
<b>17</b>	ZVRPP Lushnje  (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lushnje)	<i>Nr.1276/8 Në datë 18.11.2019</i>		Indicie Penale	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal Ligji nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
<b>18</b>	ZVRPP Lezhë  (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Lezhë)	<i>Nr.375/12 Në datë 19.11.2019</i>		Indicie Penale	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal Ligji nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

19	ZVRPP Gjirokastrër  (Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrër)	Nr.372/12 Në datë 19.11.2019	7	1) Ish Regjistrues 2) Ish Specialist 3) Ish Specialist Hartograf 4) Ish Regjistrues 5) Ish Regjistrues 6) Ish Specialist Hartograf 7) Ish Regjistrues	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
20	ZVRPP Berat	Nr.1282/8 Në datë 19.11.2019		Indicie Penale	“Shpërdorimi i detyrës” neni 248 i Kodit Penal	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
	(Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Berat)				Ligji nr. 33, datë 29.04.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme			
21	ALUIZNI Vlorë	Nr.554/9 Dt 16/01/2020	1	1) Ish drejtor në ish-Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale		Në hetim		Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit

<b>22</b>	ALUIZNI Zona Rurale Tirana	Nr.578/12 Dt 17/02/2020	4	1) Ish-Drejtor 2) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit 3) Ish-Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë 4) Ish-Specialist në Sektorin e Legalizimit	Indicie për kallëzim penal	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
<b>23</b>	AlbPetrol SHA	Nr.371/9 Datë 14/11/2019		Indicie Penale	Neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
<b>24</b>	Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA	Nr.Prot 1147/3 Në datë 22.12.2019	7	<u>Ish-anëtarët e Këshillit Mbikqyrës</u> 1) Kryetar 2) Nënkyetar 3) Anëtar 4) Anëtar 5) Anëtar 6) Anëtar 7) Anëtar	Neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimi i detyrës”	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja

<b>25</b>	Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së BE-së (AA)	Nr.Prot.427/27 Në datë 27.01.2020	1	1) Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës së BE-së	Neni 235 i Kodit Penal “Kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik“	Në hetim		Departamenti i Auditimit të Performancës
<b>26</b>	Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës së BE-së (AA)	Nr.Prot.427/30 Në datë 25.02.2020		Indicie Penale		Në hetim		Departamenti i Auditimit të Performancës
<b>27</b>	Rezidencën Studentore Universitare nr. 1 SHA Tiranë	Nr.Prot.598/11 Në datë 17.02.2020		Dërgim për vlerësim prokurorisë për procedura prokurimi		Në hetim		Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
<b>28</b>	Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”	Nr.Prot.1422/1 4 Në datë 26.02.2020		Dërgim për vlerësim të raportit perfundimtar		Në hetim		Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja
	<b>Gjithsej 28 Kallëzime penale të dërguara në Prokurori nga KLSH</b>		<b>40</b>	<b>Persona të kallëzuar 40*</b>				

KLSH nga auditimet e realizuara në vitin 2019 ka përcjellë **28 kallëzime** dhe indicie penale, nga të cilat **25** prej tyre kanë përfunduar dhe i janë dërguar prokurorisë, **3** janë dërguar për vlerësim në Prokurori dhe **2** janë në proces shqyrtimi dhe vlerësimi nga Departamenti Juridik në KLSH.

\*Shënim: Numri i personave të kallëzuar nga KLSH për auditimet e kryera përgjatë vitit 2019 në shumë indicie penale është përcjell në një fashë të gjerë pa nominuar emra konkret, për të cilët do vendoset nga organet e prokurorisë.

### A.3 Evidenca e dëmit ekonomik dhe fondeve pa efektivitetit sipas subjekteve

Mijë lekë

Nr.	Subjektet	Zbuluar	Rekomanduar për zhdëmtim
1	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	15,168,778	15,168,778
2	Ministria e Drejtësisë	92	92
3	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	47,325	47,325
4	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	344,383	344,383
5	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural	2,058,455	2,058,455
6	Garda e Republikës	46	46
7	Autoriteti Rrugor Shqiptar	662,914	662,914
8	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjes	476,579	476,579
9	Universiteti i Vlorës	2,377	2,377
10	Universiteti i Shkodrës	6,829	6,829
11	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm dhe Kujdesit Shëndetësor	948	948
12	Dega e Doganës Elbasan	39,973	39,973
13	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	919,541	919,541
14	FAF SHA	6,297	6,297
15	Bashkia Kurbin	7,220	7,220
16	Bashkia Tropojë	11,472	11,472
17	Bashkia Librazhd	1,484	1,484
18	Bashkia Pukë	10,020	10,020
19	Bashkia Tiranë	4,008	0
20	Bashkia Mat	4,102	4,102
21	Bashkia Fushë Arëz	1,666	1,666
22	Bashkia Bulqizë	462	462
23	Bashkia Gramsh	2,307	2,307
24	Bashkia Shkoder	11,870	11,870
25	Bashkia Sarandë	11,613	11,613
26	Bashkia Patos	3,285	3,285
27	Bashkia Libohovë	4,616	4,616
28	Bashkia Dropull	3,420	3,420
29	Bashkia Tepelenë	2,404	2,404
30	Bashkia Delvinë	2,875	2,875
31	Bashkia Berat	8,946	8,946
32	Bashkia Himarë	29,032	29,032
33	Bashkia Librazhd (Riauditim)	5,496	5,496
34	Bashkia Korçë (Tematik)	1,828	1,828
35	Bashkia Cërrik (Tematik terminalin)	0	0
36	Operatori i Sistemit të Transmetimit OST	11,163	11,163
37	Ujësjetllës Kanalizime Pogradec SHA	26,743	26,743
38	Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA	7,628	7,628

<b>Nr.</b>	<b>Subjektet</b>	<b>Zbuluar</b>	<b>Rekomanduar për zhdëmtim</b>
39	Spitali Rajonal Durrës	9,581	9,581
40	Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastër SHA	2,617	2,617
41	Ujësjetllës Kanalizime Fier SHA	76,356	76,356
42	Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë	321,788	321,788
43	Ujësjetllës Kanalizime Lushnje SHA	3,465	3,465
44	Spitali Rajonal Korçë	15,859	15,859
45	Albpetrol SHA	5,489,705	5,489,705
46	Ujësjetllës Kanalizimeve Shkodër SHA	480	480
47	Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA	11,697	11,697
48	Posta Shqiptare SHA	7,106	7,106
49	Hekurudha SHA	8,187	8,187
50	Autoriteti i Aviacionit Civil	2,589	2,589
51	Projekti "Fuqëzimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës", Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	99,557	99,557
52	ARRSH Projekti "Ndërtimi i rrugës Qukës-Qafë Plloçe"	4,040	4,040
53	ADISA Projekti "Ofrimi i Shërbimeve Publike dhe në Qendër Qytetarin"	429	429
54	ARRSH Projekti " <i>Mirembajtje dhe Siguri rrugore bazuar ne rezultate</i> "	67,161	67,161
55	ZVRPP Bulqizë	341	341
56	ZVRPP Tropojë	300	300
57	ZVRPP Gramsh	858	858
58	ZVRPP Lezhë	3,172	3,172
59	ZVRPP Lushnje	15,089	15,089
60	ZVRPP Berat	26,298	26,298
61	ALUIZNI Lezhë	42,251	42,251
62	ALUIZNI Tirana Jug	161,317	161,317
63	ALUIZNI Korçë	47,337	47,337
64	ALUIZNI Elbasan	69,193	69,193
65	DR ISHMPU Fier	4,800	4,800
66	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Durrës	0	0
67	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë	265,617	265,617
68	DR ISHMPU Tiranë	54,972	54,972
69	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Elbasan	825	825
70	ZVRPP Devoll	1,389	1,389
71	ALUIZNI Vlorë	157,280	157,280
72	ALUIZNI Kavajë	143,058	143,058
73	ALUIZNI Zona Rurale nr.1 Tiranë	281,867	281,867
	<b>TOTALI</b>	<b>27,304,777</b>	<b>27,300,769</b>

Evidenca nr. 3

Evidenca e pasqyrimt të parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cila kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit për periudhën Janar – Dhjetor 2019

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi i subjekteve	A	B	TOTALI =
		Shuma në të ardhura	Shuma në shpenzime	A+B
1	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	0	344,385	344,385
2	Ministria e Drejtësisë	0	31,224	31,224
3	Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës	0	1,718	1,718
4	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore	0	22,418	22,418
5	Fondi Shqiptar i Zhvillimit	0	522,513	522,513
6	Autoriteti Rrugor Shqiptar	0	488,121	488,121
7	Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjes	0	524,966	524,966
8	Ministria e Shëndetësisë	0	981,608	981,608
9	Universiteti i Vlorës	0	5,307	5,307
10	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë	0	363,978	363,978
11	Universiteti i Shkodrës	0	15,938	15,938
12	Ministria e Drejtësisë (tematik)	0	67,075	67,075
13	Drejtoria Arsimore Rajonale Fier	0	24,837	24,837
14	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	0	38,496	38,496
15	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë CFCU	0	121,700	121,700
16	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm dhe Kujdesit Shëndetësor	215,000	1,675,800	1,890,800
17	Dega e Doganës Elbasan	29,450	0	29,450
18	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	3,299,965	8,235	3,308,200
19	MFE:Drejtoria e	0	1,388,706	1,388,706

	Koncensioneve			
20	Shoqëria e parë e investimeve FAF SHA, sot Agrocredit SHA	0	111,846	111,846
21	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	38,923,755	2,782,899	41,706,654
22	MFE: Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit	0	53,430,000	53,430,000
23	MFE: Drejtoria e Buxhetit dhe Borxhit	0	17,670,254	17,670,254
24	Bashkia Kurbin	110,710	4,744	115,454
25	Bashkia Tropojë	37,152	338,782	375,934
26	Bashkia Librazhd	233,833	0	233,833
27	Bashkia Pukë	10,014	105,560	115,574
28	Bashkia Tiranë	206,707	12,813	219,520
29	Tirana Parking (Bashkia Tiranë)	0	306	306
30	Drejtoria e Konvikteve dhe Shkollave Tiranë (Bashkia Tiranë)	0	1,045	1,045
31	Drejtoria Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit (Bashkia Tiranë)	0	2,506	2,506
32	Bashkia Mat	0	246,627	246,627
33	Bashkia Fushë Arrëz	22,528	125,022	147,550
34	Bashkia Bulqizë	11,027	8,981	20,008
35	Bashkia Gramsh	31,911	69,000	100,911
36	Bashkia Shkoder	894,000	148,390	1,042,390
37	Bashkia Sarandë	774,205	448,000	1,222,205
38	Bashkia Patos	20,506	46,736	67,242
39	Bashkia Libohovë	21,257	128,995	150,252
40	Bashkia Dropull	7,567	0	7,567
41	Bashkia Mat Auditim Tematik (Pasq Fina.2018)	7,853	0	7,853
42	Bashkia Kurbin A. Tematik (Pasq Fina.2018)	113,000	0	113,000
43	Bashkia Himarë	361,328	241,359	602,687
44	Bashkia Berat	423,342	19,171	442,513
45	Bashkia Tepelenë	32,431	0	32,431
46	Bashkia Delvinë	47,486	26,933	74,419
47	Bashkia Klos	47,405	0	47,405
48	Bashkia Krujë	249,581	0	249,581
49	Bashkia Korçë (A.Tematik 1 proc	0	3,500	3,500

	prokurimi)			
50	Operatori i Sistemit të Transmetimit OST	0	146,311	146,311
51	Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA	0	35,662	35,662
52	Ujësjiellës Kanalizime Durrës SHA	0	29,876	29,876
Nr	Emërtimi i subjekteve	A	B	TOTALI = A+B
		Shuma në të ardhura	Shuma në shpenzime	
53	Spitali Rajonal Durrës	0	45,788	45,788
54	Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër SHA	953	9,348	10,301
55	Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë	253,953	220,717	474,670
56	Ujësjiellës Kanalizime Lushnje SHA	0	6,500	6,500
57	Spitali Rajonal Korçë	0	10,627	10,627
58	Albpetrol SHA	0	248,854	248,854
59	Rezidenca Studentore Universitare nr. 1 Tiranë SHA	586	9,179	9,765
60	Hekurudha SHA	0	10,954	10,954
61	Autoriteti i Aviacionit Civil	0	55,982	55,982
62	CFCU, Projekti "Ndërtimi i Sistemit të Kanalizimit në Vlorë, Faza II"	0	19,100	19,100
63	ARRSH Projekti "Mirembajtja dhe Siguria Rrugore bazuar ne rezultate"	0	378,367	378,367
64	ZVRPP Bulqizë	6,117	0	6,117
65	DR ISHMPU Fier	17,640	0	17,640
66	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë	130	8,290	8,420
67	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Elbasan	220,800	0	220,800
68	ALUIZNI Vlorë	0	8,819	8,819
69	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	0	4,078	4,078
70	Auditim IT: Ujësjiellës Kanalizime Berat, Kuçovë	0	30,455	30,455
<b>TOTALI</b>	<b>46,632,192</b>	<b>83,879,401</b>	<b>83,879,401</b>	<b>130,511,594</b>

#### A.4 Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave drejtuar KLSH-së

Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave  Fushat kryesore të shqetësimit publik	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)
		E drejtë	Pa drejtë		
<b>Për administrim financiar dhe prokurime</b>	<b>64</b>	20	2	3	37
<b>Privatizim e kthim prone</b>	<b>115</b>	18	16	19	62
<b>Taksa, Tatime e dogana</b>	<b>13</b>				13
<b>Të tjera</b>	<b>107</b>	68	3	1	36
<b>Total</b>	<b>300</b>	<b>106</b>	<b>21</b>	<b>23</b>	<b>148</b>

#### A.5 Institucionet e audituara nga KLSH gjatë vitit 2019

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHETIT		
1	1	Drejtoria e Përgjithshme e Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, Bankës Botërore dhe Donatorëve të tjerë (CFCU)
2	2	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
3	3	Dega Doganore Elbasan
4	4	Instituti i Sigurimeve Shëndetësore
5	5	FAF SHA
6	6	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
7	7	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
8	8	MFE: Drejtoria e Buxhetit dhe Borxhit
9	9	MFE: Drejtoria e Përgjithshme të Thesarit
10	10	MFE: Drejtoria e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Publik
11	11	MFE: Drejtoria e Koncesioneve
12	12	Instituti i Sigurimeve Shëndetësor (tematik për pensionet e minorëve)
13	13	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH për 8 subjekte
14	14	Raporti i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2018
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QËNDRORE		
15	1	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
16	2	Ministria e Drejtësisë
17	3	Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës

18	4	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
19	5	Instituti i Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit
20	6	Muzeu Historik Kombëtar
21	7	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
22	8	Agjencia e Prokurimit Publik
23	9	Garda e Republikës
24	10	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (Për projektet e financuara nga Buxheti i Shtetit)
25	11	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH për 22 subjekte
26	12	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
27	13	Autoriteti Rrugor Shqiptar
28	14	Agjencia Kombëtare e Ujësjetës Kanalizimeve dhe Mbetjeve
29	15	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
30	16	Avokaturën e Shtetit
31	17	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
32	18	Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi
33	19	Universitetin Ismail Qemali Vlorë
34	20	Inspektorati Qendror
35	21	Ministria e Drejtësisë
36	22	Instituti i Mjekësisë Ligjore
37	23	Drejtoria Arsimore Rajonale Fier
38	24	Komisioni i Prokurimit Publik
39	25	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
40	26	Agjencia e Zhvillimit të Investimeve në Shqipëri (AIDA)
		<b>DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETQEVERISJES VENDORE</b>
		<b>Auditime të evaduara</b>
41	1	Bashkia Kurbini
42	2	Bashkia Tropojë
43	3	Bashkia Librazhd
44	4	Bashkia Pukë
45	5	Bashkia Tiranë
46	6	Tirana Parking
47	7	Drejtoria e Konvikteve dhe Shkollave Tiranë
48	8	Bashkia Libohovë
49	9	Bashkia Mat
50	10	Bashkia Fushë Arëz
51	11	Bashkia Bulqizë
52	12	Bashkia Gramsh
53	13	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH për 13 subjekte
54	14	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH për 17 subjekte
55	15	Bashkia Shkodër
56	16	Bashkia Sarandë
57	17	Bashkia Patos
58	18	Drejtoria Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit
59	19	Bashkia Dropull
60	20	Bashkia Pukë Auditim Tematik (Pasqyrat Financiare 2018)
61	21	Bashkia Mat Auditim Tematik (Pasqyrat Financiare 2018)
62	22	Bashkia Kurbini Auditim Tematik (Pasqyrat Financiare 2018)
63	23	Bashkia Librazhd (Pasqyrat Financiare 2018 dhe Riauditim prokurimet)
64	24	Bashkia Korçë (Auditim Tematik 1 procedurë prokurimi)
65	25	Bashkia Cërrik (Auditim Tematik 1 procedurë prokurimi)
66	26	Bashkia Himarë
67	27	Bashkia Berat

68	28	Bashkia Tepelenë
69	29	Bashkia Delvinë
70	30	Bashkia Klos
71	31	Bashkia Krujë
		<b>DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE, DHE MJEDISIT</b>
72	1	ZVRPP Bulqizë
73	2	ZVRPP Tropojë
74	3	ZVRPP Gramsh
75	4	ALUIZNI Lezhë
76	5	ALUIZNI Tirana Jug
77	6	DR ISHMPU Fier
78	7	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Durrës
79	8	ZVRPP Berat
80	9	DR ISHMPU Tiranë
81	10	ZVRPP Lezhë
82	11	ALUIZNI Korçë
83	12	ALUIZNI Elbasan
84	13	Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë
85	14	ZVRPP Gjirokastër
86	15	Drejtoria Rajonale e Mjedisit Elbasan
87	16	ZVRPP Lushnje
88	17	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH për 7 subjekte
89	18	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH për 6 subjekte
90	19	ZVRPP Devoll
91	20	ALUIZNI Vlorë
92	21	ALUIZNI Kavajë
93	22	ALUIZNI Zonave Rural .1 Tiranë
94	23	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar Tiranë
		<b>DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA</b>
95	1	Ujësjetës Kanalizime Pogradec, SHA
96	2	Ujësjetës Kanalizime Durrës, SHA
97	3	Operatori i Sistemit të Transmetimit OST SHA
98	4	Spitali Rajonal Durrës
99	5	Ujësjetës Kanalizime Gjirokastër SHA
100	6	Ujësjetës Kanalizime Fier SHA
101	7	Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza, Tiranë
102	8	Ujësjetës Kanalizime Lushnje SHA
103	9	Spitali Rajonal Korçë
104	10	Albpetrol SHA
105	11	Ujësjetës Kanalizime Shkodër SHA
106	12	Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 SHA, Tiranë
107	13	Posta Shqiptare SHA
108	14	Hekurudha Shqiptare SHA
109	15	Autoriteti i Aviacionit Shqiptar
110	16	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Projekti "Fuqizimi i Qendrës Traumatologjike Kombëtare të Tiranës"
111	17	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Projekti IPA 2013 "Ristrukturimi dhe forcimi i rrjetit laboratorik të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë në Shqipëri"
112	18	Autoriteti Rrugor Shqiptar, Projekti "Asistencë teknike për përmirësimin e standardeve të sigurisë rrugore"
113	19	CFCU, Projekti "Ndërtimi i Sistemit të Kanalizimit në Vlorë, Faza II"

114	20	Projekti “Ndërtimi i rrugës Qukës- Qafë Plloçë” Autoriteti Rrugor Shqiptar
115	21	Projekti: “Ofrimi i Shërbimeve Publike dhe në Qendër Qytetarin” ADISA
116	22	Projekti: “Mirëmbajtje dhe siguri rrugore bazuar në rezultate” Autoriteti Rrugor Shqiptar
117	23	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH në 12 subjekte
<b>DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS</b>		
118	1	<i>Auditim performance me temë:</i> Performanca e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH, DRSSH Korçë, DRSSH Kukës)
119	2	<i>Auditim performance me temë:</i> Efektiviteti i Menaxhimit dhe Administrimit të Fondit Pyjor dhe Kullosur (MTM & inst. në varësi, Bashkia Tiranë, Bashkia Shkodër, Bashkia Vlorë)
120	3	<i>Auditim performance me temë:</i> Ndotja akustike (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Tirane)
121	4	<i>Auditim performance me temë:</i> Cilësia dhe siguria e Barnave në Rrjetin e Hapur Farmaceutik dhe Shërbimin Spitalor (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, AKBPM, QSUT)
122	5	<i>Auditim performance me temë:</i> Efektiviteti i Programeve Sociale të Strehimit (MFE, Bashkia Tiranë, Bashkia Korçë, Bashkia Shkodër, Bashkia Vlorë)
123	6	<i>Auditim performance me temë:</i> Efektiviteti i politikave për nxitjen e barazisë gjinore dhe forcimin e rolit të gruas (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtës Sociale)
124	7	<i>Auditim performance me temë:</i> Siguria Rrugore në Shqipëri (Ministrinë e Infrastrukturës, Ministria e Brendshme; Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë)
125	8	<i>Auditim performance me temë:</i> Zhvillimi i Shërbimeve Sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara (Ministria e Shëndetësisë dhe mirëqenies Sociale, Bashkia Tirane, Bashkia Vlore)
126	9	<i>Auditimi performance me temë:</i> Sigurimi i cilësisë së veprave ndërtimore (Instituti i Ndertimit, Ministria e Infranstrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Fondi Shqiptar i Zhvillimit)
127	10	1. <i>Auditim performance me temë:</i> Performanca e zyrave të punës (Shërbimi Kombëtar i Punësimit; Ministria E Financave Dhe Ekonomisë)
128	11	<i>Auditim performance me temë:</i> Performanca e MBZHR-së për akuakulturën (Ministria e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural)
129	12	<i>Auditim performance me temë:</i> Performanca e çerdheve dhe kopshteve (Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHFEF); Bashkitë e Vlores dhe Tiranës)
130	13	<i>Auditim performance me temë:</i> Efektiviteti i kasave fiskale në rritjen e të ardhurave tatimore (Drejtoria E Përgjithshme eTatimeve; Ministria eFinancave)
131	14	<i>Auditim performance me temë:</i> Ndotja e deteve (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Bregdetit; Agjencia Kombëtare e Mjedisit
132	15	<i>Auditim performance me temë:</i> Monitorimi i projekteve të huaja në Shqipëri (INSTAT; MFE; AAPAA)
133	16	<i>Auditim performance me temë:</i> Mbikëqyrja e tregut të telefonisë celulare (Autoriteti i Komunikimeve Elektronike Dhe Postare)
<b>DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT</b>		
134	1	<i>Auditim IT:</i> Ujësjiellës kanalizime Berat, Kuçovë
135	2	<i>Auditim IT:</i> Ujësjiellës kanalizime Lushnje Sh.a
136	3	<i>Auditim IT:</i> FSDKSH
137	4	Auditim Tematik ushtruar mbi Zbatimin e Rekomandimeve të lëna në nga KLSH (Auditimet IT)
138	5	<i>Auditim IT:</i> Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare sh.a.
139	6	<i>Auditim IT:</i> Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Njësia e TIK e AKSHI-t atashuar për MFE
140	7	<i>Auditim IT:</i> Përformanca e përdorimit të Internetit në Administratën Publike

## A.6 Pasqyrat financiare 2019

Formati nr.1

### PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

VITI 2019

Në lekë

Referenca e llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
<b>A</b>	<b>A K T I V E T</b>	<b>Mbyllur</b>	
	<b>I. Aktivët Afat shkurtra</b>	<b>53,336,098</b>	<b>52,631,163</b>
	<b>1. Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre</b>	<b>1,996,859</b>	<b>5,458,469</b>
531	Mjete monetare në Arke		
512,56	Mjete monetare në Banke		
520	Disponibilitete në Thesar	1,996,859	5,458,469
50	Letra me vlerë		
532	Vlera të tjera		
54	Akreditiva dhe paradhënie		
59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)		
	<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>21,190,041</b>	<b>18,408,418</b>
31	Materiale	21,190,041	18,408,418
32	Inventar i imët		
33	Prodhim në proces		
34	Produkte		
35	Mallra		
36	Kafshe në rritje e majmëri		
37	Gjendje të pa mbrritura, ose pranë të tretëve		
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit		
39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)		
	<b>3.Llogari të Arketushme</b>	<b>30,149,198</b>	<b>28,764,276</b>
411	Klientë e llogari të ngjashme		
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
431	Tatim e Taksa		
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Fatkeqësi natyrore që mbulojnë nga shteti		
435	Sigurime Shoqërore		
436	Sigurime Shëndetësorë		
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore		-36,720
44	Institucione të tjera publike		
465	Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë		
468	Debitorë të ndryshëm	2,845,167	2,845,167
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	27,304,031	25,955,829
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisive ekonomike		
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim(-)		
	<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

409	Parapagime		
473	Llogari e pritjes te marrëdhënieve me thesarin		
477	Diferenca konvertimi aktive		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë ne disa ushtrime		
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme		
	<b>II. Aktivët Afat gjata</b>	<b>896,686,885</b>	<b>991,723,193</b>
<b>20</b>	<b>1. Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>221,173,113</b>	<b>260,203,663</b>
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
202	Studime dhe kërkime	221,173,113	260,203,663
203	Koncesione, Patenta, Licenca e te ngjashme		
<b>21</b>	<b>2. Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>675,513,772</b>	<b>731,519,530</b>
210	Toka, Troje, Terrene		
211	Pyje, Plantacione		
212	Ndërtesa e Konstruksione	564,944,144	595,717,631
213	Rruge, rrjete, vepra ujore		
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	49,606,349	51,537,824
215	Mjete Transporti	2,852,462	3,309,120
216	Rezerva Shtetërore		
217	Kafshe pune e prodhimi		
218	Inventar ekonomik	58,110,817	80,954,955
24	Aktive afatgjata te dëmtuara		
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
25-26	<b>3. Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
25	Huadhënie e Nenhuadhenie		
26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet		
	<b>4. Investime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale		
231	Për Aktive Afatgjata materiale	0	
<b>B</b>	<b>PASIVET(DETYRIMET)</b>	<b>32,176,299</b>	<b>34,252,987</b>
	<b>I. Pasivet Afat shkurtra</b>	<b>32,176,299</b>	<b>34,252,987</b>
	<b>1. Llogari te Pagueshme</b>	<b>32,176,299</b>	<b>34,252,987</b>
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	2,140,246	894,996
42	Detyrime ndaj personelit	16,604,285	16,310,703
16,17,18	Hua Afat shkurtra		
460	Huadhënës		
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	2,081,127	2,084,835
432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
435	Sigurime Shoqërore	5,739,819	6,157,906
436	Sigurime Shëndetësorë	738,554	
437,438,	Organizma te tjerë shtetërore		-36,720
44	Institucione te tjera publike		
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisive ekonomike		

464	Det. për tu paguar për bl. letrave me vlere		
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	1,996,859	5,458,469
467	Kreditore te ndryshëm		507,389
4341	Operacione me shtetin( detyrime	2,875,409	2,875,409
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)		
	<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
419	Kreditore, Parapagime		
475	Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse		
478	Diferenca konvertimi pasive		
480	Te ardhura për t'u klasifikuar ose rregulluar		
487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se titullit		
	<b>II. Pasivet Afat Gjata</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Klase 4	Llogari te pagueshme		
16.17,18	Huatë Afat gjata		
	Provigjonet afatgjata		
Klasa 4	Te tjera		
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>917,846,684</b>	<b>1,010,101,369</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>917,846,684</b>	<b>1,010,101,369</b>
101	Teprica (Fondi i akumuluar) /Deficiti i akumuluar	915,065,061	504,709,813
12	Rezultatet e mbartura	2,567,256	
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	214,367	2,567,256
111	Rezerva		
115	Nga Fondet e veta te investimeve		
15	Shuma te parashikuara për rreziqe e zhvlerësime		
105	Teprica e Granteve kapitale te Brendshme		
106	Teprica e Granteve kapitale te Huaja		
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim		
109	Rezerva nga Rivlerësimi i Aktiveve Afatgjata		502,824,300
	Te Tjera	0	0
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>950,022,983</b>	<b>1,044,354,356</b>
<b>Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen</b>		<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
Aktivet Neto a janë te barabarta me Fondin e Konsoliduar		<b>0</b>	<b>0</b>
Totali i Aktiveve a është i barabarte me = Totalin e Pasiveve		<b>0</b>	<b>0</b>

PASQYRA E PERFORMANCES FINANCIARE Viti 2019

(Klasifikimi, sipas Natyres ekonomike)

Në lekë

Nr. Llogarije	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	Ushtrimi mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
b	c	1	2
<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>376,921,839</b>	<b>367,765,639</b>
<b>70</b>	<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
7001	Tatim mbi Fitimin		
7002	Tatim mbi Biznesin e vogël		
7009	Te tjera Tatime mbi te ardhurat		
<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurinë</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7020	Tatim mbi Pasurinë e paluajtshme		
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme		
7029	Te tjera tatime mbi pasurinë		
<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar(TVSH)		
7031	Akciza		
7032	Takse mbi shërbimet specifike		
7033	Takse mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie		
7035	Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie		
<b>704</b>	<b>4.Takse mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7040	Takse doganore për mallrat e importit		
7041	Takse doganore për mallrat e eksportit		
7042	Tarife shërbimi doganor e kolipostë		
7049	Te tjera taksa mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare		
<b>705</b>	<b>5. Takse e rrugës</b>		
<b>708</b>	<b>6. Te tjera Tatime e Taksa kombëtare</b>		
<b>709</b>	<b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>		
<b>75</b>	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
750	NGA TE PUNESUARIT		
751	NGA PUNEDHENESI		
752	NGA TE VETPUNESUARIT		
753	NGA FERMERET		
754	NGA SIGURIMET VULLNETARE		
755	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHOQERORE		
756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
<b>71</b>	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>710</b>	<b>1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare		

7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare		
7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia		
<b>711</b>	<b>2. Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh		
7112	Takse për veprime gjyqësorë e noteriale		
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve		
7114	Te ardhura nga biletat		
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestri e zhdëmtime		
7116	Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje		
<b>719</b>	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>		
<b>76</b>	<b>IV. TE ARDHURA FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
760	Nga interesat e huadhënies se brendshme		
761	Nga interesat e huadhënies se Huaj		
765	Nga interesat e depozitave		
766	Nga këmbimet valutore		
<b>72</b>	<b>V. GRANTE KORENTE</b>	<b>376,921,839</b>	<b>367,765,639</b>
<b>720</b>	<b>1. Grant korent i Brendshëm</b>	<b>376,921,839</b>	<b>367,765,639</b>
7200	Nga Buxheti për NJQP(Qendrore)	351,758,054	342,704,806
7201	Nga Buxheti për NJQP(Vendore)		
7202	Nga Buxheti për pagesa te posaçme te ISSH		
7203	Nga Buxheti për mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)		
7204	Pjesëmarrje e institucioneve ne tatime nacionale		
7205	Financim shtese për te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	25,163,785	25,060,833
7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)		
7209	Te tjera grante korrente te brendshme		
<b>721</b>	<b>2. Grant korrent I Huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Nga Qeveri te Huaja		
	Nga Organizata Ndërkombëtare		
	<b>VI. TE ARDHURA TE TJERA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
781	Te ardhura nga investimet ne ekonomi		
782	Rimarrje Shumash te parashikuara për aktive afatshkurtra		
783	Rimarrje Shumash te parashikuara për aktive afatgjata		
784	Rimarrje Shumash për shpenzime te viteve ardhshme		
787	Tërheqje nga seksioni I investimeve		
<b>73</b>	<b>VII. NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>		
<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>376,707,472</b>	<b>365,198,383</b>
<b>600</b>	<b>I. PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>256,610,484</b>	<b>246,172,773</b>
6001	Paga, personel i përherëshëm	256,610,484	246,172,773
6002	Paga personel i Përkohshëm		
6003	Shpërblime	0	
6009	Shpenzime te tjera për personelin	0	

<b>601</b>	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>40,105,464</b>	<b>37,085,021</b>
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	35,722,602	32,900,661
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	4,382,862	4,184,360
<b>602</b>	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>81,522,681</b>	<b>83,240,990</b>
602	Mallra dhe shërbime te tjera		
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	6,774,184	4,309,165
6021	Materiale dhe shërbime speciale	555,560	2,195,121
6022	Shërbime nga te trete	5,540,848	6,188,692
6023	Shpenzime transporti	4,042,487	4,482,871
6024	Shpenzime udhëtimi	59,813,975	61,825,117
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	2,538,294	2,574,712
6026	Shpenzime për qiramarrje	364,410	723,432
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	1,165,200	
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen për hua		
6029	Shpenzime te tjera operative	727,723	941,880
<b>603</b>	<b>IV.SUBVECIONE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6030	Subvencione për diference çmimi		
6031	Subvencione për te nxitur punësimin		
6032	Subvencione për te mbuluar humbjet		
6033	Subvencione për sipërmarrjet individuale		
6039	Subvencione te tjera		
	<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>1,250,466</b>	<b>1,266,855</b>
<b>604</b>	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
6040	Transferime korrente tek nivele tjera te Qeverise		
6041	Transferime korrente tek institucione qeveritare te ndryshme		
6042	Transferime korrente tek Sigurimet Shoqërore e Shëndetësorë		
6044	Transferime korrente tek Organizatat jo fitimprurse		
<b>605</b>	<b>2.Transferime korrente me jashte</b>	<b>117,266</b>	<b>123,755</b>
6051	Transferime për Organizatat Ndërkombëtare	117,266	123,755
6052	Transferime për Qeveritë e Huaja		
6053	Transferime për institucionet jo fitimprurëse te huaja		
6059	Transferime Te tjera korrente me jashtë shtetit		
<b>606</b>	<b>3.Transferime për Buxhetet familjare e individë</b>	<b>1,133,200</b>	<b>1,143,100</b>
6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
6061	Transferta Paguara nga Inst. tjera e Org. Pusht. Vendor	1,133,200	1,143,100
	<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>65</b>	<b>1.Shpenzime Financiare te brendshme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
650	Interesa për bono thesarit dhe kredi direkte		
651	Interesa për huamarrje te tjera të brendshme		
652	Interesa Letra tjera vlere Qeverise		
656	Shpenzime nga këmbimet valutore		0
<b>66</b>	<b>2.Shpenzime Financiare te jashtme</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
660	Interesa për huamarrje nga Qeveri te Huaja		
661	Interesa për financime nga Institucionet ndërkombëtare		

662	Interesa për huamarrje te tjera jashtme		
	<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
681	Kuotat e amortizimit te AAGJ, te shfrytëzimit		
682	Vlera e mbetur e AAGJ, te nxjerra jashtë përdorimit e te shitura		
683	Shuma te parashikuara te shfrytëzimit		
686	Shuma te parashikuara për aktivet financiare		
<b>63</b>	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>-2,781,623</b>	<b>-2,567,256</b>
	<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>	<b>0</b>	
<b>85</b>	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES (Rezultati i Veprimtarisë se vitit ushtrimor)</b>	<b>214,367</b>	<b>2,567,256</b>
<b>Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen</b>		<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
Te Ardhurat a janë te barabarta me Shpenzimet + Rezultatit e vitit Ushtrimor		<b>0</b>	<b>0</b>
Llogaria 85 e Pasqyrës F2 a është e barabarte me Llog. 85 ne Pasqyrën F1		<b>0</b>	<b>0</b>
Llogaria 63 ne Pasqyrën F2 a është e barabarte me Ndryshimin e Gjendjeve te Klasës 3 ne Pasqyrën F1		<b>0</b>	

### PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE(CASH'FLOË)

(Sipas Metodes direkte)

Viti 2019

Në lekë

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(b)	(c)	(1)	(2)
<b>I</b>	<b>VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT</b>	<b>3,977,279</b>	<b>10,797,918</b>
<b>1</b>	<b>Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korrente (+)</b>	<b>376,818,887</b>	<b>376,043,100</b>
<b>2</b>	<b>Arkëtime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor</b>		
	Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
	Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets. (+)		
	Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	515,669	690,850
	Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
	Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurtër(+)		
	Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)		
	Te tjera, arkëtuar(+)		
<b>3</b>	<b>Pagesa për Detyrime e Shpenzime korrente</b>		
	Për detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
	Për detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-376,818,887	-365,936,032
	Pagesat për mjetet ne ruajtje(-)	3,461,610	
	Interesi I paguar(-)		
	Tatime te paguara(-)		
	Te tjera te paguara ( - )		
<b>II</b>	<b>VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE</b>		<b>1,513,281</b>
	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)	20,000,000	26,600,000
	Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		

	Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
	Te hyra nga interesat e huadhënies dhe nenhuadhenies(+)		
	Pagesa për detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
	Për detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-190,092	-25,086,719
	Huadhënie e Nenhuadhenie(-)		
	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet(-)		
	Dividendë të paguar(-)		
<b>III</b>	<b>TRANSFERTA E TE TJERA</b>		<b>-12,311,199</b>
	Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-515,669	-690,850
	Transferime ne buxhet te Fondeve të pa përdorura (-)	-42,090,021	-11,620,349
	Lëvizje e brendshme e transferta te tjera(+/-)		
<b>IV</b>	<b>Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare</b>	<b>3,461,610</b>	<b>0</b>
<b>V</b>	<b>Teprica ne fillim te vitit ushtrimor</b>	<b>5,458,469</b>	<b>5,458,469</b>
<b>VI</b>	<b>Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor</b>	<b>1,996,859</b>	<b>5,458,469</b>

<b>Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen</b>	<b>Kuadratura</b>	<b>Kuadratura</b>
Teprica e Llogarisë se Likuiditeteve, e F3 a është e barabarte me Tepricën e Llogarive t e Likuiditeteve ne Pasqyrën F1	<b>0</b>	<b>0</b>

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE AKTIVET NETO/ FONDET NETO

Viti 2019

Në lekë

Referencë	EMERTIMI	Fonde baze dhe Grante Kapitale	Rezerva	Fonde te Tjera te veta	Rezultatet e Mbartura Teprice/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Tepricë/Deficit	GJITHESEJ Aktive/ neto Fonde/ Neto
b	c	1	2	3	4	5	6
<b>101</b>	<b>I.AKTIVET NETO/FONDET NETO</b>	<b>258,864,115</b>					<b>258,864,115</b>
	<b>II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)</b>	<b>751,237,254</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>-92,254,685</b>	<b>0</b>	<b>658,982,569</b>
	<b>1.NGA BURIME TE BRENDSHME</b>	<b>496,254,656</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>-92,254,685</b>	<b>0</b>	<b>403,999,971</b>
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	25,086,719			190,092		<b>25,276,811</b>
1016, 1059	Nga transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	78,000					<b>78,000</b>
1014, 116	Nga Shitjet e AAGJ(+)	0					<b>0</b>
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	2,567,256					<b>2,567,256</b>
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)				2,781,623		<b>2,781,623</b>
111	Nga Rezervat (+,-)	0					<b>0</b>
115	Nga Fondet e veta te investimeve (+,-)	0					<b>0</b>
15	Shuma te parashikuara për rreziqe e Zhvlerësime(+,-)	0					<b>0</b>
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	-34,301,619			<b>-95,210,834</b>		<b>129,512,453</b>
1015	Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet (-)	0			<b>-15,566</b>		<b>-15,566</b>
107	Vlera te AAGJ, te Caktuara ne përdorim(+,-)	0					<b>0</b>
109	Diferenca nga Rivlerësimi i AAGJ(+,-)	502,824,300					<b>502,824,300</b>
	<b>2.NGA BURIME TE JASHTME</b>	<b>254,982,598</b>					<b>254,982,598</b>
106,	Nga granatet e Jashtme kapitale(+)	254,982,598					<b>254,982,598</b>
1016, 1069	Nga transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					<b>0</b>
	<b>TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)</b>	<b>1,010,101,369</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>-92,254,685</b>	<b>0</b>	<b>917,846,684</b>

Kontroll	Shifra 0 (Zero)- Tregon Kuadraturen		Kuadratura	
	Totali i Fondeve sipas Pasqyrës F4 a është i barabarte me Totalin e Fondeve ne Pasqyrën F1		Ne Fillim	Ne Fund
			0	0

**INVESTIMET DHE BURIMET E FINANCIMIT**
**VITI 2019**
**Në lekë**

Nr. reshti	Nr. Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Teprica ne Fillim te Vitit	Transaksionet e vitit		Teprica ne Fund
				Debi	Kredi	
a	b	c	d	e	f	g
<b>1</b>	<b>I.</b>	<b>SHPENZIMET PER INVESTIME</b>				
<b>2</b>	<b>230</b>	<b>Shpenzime për Aktive Afatgjata jo materiale</b>				<b>0</b>
<b>3</b>	<b>231</b>	<b>Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale</b>		<b>190,092</b>	<b>190,092</b>	<b>0</b>
<b>4</b>	<b>25,26</b>	<b>Shpenzime për Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>25</b>	<b>Huadhënie dhe nenhuadhenie</b>		0	0	0
<b>6</b>	<b>26</b>	<b>Pjesëmarrje ne kapitalin e vet</b>		0	0	0
<b>7</b>	<b>II.</b>	<b>BURIMET PER INVESTIME</b>	<b>0</b>	<b>190,092</b>	<b>190,092</b>	<b>0</b>
<b>8</b>	<b>105</b>	<b>1.Grante te brendshme kapitale</b>	0	0		
<b>9</b>	1050	Grante kapitale nga Buxheti	0	190,092	190,092	0
<b>10</b>	1051	Grante kapitale nga nivele te tjera	0		0	0
<b>11</b>	1052	Kontribute te te treteveper investime	0		0	0
<b>12</b>	1059	Grante te brendshme kapitale ne natyre	0			0
<b>13</b>	<b>106</b>	<b>2.Grante te huaja Kapitale</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>14</b>	1060	Nga qeveri te huaja				0
<b>15</b>	1061	Nga institucione ndërkombëtare		0	0	0
<b>16</b>	1069	Grante te huaja ne natyre	0			0
<b>17</b>	<b>14</b>	<b>3.Grante kapitale për investime për të tretë</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>18</b>	145	Grante brendshme kapitale për pjesëmarrje ne investime ne te trete	0	0	0	0
<b>19</b>	146	Grante te huaja kapitale për pjesm. ne invest. ne te trete	0	0	0	0
<b>20</b>	<b>11</b>	<b>4.Fonde te tjera te veta.</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>21</b>	111	Fonde rezerve	0	0	0	0
<b>22</b>	115	Caktim fondi për investime nga rezultati I vitit	0	0	0	0
<b>23</b>	116	Te ardhura nga Shitja e aktiveve te qëndrueshme	0	0	0	0
<b>24</b>	<b>12</b>	<b>5.Rezultati I Mbartur</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,567,256</b>
<b>25</b>	<b>16,17</b>	<b>6.Huamarrje</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>26</b>	<b>16</b>	Huamarrje e Brendshme	0	0	0	0
<b>27</b>	<b>17</b>	Huamarrje e Huaj	0	0	0	0
<b>29</b>	<b>III.</b>	<b>BALANCA (II-I)</b>				
<b>30</b>		<b>(Burimet për Investime minus Shpenzimet për Investime)</b>				

<b>K O N T R O L L E</b>	<b>Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen</b>	<b>Ne Fillim</b>	<b>Ne Fund</b>
<b>Kontroll 1.</b>	Llogaria 105 e F6 a është e barabarte me Llog.105 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 2.</b>	Llogaria 106 e F6 a është e barabarte me Llog.106 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 5.</b>	Llogaria 111 e F6 a është e barabarte me Llog.111 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 6.</b>	Llogaria 115 e F6 a është e barabarte me Llog.115 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 8.</b>	Llogaria 12 e F6 a është e barabarte me Llog.12 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 9.</b>	Llogaria 16+17 e F6 a është e barabarte me Llog.16+17 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 10.</b>	Llogaria 230 e F6 a është e barabarte me Llog. 230 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 11.</b>	Llogaria 231 e F6 a është e barabarte me Llog. 231 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Kontroll 12.</b>	Llogaria 25/26 e F6 a është e barabarte me Llog. 25/26 ne F1	<b>0</b>	<b>0</b>

GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA( KOSTO HISTORIKE)

VITI

2019

Formati nr.7/a

Në lekë

Nr. Reference Llogarije	E M E R T I M I	Gjendje ne Fillim vit te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimor, Kosto Historike					Pakësimi gjate vitit , Kosto Historike				
			Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese		Lëvizje brenda aktiveve	Gjithe sej	Shitje	Nx. jashtë perdor	pikësime te Tjera	Gjithe sej	Gjendja mbyllje te ushtrimit
				Jashtë sistemit	Brenda sistemit							
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
<b>20</b>	<b>I. AAGJ/JO MATERIALE</b>	<b>260,203,663</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>260,203,663</b>
201	Prime te emisionit dhe rimburt huave	0					0					0
202	Studime dhe kërkime	260,203,663					0				0	260,203,663
203	Koncesione, patenta, licenca e tjera ngjashme	0					0					0
<b>21- 28</b>	<b>II. TAAGJ/ MATERIALE</b>	<b>881,364,226</b>	<b>190,092</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>190,092</b>	<b>0</b>	<b>15,566</b>	<b>0</b>	<b>15,566</b>	<b>881,538,752</b>
210	Toka ,troje, terrene	0					0					0
211	Pyje, Kullota Plantacione	0					0				0	0
212	Ndërtime e Konstruksione	616,467,743					0				0	616,467,743
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0					0					0
214	Instalime teknike, makineri, pajisje,	65,139,448					0		7,200		7,200	65,132,248
215	Mjete transporti	37,152,000					0				0	37,152,000
216	Rezerva shtetërore	0					0				0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0					0				0	0
218	Inventar ekonomik	162,605,035	190,092				<b>190,092</b>		8,366		8,366	162,786,761
24	Aktive te Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara						0				0	0
28	Caktime						0				0	0
<b>b</b>	<b>T O T A L I ( I + II )</b>	<b>1,141,567,889</b>	<b>190,092</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>190,092</b>	<b>0</b>	<b>15,566</b>	<b>0</b>	<b>15,566</b>	<b>1,141,742,415</b>

## GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA( VLERA NETO )

Formati  
nr.7/b

Nr. Reference Llogarije	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		Teprica Neto
		Kosto	Amortizim	Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	
		Historike	Akumuluar	Neto	Historike		Historike		Historike	Akumuluar	
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	260,203,663	0	260,203,663	0	39,030,550	0	0	260,203,663	39,030,550	10
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0	0	0					0	0	221,173,113
202	Studime dhe kërkime	260,203,663	0	260,203,663		39,030,550			260,203,663	39,030,550	0
203	Koncesione, patenta, licenca	0	0	0					0	0	221,173,113
21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	881,364,226	149,844,696	731,519,530	190,092	56,180,284	15,566	0	881,538,752	206,024,980	0
210	Toka, troje, Terene	0	0	0					0	0	675,513,772
211	Pyje, Kullota Plantacione	0	0	0					0	0	0
212	Ndërtime e Konstruksione	616,467,743	20,750,112	595,717,631		30,773,487			616,467,743	51,523,599	0
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	0	0	0					0	0	564,944,144
214	Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune	65,139,448	13,601,624	51,537,824		1,924,275	7,200		65,132,248	15,525,899	0
215	Mjete transporti	37,152,000	33,842,880	3,309,120		456,658			37,152,000	34,299,538	49,606,349
216	Rezerva shtetërore	0	0	0					0	0	2,852,462
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0					0	0	0
218	Inventar ekonomik	162,605,035	81,650,080	80,954,955	190,092	23,025,864	8,366		162,786,761	104,675,944	0
24	Aktive te Qend.te trupëzuara te dëmtuara	0	0	0					0	0	58,110,817
28	Caktime		0	0					0	0	0
	<b>TOTALI (I + II)</b>	<b>1,141,567,889</b>	<b>149,844,696</b>	<b>991,723,193</b>	<b>190,092</b>	<b>95,210,834</b>	<b>15,566</b>	<b>0</b>	<b>1,141,742,415</b>	<b>245,055,530</b>	<b>0</b>
											<b>896,686,885</b>

Kontrolle		Për Tepricën Ne Fillim te periudhës	Për Tepricën Ne Fund te periudhës
	<b>Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen</b>		
<b>Kontroll 1.</b>	Llogaria 20 e F7/a, a është e barabarte me Llog.20 ne F7/b	0	0
<b>Kontroll 2.</b>	Llogaria 21- 28 e F7/ a, a është e barabarte me Llog.21-28, ne F7/b	0	0
<b>Kontroll 3.</b>	Llogaria 20 e Pasqyrës F7/b, a është e barabarte me Llog.20 te Pasqyrën F1	0	0
<b>Kontroll 4.</b>	Llogarite 21 .28 te Pasqyrës F7/b, a janë te barabarte me Llogarite21 - 28 te Pasqyrës F1	0	0

**NUMRI I PUNONJSEVE DHE FONDI I PAGAVE**

**Formati nr.8**

NE / LEKE

Nr.	K A T E G O R I T E	Numri mesatar vjetor punonjësve gjithsej	NUMRI I PUNONJSEVE Ndryshuar gjate vitit			FONDI I PAGAVE DHE KONTRIBUTET					
			Pranuar te rinj	Larguar	Gjendje fund te vitit ushtrimor	Fondi pagave gjithsej	Shpërblime suplementare	Ndihma shoqërore te menjehershme	Kontributi sig. shoq. dhe shendetesore	Shpërblime te tjera	Tatimi mbi te ardhurat
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
	<b>Nr.i punonjësve gjithsej ( 1+2+3+4+5)</b>	194	16	15	196	296,715,948		1,133,200	76,932,040		24,685,289
<b>1</b>	<b>D r e j t u e s</b>	20	1	3	18	42,810,264			67,714,355		4,422,772
<b>2</b>	<b>Spec. arsim te larte</b>	163	16	12	167	244,258,936		1,103,200	6,982,927		19,748,565
<b>3</b>	<b>T e k n i k e</b>	3			3	4,667,015			1,116,840		289,790
<b>4</b>	<b>Nëpunës te thjeshte</b>										
<b>5</b>	<b>Punëtorë</b>	8			8	4,979,733		30,000	1,117,918		224,162
<b>6</b>	<b>Punonjës te përkohshëm</b>										

**SHPJEGIME :**

Nr. mesatar i punonjësve (mujo) llogaritet duke vene ne raport shumen e numrit te punonjësve për te gjitha ditët e muajit me ditët kalendarike te muajit.

Numri mesatar vjetor është shuma e mesatareve mujore pjesëtuar me 12.

Kolona 5 përmban : Pagën baze për punën e kryer, shtesat e pagës për vjetërsi ne pune, për vështirësi, funksion ,grada shkencore etj.

Kolona 6 përmban : Shpërblimet suplementare për rezultate te mira ne pune e tjera.

Kolona 7 përmban : Ndhimat qe jepen me raste fatkeqësish, lindje e tjera.




Kolona 8 përmban : Kontributin e sigurimeve shoqërore qe derdhet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi ne llogarinë e sigurimeve shoqërore.

Kolona 9 përmban : Shpërblimet e ndryshme qe institucioni mund tu japë punonjësve te vet.

Kolona 10 përmban : Kontributin e derdhur nga punëmarrësi për tatimin mbi te ardhurat

## A.7 Korrespondenca KLSH - Institucione kushtetuese mbi përzgjedhjen e Kryetarit të ri të KLSH.

1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
KRYETARI

Nr. 486 Prot. Tiranë, më 20/04 2018

**V E N D I M**  
Nr. 27, Datë 20/04 2018  
**PËR MIRATIMIN E**  
**“KODI ETIK I KRYETARIT DHE DREJTUESVE TË LARTË**  
**TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”**

Bazuar në nenet 162/1, 163 dhe 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika “a”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “ Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, sidomos në Standardin ISSAI 30 “Kodi i Etikës” dhe në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit-Të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, me qëllim plotësimin integral të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit,

**VENDOSA:**

Miratimin e Kodit Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si përmbledhje e tre dokumenteve kryesore:  
Kodit të Etikës së KLSH;  
Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë dhe  
Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t, në veçanti ISSAI 30 “Kodi i Etikës” i INTOSAI-t.

**Neni 1**

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si trupa drejtuese e institucionit që duhet të përcjellë vlerat më të larta dhe të realizojë misionin e kësaj strukture kushtetuese, miratohet dhe hyn në veprim me synim forcimin e mëtejshëm të integritetit dhe transparencës së institucionit suprem të auditimit, i cili drejton nëpërmjet shembullit, mbi bazën e parimit ndërkombëtar “tone at the top(përgjegjësia në rradhë të parë tek drejtuesit)”. Ai mbështetet në tre dokumente kryesore:

- (i) në Kodin e Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 56 datë 30.04.2015,
- (ii) në Kodin e Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61, datë 05.04.2018 dhe
- (iii) në Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t.

**Neni 2**

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së është plotësim integral i Kodit Etik

1

të institucionit, Kreu "Dispozita të Përgjithshme", Neni 4, pika 4.3.

### Neni 3

Kryetari i KLSH-së, Sekretari/Drejtorët e Përgjithshëm, Drejtorët e Departamenteve/Drejtorive dhe Kryeaudituesit njohin dhe zbatojnë pa asnjë kusht, me rigozitet dhe përpikmëri Kodin e Sjelljes së Deputetëve, miratuar me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61 datë 05.04.2018 "Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë", punuar me ekspertë të OSBE-së, si një ndër standardet më të larta në vend dhe etalon të sjelljes etike të një nëpunësi të Shtetit, zbatimi i të cilit i mundëson institucionit dhe ekipit drejtues të tij një imunitet të fortë ndaj konfliktit të interesit dhe sjelljeve në dëm të interesave të qytetarit.

### Neni 4

Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të çënojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaroi publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe, katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adresoi zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t'u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke jua bërë me dije edhe Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit,.

### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së lexohet dhe zbatohet integralisht në të tre Dokumentet e cituara në Nenin 1 dhe në këtë Vendim.

**KRYETAR**  
  
**Bujar LESKAJ**  




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Nr. 481/ Prot.

Tiranë, më 23/4/2018

VENDIM

Nr. 28, Datë 23/4/2018

PËR NJË SHITESË NË

“KODI ETIK I KRYETARIT DHE DREJTUESVE TË LARTË  
TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”

Bazuar në nenet 162/1, 163 dhe 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika “a”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “ Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, sidomos në Standardin ISSAI 30 “Kodi i Etikës” dhe në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe Përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit-Të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, me qëllim plotësimin integral të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VENDOSA:

Në Kodin Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, në Nenin 4 shtohet një paragraf me përmbajtjen:

Pas përfundimit të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për një periudhë prej 4 muajsh nga data e përfundimit të mandatit, Kryetari që dorëzon detyrën nuk merret me aktivitet aktiv politik.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
K R Y E T A R I

Nr. 1007 Prot.

Tiranë, më 02/9 /2018

**Lënda:** *Njoftim për përfundim të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe për respektim të Kodit Etik të Kryetarit të KLSH-së*

**Drejtuar:** **Shkëlqesisë së Tij, z. Ilir META**  
**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**TIRANË**

Ju bëj me dije se me Dekret të Presidentit të Republikës me nr. 7163 dt. 17 nëntor 2011 për propozim-Kuvendit dhe me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë me nr. 143 datë 15.12.2011 jam emëruar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit për një mandat shtatëvjeçar, mandat i cili më përfundon më datë 23.12.2018.

Ju falënderoj për mirëkuptimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin e çmuar që institucioni i Presidentit të Republikës dhe Ju personalisht i keni dhënë Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Kryetarit të tij.

Në bazë të Kodit të Etikës së INTOSAI-t, ISSAI 30, të Kodit të Etikës së KLSH dhe të Kodit Etik të Kryetarit, miratuar me Vendimin Nr. 27, datë 20 prill 2018, ku Neni 4 cilëson se "Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të çënojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaron publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe, katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t'u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit", Ju konfirmoj vullnetin tim për të mos rikandiduar, edhe nëse Ju, i nderuar President, do të kishit një mendim ndryshe.

Duke vlerësuar maksimalisht investimin Tuaj afatgjatë në përparimin e qëndrueshëm të vendit tonë drejt familjes së madhe Evropiane, Ju sjell në vëmendje domosdoshmërinë e përsheptimit të përzgjedhjes së një kandidature për Kryetar të KLSH, e cila jam i bindur se do të jetë sa më pranë interesave të realizimit me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të auditimeve të fondeve dhe aseteve publike, i aftë të garantojë vijimin e reformimit të plotë të institucionit të KLSH, të nisur dhe thelluar gjatë mandatit fund i dhjetorit 2011 e deri më sot, si një veprim në dobi të lartë të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, në përputhje të plotë me standardet ISSAI dhe me prishmëritë e Kuvendit dhe të qytetarëve, i cili/e cila të fillojë punë më datë 23.12.2018.

**K R Y E T A R**

**Bujar LESKAJ**



Adresa: Rruga "Abdi Toptani" nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485 E-mail: [bleskaj@klsb.org.al](mailto:bleskaj@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Nr. 1007/1 Prot.

Tiranë, më 02/9 /2018

**Lënda:** *Njoftim për përfundim të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe për respektim të Kodit Etik të Kryetarit të KLSH-së*

**Drejtuar:** **Z. Gramoz RUÇI**  
**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

**TIRANË**

Ju bëj me dije se me Dekret të Presidentit të Republikës me nr. 7163 dt. 17 nëntor 2011 për propozim Kuvendit dhe me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë me nr. 143 datë 15.12.2011 jam emëruar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit për një mandat shtatëvjeçar, mandat i cili më përfundon më datë 23.12.2018.

Me shkresë me nr. 1007 datë 2 shtator 2018, i kam bërë me dije Presidentit të Republikës përfundimin e ardhshëm të mandatit dhe respektimin e Kodit të Etikës së INTOSAI-t, ISSAI 30, të Kodit të Etikës së KLSH dhe të Kodit Etik të Kryetarit, miratuar me Vendimin Nr. 27, datë 20 prill 2018, ku Neni 4 cilëson se "*Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të çënojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaron publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe, katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t'u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit*", duke i konfirmuar vullnetin tim për të mos rikandiduar, edhe nëse Presidenti do të kishte një mendim ndryshe.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin që Ju personalisht dhe Kuvendi keni treguar për Kontrollin e Lartë të Shtetit, shpreh bindjen se përsheptimi i përzgjedhjes së një kandidature për Kryetar të KLSH, do të mundësojë realizimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të auditimeve të fondeve dhe aseteve publike, duke garantuar vijimin e reformimit të plotë të institucionit të KLSH, të nisur dhe thelluar gjatë mandatit fund i dhjetorit 2011 e deri më sot, si një veprim në dobi të lartë të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian, në përputhje me standardet ISSAI dhe me pritshmëritë e Kuvendit dhe të qytetarëve, Kryetar i ri, i cili/e cila të fillojë detyrën më datë 23.12.2018.

**KRYETAR**

**Bujar LESKAJ**

Adresa: Rruga Abdi Toptani nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485 E-mail: [bleskaj@klish.org.al](mailto:bleskaj@klish.org.al); Web-site: [www.klish.org.al](http://www.klish.org.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Nr. 1007 Prot.

Tiranë, më 09 /2018

**Lënda:** 2 Njoftim për përfundim të mandatit si Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe për respektim të Kodit Etik të Kryetarit të KLSH-së

**Drejtuar:** **Z. ERION BRAÇE**  
**KRYETAR**  
**KOMISIONI PËR EKONOMINË DHE FINANCAT**

**TIRANË**

Ju bëj me dije se me Dekret të Presidentit të Republikës me nr. 7163 dt. 17 nëntor 2011 për propozim Kuvendit dhe me Vendim të Kuvendit të Shqipërisë me nr. 143 datë 15.12.2011 jam emëruar Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit për një mandat shtatëvjeçar, mandat i cili më përfundon më datë 23.12.2018.

Me shkresë me nr. 1007 datë 2 shtator 2018, i kam bërë me dije Presidentit të Republikës përfundimin e ardhshëm të mandatit dhe respektimin e Kodit të Etikës së INTOSAI-t, ISSAI 30, të Kodit të Etikës së KLSH dhe të Kodit Etik të Kryetarit, miratuar me Vendimin Nr. 27, datë 20 prill 2018, ku Neni 4 cilëson se “Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të çënojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaron publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe, katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t’u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit”, duke i konfirmuar vullnetin tim për të mos rikandiduar, edhe nëse Presidenti do të kishte një mendim ndryshe.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin, mbështetjen dhe bashkëpunimin që Ju personalisht dhe Komisioni që drejtoni keni treguar për Kontrollin e Lartë të Shtetit, shpreh bindjen se përsheptimi i përzgjedhjes së një kandidature për Kryetar të KLSH, do të mundësojë realizimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet të auditimeve të fondeve dhe aseteve publike, duke garantuar vijimin e reformimit të plotë të institucionit të KLSH, të nisur dhe thelluar gjatë mandatit fund i dhjetorit 2011 e deri më sot, si një veprim në dobi të lartë të integritit të vendit në Bashkimin Evropian, në përputhje me standardet ISSAI dhe me pritshmëritë e Kuvendit dhe të qytetarëve, Kryetar i ri, i cili/e cila të fillojë detyrën më datë 23.12.2018.

**KRYETAR**  
**Bujar LESKAJ**

Adresa: Rruga Abdi Toptani nr. 1, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485 E-mail: [bleskaj@klsb.org.al](mailto:bleskaj@klsb.org.al); Web-site: [www.klsb.org.al](http://www.klsb.org.al)

4

**PRONONCIM I KRYETARIT TË KLSH-SË PËR PËRFUNDIMIN E MANDATIT TË TIJ  
NË DHJETOR TË VITIT 2018**

Me Vendimin Nr. 27, datë 20 prill 2018, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka miratuar Kodin Etik të Kryetarit të KLSH-së, në të cilin, në Nenin 4 cilësohet se *“Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të çënojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaroi publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe, katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t’u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit”*.

Me shkresë nr. 1007, datë 2 shtator 2018, Kryetari i KLSH i ka bërë me dije Presidentit të Republikës vullnetin e tij për të mos rikandiduar për një mandat të dytë, në respekt të Kodit të Etikës së Kryetarit të KLSH-së të miratuar me Vendimin Nr. 27, datë 20 prill 2018.

Po më datë 2 shtator 2018, me shkesat zyrtare përkatëse, Kryetari i KLSH i ka bërë me dije të njëjtin vullnet mos-rikandidimi të tij për një mandat të dytë z. Gramoz Ruçi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë dhe z. Erjon Braçe, Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Në këto shkresa, Kryetari i KLSH ka shprehur bindjen se përshpejtimi i përzgjedhjes së një kandidature për Kryetar të KLSH-së dhe të Kryetarit të ri brenda dhjetorit 2018, kohë kur mbaron mandati i tij, do të mundësojë realizimin me efektivitet, eficiencë dhe ekonomicitet të auditimeve të përdorimit të fondeve dhe aseteve publike, duke garantuar vijimin e reformimit të plotë të institucionit të KLSH, të nisur dhe thelluar gjatë mandatit të tij që nga fundi i dhjetorit 2011 e deri më sot, në dobi të modernizimit të institucionit, në përputhje me standardet ISSAI të INTOSAI-t dhe me pritshmëritë e Kuvendit dhe të qytetarëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Adresa "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 62/50 Prot.

Tiranë, më 22.12.2018

VENDIM

Nr. 244, datë 22.12.2018

PËR

"DELEGIM KOMPETENCE"

Bazuar në:

- nenin 162/2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se "*Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit "qëndron në detyrë për 7 vjet, më të drejtë rizgjedhjeje"*";
- nenin 25, germa "e", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", mbi kompetencën e Kryetarit "*për të përcaktuar strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- nenin 23, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", që përcakton se "*Mandati i Kryetarit të KLSH-së mbaron kur: a) mbaron afati shtatëvjeçar i qëndrimit në detyrë*";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, Udhëzuesit e aplikueshëm dhe praktikat më të mira bashkëkohore që i kontribuojnë mbrojtjes së paanshmërisë, objektivitetit, neutralitetit politik dhe besueshmërisë së institucionit suprem të auditimit (ISSAI 30);
- Ligjin nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë";

- Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 27, datë 20.04.2018, "Për miratimin e Kodit Etik të Kryetarit dhe drejtuesve të lartë të KLSH",
- Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 238, datë 21.12.2018, "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 4, datë 27.01.2017, "Për Strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar",

### VENDOSA:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit tek Zëvendës/Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.
2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga Zëvendës/Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm znj. Lindita Lati (Milo) nga data e botimit në fletoren zyrtare deri në paraqitjen në detyrë të Kryetarit të ri të KLSH-së.
3. Vendimi do përcillet në fletoren zyrtare, pasi Kryetari i KLSH-së të kontaktojë dhe të marrë mirëkuptimin e Presidentin të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarëve të Grupeve Parlamentare të Opozitës dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.
4. Kryetari i KLSH-së i kërkon Kryetarit të Kuvendit që Konferenca e Kryetarëve të njihet me këtë vendim.
5. Vendimi përcillet në fletoren zyrtare në ditët e para të janarit dhe hyn në fuqi pas botimit në të.

**Bujar LESKAJ**

**KRYETAR**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Nr. 1454 prot.

Tiranë, më 31.12.2018

**Lënda:** Falenderim për mbështetjen institucionale dhe informacion mbi përfundimin e mandatit të Kryetarit të KLSH-së.

**Drejtuar:** SHTZ. Ilir META  
PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**TIRANË**

Paraprakisht, më lejoni t'Ju falenderoj për mirëkuptimin, bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme institucionale që Ju i keni dhënë Kontrollit të Lartë të Shtetit si President i Republikës dhe më parë si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, duke ndihmuar me efektivitet të lartë në përmbushjen nga institucioni të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, si dhe të kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, ISSAI-ve, si dhe, në cilësinë e Kryetarit të KLSH-së, në aspektin institucional dhe personal t'Ju shpreh mirënjohjen dhe vleresimin maksimal për mbështetjen personale.

Ju sjell në vëmendje se, bazuar në nenin 162/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që përcakton se Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit qëndron në detyrë për 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje", si dhe në nenin 23, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se "Mandati i Kryetarit të KLSH-së mbaron kur: a) mbaron afati shtatëvjeçar i qëndrimit në detyrë", mandati im si Kryetar i KLSH-së, sikurse jeni në dijeni, ka filluar më 23 Dhjetor 2011 dhe ka mbaruar në datën 23 Dhjetor 2018.

Duke ju referuar bazës ligjore si më sipër, Kodit të Etikës së Kryetarit të KLSH-së dhe drejtuesve të Lartë të KLSH-së, miratuar me Vendim të Kryetarit nr. 27 dt. 20.04.2018, si dhe bazuar në nenin 25, germa "e", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", mbi kompetencën e Kryetarit "për të përcaktuar strukturën, organikën dhe emërtimin e funksioneve të Kontrollit të Lartë të Shtetit", si dhe bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, udhëzuesit e aplikueshëm dhe praktikat më të mira bashkëkohore që i kontribuojnë mbrojtjes së paanshmërisë, objektivitetit, neutralitetit politik dhe besueshmërisë së institucionit suprem të auditimit (ISSAI 30), në Ligjin nr. 44/2015, datë 30.4.2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe në Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 238, datë 21.12.2018, "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Vendimin e Kryetarit të KLSH

nr. 4, datë 27.01.2017, "Për Strukturën e renditjes së punëve, klasifikimin e vendeve të punës dhe nivelin e pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar", Ju bëj me dije se me Vendimin e Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 244, datë 22.12.2018 kam deleguar kompetencat tek Zëvendës Kryetari i KLSH-së.

Në këtë Vendim përcaktohet delegimi i kompetencave të titullarit të institucionit tek Zëvendës/Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe se kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga Zëvendës/Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm Zj. Lindita Lati (Milo) nga data e botimit në fletoren zyrtare deri në paraqitjen në detyrë të Kryetarit të ri të KLSH-së.

Zj. Lindita Milo (Lati), Drejtore e Përgjithshme në Kontrollin e Lartë të Shtetit ka përfunduar studimet universitare në profilin Financë- kontabilitet, mban titullin shkencor "Profesor" si dhe gradën shkencore "Doktor" në Kontabilitet (1996) nga Universiteti i Tiranës dhe Ph.D. në Ekonomiks (2001) nga "Staffordshire University", Britani e Madhe. Në vitet 2006-2016 ka qenë Kryetare e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës, që nga viti 1990 e vijim Lektore pranë Departamentit të Kontabilitet, Fakulteti Ekonomik, Universiteti i Tiranës. 2004-2010 anëtare e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, Bashkëpunëtoare e Jashtme e IEKA që në vitet e para të themelimit të profesionit të auditimit të jashtëm. Autore e teksteve, monografi, artikuj dhe punime të tjera shkencore në fushën e kontabilitetit, konkurrencës, auditimit, etj.

Me bindjen se ky vendim do të përbëjë një vlerë të shtuar për performancën e institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me lejon t'Ju shpreh edhe një herë falenderimet për bashkëpunimin dhe mbështetjen e veçantë që i keni dhënë institucionit të KLSH-së dhe Kryetarit të tij në vitet 2012-2018.

**Bujar LESKAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Adresa Abdi Toptani", nr.1, Tiranë

E-mail: klsh.org.al; web-site: www.klsh.org.al

Nr. 347 Prot.  
/1

Tiranë, më 21/05 2019

VENDIM

Nr. 1, Datë 21/05/2019  
MBI

SHFUQIZIMIN E KOMPETENCAVE TË DELEGUARA ME  
VENDIMIN NR. 244, DATË 22.12.2018, "PËR DELEGIM  
KOMPETENCE TË KRYETARIT TË KLSH-SË"

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit":

- Neni 24, pika 1 "Vazhdimësia pas përfundimit të mandatit" të Kryetarit të KLSH-së;
- Neni 25, "Përgjegjësitë e Kryetarit", gërmat "f" dhe "i";
- Neni 19, "Zgjedhja dhe qëndrimi në detyrë", pika 1;

Në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe konkretisht:

- Neni 164, pika 1, sipas së cilës: "KLSH paraqet në Kuvend Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit";
- Pas kërkesës për tërheqje nga kompetencat e deleguara të zv. Kryetares, znj. Lindita Milo për arsye personale, dt. 21.05.2019, nr. 347, dhe garantimit të vijueshmërisë normale të punës;
- Në kushtet e zgjatjes në kohë të nominimit dhe përzgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH-së, sipas përcaktimeve të Ligjit 154/2014:

VENDOSA:

1. Shfuqizimin e kompetencave të deleguara me vendimin e Kryetarit nr. 244, datë 22.12.2018 zv/Kryetarit të KLSH-së znj. Lindita Lati (Milo).
2. Ky vendim do i përcillet Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarit të opozitës.
3. Vendimi hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

KRYETAR

Bujar LESKAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
KRYETARI

Nr. 871 Prot.

Tiranë, më 20 /10/2019

Lënda: *Mbi domosdoshmërinë e përzgjedhjes së Kryetarit të ri të Kontrollit të Lartë të Shtetit*

Drejtuar: **Z. Ilir META**  
**PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**Z. Gramoz RUÇI**  
**KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**TIRANË**

Duke vlerësuar, me respekt dhe mirënjohje të thellë mirëkuptimin Tuaj dhe bashkëpunimin e vyer të ofruar nga Ju për Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe mua personalisht në cilësinë e Kryetarit të KLSH, si dhe mbështetjen Tuaj të plotë institucionale dhe personale, si dy nga institucionet më të larta, Presidenca dhe Kuvendi i Shqipërisë, dhe veçanërisht Ju dy drejtuesit, Presidenti dhe Kryetari i Kuvendit ndaj institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, së pari, më lejoni të shpreh dëshirën institucionale dhe personale që Presidenca dhe Kuvendi i Shqipërisë të mund të gjejnë harmoninë dhe rrugën e bashkëpunimit efektiv, për të mirën e Shqipërisë, popullit shqiptar, institucioneve publike e më gjerë.

Një harmoni dhe bashkëveprim i tillë do të zgjidhte edhe situatën e KLSH sot, pasi institucioni ndodhet në muajin e dhjetë të funksionimit pa një Kryetar të ri, të mandatuar sipas përcaktimeve në Kushtetutë (mandati im ka mbaruar në fund të dhjetorit 2018).

Sjell në vëmendjen Tuaj se institucioni i KLSH, si një strukturë kushtetuese monokratike e Shtetit, e ka domosdoshmëri drejtimin nga titullari me një mandat të plotë kushtetues, sipas Nenit 162, Pika 2 të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

Në cilësinë e Kryetarit në detyrë, deri më tani kam garantuar vijueshmërinë normale dhe ligjore të punës si dhe së fundmi, paraqitëm në Kuvend Raportin për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin paraardhës (detyrim ky kushtetues), duke i hapur rrugën dhe mundësuar miratimin e Ligjit për Buxhetin e Shtetit për vitin 2020.

Pavarësisht ushtrimit të kompetencave të mia ligjore si Kryetar në detyrë (procesi i delegimit të kompetencave për periudhën janar-prill 2019 nuk rezultoi i suksesshëm), çdo ditë që kalon, për shkak të mungesës së drejtuesit të ri të zgjedhur nga prerogativat kushtetuese, sjell për

pasojë dobësimin e pozitës institucionale kushtetuese të KLSH, me efekt uljen e forcës dhe nivelit të zbatimit të rekomandimeve të institucionit.

Një statukuo e tillë institucionale cënon imazhin e pavarësisë, integritetit dhe profesionalizmit të KLSH, të fituar me mund gjatë tetë viteve të fundit, duke zbatuar me rigorozitet kërkesat e standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI-ve, si dhe dobëson procesin e mbajtjes së përgjegjshme të administratës shtetërore, nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve të institucionit.

Sikurse jeni në dijeni, mandati im shtatëvjeçar ka mbaruar dhe, në bazë të Kodit të Etikës së Kryetarit të KLSH dhe të praktikave më të mira të institucioneve supreme të zhvilluara të auditimit, kam shprehur që në prill 2018 vullnetin dhe vendimin tim për të mos rikandiduar, përmes miratimit të Kodit Etik të Kryetarit, çka Jua kam njoftuar zyrtarisht në shtator 2018. Këtij vendimi i qëndroj pa asnjë mëdyshje edhe sot, në respekt të standardeve të larta, të integritetit dhe pavarësisë së KLSH, çka konfirmon bindjen time profesionale dhe personale se institucioni e ka të nevojshëm një mandat të vetëm, dhe jo ripërsëritje të tij nga i njëjti drejtues.

Në këto kushte, për të garantuar zbatimin e plotë të rolit dhe misionit kushtetues të institucionit të KLSH, në emër të të gjithë trupës audituese të KLSH, në respektin më të lartë për Ju personalisht, do të vlerësonim maksimalisht shtimin e përpjekjeve Tuaja në vijimësi, nëpërmjet koordinimit, bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes dy institucioneve më të larta të Shtetit, Presidencës së Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë, në dobi të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për zgjedhjen sa më shpejt të Kryetarit të ri të KLSH.

Me besim në mbështetjen Tuaj, si gjithnjë të vyer dhe të plotë, si dhe në vijimin e bashkëpunimit të frytshëm të institucioneve të Presidencës së Republikës dhe Kuvendit të Shqipërisë, si dhe Tuajin personalisht, si dy drejtuesit më të lartë të Shtetit me institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si dhe me urimet më të mira për Kryetarin e ri të KLSH, që Ju do ta përzgjidhni në respekt dhe detyrim të Kushtetutës.

**KRYETAR**

Bujar LESKAJ

## **PRONONCIM I KRYETARIT TE KLSH-SË NE ANALIZËN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2019 KRYER NË DATAT 28-29 SHKURT 2020**

*Duhet theksuar se viti 2019, është karakterizuar nga një dukuri, veçori juridike dhe kushtetuese që është jashtë atributëve, jurisprudencës, kontrollit dhe influencës menaxheriale të këtij institucioni, (e pa ndeshur më parë në gjithë historikun e këtij institucioni të pavarur), dhe e kushtëzuar nga mosarritja e një emëruesi të përbashkët të hallkave dhe autoriteteve më të larta shtetërore për dekretimin dhe miratimin e Kryetarit të Ri të KLSH përgjatë vitit 2019.*

*Kjo situatë, dashur - pa dashur, ka influencuar në mënyrë indirekte e në një farë mase, impaktin dhe rezultatet e institucionit në vitin e kaluar dhe në vijimësi.*

*Kjo situatë e drejtimit të KLSH-së me qëndrimin në detyrë deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri, në përputhje me kërkesat e nenit 24 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, në një farë mënyre e ndikon vijueshmërinë normale institucionale.*

*Në këto kushte, në emër të gjithë audituesve të KLSH u bëj thirrje Presidentit të Republikës dhe maxhorancës qeverisëse që të përshpejtojnë proceset e zgjedhjes së Kryetarit të ri të KLSH, duke shprehur vullnetin tim për sigurimin e vazhdimësisë deri në ardhjen e titullarit të ri të institucionit, referuar kuadrit ligjor aktual.*

*Në lidhje me sa sipër, unë si Kryetar i KLSH-së edhe sot kam një qëndrim të pandryshuar, të shprehur edhe në Kodin Etik të Kryetarit të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 27, datë 20.4.2018, adresuar zyrtarisht Presidentit të Republikës përmes kërkesës time për mos rikandidim për tu ri zgjedhur në postin e Kryetarit të KLSH-së, për të cilën kam bërë me dije dhe autoritetet e larta shtetërore përfshirë Kuvendin e Shqipërisë.*

